



Mahathir Mohamad

Sfida





Mahathir Mohamad



Sfida



E përktheu nga anglishtja:
Brikena Qafa-Osmani


Titulli i originalit:


Mahathir Mohamad, The Challenge,
7th printing, Pelanduk Publications,
Selangor Darul Ehsan, Malaysia, 2002.

Mahathir Mohamad



Sfida





© LOGOS - A
2 0 0 6



S H K U P
P R I S H T I N Ě
T I R A N Ě

Përmbajtja:

Dy fjalë për botimin shqip	9
Rruga e Mahatir Mohamadit: Nga sfida deri te triumfi	11
Hyrja	15
Kapitulli I	17
Polemikat	19
Kapitulli II	25
Të varfrit më të varfër dhe të pasurit më të pasur	27
Kapitulli III	49
“Dilema” e edukimit	51
Kapitulli IV	89
Perëndimi dhe Lindja	91
Kapitulli V	111
Materializmi dhe spiritualizmi	113
Kapitulli VI	149
Malajzianët dhe influenca komuniste	151
Kapitulli VII	161
Sistemi i vlerave dhe malajasit	163
Kapitulli VIII	185
Shpirtërorja dhe sfida moderne	187
Kapitulli IX	205
Grupet presioniste në demokraci	207
Kapitulli X	215
Shtetëzimi i industrive të huaja	217
Kapitulli XI	231
Organizimi dhe disiplina	233

Kapitulli XII	249
Korrupsioni	251
Kapitulli XIII	275
<i>Quo Vadis</i> Malajzia (Për ku është duke shkuar Malajzia).....	277
Treguesi i emrave:	288

Dy fjalë për botimin shqip

Në këtë parathënie dua t'i falënderohem znj. Brikena Qafa-Osmani për përkthimin e librit tim *Sfida* në gjuhën shqipe, ndërsa Dr. Mesut Idrizit po ashtu t'i falënderohem për ndihmën e dhënë për botimin e tij.

Sfida u është dedikuar malajëve të Malajzisë. Ata janë muslimanë, por në një mënyrë ata ngecin pas kinezëve dhe hindusëve në Malajzinë shumë racore. Dallimi në të arriturat materiale dhe statusin e tyre krijon probleme për vendin i cili dëshiron që secili qytetar t'i shijojë frytet e pavarësisë së barabartë.

Për t'u ndihmuar malajëve që t'i arrijnë racat e tjera, Qeveria ka ndërmarrë disa veprime të dukshme. Por, për ta arritur këtë, malajët duhet të bëjnë orvatje të posaçme që ashtu t'i përmirësojnë kapacitetet e tyre.

Unë besoj se suksesi i secilës racë varet nga sistemi i vlerave në të cilin besojnë dhe të cilin e praktikojnë ata. Njerëzit që kanë besim në punët e zellshme, orvatjet e qëndrueshme për ta përmirësuar vetveten dhe që kanë besim në rëndësinë e përvetësimit të diturisë dhe shkathësisë, gjithnjë do të kenë sukses. Ndërkaq, njerëzit që nuk do të orvaten, të cilët dëshirojnë të mbështeten vetëm nga të tjerët, do të dështojnë.

Për këtë arsye e kam cituar ajetin 39-40 të sures kur'anore Nexhm ku thuhet: "*Njeriu nuk do të ketë asgjë, përpos asaj për të cilën është orvatur ...*"

Unë mendoj se edhe komunitetet e tjera muslimane gjithashtu duhet të ballafaqohen me sfidat. Muslimani i vërtetë patjetër duhet të orvatet t'i tejkalojë këto sfida dhe këtë ta bëjë me urtësi.

Shpresoj që ky libër të mund të ndihmojë sadopak në tejkalimin e sfidave me të cilat ballafaqohen vëllezërit muslimanë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e gjetiu.

Dr. Mahathir Bin Mohamad
nëntor, 2005

Rruga e Mahatir Mohamadit: Nga sfida deri te triumfi

Botuesi tashmë i njohur “Logos-A” nga Shkupi bëri hap të jashtëzakonshëm kur vendosi që opinionit tonë t’ia paraqesë *Sfidën* e prijësit disavjeçar të mrekullisë ekonomike, politike dhe kulturore të quajtur Malajzi dhe njërin nga figurat më markante të politikës botërore në shekullin XX.

Tashmë është i njohur edhe vlerësimi funksional sipas të cilit njerëzit qëndrojnë në krye të shtetit dhe ndahen në politikanë dhe burrështetas. Sipas kësaj ndarje, politikanët janë ata që mund t’i zgjidhin problemet e atypëratyshme, por që nuk kanë kapacitet vizionar. Thënë ndryshe, fuqia e tyre arrin që shoqërisë t’ia sigurojë atë nga e cila *jetohet*, por jo edhe atë *për çka* jetohet. Pikërisht për shkak të fuqisë për ta formuluar identitetin, ardhmërinë e qartë dhe vizionin afatgjatë, burrështetasit janë një lloj i super-politikanëve, forma më e përkryer pse ata janë të suksesshëm në të dyja fushat.

Është e qartë se nuk janë të shumtë ata që në historinë botërore i përmbushin kriteret për burrështetas, edhe pse as politikanë të mëdhenj nuk ka pasur. I matur dhe me standarde më të larta, Mahathir Mohamad, është një burrështetas i madh dhe sigurisht lideri më i suksesshëm politik i shekullit XX.

Edhe titulli i këtij libri asocon dhe na orienton drejt karakterit të situatës në të cilën është gjetur Malajzia para më pak se 50 vjetëve. Nëse kihet parasysh se vepra është shkruar dhe është botuar për herë të parë në vitin 1986 (përkthimi është bërë sipas botimit të 7-të të vitit 2002), kjo do të thotë se ajo i referohet të kaluarës së afërt ndërmjet më së shumti një gjeneratë.

Ajo situatë jashtëzakonisht e vështirë dhe e rëndë ka qenë sfida. Por, çfarë sfide? Gjykuar objektivisht, asnjë shtet bashkëkohor, madje ndoshta asnjë shtet në tërë historinë botërore, nuk ka bërë ngritje më spektakulare politike, ekonomike dhe kulturore si Malajzia. Banorët e saj autoktonë, bartës të pavarësisë së posaarritur, malajët, për shkak të popullimit sistematik të kinezëve dhe hindusëve gjatë decenieve të tëra të mundësuar nga britanezët, ishin vënë në rolin e pakicës demografike; praktikisht merrnin pjesë me 0 % në pasurinë nacionale, ishin analfabetë, të shtypur në xhungël, të aftë vetëm për detyra manuale, pra ata ishin faktor plotësisht të marginalizuar në aspekt politik dhe ekonomik. Të gjitha vlerësimet ishin se shteti i ri jo vetëm që do të ballafaqohet me sfida, porse nuk do të mund t'i shmanget as luftës së përgjakshme racore, religjioze, kulturore dhe etnike.

Në kundërshtim me të gjitha parashikimet reale dhe objektivisht më bazë të fuqishme, ky i vend i fragmentuar, Malajzia, dikur një vemëz famullie e udhëhequr prej së largu dhe me metodat e refleksit elementar të kushtëzuar, u transformua në flutur impulsive, vitale dhe të bukur, e cila jo vetëm që di të fluturojë me krahët e saj, por ka edhe qëllim të qartë kah fluturon dhe fuqi të saj të brendshme për të arritur atje.

Libri është shkruar nga njeriu që është më meritor për këtë ngjarje mahnitëse dhe të vetme, nga ai që e kthen besimin si në politikë, ashtu edhe në aftësinë nje-

rëzve që janë të vendosur të bashkohen për të mirën e përgjithshme. Në 13-të kapitujt e tij është kondensuar kjo epope transformuese, e paraqitur në 13 sfida, të pranuar me guxim, të vlerësuara me pjekuri dhe të fituara me sukses. Në këtë kuptim ky libër në mënyrë analitike, maksimalisht me nderë dhe jashtëzakonisht në mënyrë inteligjente e ndjek rrugën e sfidës së madhe me të cilën u ballafaqua Malajzia deri te triumfi më i madh që e arriti sot.

“Successful stories” (Rrëfimet e suksesshme) janë shumë të rralla në jetë, edhe pse janë aq shumë nevojshme. Shpeshherë njeriu patjetër duhet t’i imagjinojë ato. Rrëfimi i treguar në këtë libër i referohet një suksesi të madh dhe, aq më tepër, në të asnjë detaj nuk është i imagjinuar. Nuk kishte nevojë të imagjinohet: ajo me realitetin e saj, e tejkalon dhe imagjinatën e guximshme!

Ideja themelore e burrështetasit Mahathir Mohamad është se veprimi i drejtë është pasojë e mendimit të drejtë, ndërsa mendimi i drejtë është i mundur vetëm nëse kuptohen saktë fjalët në të cilat janë përfshirë konceptet qytetëruese dhe humaniste me interpretimin e të cilave ndërtohet fati i një shteti. Në rastin e Malajzisë, më të përdorura dhe më me ndikim ishin konceptet liri, barazi, demokraci, socializëm, komunizëm, materializëm, shekullarizim, jetë shpirtërore e të tjera, siç thotë autori: “Kërkesa reale që e përmbajnë këto fjalë dhe marrja e vendimeve relevante të bazuara në atë vlerësim, të çliruara nga iluzionet, shtrembërimet dhe interpretimet e gabuara, paraqet sfida para së cilës qëndron bota bashkëkohore, e në veçanti komuniteti malajas në Malajzi”.

Në raport me disputin e madh të çastit aktual botëror rreth karakterit të Islamit, si dhe aftësisë dhe mundësisë së tij që të përshtatet ndaj kërkesave të botës bashkëkohore, ky libër gjithashtu ka rëndësi të madhe. Mosnjohja e spiritualizmit të vërtetë dhe gabimi që bën mos

të vërehet dallimi ndërmjet materializmit dhe angazhimit të shëndoshë në gjërat laike dhe në jetë, ka kontribuar në thyerjen e stereotipit negativ i cili besimtarët muslimanë i nxitin t'ia kthejnë shpinën asaj bote.

Pa dyshim, mund të thuhet se ky është vetëm edhe një libër. Por, libër që është shkruar edhe si doracak arsimor me bazë precize enciklopedike, si program aktivistik i orientuar kah progresi dhe si vepër vizionare, si studim analitik inteligjent dhe si rrëfim maksimalisht i ndershëm i njeriut që e ka bërë mrekullinë e mundur të quajtur Malajzi. Për dallim nga numri më i madh i librave të çmuara dhe të vlefshme, pas secilës fjalë të këtij libri qëndron realiteti i fuqishëm dhe e vërteta e rezultateve të jashtëzakonshme.

Libri ka rëndësi të madhe, politikisht është në kulmin e aktualitetit, paraqet burim të çmuar të studimeve krahasimtare, e duke e pasur parasysh ngjashmërinë e caktuar ndërmjet skenës sociale dhe politike malaje dhe maqedonase multietnike dhe multikulturore, pa dyshim është shumë i nevojshëm edhe si lektyrë e detyrueshme e studimeve në të gjitha universiteteve tona.

Ferid Muhiq

Hyrja

Fjalët janë për të komunikuar, por shumë shpesh ato keqpërdoren gjatë komunikimit duke sjellë pështjellim dhe kaos. Dhe ky fenomen mund të them se ndodh më shumë me fjalët si, liri, barazi, demokraci, socializëm, komunizëm, materializëm, shekullarizëm, spiritualitet dhe shumë të tjera.

Që të gjesh të vërtetën pas këtyre fjalëve dhe të bësh diskutimin e posaçëm, të pa turbulluar nga iluzionet, shtrembërimet, apo keqinterpretimet është një sfidë duke marrë në ballafaqim në përgjithësi botën moderne, dhe komunitetin malajzian të Malajzisë në veçanti.

Malajzianët kanë dalë nga një periudhë e gjatë prapambetjeje duke u tërhequr në drejtime të ndryshme nga forca kontradiktore, disa nga të cilat kërkojnë ta shkatërronjë çfarëdo lloj progresi të bërë dhe ta zhysin të gjithë vendin përsëri në Vitet e Territ.

Dhe kohët e fundit një nga ironitë më të dhimbshme, është se besimi islam, besimi që i bëri një herë e një kohë ithtarët e kësaj feje të fuqishëm dhe përparimtarë, të përdoret ose të promovohet, për të sjellë shkuarje mbrapa dhe prapambetje. Kjo forcë iluministe është kthyer në një arsye të mendjeve të cekëta, ky inspirim për unitet është kthyer në një instrument për ndarje dhe shkatërrim.

Injoranca që përbën një pjesë të këtij grupi të besimtarëve dhe mangësia e tyre për të parë dallimin në mes të materializmit dhe inkuadrimit të shëndoshë të kërkesave

shoqërore, bënë që disa nga pjesëtarët e komunitetit Malajzian (musliman), të mendojnë që besimi islam i nxit besimtarët e vet t'ia kthejnë kurrizin kësaj bote.

Në të njëjtën kohë, ndarje të tjera të komunitetit malajzian (musliman), janë çoroditur nga përpjekjet e bëra prej disave për të barazuar besimin islam me socializmin, duke përdorur paqartësinë e fjalëve si drejtësi, barazi dhe vëllazërim.

Në këtë libër jam munduar të bëj të qartë keqkuptimet e kësaj forme duke sjellë si evidencë dy burimet e pranuar në studimet e besimit islam që janë *delil akli* dhe *delil nakli* d.m.th argumentet racionale dhe ekstraktet nga Kur'ani (Libri i Shenjtë në Islam) dhe hadithi (traditat e Profetit Muhammed, s.a.v.s.).

Për këtë të fundit jam konsultuar me përkthimet dhe interpretimet e autorizuara duke pasur mbështetjen dhe ndihmën e ekspertëve në këtë fushë.

Keqinterpretimi i fesë islame është një nga format e shumta të çoroditjes që i kanoset komunitetit Malajzian (musliman) sot. Thirrja është shumë e qartë:

Të bëjmë të pamundurën për mbijetesë.



Kapitulli I

Polemikat

Polemikat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të traditës malajziane. Gjithmonë në debatet e hapura jo vetëm që ideja e propozuar do të mbetet e pa mbështetur, por gjithashtu edhe opinionet e sjella nga kritikët do të debatohen akoma më thellë dhe më së fundi do të lihen zvarrë.

Dhe meqë asnjë nga idetë nuk pranohet atëherë si rezultat asnjëra prej tyre nuk do të ndiqet apo të vihet në zbatim. Kështu që situata (status quo) është përjetuar gjithmonë..." Megjithëse është e qartë se ideja e dhënë nuk është perfekte ajo duhet të ndryshohet." Dhe më e keqja vazhdon, opinionet konfliktuese që shprehen gjatë debatit do të shtojnë më shumë paqartësinë në shoqëri. Dhe mbi studimet e bëra mbi kritikën dhe polemikat është gjendur se ato jo vetëm që janë të pafrytshme, por gjithmonë ato kanë shtuar edhe vështirësi në sfidat e marra nga shoqëria malajziane në veçanti.

Dhe përgjatë gjithë historisë malajziane, mësojmë se shumë nga idetë konstruktive kanë pasur të njëjtin fat. Çdo herë kur një ide është sjellë për diskutim të gjitha energjitë dhe mendimet janë përdorur jo për të bërë të mundur aplikimin e saj, por në të kundërtën janë hapur debate në kundërshtim të saj. Zakoni i hyrjes nëpër polemika është bërë një pjesë e jetës malajziane sa që mund të themi se ka edhe nga ata që shkruajnë libra të tërë me të vetmen arsye, për të hapur seri polemikash.

Mbas gjithë këtij nocioni mendohet se polemikat do të ndihmojnë në mprehtësinë e mendjes dhe se gjithashtu ajo është një ushtrim i mirë intelektual. Por lind pyetja: A duhet malajzianët të humbasin kohën në këto ushtrime intelektuale? A nuk do të ishte më e rëndësishme për ta, të punojnë për të sipërmarrë problemet e shumta që i konfrontojnë?

Gjithashtu me mirësjellje kërkojmë të shpjegohemi se artikujt pasardhës nuk janë parashtruar për të sjellë seri të tjera polemikash. Ato shprehin thjeshtë idetë e shkrimtarit me të vetmen arsye për të arritur ndryshime në mënyrën e të vepruarit duke konsideruar si të rëndësishëm ballafaqimin me vetë sfidat e kësaj kohe në të cilën jetojmë. Lexuesit sipas dëshirës se tyre mund t'i pranojnë apo t'i hedhin poshtë këto ide, por më e rëndësishmja do të ishte që mos ti shqyrtojnë me shumë hollësi me qëllim që të gjejnë të metat apo gabimet në to, që fare lehtë mund të gjenden në qoftë se çdonjëri prej jush do të ulet me bindje për ti gjetur ato, dhe të pranojë prej këtyre ideve ato që janë më të pranueshme.

Dhe në qoftë se të paktën vetëm njëra prej ideve të shumta të dhëna në këtë libër do të pranohet nga një lexues i vetëm mund të themi me plot bindje se e kemi arritur qëllimin e vënë.

Një qëndrim i padëshiruar është ai i pritjes për palën tjetër për të hedhur hapin e parë. Dhe kjo më së miri mund të themi është e ilustruar në rastet e marrjes së drogës midis të rinjve në shoqërinë malajziane (muslimane).

Kur marrja e drogës midis të rinjve ishte në fillimet e saj një nga liderët e të rinjve tha: Në qoftë se krahasojmë numrin e të rriturve dhe të liderëve që janë duke konsumuar alkoolin çfarë është numri i të rinjve që konsumojnë drogë? Kjo deklaratë është përkrahur me je-

honë të madhe nga disa personalitete prominente duke përfshirë këtu edhe “ekspertë” të fesë islame (ulema).

Është e vërtetë se pirja e alkoolit është gabim, është e ndaluar dhe nuk duhet të praktikohet. Por a mund ta lejojmë që praktikimi i këtyre njerëzve të lëshojë shkëndijë për të tjerët për të konsumuar drogë?

E liga është një e ligë, dhe ajo duhet të eliminohet sepse është e ligë. Në qoftë se një e ligë duhet të eliminohet pasi të eliminohen të ligat e tjera, atëherë cila e ligë duhet eliminuar e para!? Kështu që, në qoftë se, një palë do të presë për palën tjetër të marrë hapin e parë, asnjëra prej tyre nuk do të guxojë ta hedhë këtë hap, dhe e keqja midis tyre do të vazhdojë të ekzistojë.

Pra deklarata e dhënë nga një lider i të rinjve do të nënkuptonte që të rinjtë që konsumojnë drogë nuk duhen fajësuar përderisa të rriturit do të vazhdonin të pinin alkoolin. Dhe përderisa lënia e alkoolit ndër të rriturit është një mundësi mjaft e vogël, atëherë edhe konsumimet e drogës do të vazhdojnë..., por a është e gjithë kjo çfarë ne dëshirojmë? I harruam ne ato kohë kur numri i të rriturve që konsumonin pije alkoolike ishte mjaft i madh dhe numri i të rinjve të përfshirë në konsumimin e drogës ishte shumë i vogël. Të rinjtë e viteve 50-ta nuk ishin të përfshirë në konsumimin e drogës edhe pse një numër i të rriturve ishin të dhënë pas alkoolit. Pra është ky lloj i të menduarit që inkurajon dekadencën morale.

Artikujt që vijojnë më pas, përmbajnë një numër pikëpamjesh, mendimesh dhe sugjerimesh. Dhe lexuesi ndoshta gjen ndonjë prej tyre si ide të pranueshme, por në qoftë se atij do t'i duhet të presë për të tjerët që t'i pranojnë dhe t'i praktikojnë këto ide përpara tij, atëherë pajtueshmëria e këtij lexuesi me këto artikuj nuk do të ishte gjë tjetër veçse një hedhje poshtë e këtyre ideve. Dhe qëllimi i këtij libri mund të themi se nuk është arritur.

Ky libër është shkruar me një qëllim të caktuar. Hang Tua¹ ka thënë se Kombi Malajzian nuk do të shuhet asnjëherë nga faqja e dheut. Dhe kjo thënie nuk do të thotë të përdoret si jehonë vetëm nëpër poema apo ligjërata, por në të kundërtën ajo riprezanton një shpresë. Por nëse kjo shpresë e Hang Tuasë, do të bëhet një realitet apo do të mbetet vetëm si e tillë kjo varet e gjitha të vetë malajzianët si komb.

Fare mirë mund të themi se qëllimi i këtij libri është që të analizojë dhe të verifikojë apo qartësojë pse gjërat po ndodhin, duke sjellë si shembull: që të shërosh një sëmundje sa më mirë, diagnoza e saktë, është hapi i parë që duhet ndërmarrë për ta shëruar. Dhe vetëm atëherë shpresa e Hang Tuasë, nuk do të mbetet vetëm si një shpresë.

Historia e çdo vendi apo populli ka pjesë të errëta dhe të ndriçuara. Asnjë komb nuk mbetet gjithmonë pas dhe asnjë komb nuk ka shkuar gjithmonë përpara. Perandori të tëra si ajo Greke, Romake, Persiane, Sri Vijaya, Malakës dhe e Britanisë kanë kaluar nëpër të njëjtat faza. Njëherë e një kohë ato ishin aq të avancuara dhe të fuqishme saqë ishte e pamundur të mendohej që ato do të binin ndonjëherë. Por të gjitha këto ranë dhe u shkatërruan. Studimet e kryera tregojnë se çarku i rënies-progresivitetit dhe rënies se një shteti ka një lidhje të drejtpërdrejtë me sistemin e vlerave të vetë atij kombi. Kur zellshmëria, efikasiteti, aftësia, ndershmëria, disiplina dhe vlera të tjera të mira praktikohen dhe shihen më nga afër patjetër që progresiviteti i një vendi do të arrihet. Por kur këto vlera janë të një standardi mjaft të ulët ose mbahen shumë lart, por nuk zbatohen, pa diskutim që ai komb do të shkojë gjithmonë pas.

¹ Një nga figurat e njohura malajziane.

Në këtë kohë që jemi sot vetë malajzianët i vlerësojnë shumë këto cilësi të larta, por secili prej tyre shpreson që dikush tjetër do të marrë iniciativën i pari dhe t'i zbatojë. Sot disa malajzianë e shikojnë zellin për punë si diçka të dëshirueshme dhe të dobishme, por vetë nuk janë aspak të zellshëm, ndërsa në të njëjtën kohë disa të tjerë i bëjnë objekte talljesh ata që janë të zellshëm në studime dhe që mundohen të arrijnë majat e suksesit. Ky është një fakt dhe derisa këta njerëz nuk janë në gjendje që ta pranojnë këtë fakt ata do të jenë akoma në këtë gjendje të mjerueshme. Fati është në duart e tyre. Ndoshta faji qëndron me të tjerët, por malajzianët duhet vetë të vendosin për fatin e tyre.

Zoti nuk e ndryshon fatin e asnjë kombi në qoftë se ai komb nuk përpiqet që të përmirësohet vetë. Dhe që të përmirësosh gjërat që janë shumë të rëndësishme për një komb nuk do të thotë të sjellësh polemika për të diskutuar, por të pranosh çfarë është e pranueshme dhe t'i vësh ato në zbatim. Në qoftë se ndonjë prej artikujve që vijojnë ka ndonjë ide me vlerë mundohuni t'i implementoni dhe të tjerat mundet fare lehtë t'i harroni.

Kapitulli II

Të varfrit më të varfër dhe të pasurit më të pasur

Kohët e fundit ideologjia dhe logjika materialiste e kanë influencuar shumë shpejt njerëzimin. Por e gjithë kjo mund të themi është si rezultat direkt i impaktit të mendimit dhe të sistemit të vlerave të vetë Perëndimit, i cili në mënyrë fanatike e vë më shumë në qendër se materialja, është baza e jetës. Vlerat e bazuara në spiritualen, qetësinë shpirtërore nuk kanë asnjë vend apo vlerë në psikologjinë perëndimore.

Midis vetë muslimanëve malajzianë dhe pikërisht ata me origjinë malaje, vlerat materialiste perëndimore janë përhapur shumë dhe kanë zënë rrënjë të thella. Vetë njerëzit që bëjnë thirrje për spiritualen duke hedhur poshtë materialen më së fundi përdorin kriterin material për të matur vlerat spirituale d.m.th vlerave materiale u jepet rëndësi në punët spirituale ose për aktivitetet me elementet shpirtërore.

Në një shoqëri ku materializmi nuk konsiderohet si shumë i rëndësishëm është për t'u habitur që vlerat materiale përdoren për të kontrolluar lëvizjet dhe aktivitetet e kësaj shoqërie.

Në të kundërtën në një shoqëri materialiste, e shikojnë pozitën apo pasurinë si diçka shumë fundamentale, apo bazike që ndikon në lumturinë apo fatkeqësinë e njeriut. Dhe sipas tyre sa më i pasur është një njeri, aq

më i lumtur është ai, dhe në të kundërtën mospasja e një burimi parash apo një pasurie do të thotë shkatërrim, degradim dhe vuajtje.

Duke u bazuar në konceptet dhe vlerat materialiste një slogan është nxjerrë në mënyrë që të influencojë mendjet dhe zemrat e njerëzve. Dhe kjo është: “Të varfërit janë më të varfër, dhe të pasurit më të pasur.” E krijuar nga socialistët e Perëndimit ky slogan është përhapur dhe ka infektuar pothuajse të gjithë botën. Dhe midis komuniteteve të zëna nën influencën e këtij slogani mund të themi se janë edhe malajët e Malajzisë.

Ideologjia komuniste gjithashtu është e përfshirë nga pyetjet për pasuri dhe varfërim. Feja, e cila i jep rëndësi spirituale, për mendjet e infektuara nga ideologjia materialiste siç janë komunistët është quajtur “opium”. Dhe e gjithë kjo ndodh sepse feja i jep një rëndësi më të madhe spirituale në krahasim me materializmin, si një burim për lumturinë dhe qetësimin e shpirtit. Pra spiritualiteti apo shpirtërorja ndihmojnë mendjet e besimtarëve të çlirohen nga mania për pasuri, e cila është ajo më kryesorja për psikologjinë komuniste. Pra meqë feja sjell qetësinë shpirtërore nëpërmjet spiritualitetit atëherë, kjo do të bëjë të mundur eliminimin sado pak të konfliktit midis të varfërit dhe të pasurit. Dhe komunistët e krahasojnë këtë qetësi, të sjellë nga feja si faza pas marrjes së opiumit. Ata nuk e durojnë dot këtë qetësi shpirtërore të njerëzve që ndikon në mënyrë të ndërsjellët në shtypjen dhe nënshtrimin, të cilat janë mjaft të rëndësishme për çështjen e tyre.

Por komunizmi me kundërshtimin e tij të hapur kundër fesë dhe Zotit, nuk mundet të propagandohet lehtë midis besimtarëve të çdo feje në përgjithësi dhe midis besimtarëve muslimanë në veçanti. Me gjithë përpjekjet e shumta të komunistëve duke u munduar të tre-

gojnë se Islami dhe komunizmi në të vërtetë nuk janë në asnjë konflikt, muslimanët e kanë mjaft të qartë dhe vazhdojnë gjithmonë ta kundërshtojnë komunizmin si ideologji dhe si sistem politik.

Por e njëjta gjë nuk mund të thuhet për socializmin, pasi socializmi ka raste kur ai është i pajtueshëm me fenë, duke përfshirë edhe fenë islame. Besimi në vëllazërimin dhe në barazinë e njeriut, që është një nga elementet thelbësore të fesë islame, mund ta gjejmë edhe në socializëm, por koncepti socialist i vëllazërimit dhe barazimit kanë për bazë materializmin dhe nuk i japin fare rëndësi spirituales. Dhe këtu qëndron edhe ndryshimi i madh midis socializmit dhe pikëpamjes islame.

Ideologjia socialiste nuk është aspak e kënaqur me konceptin se të gjithë njerëzit kanë lindur njëloj. Ata insistojnë në ekzistencën e veçorive materiale përpara ekzistencës së gjykimit. Dhe pasi barazimi material është objektivi i socialistëve ata gjithmonë krahasojnë pasurinë e zotëruar nga pjesë të ndryshme të shoqërisë. Dhe sa herë që ata bëjnë këto krahasime ata do të ndeshen me jobalancimet dhe diferencat që padyshim, ekzistojnë në shoqërinë njerëzore. Pra shoqëria socialiste është gjithmonë e zënë me konfiskimin dhe shpërndarjen e pasurisë.

Socialistët vetë besojnë në shtetëzimin si një mënyrë për të barazuar pasurinë. Dhe kjo vjen për arsye të mendimit se shtetëzimi i industrive e komerces, do të rrisë të ardhurat e punëtorëve meqenëse shteti luan rolin e një punëdhënësi që nuk do ta mbajë të gjithë profitin për vete. Gjithashtu mendohet se edhe hendeku midis të ardhurave të larta dhe të ardhurave shumë të ulëta të punëtorëve do të zvogëlohet, madje do të eliminohet tërësisht.

Për këtë mund të themi se është vetëm një mit, për arsye se kur qeveria merr përfitimet nga një industri e veçantë ajo nuk mund ta ndajë profitin vetëm ndërmjet

punëtorëve të asaj industrie, sepse shteti dhe qeveria janë përgjegjës për të gjithë klasën punëtore, në të vërtetë për të gjithë popullin. Kështu që në qoftë se të ardhurat do të jenë njëlloj të gjitha, në shoqërinë socialiste atëherë profitet e një industrie duhet të llogariten me humbjet e industrive të tjera të shtetit dhe pasi do të mbli-dhen me të ardhurat e bizneseve të tjera, vetëm atëherë do të bëhet e mundur ndarja e fitimit.

Fatkeqësisht punëtorët e industrisë me përfitim nuk janë të kënaqur të lënë profitet e arritura prej tyre të merren nga shteti dhe të bëhen pjesë e të ardhurave të shtetit. Kjo sipas tyre do të ishte njëlloj si taksat e vëna në të ardhurat apo në fitim në punësimin privat ashtu si në sistemet e mëparshme. Ata dëshirojnë që profitin e marrë ta kenë për vetë dhe jo ta ndajnë me punëtorët e industrive të tjera apo pjesa tjetër të kthehet tek shteti.

Nga ana tjetër punëtorët në industritë shtetërore, të cilat kanë pasur humbje kërkojnë nga shteti si punëdhënës, të mbulojë këto humbje me të ardhurat nga burimet e tjera. Meqenëse, të gjitha industritë janë shtetëzuar, taksat e të ardhurave në kompani janë hequr dhe që të mbulojnë humbjet në një industri qeveria duhet të mbledhë profitet e marra nga industria tjetër, punëtorët e së cilës nuk do të ishin aspak të kënaqur me këtë marrëveshje.

Dhe kur ky problem shfaqet, është një sfidë për administratën shtetërore, ndërsa pyetja e pabarazisë në të ardhura vazhdon të jetë një kërcënim për shtetin socialist së bashku me vlerat e tij materialiste. Punëtorët duan të gjithë rroga të barabarta ose përafërsisht të barabarta, fatkeqësisht kjo nuk mund të bëhet pasi edhe funksionet apo përgjegjësitë që ata kanë në punë nuk mund të jenë të barabarta. Ndërkohë që punëtorët në rangjet e ulëta kërkojnë të ulin ose të eliminojnë ndryshimin midis klasës se tyre dhe rangjeve më të larta, njerëzit e klasave më

të larta kërkojnë që të vendosen në pozita apo poste të rëndësishme. Por në qoftë se shteti do të bënte të mundur ekualizimin apo barazinë në paga apo të ardhurat, atëherë klasat e larta do të humbin interesin për punë, dhe në anën tjetër, përderisa të ekzistojë pabarazia në të ardhurat, punëtorët me të ardhurat më të vogla do të jenë gjithmonë të zhgënjyer dhe do të mbeten një kërcënim për stabilitetin e gjendjes në vend.

Administrata kërkon fonde për zhvillimin e vendit. Rritja dhe barazia e të ardhurave të njerëzve nuk do të mund të arrihej pa pasur edhe ndihma të tjera. Kështu që në qoftë se të gjitha industritë janë pronë shtetërore, atëherë administrata e shtetit duhet të rregullojë të gjitha të tjerat si: rrugët, strehimin, shkollat, spitalet, ujin, energjinë dhe plot të tjera gjëra të nevojshme të jetesës së përditshme dhe të gjitha këto duhet të financohen nga profitet e marra nga industritë shtetërore. Por këto profite kërkojnë jo vetëm nga punëtorët e industrive të ndryshme profitative, por edhe nga punëtorët e industrive që dalin me humbje. Atëherë në qoftë se administrata do të varej vetëm në këto profite që të financonte lehtësimet e tjera për popullin, punëtorët nuk do të mund të ndanin këto profite midis tyre që të marrin diçka më shumë si rezultat i punës që ata kanë kryer. Pra është qeveria (administrata) që duhet të marrë një pjesë të mirë të këtyre të ardhurave për të financuar shërbimet e tjera.

Duke u ballafaquar me problemet e financimit të shërbimeve publike, qeveria është e detyruar të marrë taksa nga të ardhurat e popullit në mënyra të ndryshme. Ne shoqërinë socialiste megjithëse punëtorët kanë një të ardhur të lartë, pothuajse të gjithë ata duke përfshirë këtu edhe punëtorët me rroga të ulëta duhet të paguajnë taksa për të ardhurat. Por kjo do të ulte të ardhurat e tyre dhe ato do të jenë gjithmonë të pamjaftueshme. Në

disa vende socialiste të ardhurat e punëtorit pas pagesës së taksave janë më të ulëta se të ardhurat e një të papuni me ndihmë sociale. Dhe si rezultat shumë dëshirojnë të jenë të papunësuar, gjë që do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Përveç problemeve dhe dështimeve të shtetit socialist për të arritur barazimin e të ardhurave të popullit, edhe dy tendenca shumë të rëndësishme ekzistojnë në shoqërinë socialiste.

Një, vlerat materialiste pothuajse kontrollojnë tërësisht mendjet e njerëzve dhe influencojnë çdo lëvizje të bërë nga shoqëria apo individi. Dhe tjetra vlerë si spiritualiteti është plotësisht e shkatërruar nga devocioni i madh për materialen.

Dy, drejtimi drejt ideologjisë komuniste është më i lehtë dhe më i qartë.

Në një shoqëri që është e influencuar nga socializmi, kriteret materialiste kontrollojnë gjithçka. Ato përdoren në çdo kohë dhe në çdo fushë, dhe çështja e pasurisë dhe e varfërimit është në fokus të interesit të përherëshëm. Këtu pasuria kërkohet nga të gjithë, por edhe kur disa munden të arrijnë të fitojnë diçka në krahasim me ata që janë më të pasur, ky fitim i arritur prej tyre do të ishte shumë i vogël (dhe është ironike se, asnjëherë nuk bëhet krahasimi me ata që janë më të varfër) dhe kjo gjithmonë do të sjellë ndjenja pakënaqësie. Dhe që ky krahasim të mbahet gjithmonë në qendër të vëmendjes sloganet si “të varfrit më të varfër dhe të pasurit më të pasur” sillen gjithmonë në skenë. Në këtë mënyrë komuniteti nuk do të ndihet asnjëherë i kënaqur. Këto kritere janë gjithmonë të urryera dhe të tmerrshme pasi janë direkt të lidhura me lumturinë apo mizërinë e vetë njerëzve. Sepse në sytë e një shoqërie materialiste me të ardhurat e larta do të thotë lumturi dhe me të ardhurat e vogla

nënkuptohet mizëri dhe varfëri. Ose me fjalë të tjera mund ta themi se lumturia apo mizëria e njeriut janë të bazuara dhe varen nga pasuria dhe të ardhurat e tij.

Prandaj, liderët që janë të influencuar nga socializmi janë të pakënaqur kur shikojnë grupet që edhe pse kanë të ardhura të pakta janë të gëzuara. Sa herë që ata shikojnë këtë gjë, do të sjellin krahasimin midis këtyre grupeve dhe njerëzve që kanë të ardhura më të larta. Dhe kur diferenca apo ndryshimi midis tyre fillon të ngushtohet ata menjëherë fillojnë të shikojnë në kriterin tjetër që tregon “të ardhurat e vërteta” janë duke u pakësuar. Çfarëdo arritje është arritur në nivelin e të ardhurave ata gjithmonë do të provojnë se “të varfrit më të varfër dhe të pasurit më të pasur”, dhe në këtë mënyrë ata do e ndryshojnë lumturinë e njerëzve në mizëri dhe gjithmonë do të sjellin pakënaqësi midis popullit.

Aktualisht, në vendet që janë duke u zhvilluar, dhe një ndër këto vende është edhe Malajzia, nuk është e lehtë të kesh situata me terma absolute kur një i varfër të jetë plotësisht i varfër. Të ardhurat e një njeriu të varfër nuk është e lehtë të bien me poshtë asaj që ai ka, por kjo mund të ndodhë vetëm në rastet kur ai pushon së punuari apo është i papunë për një kohë të gjatë. Të ardhurat e tij do të vijnë gjithmonë duke u rritur pa marrë parasysh se nga vjen, (rroga, prodhimet bujqësore, blegtoaria, apo profitet nga investime të ndryshme etj.) sepse vlera e burimeve të të ardhurave vjen gjithmonë duke u rritur. Por problemi qëndron se nevojat e tij janë më të shumta se sa ai ka të ardhurat. Për shembull, në qoftë se një fermer do të shkonte më parë në qytet një herë ose dy herë në muaj, tani që udhëtimi është më i lehtë dhe më i lirë ai do të shkojë një herë në javë. Në qoftë se një herë e një kohë ai ishte i kënaqur me një llambë me vajguri, tani ai dëshiron të këtë elektrifikim të

përgjithshëm dhe mjetet elektroshtëpiake. E gjitha kjo është e njohur si “revolucion i rritjes së kërkesës” dhe është e gjitha kjo që shumë shpesh bën që të ardhurat të mos jenë të mjaftueshme. Megjithatë, mund të themi se situata rëndohet akoma më shumë kur disa njerëz qëllimshëm sjellin në skenë ndryshimin midis arritjeve dhe atyre çfarë është pritur të bëhej. Dhe kur dëshirat e zemrës krahasohen me atë çfarë jemi në gjendje të plotësojmë atëherë çdo njeri prej nesh do të ishte i varfër. Por po të krahasojmë të ardhurat e mëparshme me ato që merren sot, mund të themi se edhe i varfëri është i pasur. Sigurisht kur bëhet krahasimi midis një të pasuri që gjatë këtij procesi është bërë më i pasur, mund të themi se i varfëri do të duket akoma më i varfër.

Dhe për ata që përdorin vetëm një anë të sëpatës, kanë dëshirë që gjithmonë të vënë në dukje varfërinë, sesa të flasin mbi pasurinë. Çfarë ata nuk kanë dëshirë të tregojnë është se gjithmonë në shoqërinë moderne të pasurit kanë për të paguar taksa më të larta për të ndihmuar dhe për të përkrahur të varfrit. Në qoftë se “të ardhurat e vërteta” pas pagimit të taksave do të krahasoheshin, atëherë diferencat midis të pasurve dhe të varfërve nuk do të ishin shumë të mëdha. Përveç kësaj, pa të pasurit, të varfrit do të bëheshin akoma më të varfër, pasi produktet dhe energjitë që ata do të shpenzonin në to, nuk do të gjenin një mjedis tregtar të mirë për t’i shitur.

Për të parë se si të pasurit shfrytëzohen nga shoqëria në mënyrë që të ndihmojnë të varfrit le të bëjmë një analizë të vogël të një njeriu më të ardhura vjetore gjysmë milioni ringitë. Taksa për të ardhurat që është vendosur është më shumë se 40%, dhe duke bërë një llogari të përafërt ai ka për të paguar rreth 150.000 ringitë taksë prej të ardhurave.

Nga ajo që i mbetet 350.000 ringitë, atij ndoshta i duhet të paguajë shoferin, kopshtarin, shërbëtorin, kuzhinierin dhe ndihmësit e tjerë. Kjo tregon se nga ana tjetër të ardhurat e një njeriu të pasur gjithmonë do të sjellin edhe shanse për të punësuar shumë që mund të jenë të papunë.

Me atë çka i mbetet ai do t'i përdorë për nevojat dhe lukset që i duhen për çdo muaj, dhe mund të themi se të gjitha nevojat e tij janë nën taksat shtetërore, pasi taksat më të larta janë në lukset, të cilat kërkohen më shumë nga të pasurit. Pra edhe harxhimet e tyre në nevojat dhe lukset do të thotë një e ardhur nga taksat për shtetin, profit për shitësin (profit ky, që do ti merret taksa më vonë nga shteti) dhe mundësi më shumë, për shumë njerëz të punojnë në këto dyqane dhe në industritë ku përfshihet prodhimi dhe shpërndarja e gjërave që blihen nga të pasurit.

Le të themi se pasi ai ka blerë çdo gjë që ai dëshiron, një i pasur ka akoma një pjesë të të ardhurave, si do të jetë efekti i kësaj pjese të të ardhurave në shoqëri? Në qoftë se ai i mban këto në bankë, përveç rritjes së përqindjes së huadhënies, që jepet nga banka nga këto para, banka do të marrë taksën me interesin e vënë. Por në qoftë se ai do t'i investojë këto para në një industri, atëherë mundësitë për punësim, do të rriten duke ndihmuar të papunët dhe gjithashtu mbi profitin e marrë nga investimi do të ketë përsëri një taksë. Në qoftë se ai do të blejë një pronë, profiti i bërë nga shitësi i kësaj prone, përsëri do t'i vihet një taksë nga shteti. Edhe në qoftë se ai i ruan apo mban këto të ardhura në arkën e tij personale, një ditë ai do të vdesë dhe trashëgimtarët e tij duhet të paguajnë për shërbimet ditën e varrimit që pa dyshim do të jenë shpenzime nga kursimet e veta. Dhe sa herë që ata do të shpenzojnë diçka, shteti do të mbledhë tak-

sat, mundësi apo vende pune do të krijohen, biznesmenët do të marrin fitimet, dhe së fundi njerëzit do të kenë mundësi që të jetojnë më mirë.

Realiteti është se në një vend ku administrata vepron në mënyrë të pastër dhe me drejtësi dhe kur taksat janë vënë sipas nivelit të pasurisë, të pasurit janë gjithmonë të detyruar të ndihmojnë të varfrit direkt apo indirekt qoftë kjo ndihmë. Mundësitë e krijuara për punësim dhe profitet e marra nga biznesmenët, nga shpenzimet që bëjnë të pasurit sjellin një ndihmë direkte, taksat që ata paguajnë indirekt ndihmojnë klasën tjetër nëpërmjet lehtësimeve që ata krijojnë si spitalet, shkollat, rrugët dhe shërbimet e tjera të kryera nga qeveria.

Në Malajzi, prej popullsisë së 22.000.000 banorëve, vetëm 500.000 vetë (ose 1 në 12 të rritur) paguajnë taksën e të ardhurave, e cila llogaritet si totale rreth 2.500 milion dollarë për vit. Pra vetëm një pjesë shumë e vogël prej tyre paguajnë pasi rreth 2.500.000 punëtorë janë përjashtuar duke marrë parasysh se të ardhurat e tyre konsiderohen mjaft të ulëta. Në vendet me një udhëheqje socialiste siç është Anglia, të gjithë ata që janë të punësuar dhe kanë një rrogë fikse janë të detyruar të paguajnë një taksë për të ardhurat. Në këtë mënyrë pa dyshim shteti ka një të ardhur më të madhe, por punëtorët me rroga të ulëta janë gjithmonë nën presionin e taksave, dhe asnjëherë nuk mund të ndihen të qetë dhe të lirë. Gjithashtu ndryshimi midis tyre dhe grupeve me një të ardhur më të madhe nuk thellohet më shumë në qoftë se ata nuk do të kenë të paguajnë taksat.

Politika për të imponuar taksat në të ardhurat, vetëm për grupet me të ardhurat më të larta është mjaft e drejtë dhe e ndershme. Nëpërmjet kësaj politike ata që kanë mundësi për të arritur një pasuri janë të detyruar të kontribuojnë diçka nga rezultati i kësaj arritjeje edhe në

shoqëri, dhe në veçanti ata që janë më pak të zgjuar apo më me pak fat. Dhe si rrjedhim jo vetëm që ndryshimi midis të varfërve dhe të pasurve sa do të vijë dhe do të ngushtohet, por secili nga ne do të jetë në gjendje të gëzojë të mirat që sjell jeta në komunitet dhe produktet nga resorët, burimet natyrale, dhe arritjet njerëzore, d.m.th. të gjitha ato që na i dhuron i madhi Zot. Sa më shumë pasurohet një pjesë e shoqërisë, aq më të mëdha janë dobitë dhe përfitimet e pjesës tjetër të shoqërisë që janë më me pak fat.

Në qoftë se disa do të vijnë të deklarojnë se edhe ata gjithashtu janë të pasur, atëherë ata duhet të bëhen gati për të paguar taksat e vëna mbi të ardhurat. Kështu që, në qoftë se çdonjëri do të bëhej i pasur totalja nga taksat e shtetit do të rritej dhe gjithashtu shteti do të lehtësohej nga përgjegjësitë për të ndihmuar të varfrit.

Por fatkeqësisht në qoftë se të gjithë do të bëheshin të pasur asnjë nuk do të ishte i pasur në kuptimin e plotë të fjalës, kjo për të vetmen arsye se tregu i vlerave të punës do të rritej. Kështu që punëtorëve duhej t'u paguhej një rrogë më e madhe që të barazohen të ardhurat e tyre me ato të të pasurve, gjithashtu çmimet e produkteve do të rriten akoma shumë, të pasurit që i blejnë këto produkte do t'u duhet të paguajnë më shumë dhe ata nuk do të kenë më të ardhura për të blerë të tjera gjëra që u nevojiten. Por në qoftë se të pasurit nuk do të kenë për të blerë ato gjëra për të cilat ata kanë nevojë, atëherë ata nuk do të jenë më të pasur. Gjithashtu edhe punëtorëve që iu është paguar rrogë e madhe nuk do të jenë në gjendje të blejnë ato çfarë ata dëshirojnë për shkak të çmimeve shumë të larta të mallrave. Dhe në qoftë se asnjë nuk do të shpenzonte çfarë ata do të dëshironin atëherë fjala i pasur nuk do të kishte kuptim. Situata do të ishte një shtet në inflacion, me një të ardhur të lartë, por me

një fuqi blerëse të ulët për shkak të çmimeve të larta. Fakti është që në një vend me të ardhura të larta askush nuk është i pasur, në të vërtetë gjithkush është i varfër.

Insistimi nga ana e socialistëve dhe komunistëve për një barazi në pasuri është i bazuar në fantazitë e lindura mbi zilinë dhe smirën. Dhe rezultati i këtij eksperimenti është jo një pasuri e barabartë, por një varfëri e barabartë. Dhe më së miri ky realitet mund të gjendet në shtetet komuniste apo socialiste, ku punëtorët dhe sektorët e tjerë të shoqërisë janë të gjithë të varfër. Të pasurit janë ata që kanë propaganduar frymët ideologjike socialiste apo komuniste dhe tani janë bërë lider apo udhëheqës lokal, apo në mbarë vendin. Ata vetë jetojnë në komoditet të plotë, udhëtojnë aty këtu dhe arrijnë të plotësojnë të gjitha dëshirat e zemrës, në qoftë se jo plotësisht të paktën më shumë se nga një njeri i thjeshtë do të mendonte.

Varfëria dhe pasuria janë relative. Me pasuri do të nënkuptojmë më shumë pasuri dhe të ardhura se të tjerët. Ndryshimi midis dy grupeve (të pasur dhe të varfër) duhet të këtë ekzistuar përpara se të këtë qenë pasuria, por në qoftë se ky ndryshim do të ishte shumë i madh atëherë trazirat dhe shqetësimet që do të sillte do të bënin që shoqëria do të mendohej ta ngushtonte sa më shumë këtë ndryshim. Kështu që dy pikëpamjet kundërshtuese do ta ndikonin shoqërinë.

Njëra pikëpamje është se, pasuria e të pasurve, duhet të konfiskohet dhe t'u jepet të varfërve duke bërë kështu të mundur që ndryshimi midis klasave të zhduket. Dhe si rezultat i gjithë kësaj, të gjithë do të bëheshin të varfër, dhe sa herë kjo është provuar rrjedhimet do të ishin se njerëzit do të varfëroheshin dhe do të bëheshin skllëvër të shtetit apo qeverisë, duke shtuar këtu se edhe vetë vendi do të varfërohej pasi fuqia prodhuese është prekur.

Pikëpamja e dytë është se, pasuria e të pasurve nuk duhet të konfiskohet menjëherë, taksa të larta duhen vendosur mbi këtë pasuri. Dhe kjo nuk do të sillte ndonjë ndryshim në dëshirën e atyre për të punuar më shumë për të pasur më shumë pasuri dhe në të njëjtën kohë një pjesë e kësaj pasurie në mënyrë indirekte do t'i përkiste të varfërve, gjithmonë nëpërmjet taksave të vëna. Pra sa më të mëdha të jenë arritjet e tyre gjithashtu dhe pasuritë, aq më të mëdha do të jenë edhe përfitimet që do të këtë pjesa tjetër e popullsisë.

Kështu që meqenëse dëshira e madhe për të pasur pasuri nuk u shkatërrua ata që kanë mundësi për të akumuluar pasuri do të shfrytëzohen nga shoqëria. Ata do të ndërtojnë fabrika të mëdha për industri dhe për tregti të ndryshme, të cilat jo vetëm që do të rrisin të ardhurat nga taksat që shteti do të mbledhë, por gjithashtu ata do të krijojnë shumë vende pune ku u jepet mundësi të papunëve të përfitojnë nga ky rast për tu punësuar.

Kur dëshira dhe aftësia e të pasurve për t'u pasuruar shfrytëzohet në të njëjtën kohë duhet pasur parasysh që taksat të mbahen në atë nivel që mos t'ua vrasin entuziazmin për të bërë të pamundurën për të arritur akoma më shumë. Në Britani për shembull, ku taksat nga të ardhurat mund të shkojnë deri në 95%, dëshira për të pasur më shumë sa vjen dhe zvogëlohet, pasi ata punojnë më shumë dhe marrin shumë pak nga puna e vet duke u shfrytëzuar nga shteti, dhe ka nga ata të cilët përsëri duan të pasurohen dhe e mënjanojnë problemin e taksave duke emigruar në vende të tjera ku taksat janë më të vogla dhe profiti i tyre do të jetë më i madh.

Në këtë kontekst të pasurit mund të krahasohen me patën që bëri vezën e artë. Në qoftë se pata do të therej, vezët që do të kishte do të merreshin njëherë dhe kaq, por më me profit do të ishte të mbarështonim dhe të

merrnim vezë sa të mundeshim. Logjika e kësaj përralle është shumë e qartë, por kur vjen në praktikë, qeniet njerëzore janë të përfshira nga smira dhe zilia që kanë dhe asnjë gjë e logjikshme nuk do t'i ndalonte ta vrisnin patën e artë. Dhe kjo ndodh në besimin për konfiskimin e pasurisë dhe në praktikën e ideologjive socialiste dhe komuniste. Zilia për materialen nuk do të sjellë asnjëherë prosperitet, por do të çojë në skllavërimin e popullit nga vetë shteti.

Kjo është një gjë që ekziston në të gjitha vendet ku nuk ka të pasur. Në këto vende askush nuk paguhet mirë pavarësisht nga përpjekjet dhe puna e mirë që bëjnë. Kështu që kush do të bëjë i varfër. Dhe në vendet komuniste të gjithë bëhen skllav të shtetit, me një të ardhur dhe me një mënyrë jetese që nuk ka ndryshim nga ajo e skllavëve në kohët e lashta. Ndërsa në vendet socialiste megjithëse kërkesat për një page më të mirë i përafrohen kërkesave të kohës, njerëzit asnjëherë nuk do të ngrenë kryet prej varfërisë.

Dhe e gjitha kjo është si rezultat i efektit të një kontrolli të materialit në shoqërinë njerëzore. Çdo pjesëtar i kësaj shoqërie vazhdon të mundohet dhe sundohet nga urrejtja dhe zilia, si dhe brenda kësaj shoqërie nuk do të ketë asnjëherë harmoni dhe qetësi shpirtërore.

Vetëm një përpjekje e vogël do të mjaftonte t'i ngrinte njerëzit kundër atyre që e shkaktojnë këtë varfëri dhe njerëzit shumë lehtë do të rebelohen, dhe kjo është edhe objektivi i atyre që shpesh e përdorin sloganin "të varfrit më të varfër dhe të pasurit më të pasur". Ata që përdorin këto slogane nuk janë të interesuar që të rrisin mirëqenien e popullit, ata duan vetëm ta shfrytëzojnë popullin. A do të arrijnë sukses në kauzën e vet, rezultatet do të jenë ato që u përmenden pak më lartë, d.m.th.

një shoqëri materialiste në kallëpin socialist ose komunist e karakterizuar nga varfëria dhe skllavëria.

Socializmi e ngrre materializmin dhe e lidh me lumturinë dhe mizërinë njerëzore, dhe shoqëria, e cila pranon këto vlera do të jetë më afër ideologjisë komuniste që është akoma më e devotshme ndaj vlerave materialiste. Por, ndërsa socializmi lejon edhe besimin fetar apo ide të tjera, në komunizëm gjejmë vetëm vlera materialiste. Sipas komunistëve, lumturia e njeriut mund të vijë vetëm atëherë kur pasuria konfiskohet, bëhet pronë e shtetit apo e qeverisë në fuqi dhe ndahet në mënyrë të barabartë nga shteti në mesin e vetë popullit.

Duke parë se rruga socialiste nuk pati sukses (dhe nuk mund të ketë sukses) duke barazuar pronësinë midis individëve të shoqërisë shumë nga socialistët kthejnë sytë tek sistemi ideologjik komunist. Në ideologjinë komuniste individi nuk ekziston si individ, por si një pjesëtar i shoqërisë që është vetë shteti. Barazia do të arrihet vetëm atëherë kur të gjithë pjesëtarët e shoqërisë do të jenë skllavër të shtetit, pra në fjalë të tjera është një barazi midis skllavërve. Megjithëse ata punojnë dhe shërbejnë në fusha të ndryshme ajo që marrin do të jetë e njëjtë për të gjithë. Meqenëse shteti ka nevojë për një shumë të madhe të ardhurash për t'u përdorur për makinën administrative, për kënaqësitë dhe lukset, për armatën dhe mbrojtjen e vendit, ajo çka mbetet për të dhënë tek populli do të ishte shumë e vogël dhe asnjëherë nuk do të rritet. Pra popullit do t'i jepet një e ardhur sa për të mbijetuar.

Kështu që pasuria dhe pronësia janë të pakuptimta në shoqërinë komuniste pasi supozohet që të gjithë janë njëllor, askush nuk ka as më pak e as më shumë se tjetri. Në realitet të gjithë janë të varfër, pasi ata as nuk shqetësohen nga fakti se standardi i jetës është shumë i ulët. Për komunistët ajo çka është më e rëndësishme është

barazia e të ardhurave për të eliminuar smirën dhe zilinë midis njerëzve dhe kështu ata pretendojnë se shoqëria komuniste është në paqe dhe lumturi.

Por realiteti është ndryshe nga teoritë e tyre. Nuk ka asnjë shoqëri komuniste është më e lumtur dhe më e kënaqur se shoqëritë e tjera. Mënyra e jetesës si skllëvër të shtetit, që do të thotë skllëvër të pakicës në fuqi nuk mund të sjellë asnjëherë lumturinë, po kështu as qetësia shpirtërore nuk mund të vijë ashtu spontanisht. Rendi në një shtet komunist vjen nga sundimi absolut për të cilin ata përdorin policinë dhe ushtrinë për të shtypur çdo kryengritje të popullit.

Studimet e bëra mbi sistemin socialist dhe komunist kanë treguar se vetëm materializmi nuk mund të sjellë lumturinë e njeriut apo të shoqërisë. E drejta mbi një pronë mund në të vërtetë të sjellë një kënaqësi tek njeriu, por edhe kjo kur prona që ai ka është më shumë se ajo që kanë të tjerët. Prandaj kjo do të jetë e përkohshme, sepse krahasimi do të bëhet gjithmonë dhe ndonjëherë dikush mund të ketë më shumë, dhe kjo do të sjellë gjithmonë pakënaqësinë. Edhe pse komunistët apo socialistët do të mundohen të arrijnë sukses duke ua rritur pagat njerëzve, kënaqësia asnjëherë nuk do të arrihet. Dhe në qoftë se ata do të eliminonin ndryshimin në pagat apo në të ardhurat që asnjëherë nuk do të arrihet, ndjenja e xhelozisë do të vazhdojë të ekzistojë përsëri. Pra në fjalë të tjera mund të themi se një shoqëri që është plotësisht e dedikuar në materializëm nuk mund të arrijë asnjëherë lumturinë.

Meqenëse pronësia dhe pasuria nuk mund të kompletohet apo të dalin mbi vlerat e një shoqërie njerëzore, vlerave të tjera që nuk janë të bazuara në materializëm duhet t'u jepet një vend i veçantë. Për shembull vlerat spirituale mund të qëndrojnë presionit të botës materiale.

Shenjtorët fetarë për shembull që jetojnë nëpër male apo vende të shenjta mund ti kapërcejnë kufijtë e kërkesave materiale. Megjithatë, dedikimi i plotë në spiritualen nuk mund të praktikohet nga të gjithë pjesëtarët e shoqërisë, ashtu sikurse ngritja e vlerave materiale mbi ato të tjerat nuk mund të zgjidhë problemet e individëve në një shoqëri.

Shkaku është shumë i qartë. Në qoftë se të gjithë individët e një shoqërie do të harronin botën dhe do të shkonin të jetonin nëpër male duke bërë një jetë shenjtorë, jeta familjare nuk do të ekzistonte dhe njerëzimi do të zhdukej nga faqja e tokës vetëm me një gjeneratë.

Dhe kjo do të ishte shumë me keq se vetëvrasja, do të ishte në të vërtetë një formë gjenocidi. Por siç e dimë vetëvrasja është një nga aktet më të ndaluara në fenë islame, dhe gjenocidi është pothuajse i njëllojtë për të shkatërruar Islamin.

Në qoftë se disa pjesëtarë të shoqërisë do të bëheshin shenjtorë ndërkohë që të tjerët do t'i ndihmonin apo do t'i mbanin këta shenjtorë dhe vetveten, kjo do të thotë se aktivitetet materiale qenkan të rëndësishme edhe për një shenjtor. Do të ishte shumë e padrejtë në qoftë se ndonjë fe do t'u jepte 'merita' të shumta shenjtorëve kur fare mirë e dimë se aktivitetet e tyre spirituale varen nga aktivitetet materiale të të tjerëve. Pra është mjaft e qartë pse në fenë islame nuk ka shenjtorë.

Në realitet, do të ishte e pamundur në një shoqëri kur disa i kthejnë kurrizin botës dhe të tjerët ndihmojnë shoqërinë nëpërmjet punës së tyre materiale. Bota dhe jeta e njeriut është e mbushur plot me fatkeqësi dhe kërcënime.

Edhe në kohën e profetit Muhamed (a.s.) ata që ishin të patundur dhe besonin në vlerat spirituale u ndoqën dhe u kërcënuan me të gjitha mënyrat, dhe që të hiqnin vëmendjen e njerëzve, muslimanët e asaj kohe duke përfshirë edhe vetë Profetin, merreshin edhe me

aktivitete të tjera shoqërore. Fitimi dhe grumbullimi i pasurisë dhe pronave, perfeksionimi në artet marciale (luftarake), dhe organizimi i një administrate të rregullt ishin ndër aktivitetet e rëndësishme me të cilat muslimanët e asaj kohe merreshin, në mënyrë që të ishin më të fortë për të mbrojtur vlerat spirituale dhe fenë islame në veçanti. Është e rëndësishme të theksojmë se do të ishte e paarsyeshme sikur të supozonim se aktivitetet materiale mund të ndahen nga vlerat spirituale në një shoqëri njerëzore në kohët që jetojmë sot, kur një ndarje e tillë ishte e pamundur në kohën e Profetit.

Pra nga ky diskutim është mjaft e qartë se as vlerat spirituale dhe as ato materiale duke qenë në vetmi nuk mund të ushqejnë apo të sjellin lumturi në jetën e njerëzve. Që një shoqëri njerëzore e madhe apo e vogël qoftë të jetë sa më e kompletuar është e rëndësishme që të vendoset një balancë midis vlerave materiale dhe atyre spirituale. Por pyetja qëndron se si duhet të vendoset balanca midis këtyre dy sistemeve për të arritur lumturinë e kërkuar.

Tendencimi i kohëve të sotme është më shumë drejt materialeve se sa spiritualeve. Dhe siç e diskutuam edhe më parë edhe ata që thërresin për spirituale, edhe ata vetë pengohen nga materialja dhe shpesh i përfshijnë kriteret materiale në ato shpirtërore. Prandaj këtë epokë nuk mund ta quajmë me terma plotësisht materiale.

Shumë e mbrojnë influencën e materializmit duke thënë se kjo është një pjesë e natyrës njerëzore, por njeriu asnjëherë nuk duhet ta lëshojë veten të kufizohet nga natyra e tij. Ndryshimi midis botës njerëzore dhe botës së kafshëve është se njeriu mund ti kontrollojë tendencat e natyrës së tij. Pra njeriu mund të identifikohet dhe të studiojë çdo gjë që ai është i përfshirë dhe pastaj të gjykojë nëse ajo diçka, është e mirë apo e ligë për të. Dhe si rezultat i këtij studimi akademik apo çfarë do qoftë, nje-

riu formon normat e sjelljes dhe sistemin e vlerave të tij. Njeriu në veçanti dhe e gjithë shoqëria njerëzore zakonisht e hedhin poshtë të keqen dhe praktikojnë të mirat.

Tendencat e kësaj kohe drejt materializmit nuk janë të mira për shoqërinë njerëzore, por edhe përpjekjet për të ndryshuar këto tendencë dhe thirrjet për një qind për qind praktikimi të spirituales dhe hedhje poshtë në mënyrë totale të asaj materiale do të ishte e pasuksesshme dhe e paarritshme për një shoqëri njerëzore. Prandaj ata që janë më të ditur dhe më të mësuar, nëpërmjet këshillave, thirrjeve, dhe shembujve duhet ta bëjnë të qartë tek pjesa tjetër e shoqërisë se adhurimi i ditëve të sotme në materialen duhet të zvogëlohet dhe zëvendësimi i saj me ekstremizëm në shpirtëroren nuk do të ishte aspak zgjidhje e mirë, por gjithmonë duhet të vendoset një balancë midis materiale dhe spirituales, apo shpirtërores.

Për shembull një punë nuk duhet të bëhet vetëm se prej asaj njeriu do të marrë një të ardhur, por gjithashtu se është mirë për individin dhe shoqërinë. Pra çdo njeri duhet të jetë krenar për çdo punë që bën dhe të jetë i lumtur me këtë punë, pa marrë parasysh lodhjen dhe të hedhë poshtë paragjykimet, sepse në këtë punë ai nuk merr atë çfarë meriton.

Për vetë besimtarët muslimanë rruga e mesme do të ishte ajo më e mira duke ndjekur fjalën e Allahut (xh.sh.):

“Bëhuni sa më të përmbajtur në rrugën që zgjidhni dhe ulni zërat tuaj. Me të vërtetë zëri më i shëmtuar është zëri i gomarit.”
(Kur’ani, Lukman: 19)

Dhe nga historia islame jepen shumë shembuj kur besimtarët e kësaj feje janë shumë të matur në gjërat që bëjnë. Pasuria, nga feja islame nuk është as e ndaluar dhe as e paaprovuar. Ajo çka na mëson kjo fe është, që të pasurit t’i ndihmojnë të varfrit vullnetarisht, nëpërmjet ndihmave apo pagimeve fetare si zekati, fitrat etj. Dhe

në këtë mënyrë shoqëria nuk do të vuante nga problemi i disbalancës dhe mosbarazisë.

Megjithëse zekati (taksa islame mbi pasurinë) është një nga detyrat apo obligimet e të pasurve, ata nuk kanë krenari për atë që bëjnë dhe nganjëherë mendojnë se të varfrit janë në borxh tek ta. Por, në qoftë se ata do të jepnin ndihma dhe të tjera gjëra vullnetarisht kjo patjetër që do të vlerësohej shumë nga shoqëria dhe pa diskutim kjo do ta bënte më të përkryer atmosferën në shoqëri dhe do ta bënte këtë shoqëri më të lumtur dhe me paqësore.

Sa për të varfrit, feja islame ka një pikëpamje serioze që shkon deri në ato kufij kur e konsideron varfërinë si diçka që është shumë afër mosbesimit. Megjithëse shoqëria është e përgjegjshme për të pasur kujdes të varfrit, nuk ka asnjë evidencë se varfëria dhe jeta e një lypësi duhen parë me një sy të veçantë ashtu siç ndodh në disa besime fetare.

Kërkimi i lëmoshës nëpër rrugë duke lexuar Kur'an, nuk ka vend në fenë islame, ashtu siç është e shprehur në ajetin Kur'anor si me poshtë:

“Dhe besoni atë, që shpallja (Kur'ani) e që vërteton atë që keni ju (Teurat) e mos u bëni mohues të parë të tij, dhe mos i ndërironi ajetet e Mia (Kur'anit) me një vlerë të paktë, por vetëm Mua më keni frikë”. (Kur'ani, el-Bekare: 41)

Duke e parë nga çdo kënd, feja islame nuk e ngre në pedestal varfërinë dhe as nuk e aprovon pasurinë e madhe. Në të kundërtën ky besim i jep me shumë prioritet zgjidhjes se gjërave me rrugën e mesme, dhe në të njëjtën kohë shoqëria vetë është përgjegjëse për të vënë çdo balancë që kërkohet për të mbajtur një shoqëri.

Moderimi apo përmbajtja varen shumë nga kontrolli i arsyeshëm i vlerave ekstremiste dhe sjelljes së bazuar në materialen dhe shpirtëroren. Vlerat dhe sloganet e socialistëve dhe komunistëve, të cilët fokusohen më shumë

në materialen, nuk kanë vend në shoqërinë islamike, në të vërtetë në asnjë shoqëri njerëzore. Prandaj është shumë e rëndësishme, të mos shkohet duke bërëtitur e çjerrë slogane materialiste pa pasur rezultat në motivet apo në efektet që ato kanë. Dhe mbi të gjitha të mos lëmë sloganin: “të varfrit më të varfër, dhe të pasurit më të pasur” të çirret kaq fort, kur në të nuk ka asnjë gjë të vërtetë.

Kapitulli III

“Dilema” e edukimit

...Më së fundi Xhebraili erdhi përpara Muhamedit... (dhe) e shtrëngoi atë fort, dhe e la: e pastaj i tha: “Lexo”! Ai u përgjigj: “Nuk mundem të lexoj”. Edhe një herë Xhebraili e përqafoi fort dhe pasi e la të lirë i tha: “Lexo”! Trupi i dhembte dhe ai me një zë të dridhur i tha: “Unë nuk di të lexoj”. Atëherë Xhebraili nisi të lexonte vetë:

“Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.” (Kur’ani, el-Alak: 1-5)

Këto ishin edhe ajetet e para të shpallura të Kur’anit të Shenjtë, ku profetit Muhamed iu kërkua nga Xhebraili të lexonte. Fjala “lexo” është fjala e parë që është shpallur në ajetet kur’anore.

Roli i dijes në propagandimin e Islamit është mjaft i qartë, ashtu sikur se është roli i të kërkuarit të njohurisë dhe i arsimimit në shpërndarjen e dijes.

Në komentimet e ajetit të katërt të kaptinës el-Alak, A. Yusuf Ali, një nga komentatorët e njohur të Kur’anit shkruan, “Simboli i një revolucioni të përhershëm është Pena mistike dhe Dokumentimi mistik.”.

Në gjuhën arabe, fjalët “mësim” dhe “njohuri” kanë të njëjtën rrënjë, por që kur ti përkthesh këto fjalë është e pamundur të ruash harmoninë e tyre, kështu për fjalët “lexo”, “mëso” dhe “penë” në përkthimin e zakonshëm

nënkuptojnë lexim, shkrim, libra, studim, kërkim, ndërsa për fjalën “njohuri” këtu përfshihen fjalët (shkencë, dije, njohuri shpirtërore) dhe për fjalën “shpallje” ka fjalë alternative si “lexo”

“Lexo” kjo ishte direktiva e parë që iu shpall Profetit Muhamed dhe pati një rol të rëndësishëm në përhapjen e fesë islame. Pa qenë të aftë të lexojmë, apo pa pasur një njohuri, mësimet e Kur’anit dhe Traditat e Profetit nuk do të mund të përhapeshin. Ata që mundën të “lexojnë” janë më të edukuarit në shoqëri. Edukimi dhe aftësia për të “lexuar” janë pothuajse sinonime të njëra tjetrës. Feja islame i inkurajon besimtarët e vet të “mësojnë”, “të kërkojnë dijen” dhe me përhapjen e edukimit natyrisht do të kemi edhe përhapjen e fesë islame. Dhe historia islame mund të themi se ka një dëshmi për këtë: kudo që feja islame u pranua, njohuria dhe dija gjithashtu e ndriçuan akoma me shumë botën e muslimanëve.

Pretendimet e malajzianëve (malajve) që fëmijëve të tyre t’u jepen me shumë mundësi për edukim, mund të themi se janë në vijë me pikëpamjet e besimit islam dhe të jep përshtypjen se qëndrimi i tyre ndaj edukimit është shumë i vendosur dhe pozitiv. Por po t’i bëjmë një studim më të thellë, do të vihet re se malajzianët duhet të bëjnë akoma më shumë që të jenë më të sigurt për rolin e edukimit dhe të mbajnë një qëndrim akoma më të vendosur.

Ata ende shqetësohen se edukimi i dhënë nga shkollat apo nga institucionet e larta përfshin vlera të reja, të cilat nuk janë shumë të përshtatshme për malajzianët, por në anë tjetër, ata frikësohen se në qoftë se nuk do të marrin këtë edukim, ata do të mbeten prapa në marshin e kohës dhe kështu që në jetën e tyre do të kenë mangësi. Dhe kjo “dilemë” bëhet akoma më e vështirë për malajzianët meqenëse ata janë pjesë e një kombi me raca të ndryshme dhe një hap i gabuar mund të sjellë pasoja

të ndryshme dhe të thellojë ndryshimin midis tyre dhe komuniteteve të tjera.

Ndjenja e frikës tek malajzianët se vlerat e reja materialiste ndoshta do të zëvendësojnë vlerat spirituale, që mund të vijjnë si rezultat i asaj që ata e quajnë “shekullarizëm” apo “edukim i perëndimit” i ka rrënjët në historinë e një zhvillimi sistematik, dhe në edukimin e një shkalle të gjerë në këtë vend. Megjithëse ka evidenca që malajzianët mundeshin të lexonin dhe të shkruanin para ardhjes së fesë islame në këtë vend, është një fakt i padyshimtë se “edukimi” në shkallë më të gjerë dhe në mënyrë me sistematike filloi të ndiqej pas pranimit të fesë islame.

“Edukimi” që jepej nga arabët dhe muslimanët indianë kur malajzianët vetë pranuan fenë islame ishte i kufizuar vetëm në akide (besim) dhe *ibadet* (principet dhe ritet e adhurimit). Kjo ishte mjaft e drejtë për atë kohë pasi malajzianët duhet të kishin një kuptim më të gjerë dhe të kthjellet të besimit dhe fesë që ata filluan të ndiqnin dhe sa me shumë të ishte e mundur të harronin besimet e tyre të vjetra.

Hinduizmi² dhe animizmi³ - janë besime që besojnë se shpirti i përket çdo krijese, peme, vendi dhe çdo gjëje që ekziston, dhe këto besime që kanë kontrolluar për një kohë të gjatë psikikën malajziane para ardhjes së Islamit.

² Është feja dhe kultura e ndjekur nga indianët. Kjo si fe i referohet besimit dhe filozofive që lulëzuan në tokat përgjatë lumit Indus, dhe si fe më së shumti praktikohet në nënkontinentin indian, sot ndiqet prej afro 1 bilion besimtarëve, më së shumti në Indi, por edhe në vendet të tjera. Si fe nuk ka themelues dhe nuk është një fe e organizuar ashtu sikur se feja islame apo krishterizmi. (shën. i përkth.)

³ Ky term aplikohet tek besimi se në çdo krijesë dhe në çdo objekt ekziston një shpirt dhe një personalitet. Pra është një besim spiritual që shumë nga filozofët mendojnë se ka qenë një ndër konceptet e para spirituale apo shpirtërore të njerëzimit. (*anima* do të thotë shpirt), pra kjo është doktrina ose teoria e shpirtit. (shën. i përkth.)

Këto besime ishin rrënjësor në mendjet e tyre, por në qoftë se malajzianët do të pranonin të bëheshin muslimanë, këto besime të vjetra duhet të lireshin mënjane dhe të zëvendësoheshin me besimin e pastër islam. Kështu që mësimet përr besimin dhe adhurimet ishin shumë të rëndësishme në fillimet e islamizimit të tyre, por këto mësimet mbetën si të tilla edhe më pas. Ka evidenca të shumta që tregojnë se kur mësimet në këto fusha neglizhoheshin, besimet e vjetra animistike kontrollonin menjëherë mendjet e malajzianëve.

Zhvillimi i dorëshkrimit Jawi⁴, në gjuhën malajziane gjithashtu synonte për propagandimin dhe për ta bërë më të lehtë kuptimin e fesë islame. Dorëshkrimet në Jawi, që përdorshin për përkthimet, komentimet, shpjegimet dhe mësimet e rregullave të Islamit, gjithashtu u përdorën edhe për propagandimin e letërsisë malajziane dhe për shkrimin e librave dhe artikujve të ndryshëm. Por, në përgjithësi dorëshkrimet Jawi, u përdorën më shumë për përhapjen e njohurive në fushat e akides, ibadetit, dhe sheriatit (ligjit islam) dhe fushave të tjera që ishin të lidhura me praktikën dhe principet e Islamit.

Meqenëse me pranimin e fesë islame, edukimi i malajzianëve ishte më shumë i kufizuar të *akide*, *ibadet*, *ablak* (moral) dhe të tjera fusha të ngjashme me këto, fushat e tjera të njohurive, të cilat u eksploruan nga shkrimtarët, shkencëtarët, dhe matematicienët islamikë nuk u propaganduan tek malajzianët. Pra si rezultat edhe zhvillimet që morën hov në shoqërinë malajziane pas pranimit të fesë islame, ishin të kufizuara vetëm në praktikimin e ibadetit, dhe rregullave të tjera islame. Fakti se Islami është një fe e kompletuar e shpallur nga Allahu nëpërmjet Profetit të tij për t'u përhapur tek i gjithë njerëzimi,

⁴ Jawi është shkrimi dhe leximi i gjuhës së vjetër malajziane, shkrimi i saj është me shkronjat apo hieroglifët si në gjuhën arabe. (shën. i përkth.)

përbën një sistem të jetës mjaft të gjerë dhe që përfshin gjithçka për lumturinë e njeriut në këtë botë dhe për në botën tjetër, por që nuk mundi të bëhet i qartë pas islamizimit të malajzianëve, për të vetmen arsye se islamizimi i malajzianëve u kufizua vetëm në fushat të veçanta si ato që përmendëm më lart, kështu që madhështia e Islamit si fe nuk u reflektua në zhvillimet e shoqërisë malajziane pas pranimit të Islamit si fe. Nga ana tjetër islamizimi i arabëve solli një zhvillim dhe një madhështi, e cila u përhap tek turqit, sllavët, persianët, indianët, malajzianët në Lindje, berberët, egjiptianët dhe tek evropianët në Perëndim.

“Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit!” (Kur’ani, Ali Imran: 191)

Ata që gjithmonë kujtojnë Zotin dhe që mendojnë rreth krijimit të qiejve dhe tokës, dhe që nuk i shpërdojnë dhuratat apo të mirat që Zoti ua ka dhënë, jo vetëm që besimi i tyre do të forcohet akoma më shumë, por ata, do të bëhen më të ditur në njohuritë rreth botës që i rrethon. Me fjalë të tjera ata do të bëhen njerëz të besimit dhe të dijes, dhe jo vetëm besimtarë që i kuptojnë të mirat dhe dhuratat që Zoti iu ka bërë por që u mungon njohuria.

Ky ajet dhe ajete të tjera kur’anore theksojnë rëndësinë e *vëzhgimit* dhe mendimit mbi krijesat e Zotit kur në të njëjtën kohë mendojmë për vetë Zotin.

Përveç çështjeve të lidhura me adhurimin e Zotit, siç janë kryerja e namazit, agjërimi, shkuarja në haxh, Kur’ani gjithashtu përmban edhe ajete, të cilat flasin rreth politikës, ekonomisë, shkencës, teknologjisë, luftës, krimit, martesës, moralitetit, edukimit, artit, letërsisë etj.

Zhvillimi dhe progresi që u pa në vendet e Azisë Perëndimore, Afrikës së Veriut, Spanjës, Evropës Lindore, Azisë Qendrore dhe Jugore pas përhapjes së Islamit në këto vende nuk u pa në tokat malajziane. Megjithëse shkaqe të tjera mund të kenë ndikuar për mangësitë e shkaktuara në këtë zhvillim, një shkak mund të themi me plot bindjen se ka qenë edhe fokusimi i malajzianëve vetëm në disa mësimet të Islamit duke i neglizhuar të tjerat dhe në veçanti ato që ishin të lidhura me këtë botë. Por kjo gjë ishte në kundërshtim me ato që vetë Zoti i ka shpallur në Kur'an.

Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos le mangu atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit. (Kur'ani, el-Kasas: 77)

Kur anglezët kolonializuan shtetet malaje dhe ngritën shkolla për të ushtruar dhe trajnuar stafet për qeverinë e tyre, edukimi midis malajzianëve ishte akoma i kufizuar në akide, ahlak dhe ibadet si pjesë përbërëse të Islamit.

Koncepti i edukimit si një mënyrë e përhapjes së dijes pa marrë parasysh qoftë ky edukim i përgjithshëm apo specializime të veçanta për trajnimin e punëtorëve ishte një diçka e re dhe e huaj për ta. Zhvillimet e sistemit shkollor të sjella nga anglezët vetë malajzianët i shikonin me dyshim, gjithashtu për ta këto sisteme ishin të huaja dhe shekullare. Ajo çka i shqetësonte ata më shumë ishte efekti i këtij sistemi shkollor në besimin e tyre fetar, Islamin.

Dhe dyshimet e tyre u rritën edhe më shumë kur shumë nga këto shkolla të periudhës koloniale të anglezëve drejtoheshin dhe menaxhoheshin nga trupat misionare të krishtere. Përveç dhënies së një edukimi "shekullar" në këto shkolla mësohej dhe propagandohej edhe

feja kristiane. Shumë nga këto shkolla gjithashtu kishin në ambientet e tyre të brendshme kishëza dhe kryqet.

Pra nuk është për t'u çuditur po të themi se shumica e malajzianëve mendonin se edukimi i dhënë në shkollat angleze ishte rreth kristianizmit apo i bazuar në fenë e krishterë. Kështu që ata mendonin se ky edukim, jo vetëm që ishte i pavlerë dhe që ishte në kundërshtim me besimin e tyre fetar, por gjithashtu vazhdimi i studimeve në këto shkolla mund të minonte besimin islam. Kjo pikëpamje e arritur prej tyre pati në përgjithësi një qëndrim negativ drejt sistemit modern të edukimit dhe shkollimit të dhënë nga qeveria angleze në periudhën e kolonializmit.

Dhe ky qëndrim u forcua më shumë kur anglezët i referoheshin këtij sistemi të edukimit në shkollat angleze si edukim "perëndimor". Perceptimi për edukimin dhe dijen e dhënë nga anglezët si një dije dhe edukim "shekullar" dhe "perëndimor" u forcua më shumë në qëndrimin e tyre ndaj këtyre shollave dhe u skalit si e tillë në psikikën malajziane. Edhe sot e kësaj dite njerëzit e kundërshtojnë të ashtuquajturin edukim "shekullar" dhe akoma vazhdojnë debate në meritat dhe anët negative të edukimit në këto shkollat që janë ndryshe nga ato fetare.

Si rezultat i kësaj pikëpamjeje dhe mosbesimi, malajzianët kanë treguar një mosinteresim në arritjet në fushat e tjera të dijes. Sa herë që projekte të ndryshme janë ndërmarrë nga qeveria për të rritur standardin e malajzianëve edhe në fushat e tjera të dijes, dyshime janë ngritur rreth efekteve që këto projekte do të kenë në besimin fetar dhe si rezultat kjo gjë ka bërë që suksesi të vonohet.

Por lind pyetja: vallë edukimi "shekullar" apo "perëndimor" i futur nga qeveria koloniale e kishte origjinën e vetme të vërtetë nga Perëndimi dhe a ishte ky edukim në konflikt me fenë islame? Për t'u përgjigjur kësaj pyet-

jeje që i ka hutuar malajzianët kaq shumë, na nevojitet të studiojmë dhe të krahasojmë historinë islame dhe të vendeve evropiane të cilat janë referuar në përgjithësi si Perëndim.

Ne kohën e xhahilijetit, apo periudhën para ardhjes së Islamit, Evropa, përfshirë këtu edhe Romën dhe Greqinë ishin në të ashtuquajturat Vitet e Errësirës. Historianët perëndimorë i quajtën këto vite si Vitet e Mesjetës dhe fillimet e saj ishin në shekullin V (470 pas lindjes së Isait a.s.). Gjatë kësaj periudhe njerëzit në Evropë ishin shumë të prapambetur. Sistemet feudale që ekzistonin në atë kohë i bënë evropianët skllëvër të princave tiranë, megjithatë si princat e kësaj kohe edhe populli ishin injorantë dhe të pashkolluar, vetëm një pjesë e vogël e priftërinjve mund të lexonin dhe të shkruanin.

Nga shekulli IV deri në shekullin VII, sulmet nga barbarët, që ishin një racë e pashpirt, mizore, e ashpër dhe që ishin të dhënë pas masakrave dhe luftës e shkatërruan pothuajse të gjithë Perandorinë Romake. Ata ndërtuan qendra të vogla, të cilat ishin jo shumë të forta dhe të përkohshme, por që vazhdimisht ishin në luftë midis njëra tjetrës. Midis këtyre kohëve të turbullta dhe të liga, dhe shfrytëzimit të fshatarëve nga princat, edukimi dhe kultura nuk patën shanse se si të zhvilloheshin. Dhe Vitet e Mesjetës vazhduan deri në shekullin XV, kur civilizimi modern erdhi me Rilindjen, e cila rezultoi me hyrjen e civilizimit islam në Spanjë në vitet (755-1492) dhe në Azinë e Vogël.

Në një kontrast të madh, Islami nga fillimet e shekullit VII e më pas, solli së bashku me dritën dhe besimin e vërtetë, edhe një zhvillim të kulturës dhe edukimit në një shkallë të paparë në historinë e njerëzimit. Pra Vitet e Mesjetës në Evropë koïnciduan me atë që historianët i quajnë Vitet e Arta të Islamit kur arti dhe dija lulëzuan si

asnjëherë me parë, d.m.th. kur civilizimi islam ishte në kulmet e arritjeve të tij.

Në kohën kur feudalizmi terrorizonte Evropën, Bagdadi ishte qendra e kërkimeve dhe studimeve në fusha të ndryshme të dijes. Në kohën e kalifëve të abasitë dhe sidomos në kohën e kalifit Harun er-Reshid dhe djalit të tij, që përkon me fundin e shekullit VIII dhe fillimet e shekullit IX, ndjekja e dijes kurajohej me dhënien e çmimeve dhe ngritjen e bibliotekave, që ishin një punë e shkëlqyer në shkrime, përkthime, studime të ndryshme, etj. në fusha të ndryshme të dijes dhe arsimit.

Kur Islami arriti në Spanjë, i gjithë gadishulli spanjoll pati një eksperiencë të këtyre Viteve të Arta. Kordova, e cila ishte nën sundimin e Abdurrahmanit III, ishte më e avancuar dhe e zhvilluar se ç'është sot. Qyteti kishte me shumë se 600 xhamia, spitale, shkolla dhe biblioteka. Muslimanët filluan t'ua mësonin evropianëve të asaj kohe shumë gjëra të reja nga bërja e parfumeve deri tek matematika e avancuar, e cila i pati rrënjët e zbulimit nga mendjet intelektuale muslimane. Letërsia dhe literatura nuk u kufizuan vetëm tek të pasurit dhe tek ata që i kishin mundësitë e shkollimit, por u mësua dhe u përhap edhe tek fshatarët e thjeshtë.

Gjuha arabe lulëzoi dhe e pasuroi akoma më shumë gjuhën e artit, të shkencës dhe të termave të tjera akademike, si algjebra për matematikën, gjithashtu astronomia, gjeografia u themeluan dhe u zhvilluan nga muslimanët.

Disa nga ekspertët e njohur në fusha të ndryshme të dijes si dhe në medicinë dhe disiplina të tjera ishin Abdullah Ibën Sina (Avicena 990-1037) dhe Muhamed Ibën Rushdi (Averros 1126-1198), Muhamed Ibën Musa el-Khwarizmi ishte i njohur në matematikën e avancuar dhe figura të tjera të mëdha si el-Biruni, Ibën-Halduni, Ibën Betuta, Ebu Musa Xhabir etj. Librat e shkencëtare-

ve islamë të cilët influencuan mendimet e të ashtuquajturve shkencëtare perëndimorë, përfshijnë *Kitabu'l-menadhbir* i shkruar nga Ibnu'l-Hejthem në 'optikë', *el-Mesa'il fi't-tibb* shkruar nga Hunejn Is'hak el-Ibadi ishte shumë i njohur dhe i preferuar nga doktorët evropianë dhe një libër tjetër i shquar në fushën e medicinës i shkruar nga Ebu Bekër Muhammed ibën Zekerija er-Razi është *Kitab el-Mansuri*, dhe gjithashtu libri i njohur i Ibën Sinës në medicinë titulluar, *el-Kanun* (Ligjet e medicinës).

Impakti më i madh ishte në matematikë, disiplinën që i kontrollonte të gjitha disiplinat e tjera shkencore. Sistemi i llogaritjeve që përdoret edhe sot në Perëndim është i bazuar në numërimin arab, sistem që përdor nëntë gishtat dhe një zero, e cila mund të tregojë çdo lloj shume sado e madhe qoftë. Sistemi numerik romak që përdorej më përpara ishte një pengesë për zhvillimin e matematikës dhe të gjitha llogaritjeve në përgjithësi. Me anë të sistemit numerik arab llogaritjet dhe matjet e nevojshme në të gjitha shkencat jo vetëm që ishin të mundshme, por ishin edhe më të lehta. Sistemi binar që përdoret sot në shkencën e kompjuterëve, nuk do të mund të zhvillohej pa qenien e sistemit numerik arab.

Pra të gjitha këto që përmendëm më lart ishin vetëm një panoramë e shkurtër për të treguar kontributin e madh që ka dhënë Islami në botën e edukimit që i ka fillimet e veta qysh prej shekullit XIV.

Ardhja e Islamit në çdo epokë, qoftë në Evropë, Afrikën e Veriut, Azinë Perëndimore, Azinë Qendrore dhe Indi, ndiqej nga një zhvillim i madh dhe i shpejtë që reflektohej në standardet e larta të aftësive në fushën e arkitekturës, inxhinierisë, agrikulturës, mjeshtritë detare, astrologjisë dhe në fusha të tjera të rëndësishme. Shumë nga punimet e tyre si urat, xhamitë, rrugët etj, vazhdojnë të qëndrojnë edhe sot pas gjithë asaj kohë dhe një numër

prej tyre janë të paarritura dhe të paimitueshme duke marrë parasysh edhe teknikën dhe veglat moderne të kohës së sotme, si Pallati i Alhambres (ar. el-Hamra') në Granada, në Spanjën Jugore, dhe Taxh Mahali në Agra, në Indi që i mahnitë të gjithë vëzhguesit me bukurinë e saj.

Fare mirë e kemi parë se si evropianët dhe spanjollët mësuan shumë artizanate, disiplina dhe industri nga pushuesit e tyre muslimanë. Kur Evropa doli nga Mesjeta e cila përfundoi në shekullin XV me ardhjen e Rilindjes, përpjekjet e evropianëve u bënë me intensive për të mësuar nga muslimanët. Librat e Ibën Sinës, Ibën Rushdit dhe shumë të tjerëve jo vetëm që u përkthyen nga gjuha arabe në gjuhën latine dhe gjuhët e tjera evropiane, por ata u studiuan dhe u mësuan me zell nga studentët evropianë. Por, fatkeqësisht shumë emra të autorëve arabë si dhe emra të disiplinave apo librave që ata kishin shkruar u ndryshuan për t'iu përshtatur gjuhëve perëndimore duke mos lënë asgjë të lidhur me origjinalitetin. Dhe së fundi, dija që i përkiste muslimanëve filloi të njëhej si një edukim perëndimor, emrat dhe çdo gjë e lidhur me origjinalet u ndryshuar për t'iu përshtatur me mirë Perëndimit.

Megjithatë shkollarët evropianë nuk u mjaftuan vetëm me kaq, ata vazhduan kërkimet dhe shtuan shumë mbi njohuritë e marra nga muslimanët, duke bërë kështu të mundur të mundnin muslimanët në të gjitha fushat që këta kishin shpikur apo përhapur me parë. Dhe në kohën kur Malajzia u kolonializua, Perëndimi kishte zotëruar të gjitha njohuritë e dijet dhe kishte filluar të merrte prapa të gjitha territoret që muslimanët kishin pushtuar me parë.

Rilindja solli një epokë moderne në Evropë. Dijet në fushat e ndryshme filluan të kërkoheshin dhe merreshin në mënyrë sistematike, e cila rezultoi me një progres mjaft të madh. U ngritën shumë institucione mësimi, që nga sallat e mëdha të studimit, laboratorët etj, ku tek-

nikat dhe materialet industriale filluan të krijoheshin dhe të prodhoheshin. Por një studim të thellë i bërë mbi të gjitha këto arritje, do të na tregonte se të gjitha njohuritë dhe mjeshtëritë i kishin fillimet dhe zanafillën nga kontributi i pionierëve muslimanë. Pra mund të themi se edukimi “perëndimor” apo “shekullar” nuk është as perëndimor dhe as shekullar, pasi çdo njohuri i ka fillimet dhe bazat nga vetë muslimanët. Edukimi dhe dija që Perëndimi apo njerëzit në Perëndim kanë shpërndarë kudo në botë në realitet i ka burimet nga edukimi dhe dija islame. Kur vetë muslimanët i zotëruan dhe u mjeshtëruan në këto dije, Islami u përhap me hove shumë të shpejta në botë, dhe nuk do të ishte shumë në qoftë se do të thoshim se ishte kjo dije që ndihmoi akoma në shumë përhapjen e Islamit, dhe kjo dije ishte kaq shumë efektive në përhapjen e Islamit sa që nuk mund të themi kurrëse se ishte në kundërshtim me Islamin, ashtu sikurse mendohej nga malajzianët.

Prandaj mund të themi se ishte shumë e qartë se edukimi që Perëndimi i referohej me termat si edukim “perëndimor” apo “shekullar” nuk i ka zanafillat as në Evropë dhe as në Perëndim, gjithashtu edhe historia nuk na ka treguar asgjë se kjo dije është në konflikt me Islamin. Për asnjë fushë të dijes nuk mund të themi se është e mirë apo e ligë; çdo gjë varet nga mënyra se si e përdorim atë dije. Shumë izraelitë e studiojnë Islamin, por i përdorin këto njohuri që t’i japin një figurë të ligë fesë. Nga nocioni i hedhur se dija e sotme është në konflikt me Islamin mund të përfitojnë vetëm armiqtë e fesë islame, vetë muslimanët nuk duhet ta propagandojnë pasi nuk ka asnjë evidencë që e përkrah këtë pikëpamje të pabazë.

Por në momentet e sotme mund të themi se akoma edukimi “shekullar” shikohet me dyshim, dhe kjo fare mirë mund të tregohet nga thirrjet që bëhen për eduki-

min “fetar” që të mos lihet pas dore, por të përkrahet më shumë dhe të merren metoda me efektive për propagandimin e këtij edukimi. Kërkesa të vazhdueshme janë bërë që edukimi “fetar” d.m.th. mësimi i besimit dhe adhurimeve islame të vihet në të gjitha sistemet shkollore dhe të rritet numri i studentëve në shkollat fetare.

Por lind pyetja: Vallë si është statusi i edukimit “fetar” sot në Malajzi dhe a duhet malajzianët (malajtë) të shqetësohen kaq shumë pas kësaj çështjeje? Në kohën e anglezëve, fëmijët malajziane kishin një edukim minimal në *akide* dhe *ibadet*. Në shkollat malaje, instruksionet për këto lëndë jepeshin të ndara dhe në shkollat e mbrëmjes. Në shkollat angleze, këto lëndë nuk mësoheshin dhe as nuk lejoheshin zyrtarisht. Pra, për shumicën e fëmijëve malajzianë e vetmja mënyrë e edukimit “fetar” jepej nga mësimet private të dhëna në Kur’an të marra në shtëpi.

Disa prej prindërve i dërgonin fëmijët në shkolla të vogla fetare me një pagesë të vogël për të mësuar Kur’anin dhe besimin fetar, pasi vetëm një numër shumë i vogël prej tyre mundeshin të përballonin të hyrin në shkollat e veçanta “fetare” të qeverisë ose siç quheshin ndryshe shkolla arabe si ajo “Mekteb Mahmud” në Alor Setar. Ndërsa në zonat e thella dhe në periferi edukimi fetar pothuajse mungonte fare.

Pra megjithëse edukimi në *akide* dhe *ibadet* gjatë periudhës angleze nuk ishte shumë sistematik, dhe nuk i jepej shumë vëmendje nga qeveria koloniale, malajzianët nuk mbetën pas në Islam. Edhe pse njohuritë e tyre fetare ishin shumë të dobëta ata nuk ngurruan asnjëherë në marrjen e besimit të tyre fetar apo në praktikimin e fesë. Tiparet e fesë Islame ishin shumë të qarta në jetën malajziane. Krimi, pija alkoolike, konsumimi i drogës dhe sjellje të papëlqyeshme si mosrespektimi i prindërve, mësuesve, më të vjetërve nuk ekzistonin dhe ishin një

shfaqje e huaj për shoqërinë e atëhershme. Shoqëria malajziane ishte e disiplinuar dhe shumë e rregullt dhe kishte një udhëheqje fetare. Xhamitë edhe pse në atë kohë të vogla dhe jo shumë të sofistikuara ishin gjithmonë të mbushura me besimtarë dhe me zyrtarët e nevojshëm.

Liderët malajzianë të asaj kohe që ishin sulltanët dhe këshilltarët e tyre ishin shumë fetarë dhe mbanin një qëndrim serioz ndaj fesë. Në vendet e tjera islame të kolonializuara nga Perëndimi, krishterimi u propagandua me shumë lehtësi, kurse në Malajzi, kolonizatorët nuk ishin të lejuar të bënin asnjë lloj propagande fetare midis malajzianëve, ata ishin të gjithë muslimanë.

Pra situata gjatë periudhës koloniale shumë mirë tregoi se malajzianët nuk mund të kthehen lehtë nga feja e tyre islame dhe se ata janë gjithmonë gati ta mbrojnë këtë fe.

Dhe së njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar. Dhe së mudi i tij më vonë (ditën e gjykimit) do të shihet. (Kur'ani, en-Nexhm: 39-40)

Interpretimi i këtij ajeti kur'anor e shpreh mjaft mirë se përpjekjet e tyre do të shpërblehen nga vetë Zoti një ditë.

Megjithatë situata qysh pas fitores se pavarësisë, paraqitet shumë ndryshe nga ajo që pamë në periudhën e kolonializmit. Menjëherë pas fitores se pavarësisë, edukimi fetar në *akide* dhe *ibadet* i është dhënë një status i veçantë dhe është bërë zyrtar. Të gjitha shkollat edhe ato të cilat zotërohen nga misionarët kristianë, duhet t'i përmbajnë mësimet e fesë islame. Mësuesit e "fesë" janë më shumë në numër dhe më të përgatitur, dhe këta mësues gëzojnë të njëjtin status, ashtu sikur se edhe mësuesit në lëndët e tjera, gjithashtu *akideja* dhe *ibadeti* nuk janë më të ndara nga lëndët e tjera që merren në shkollë. Një numër i madh nxënësish dhe studentësh specializohen në *usuluddin* (principet e fesë islame), në *shariat* dhe në fushat e tjera në nivelet universitare dhe pasuniversitare.

Ata që kanë jetuar në periudhën e kolonializimit dhe që janë akoma duke jetuar nuk mund ta kundërshtojnë apo ta hedhin poshtë vëmendjen dhe kujdesin e veçantë që i është dhënë mësimin të *akide* dhe *ibadet*, përmirësimit të teksteve dhe rritjes së numrit të nxënësve në shkollat fetare. Megjithatë prapë dyshimet mbi edukimin “shekullar” dhe deklaratat se edukimi “fetar” po vazhdon të neglizhohet dëgjohen përsëri të thirren në popull. Si vallë mund të hiqet kjo dilemë e malajzianëve dhe e liderëve të tyre, kur të gjithë nxënësit dhe studentët të mësojnë vetëm *akide* dhe *ibadet* dhe t’i lënë mënjanë subjektet e tjera? Po çfarë do të ndodhë vallë me fushat e tjera të dijes, të cilat janë po aq të rëndësishme për vetë malajzianët, ashtu siç janë është për rritjen e forcimin e Islamit.

Ndryshimet apo diferencat midis fesë islame dhe besimeve të tjera fetare i diskutuam më lart. Feja islame nuk është një besim i kufizuar vetëm në aspektin fetar, kjo fe diskuton dhe sistematikisht flet edhe për aspektet e tjera të jetës dhe vdekjes së besimtarëve. Pra në Islam nuk ka ndarje midis asaj që është “fetare” dhe asaj “shekullare”, dhe të njëjtën gjë mund të themi se kur bëhet fjalë për dijen nuk ka ndarje nga dija “fetare” apo dija “shekullare”. Edukimi që është i përdorshëm për shoqërinë njerëzore bën pjesë në dijen që Islami e inkurajon çdo besimtar ta marrë. Dhe një musliman mund të quhet dijetar (*alim*) vetëm kur ai të ketë njohuri dhe të jetë i edukuar në të gjitha fushat e dijes. Pra me emra të tillë ne mund të thërrasim si për shembull, Imam Gazaliun, Ibën Sinën e të tjerë të asaj kohë. Por diferenca me të sotmit është se këta dijetarë patën shumë sukses në fushat që studiuin, p.sh Gazaliu shkëlqeu në fushën e akides, shariatit, dhe në fusha të tjera duke arritur në nivelet e misticizmit, Ibën Sina shkëlqeu në matematikë dhe në medicinë. Por të kemi parasysh se statusi i tyre si

besimtarë muslimanë nuk mund të vihej asnjëherë në dyshim dhe as që mund të krahasohej me dikë. Të dy ishin besimtarë të devotshëm dhe asnjë nuk mund të thotë se Ibën Sina ishte më musliman se Gazaliu apo anasjelltas. Faktikisht këto krahasime nuk gjejnë vend në Islam.

Disa janë të prirur që për statusin e një muslimani të gjykojnë duke e marrë për kriter dijen e tij në *akide* dhe në fushat që ndërlidhen me të. Ata i japin vlerë të veçantë studimit të akides dhe gjykojnë për bindjet fetare të dikujt përmes të arriturave të tij në këtë subjekt.

Në të vërtetë Islami nuk kërkon prej besimtarëve të vet muslimanë të mësojnë vetëm akiden dhe t'i lënë mënjane dijet e tjera. Që ti kthesh kurrizin dikujt për shkak të formës tjetër të edukimit që ai merr nuk është diçka e mirë, dhe nuk e bën një njeri musliman më të mirë se tjetrin. Meqenëse aftësitë njerëzore ndryshojnë, komunitetet muslimane detyrimisht që do të kenë njerëz të ndryshëm të kualifikuar në fusha të ndryshme, ashtu si në rastet e Gazaliut dhe Ibën Sinasë siç i përmendëm edhe më lart. Pra shoqëritë muslimane nuk ka rëndësi nëse janë në një vend apo në një kohë apo vende të ndryshme dhe kohë të ndryshme, pa dyshim që do të kenë njerëz të edukuar në fusha të ndryshme të dijes, dhe përderisa besimi dhe mësimet islame shtrihen në të gjitha aktivitetet shoqërore, Islami do të vazhdojë të mbetet besimi fetar dominues i kësaj shoqërie.

Prandaj mund të themi se nuk ka asnjë justifikim për frikën se besimi islam do të venitet, përderisa t'i kushtohet më shumë kohë studimit të akides. Koha duhet të ndahet në mënyrë të atillë që të studiohet jo vetëm akideja, por vëmendje t'u jepet edhe fushave të tjera të mësimet, pasi të gjitha kanë një rëndësi të veçantë në jetën e një muslimani. Dhe vetëm kur kjo të arrihet, muslimanët nuk do të gjejnë vetëm veten me besimin e tyre

por ata do të jenë të pathyeshëm dhe të pamposhtur nga armiqtë e fesë islame.

Dhe vetëm në qoftë se kjo kuptohet mirë nga të gjithë muslimanët, atëherë ata do të jenë në gjendje ta dedikojnë kohën në shërbim të zotërimit të njohurive në fushat e ndryshme duke përfshirë këtu edhe akiden dhe ibadetin. Por sa kohë duhet të harxhohet në mësimin e akides dhe ibadetit kjo varet nga mençuria e liderëve islamë. Ata duhet të jenë të qartë në vendimet e tyre në mënyrë që vlerësimi i të gjitha fushave të dijes të bëhet në mënyrë proporcionale, pa lënë pas dore njërën apo tjetrën.. Dhe në qoftë se kjo arrihet me një mençuri dhe maturi atëherë do të kemi një baraspeshë midis studimit të akides dhe fushave të tjera të dijes.

E, kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni begatitë e Allahut, por edhe përmendni shpeshherë Allahun, ashtu që të gjeni shpëtim. (Kur'ani, el-Xhumua: 10)

Nga ky ajet kur'anor, Zoti na e bën të qartë se koha nuk është vetëm për falje, por gjithashtu edhe për të punuar, dhe sigurisht edhe për të mësuar, se asnjë punë nuk mund të bëhet në mënyrë korrekte po nuk pate një eksperiencë apo një njohuri të mjaftueshme.

Pak me parë e diskutuam nga vetë historia e Islamit, se lëndët që mësohen në shkollat sot, në të vërtetë nuk e kanë zanafillën prej Perëndimit dhe nuk janë aspak në konflikt me fenë islame, pra nuk ka asnjë të ligë edhe pse mos të mësohen. Të gjitha njohuritë i kanë zanafillat dhe janë studiuar nga muslimanët dhe duke u praktikuar përkrah detyrave të tjera fetare ato u rritën dhe u përhapen së bashku me Islamin. Thënia e Profetit se dituria duhet të ndiqet edhe në Kinë po që e nevojshme, tregon për vendin e lartë që Islami e vendos marrjen e dijes. Kjo thënie pa dyshim është thënë kur vetë feja islame nuk kishte arritur akoma në Kinë, dhe nuk mund të

themi se ishte e kufizuar vetëm në *akide* apo *ibadet*, kuptimi i saj ishte dija në përgjithësi.

Thuaj: "Udhëtoni nëpër tokë e shikoni se si filloi krijimi, pastaj Allahu e fillon krijesën tjetër (ringjalljen). Është e vërtet se Allahu ka mundësi për çdo send . (Kur'ani, el-Ankebut: 20)

Ky ajet kur'anor, na kërkon të shikojmë me vëmendje krijimin që ka bërë Allahu, pasi një shikim më i ngushtë dhe më i vëmendshëm do të na bëjë të ndiejmë një ndërrim më të madh ndaj tij. Ibën Rushdi, doktori musliman i Kordovës, Spanjë (1126-1198) thotë: "Për atë njeri që njeh shumë mirë anatominë dhe fiziologjinë e njeriut, besimi i tij tek Zoti do të thellohet akoma me shumë." Kjo është një e vërtetë, kush do që studion me vëmendje se sa kompleks është trupi i njeriut dhe se si jeton e lëviz, do të kuptojë më së miri fuqinë e Zotit. Studimi me vëmendje mos të harrojmë se gjithmonë sjell një eksperiencë dhe një njohuri të re. Pra është e qartë se nga ne është e nevojshme të studiojmë krijesat e Zotit, se me anë të kësaj vetëm atëherë ne do të dimë të vlerësojmë ato që na ka dhënë Zoti dhe mosrealizimi i kësaj detyre do të thotë të mos vlerësosh dhuratat që Zoti na ka bërë.

Përveç faktit se Islami nuk e ndalon marrjen e njohurisë, por gjithmonë e ka inkurajuar si diçka shumë të rëndësishme, është e vërtetë dhe duhet të merret në konsideratë që në kohët e sotme, shoqëritë apo grupet që kanë mangësi në dije do të jenë gjithmonë pre e shtypjes dhe e kolonializimit. Historia gjithmonë e ka provuar se sa lehtë një popull i prapambetur, gjithmonë është pushtuar dhe është bërë pre e atij që është më i avancuar dhe më i suksesshëm. Duke qenë i pushtuar ky popull i prapambetur, sado i ditur të jetë në çështjet 'fetare' do të vijë një kohë që do të shkëputet prej besimit fetar, dhe kjo në qoftë se nuk ndodh me një gjeneratë do të ndodhë në një të ardhme të afërt.

Vete historia moderne po na tregon se sa lehtë vendet muslimane po pushtohen, se si muslimanët po keq-trajtohen dhe persekutohen nga jomuslimanët, dhe se si po shkatërrohet feja islame. Edhe pse në disa raste pushtimi mund të mos ndodhë me anë të forcës dhe dhunës, përdoren forma të tjera. Për shembull në qoftë se disa prej vendeve muslimane nuk kanë një ekspertizë ekonomike, ata do të pranojnë kolonializimin ekonomik, kur ata kanë mungesë në teknologjitë dhe aftësitë moderne fare lehtë ata do të kolonializohen nëpërmjet këtyre mangësive që kanë dhe si rezultat kjo do të sjellë dalëngadalë dobësimin e vetë këtyre vendeve.

E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake) e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të, (me përgatitje) ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e Allahu i di ata. Çkado që shpenzoni për rrugë të Allahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë. (Kur'ani, el-Enfal: 60)

Ky ajet kur'anor thekson mbi përgatitjen dhe gatishmërinë për t'u ballafaquar me armikun, edhe pse në këtë ajet janë të përmendur mjete luftarake si shpatat, shigjetat, e kuajt, kjo i referohet luftës në kohën e Profetit. Në ditët e sotme armatimet e kërkuara nuk mund të jenë shpatat, e shigjetat, por armët, topat, aeroplanët dhe anijet luftarake dhe mjete të tjera të cilat patjetër kërkojnë njohuri që të përdoren në mënyrë më efektive. Por muslimanët që kanë mangësitë e këtyre njohurive duke u fshehur pas asaj se kjo dije është “shekullare”, edhe pse janë të aftë nga ana fetare, do të mposhten lehtë dhe kështu ata do t'ia ulin më shumë faqen fesë së tyre, se sa do ta ruajnë integritetin.

O ju që besuat, kur t'ju thuhet: zgjerohuni (bëni vend) në vend ndeje, zgjerohuni, se Allahu bën zgjerim për ju, e kur t'ju thuhet: ngrihuni, atëherë ju ngrihuni! Allahu lartëson ata që besu-

an prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri. Allahu është i njohur mirë me atë që punoni. (Kur'ani, el-Muxhadele: 11)

Zoti i dhuron dije apo njohuri kujtdo që ai dëshiron, dhe ata që janë ndër radhët e atyre njerëzve të zgjedhur nga Zoti, ata përveç dijes se dhuruar do të kenë edhe plot të mira nga pas.

A nuk i shikojnë deret se si janë krijuar? Edhe qiellin se si është ngritur lart! Edhe kodrat se si janë venduar! Edhe tokën se si është shtruar! (Kur'ani, el-Gashije: 17-20)

Pa dyshim që njohuria dhe dija këtu nuk referohen vetëm për akide, ibadet dhe sheriat. Në qoftë se kuptimi i këtyre ajeteve do të ishte i kufizuar vetëm tek këto atëherë kjo do të ishte bërë më e qartë dhe vetë Profeti do ta kishte theksuar më shumë këtë pikë. Por nga traditat e Profetit nuk kemi asnjë gjë të përmendur rreth kësaj pike, por në të kundërt, muslimanët inkurajohen të kërkojnë çdo lloj dije apo njohurie edhe kur kjo kërkon shkuarje deri në Kinë.

Nuk do të ishte një ekzagjerim po të thoshim se muslimanët, dhe në veçanti muslimanët në Malajzi, nuk do të kishin qenë në gjendje të kryenin ritualet e adhurimit po të mos kishin qenë disa nga lehtësimet që janë arritur vetëm me anë të përdorimit të disa formave të dijes. Ata së pari nuk do të kishin pasur rroba për të veshur të cilat janë punuar vetëm me anë të njohurive mbi qepjen dhe teknikat e saj. Ata nuk do të kishin mundur të faleshin në grupe të mëdha nëpër xhami, të cilat nuk do të kishin ekzistuar pa u ndërtuar me teknikën dhe metodat e njohurisë “shekullare” siç e quajnë këta muslimane. Të ardhurat për të ndërtuar këto xhami të bukura dhe moderne kanë ardhur vetëm si rezultat i taksave të marra nga industritë dhe tregtitë e ndryshme, të cilat ek-

zistojnë si pasojë e përdorimit të dijes dhe njohurisë që nuk është e kufizuar vetëm tek akideja.

Një tjetër rast është shkuarja në haxh, e cila në ditët moderne nuk mund të kryhet si në kohën e Profetit me anë të deveve. Tani nevojiten anije apo aeroplanë për të shkuar në Mekë, Tokën e Shenjtë, për të kryer këtë detyrë fetare, por këto mjete janë shpikur dhe janë ndërtuar vetëm nëpërmjet të ekzistimit të dijes “shekullare” apo “perëndimore”. Më përpara kur këto lehtësime të transportit nuk ishin të mundshme vetëm një numër shumë i vogël e plotësonte këtë detyrë të rëndësishme fetare, kurse sot çdo musliman mund të shkojë dhe ta kryejë këtë rit fetar. Të varfërit, të cilët varen nga zekati dhe fitrat do të përjetonin vuajtje sikur shoqëria të mos kishte njohuri për tregtinë, industrinë, sepse çdokush do të ishte i varfër dhe askush nuk do të ishte në gjendje t’i kryente detyrat e përmendura.

Pra është shumë e qartë se ritet e adhurimit fetar, nuk do të mund të kryheshin në mënyrë perfekte në qoftë se nuk do të ishte pasuria që vjen prej formave të tjera të dijes.

Një shembull që mund ta ilustrojë lidhjen ndërmjet trajtave të ndryshme të dijes dhe adhurimeve islame në Malajzi është Skema e Mudas për Ujitje. Kjo skemë ishte bazuar në një studim socio-ekonomik të komunitetit të bujqve të zonës së “tasit të orizit” në Kedah. Projekti i sistemit të ujitjes ishte përgatitur nga ekspertët e inxhinierisë së vaditjes dhe nga inxhinierë të tjerë.

Ekspertët financiarë dhe bankat e studiuuan skemën dhe punuan që t’i gjejnë 340 milionë \$ për ta financuar këtë projekt gjigant. Ndërtimi përfshiu qindra inxhinierë, afaristë, punëtorë të kualifikuar dhe të thjeshtë, zyrtarë të ndryshëm, si dhe shfrytëzimin e llojeve të ndryshme të makinave dhe teknikave të ndërlikuara.

Si përfundim i kësaj skeme, prodhimi i orizit u dyfishua dhe me këtë edhe sasia e zekatit të tubuar. Pas kësaj më tepër bujq kishin mundësi ta kryenin detyrën e ha-xhit. Edhe shumë dobi të tjera në sferën e fesë u siguruan nga ky projekt. Dhe, më në fund, bujqit muslimanë mund të jetonin e të vdisnin në kushte më të mira dhe më të lumtur, siç në të vërtetë kërkon Islami.

Kjo njohuri e ashtuquajtur “shekullare” jo vetëm që është e lidhur me fenë, por edhe ndihmon vetë muslimanët për t’i kryer sa më me efikasitet dhe në mënyrë të shkëlqyer detyrat e tyre fetare. Nuk do të ishte shumë sikur të thoshim se shumë nga këto forma të dijes janë shumë jetësore për Islamin.

Pra të gjitha këto, janë një fakt i rëndësishëm që tregojnë pse Islami e inkurajon aq shumë marrjen e dijes pa dalluar mbi këtë formë apo atë formë. Vetë përhapja e Islamit, ndodhi vetëm atëherë kur muslimanët i lanë prapa besimtarët e feve të tjera jo vetëm në adhurimin ndaj Zotit, por edhe në zotërimin e formave të ndryshme dhe të përdorshme të dijes.

Të kthehemi edhe një herë tek çështja e shtimit të lëndëve në lidhje me besimin dhe adhurimet nëpër shkolla ku disa mendojnë se kjo do të forcojë me shumë Islamin. Kjo mendoj se nuk është gjithmonë e vërtetë pasi e kundërta mundet fare lehtë të ndodhë. Duke harxhuar një kohë të madhe në këto lëndë, nuk do të mbetet kohë e mjaftueshme për lëndët e tjera shoqërore dhe si rrjedhim studentët do të kenë mangësi në njohuritë e tjera, dhe dobësia dhe mangësitë në njohuritë e tjera do të thotë dobësim i vetë pozitës së Islamit. Është e rëndësishme për studentët të studiojnë edhe fushat e tjera të dijes, të cilat kanë lidhje me praktikimin e Islamit dhe mirëqenien e shoqërisë muslimane. Pra ashtu sikur se *akideja* dhe *ibadeti* nuk duhet të neglizhohen, të njëjtën

gjë mund të themi edhe për njohuritë në fushat e tjera të dijes, që janë po aq të rëndësishme për vetë Islamin, të mos lihen asnjëherë pas dore.

Prandaj përveç dhënies se instruksioneve tek çdo musliman për të mësuar mbi akiden dhe ibadetet duhet të inkurajohet edhe specializimi në fushat e tjera të dijes. Është detyrë e çdo shoqërie muslimane të bëjë të mundur trajnimin e individëve të kësaj shoqërie në fushat e ndryshme që janë po aq të rëndësishme për mirëqenien e kësaj shoqërie, pastaj që të vendoset se cila fushë është më e mirë apo më e rëndësishme se tjetra, gjë që vendoset nga shoqëria.

Roli i edukimit është përmbushja e shoqërisë me kuadro sa më efektive dhe të aftë. Për shembull në qoftë se një shoqërie muslimane i kanosej rreziku për t'u sulmuar nga një force antiislame, shoqëria do të ishte në një gabim shumë të madh në qoftë se nuk do të kishte personelin dhe kuadrot e kualifikuar për të mbrojtur vendin. Të njëjtën gjë mund të themi në rastin e përhapjes së sëmundjeve të ndryshme, kur kësaj shoqërie do t'i mungonte personeli dhe kuadrot e aftë për dhënien e shërbimeve mjekësore, për të vetmin shkak të neglizhimit të trajnimit të stafit në mjekësi, për arsyen se është një njohuri "shekullare" dhe jo shumë e rëndësishme për Islamin. Në këtë rast do të thuhej me plot bindje se kjo shoqëri nuk e ka bërë si duhet detyrën e saj në këtë aspekt lidhur me vetë besimin islam.

Pra ashtu sikur se edhe aqidah dhe ibadah, asnjë nga fushat e tjera të dijes nuk duhet parë me dyshim, pasi edhe këto janë dije islamike me zanafillën nga vetë muslimanët, nuk ka asnjë ligj që është kundër mësimit të këtyre njohurive. Mësimi dhe marrja e këtyre dijeve nuk do të dobësojë besimin në Zot, por përkundrazi do ta forcojë më shumë besimin.

Në Islam ne besimtarëve, shpesh na kërkohet të vëzhgojmë me kujdes në krijesat e Zotit. Në ajetet 17-20 të sures el-Gashiye të përmendur më lart, na kërkohet të mendojmë mbi krijimin e devesë, të qiejve, të maleve dhe se si ato qëndrojnë ashtu të fiksuara, dhe si janë të shpërndarë në tokë. Gjithashtu në ajetin 20, të sures el-Ankebut na kërkohet të përshkojmë tokën dhe të vëzhgojmë çdo gjë që krijoi Zoti. Dhe vetëm kur ne të kuptojmë krijimin e gjithçkaje që Zoti ka krijuar atëherë ne do ta adhurojmë më shumë fuqinë e pafundme të Zotit. Sa më shumë t'i shohim me imtësi, aq më shumë do të mrekullohemi me ndërlikimet dhe kompleksitetet e krijesave të Zotit.

Një arrogancë e tepruar ekziston midis shkencëtarëve perëndimorë, që mendojnë se kanë pushtuar “natyrën”. Ata mendojnë se kuptojnë dhe dinë sekretet e të gjitha krijesave dhe nuk ka asgjë që ata nuk ia dinë origjinën dhe që nuk janë në gjendje të zbulojnë. Por, megjithëse këta shkencëtarë mund të shpjegojnë si diçka ka ardhur në ekzistencë apo si u krijua, ata nuk janë në gjendje të shpjegojnë pse kjo diçka është krijuar si e tillë.

Shkencëtarët shumë lehtë e shpjegojnë se si oksigjeni përdoret nga trupi i njeriut dhe rëndësinë e tij për njeriun, por këta shkencëtarë nuk janë në gjendje t'i përgjigjen pyetjes: Pse oksigjeni? Pse jo ndonjë nga gazet e tjera që gjendet në natyrë? Në qoftë se dioksidi i karbonit përdoret nga bimët pse nuk mund të përdoret nga kafshët? Pse qeniet njerëzore nuk shtohen me anë të vezëve, ashtu sikur se ndodh me disa specie të botës shtazore? Pse, çfarë lind vdes?

Për këto pyetje dhe një numër të madh pse-shë, jo vetëm shkencëtarët, por asnjë nuk mund të ofrojë një përgjigje të saktë. Për këtë ka vetëm një përgjigje: “Gjithçka është fuqia e Zotit” .

Mund të themi se arroganca e shkencëtarëve perëndimorë vjen si rezultat i injorancës. Në qoftë se ata do t'i kishin sytë hapur, nuk do të ishin kaq krenarë për këtë zgjuarsì të tyre. Të paktën muslimanët, të cilët kanë marrë një trajnim të mjaftueshëm fetar të mos e fusin vetveten në atë rrugë. Ata duhet të jenë të ndërgjegjshëm për kufizimet dhe dobësitë që kanë. Ata fare mirë mund ta kuptojnë se ata nuk mund ti përgjigjen pyetjeve si ...pse kjo është kështu? Përgjigja e vetme që mund të jepet është se pa diskutim çdo gjë varet në dëshirën e Zotit. Dhe në këtë mënyrë ata do të forcojnë edhe me shumë besimin në Zot, në më të Madhërueshmin dhe më të Lartin.

Prandaj nuk është as e nevojshme të shqetësohemi apo të kemi dyshime në lidhje me fushat e tjera të dijes dhe shkencës. Zotërimi i këtyre njohurive jo vetëm që nuk do të dobësojë asnjëherë besimin në Islam, por as do të mund ta shkatërrojë këtë besim. Por në të kundërtën ky besim do të forcohet akoma me shumë, dhe në të njëjtën kohë zotërimi i këtyre njohurive do t'i ndihmojë shoqëritë muslimane të mbahen më fort dhe të mos kenë frikë të krahasohen në fushat e tjera të dijes me të tjerët.

Për tu siguruar se muslimanët kanë një udhëheqje të vërtetë fetare, dhe që nuk do të mbeten mbrapa në asgjë që ata mësojnë, shoqëritë muslimane duhet të plotësojnë radhët e tyre me specialistë në *akide* dhe *ibadet*. Këta specialistë apo ekspertë duhet të jenë aty për të mirën e shoqërisë dhe jo vetëm për të mirën e vetes në këtë botë dhe për në botën tjetër, pasi edhe roli i tyre është ndryshe nga ai i priftërinjve apo murgjve në fenë e krishtere, apo të udhëheqësve fetare në fetë e tjera. Roli i tyre nuk është si ai i mediatorit apo ndërmjetësit midis muslimanëve të tjerë dhe Zotit, por ata janë në shoqëri thjesht për t'iu shërbyer muslimanëve të tjerë në lehtësimin e

kuptimit të fesë. Pra specializimi në besim dhe adhurime, është një diçka e mirë jo vetëm për shoqërinë, por edhe për vetë këta specialistë, por kjo nuk duhet të çojë në neglizhimin e specializimeve në fushat e tjera të dijes, pasi në qoftë se specializimi në fushat e tjera të rëndësishme do të neglizhohet për të vetmen arsye për të arritur shpërblimet në këtë botë apo në tjetrën, (nëpërmjet studimit të akides dhe ibadeteve) konsekuencat nuk do të jenë ashtu siç i kërkon Islami.

Një besim fetar që të ekzistojë i duhet të këtë besimtarët pas. Por në qoftë se një shoqëri muslimane, për shkak të dëshirës që të bëhet e njohur si një shoqëri plotësisht islame, do të vijë duke u dobësuar në të ashtuquajturat njohuri “të kësaj bote” të cilat janë shumë të rëndësishme për mbijetesën e kësaj shoqërie, dhe kur kjo shoqëri do të shkatërrohet nga armiqtë e saj, Islami nuk do të ekzistonte më në këtë shoqëri. Një shembull i qartë është Spanja, ku Islami ka humbur çdo shenjë të ekzistencës në këtë vend. Sot në Spanjë pasardhësit e muslimanëve janë kristiane, dhe xhamtë e paraardhësve të tyre sot janë kthyer në muzeume apo kisha. E njëjta gjë ka nisur të ndodhë edhe me disa shtete arabe muslimane në Azinë Perëndimore. Pra është shumë e drejtë të thuhet se kur një shoqëri muslimane, hedh poshtë apo kundërshton mësimin dhe marrjen e njohurive të tjera që nuk janë të lidhura me akiden dhe ibadetet, por që janë të lidhura me mbrojtjen dhe mirëqenien e vetë shoqërisë, kjo shoqëri nuk është aspak në përputhje me principet e Islamit. Dhe ata që e kundërshtojnë këtë edukim do të jenë më shumë fajtorë në qoftë se e bëjnë me dëshirën për të treguar se shoqëria e tyre është “kampionia e fesë”, pra nëse e bëjnë vetëm për krenarinë e tyre dhe për tu treguar si “fetarë”. Dhe për të vendosur nëse kjo që u tha është një diçka e ekzagjeruar apo jo, është e

nevojshme të bëhen disa studime në disa shoqëri muslimane që kanë pushuar se ekzistuari.

Por “dilema” e edukimit për malajzianët (malajtë) shkon deri atje kur zgjedhin midis edukimit “fetar” dhe atij “jofetar”. Edhe pse dyshimeve të tyre, iu gjenden përgjigjet mbi fushat e dijes që Perëndimi i quan si edukim “shekullar” apo “perëndimor” ata akoma zgjedhin midis fushave që duan të specializohen. Po ku vallë qëndrojnë bazat e tyre në këto zgjedhje!?

Edukimet e tjera përveç atyre “fetare” zakonisht konsiderohen thjesht si një mënyrë për të siguruar jetesën, pra kërkohen për vlerat e tyre ekonomike. Rëndësia e dhënë në vlerat ekonomike është kaq e madhe sa që mund të themi nga presioni i madh vendosen edhe vlera ekonomike edhe në vetë edukimin “fetar”. Pra vlerat ekonomike mund të terheqin më shumë njerëz për të studiuar “fenë” dhe si rrjedhojë do të kemi përhapjen e njohurive fetare, por kjo do të rrisë numrin e njerëzve që do ta shikojnë fenë thjeshtë si një mënyrë për të pasur një siguri ekonomike. Ata që e shikojnë njohurinë fetare d.m.th. akiden dhe ibadetin thjeshtë si një vegël ekonomike nuk do të përfitojnë nga kjo njohuri as nga ana fetare dhe as nga ajo shoqërore. Njohuria fetare është për të arritur shpirtëroren, spiritualen, dhe për shkak të kësaj njohurie fetare kur një njeri fiton një të ardhur, kjo duhet parë vetëm si një incident. Se që të shikosh njohurinë fetare si një burim për një të ardhur kjo do të thotë se vlerat materialiste kanë mbizotëruar vlerat spirituale. Me fjalë të tjera dija fetare nuk ka arritur sukses në formimin e vlerave të dëshiruara shpirtërore. Megjithatë, prapë shoqëria duhet ta vlerësojë dijen fetare edhe të këtij njeriu, se në qoftë se ai me punën e tij do t’i japë këto dije tek një njeri tjetër që është më serioz në këtë pikë, kjo

do të sjellë vlera të mira në shoqëri, dhe kontributi i të dyve duhet të vlerësohet.

Është fakt se edukimi në fusha të ndryshme të njohurive të kësaj bote, mund të sjellë një jetë më të mirë dhe për këtë shkak do të jetë shumë e arsyeshme për të kërkuar këtë edukim. Natyrisht një edukim që jep të ardhura më të larta dhe më të mira do t'iu interesojë më shumë studentëve. Por, ka raste që interesi në vetë fushën e zgjedhur nuk ka lidhje me të ardhurat që merren. Shpesh një fushë dijeje që kërkon më shumë aftësi në zotërimin e saj, siguron të ardhura më të larta, kur në të njëjtën kohë ajo që është më e lehtë do të sjellë me pak të ardhura.

Pra zgjedhja e vetë fushës së studimit bëhet një problem tjetër në "dilemën" e edukimit. Ky problem shikohet në zgjedhjen midis shkencave të artit dhe shkencave shoqërore nëpër shkolla. Shkencat e artit mendohet të jenë më të lehta se shkencat e tjera shoqërore, kështu që shumica e studentëve malajzianë zgjedhin shkencat e artit. Dhe s'ka rëndësi nëse kjo i kënaq të gjithë apo jo, numri i shumtë i atyre që marrin artet, do të bëjë që në shkencat e tjera të jetë një numër më i vogël i studentëve malajzianë. Dhe nëpër universitete do të shikojmë vetëm një pjesë të vogël të studentëve malajzë që studiojnë shkencat e tjera.

Kjo gjë e bën të gjithë shoqërinë të pakënaqur, por ata do të jenë më të pakënaqur kur të dinë faktin se kjo krijon një rreth vicioz, ku numri i pakët i studentëve në shkencat shoqërore, bën që numri i mësuesve që do të dalin nesër gjithashtu do të jetë i vogël, dhe kjo do të sjellë mangësi nga ana e studentëve në shkencat e tjera shoqërore. Për shkak se suksesi në shkencat shoqërore është pak i vështirë të arrihet, si rezultat kemi edhe mangësi të studentëve malajas në këto fusha. Por mangësia e

studentëve do të thotë mangësi e njerëzve të kualifikuar dhe mësuesve në këto shkenca dhe si rrjedhojë rrethi do të vijë duke u ngushtuar akoma më shumë në mangësitë dhe në arritjen e mospushtesit të studentëve në këto fusha.

Si rezultat i kësaj mangësie thirrjet nga shoqëria malajziane rriten akoma më shumë, e këto thirrje u çohen edhe autoriteteve, hapen nëpër shoqëri dhe në studentë. Por edhe pas këtyre thirrjeve çdokush shpreson se dikush tjetër do t'i përgjigjet i pari kësaj thirrjeje. Askush nuk e merr iniciativën, vetë ata persona që bëjnë këto thirrje ngurrojnë më shumë t'i çojnë fëmijët e tyre në shkollat me drejtim shkencor për shkak të rezultateve që ata do të marrin. Dhe kështu shoqëria malajzase vazhdon të këtë mangësi në studentët që studiojnë shkencat.

E njëjta gjë ndodh edhe për studentët malajas, të cilët mbarojnë studimet në këto shkenca. Edhe pse ata kërkojnë që të rritet numri i mësuesve nëpër shkolla që flasin gjuhën malajziane (Bahasa Malaysia) në mënyrë që të rritet numri i nxënësve, kur vjen puna kur këta kryejnë shkollat dhe duhet të fillojnë punë, këta vetë nuk duan të punojnë si mësues.

Dhe kjo mund të themi se nuk ndodh vetëm me shkencat shoqërore. Pothuajse në të gjitha fushat që janë të vështira për t'u zotëruar dhe kërkojnë kohë për t'u mbaruar, konkurrimi do të mënjanohet nga studentët malajas duke gjetur arsye nga më të ndryshmet. Dhe kërkesa bëhet që numri i vendeve për arte të rritet më shumë, që të kenë më shumë mundësi konkurrimi. Por kjo gjë është shumë e dëmshme pasi do të ndikojë më vonë në plotësimin e administratës apo posteve të ndryshme me njerëz që nuk janë të kualifikuar për postin e vet. Dhe në këto kohë poste të ndryshme dhe disa vende pune janë shumë të rëndësishme për të ruajtur paqen dhe mirëqenien e kombit dhe të shoqërisë. Këto poste

patjetër që duhet të mbushen vetëm me njerëz shumë të kualifikuar, pasi sa më shumë janë të trajnuar ata për këtë punë, aq më mirë do të bëhet puna nga këta njerëz. Dhe në qoftë se të gjitha postet do të mbusheshin me ekspertë dhe me njerëz të kualifikuar, populli dhe shoqëria patjetër që do të ishin më progresive dhe më të qeta.

Duke parë se malajasit vetë si individë nuk janë të gatshëm të zgjedhin një edukim për veten e tyre që më vonë do t'i ndihmonte interesit të shoqërisë dhe të vendit, dhe duke parë konsekuencat e zgjedhjes se tyre të pabaza, atëherë shoqëria mundohet të mos e neglizhojë detyrën e saj ndaj këtyre individëve. Shoqëria vetë vendos, patjetër në limite të pranueshme, fushën e edukimit që secili mund të ndjekë.

Pra ndarja në arte apo shkencat e tjera që kanë filluar të praktikohen në Malajzi këto kohët e fundit, janë një përpjekje nga ana e komunitetit për të korriguar mosbalancimin në edukim dhe në punësim. Ky qëndrim i shoqërisë, i cili riprezantohet nga qeveria, interpretohet si i drejtë dhe i përshtatshëm. Por në të njëjtën kohë kur individët si pjesëtarë të shoqërisë e mirëpresin këtë politikë apo reformë të ndjekur nga qeveria, individët si individë nuk do të bien "viktimë" e këtij inspirimi të shoqërisë. Kështu që presionet nga individët e ndryshëm në mosrënien dakord me këtë politikë e detyrojnë shoqërinë të ndryshojë qëndrimin e saj. Dhënia përparësi e shkencave të tjera shoqërore që më parë konsiderohej shumë e rëndësishme nuk implementohet më si më parë. Dhe efekti dihet, numri i shkencëtarëve malajas sa do të vijë dhe do të pakësohet dhe kjo do të sjellë pakënaqësi tek qytetarët.

Në këtë çështje përgjegjësitë dhe të drejtat e individit si individ, dhe si një pjesëtar i shoqërisë duhet të kuptohen

dhe të praktikohen. Njeriu nuk mund të jetojë vetëm në izolim, por duhet të jetojë me familjen dhe në një shoqëri.

Edhe në çështjen e edukimit këto të drejta që u përmendën më lart nuk janë gjithmonë absolute. Shoqëria i siguron individit mundësi edukimi sepse, nga ky edukim më vonë do të përfitojë jo vetëm individi, por edhe vetë shoqëria.

Dhe ky përfitim i të dyve do të shihet më mirë kur individi mbaron një edukim që është i përshtatshëm për punën që ai do të kryejë më vonë, pra ai gjen punën e përshtatshme për edukimin që ka mbaruar (këtu ai përfiton) dhe shoqëria merr të mirat nga shërbimet e tij, (këtu shoqëria përfiton).

Por në qoftë se ai edukohet në një fushë të veçantë dhe fillon punë në një fushë tjetër që nuk ka lidhje me atë për çka ai ka mbaruar, këtu ai ndoshta prapë do të ketë përfitim si individ, por shoqëria nuk do të ketë asnjë dobi prej tij. Por nuk përjashtohen edhe rastet kur asnjëri nuk ka përfitim dhe kjo ndodh kur njohuria e marrë nga individi gjatë edukimit të tij nuk është aspak e përdorshme. Dhe në shoqërinë moderne, ata që janë të papunë për shkak të mungesës së aftësive të tyre janë një barrë për shoqërinë.

Prandaj shoqëria ndonjëherë nuk duhet të lëshojë shumë pe në dëshirat dhe kërkesat e individit. Edukimi që sigurohet prej saj duhet në radhë të parë të jetë në interesat të vetë shoqërisë. Dhe këta nxënës apo studentë duhet të pranojnë këshillat apo udhëzimet e dhëna nga liderët apo planifikuesit që ka caktuar shoqëria për t'u marrë me këtë punë. Refuzimi i tij, i këtyre direktivave duhet të gjykohej nga shoqëria me refuzimin për të mos i siguruar apo garantuar një punësim në të ardhme.

Dhënia prioritet interesave të shoqërisë, ndonjëherë ndikon në disa studentë. Detyrimi i studentëve të zgje-

dhin fusha të veçanta të edukimit ndoshta i zhgënjën ata dhe kjo ndikon që ata të dështojnë në studimet e tyre. Por, edhe në qoftë se atij i jepet mundësia vetë të zgjedhë dhe ai zgjedh diçka që nuk është shumë e vlefshme më vonë ai do të mbetet i papunë dhe, edhe kjo do të ndikojë tek ai. Por, në anën tjetër, kur ai forcohet të zgjedhë në fushat e veçanta aty përsëri ka mundësi të gjejë punë, tani e gjitha varet tek puna e tij që do të bëjë për të arritur një sukses në këtë edukim dhe menjëherë pas mbarimit mund të fillojë punë në vendin e premtuar. Dhe në qoftë se ndodh në këtë mënyrë të dy palët do të kenë një përfitim, megjithëse dëshira e studentit nuk u realizua të studionte në specialitetin që ai dëshironte.

Përveç kësaj, një fushë e re dhe jo shumë e lehtë ndoshta nuk do të jetë shumë tërheqëse për njerëzit dhe do të mbetet si e tillë derisa dikush do të marrë iniciativën dhe të futet i pari. Dhe kur akoma më shumë njerëz do të vijnë në atë fushë atëherë, kjo nuk do të mbetet më si e tillë, njerëzit do të tërhiqen më shumë .

Ka qenë një kohë kur mendohej se pilotë mund të bëheshin vetëm njerëzit e Perëndimit. Malajziani i parë që u fut në këtë profesion dhe u trajnua, u konsiderua si i jashtëzakonshëm. Më pas prindërit e atyre studentëve që zgjidhnin këtë si profesion nuk ishin shumë të kënaqur, por sot megjithëse akoma ka prindër që nuk janë të kënaqur me këtë zgjedhje të fëmijëve të tyre, pilotimi si profesion nuk shikohet me atë sy siç shikohej me parë. Tani që ta zgjedhësh profesionin e pilotit nuk është më aq profesion i vështirë ashtu siç mendohej më parë, dhe pa dyshim do të vijë një kohë që të zgjedhësh të bëhesh pilot do të bëhet si diçka e zakonshme, ashtu sikur të ngasësh një makinë.

Mos të harrojmë se së pari çdo fushë duhet të këtë pionierët e saj të parë. Edhe pse një pionier i vetëm do

të japë shembullin e tij, ai do të ndiqet shumë shpejt nga të tjerët, dhe me kalimin e kohës numri i tyre jo vetëm që do të rritet, por kjo fushë do të bëhet e frekuentueshme si gjithë të tjerat.

Pra edhe një herë na vjen në skenë fenomeni i rrethit vicioz. Në qoftë se në një fushë asnjë nuk do të bëhet pionier i parë, askush nuk do të dëshiroje të futet në këtë fushë, por me ardhjen e të parit, ai do të ndiqet nga të tjerë më pas dhe nuk do të kalojë shumë kohë kur numri i tyre do të shumëfishohet me ritme të shpejta. Ky fenomen na tregon se talentet ekzistojnë në një shoqëri, por ata duhet të zbulohen. Nganjëherë një talent del në sipërfaqe vetë në mënyrë spontane dhe e thyen këtë rreth vicioz, por një shoqëri që është në progres nuk mundet gjithmonë të presë për çdo gjë të dalë kur dëshiron. Një shoqëri që është e vetëdijshme për përgjegjësitë e saj i duhet t'i zbulojë vetë talentet dhe të planifikojë pionierët në çdo fushë dhe gjithashtu të vëzhgojë e të ndjekë nga afër zhvillimet që do të vijnë më pas.

Pra nga ky diskutim mund të themi se përgjegjësitë e një shoqërie janë mjaft të qarta. Në të njëjtën kohë kur dëshirat dhe të drejtat e individit duhet respektuar, edhe interesat e shoqërisë nuk duhet të neglizhohen, vetëm e vetëm për të respektuar të drejtën e individit. Në rastin e edukimit, kjo do të thotë se shoqëria duhet të identifikojë cilat fusha të edukimit janë ato më të rëndësishmet për të dhe kështu direkt ajo do të rregullojë individin në këto fusha në lidhje edhe me nevojat e tij.

Për shoqërinë malajziane në veçanti atë malajase, ky problem përbën një tjetër dilemë. A duhet të jetë shoqëria e prerë në qëndrimin e saj për vendosjen e edukimit që duhet të jepet tek gjeneratat e reja, pa marrë parasysh rënien apo heqjen dorë të shumë prej kandidatëve nga vendosja e bërë? Apo duhet shoqëria të sigurojë edukime të

cilat nuk janë aspak me vend dhe të nevojshme vetëm e vetëm për të plotësuar dëshirat e fëmijëve të tyre për t'i parë ata të kënaqur dhe duke i mbaruar këto shkolla?

Dhe së fundi problemi i gjuhës është një tjetër problem, i cili bën pjesë në dilemën e edukimit tek malajzianët. Gjatë periudhës nën kolonializimin britanik, gjuha malajase, *Bahasa Malay*, siç quhet në gjuhën vendase, filloi të neglizhohej gati sa edhe të harrohej. Për çdo racë, apo shoqëri, humbja e gjuhës do të thotë humbje e identitetit. Kështu edhe për malajasit, gjuha ka të bëjë me çështjen e ndjenjave. Ata dëshirojnë që gjuha e tyre jo vetëm të mbijetojë dhe të flitet në mënyrë të shkëlqyer, por ta bëjnë përdorimin e saj në një shkallë me gjuhët e tjera të njohura në botë.

Dhe kjo nuk është vetëm një ëndërr për ta, pasi gjuha malajziane ka filluar të përdoret si gjuhë ndërkombëtare. Para se të pranohej si një gjuhë zyrtare në këtë vend, kjo gjuhë ka qenë edhe gjuha kombëtare në Indonezi, me popullimin e saj prej 100 milionë banorë. Por përdorimi i gjuhës indoneziane garantoi sovranitetin e gjuhës malajziane, dhe me pranimin e malajzisches si një gjuhë kombëtare, e ardhmja e këtij vendi u bë akoma më e sigurt.

Dhe qysh pas fitores së pavarësisë nga Federata Malaje, apo Federata e Malajzisë, fushata të gjëra mbarëkombëtare u mbajtën për të bërë përdorimin e Bahasa Malajsia, gjuhës malajziane, të një rangu më të gjerë. Departamentit të gjuhës ju dha si detyrë që bënte kërkime dhe të bënte të mundur përdorimin e fjalëve dhe terminologjive të reja në gjuhë. Nëpër shkolla përdorimi i gjuhës malajziane u bë i detyrueshëm nga klasat e ulëta deri në nivelet më të larta. Dhe me anë të këtyre reformave të marra, gjuha që në kohën e kolonializimit ishte në pragun e zhdukjes së saj si gjuhë, tani përdoret edhe në nivelet universitare, kështu që nxënësit mund të ndjekin

fare lehtë leksionet dhe të marrin diplomat e tyre në po këtë gjuhë.

Tani pozita e gjuhës malajziane në lobin e edukimit nuk është më në dyshim. Jo vetëm qeveria dhe vetë malajsit, por edhe racat e tjera jomalajase (kinezët dhe indianët), e kanë pranuar gjuhën malajziane si gjuhë zyrtare dhe janë plotësisht të gatshëm të marrin njohuritë e tyre në këtë gjuhë. Pra përpjekjet e malajasve për ta bërë gjuhën e vet të përjetshme dhe të kohës, kanë arritur suksesin e dëshiruar, megjithëse nuk përjashtohen rastet e pakënaqësive në disa pakica.

Por përveç zotërimit të gjuhës malajase edhe në gradat shkencore më të larta, në kohët moderne ata që janë më të edukuar zotërojnë edhe gjuhë të tjera të huaja. Në fakt zotërimi i më shumë se një gjuhe të huaj, i jep çdokujt mundësi më të mëdha për aktivitetin e tij, dhe jo vetëm që shton një fushë tjetër në njohuritë e tij, por gjithashtu është një burim tjetër informacioni. Kështu që personi që zotëron dy ose me shumë gjuhë të tjera ka më shumë avantazhe ndaj atij që zotëron vetëm një gjuhë. Dhe këtu duhet të theksojmë se çështja nuk ngrihet se çfarë gjuhe di, por sa gjuhë di. Pra çështja nuk është kapaciteti apo aftësia e gjuhës kombëtare si një mjet komunikimi apo zotërimi të njohurisë së saj. Megjithëse të zotërosh mirë vetëm gjuhën kombëtare mund të jesh plotësisht në gjendje t'ia arrish qëllimeve të tua për të marrë njohuri, zotërimi i një gjuhe të vetme pa pasur njohuri mbi asnjë gjuhë tjetër tregon një dobësi të njeriut.

Duke e konsideruar këtë fakt, mund të themi se qëndrimi i malajzianëve dhe në veçanti studentëve malajas për të mos mësuar gjuhë të dyta, është mjaft i gabuar. Patjetër që pranimi i gjuhës kombëtare si e tillë është e padiskutueshme, por refuzimi i mësimit të gjuhëve të tjera nuk mund të merret si një qëndrim pionier në këtë kauzë. Qëndrimi i

tyre ndaj refuzimit të gjuhëve të tjera është i pabazë dhe i pakuptimtë. Pa diskutim devijimi në implementimin e gjuhës kombëtare, apo në fjalë të tjera mund të themi se përdorimi i gjuhëve të tjera dhe jo asaj malajase duhet kritikuar, por edhe hedhja poshtë apo refuzimi i mësimin të gjuhëve të tjera nuk mund të konsiderohet aspak si një qëndrim i mirë, apo si qëndrim i një kampioni.

Ky qëndrim i pajustificuar mbi mësimin e gjuhëve të huaja nuk është korrekt dhe padyshim që do t'i ketë efektet tek malajasit. Krenaria e malajasve që përdornin vetëm anglishten në kohë e kolonializimit britanik nuk duhet të përsëritet në kohët e sotme me gjuhën malajase, duke refuzuar gjuhët e tjera. Se shoh aspak të gabuar pse malajzianët mos të ndihen krenarë kur këta krahas gjuhës se tyre kombëtare të zotërojnë dhe të flasin rrjedhshëm edhe një gjuhë të dytë, çfarë do qoftë kjo gjuhë.

Pasi tani anglishtja nuk është më si më përpara e përdorshme në shumicën e shkollave në vend, kështu që zotërimi i saj tani nuk është dhe aq i lehtë si me parë, pasi një gjuhë zotërohet mirë vetëm kur ka një përdorim të gjerë. Pra është e vështirë të zotërosh një gjuhë të huaj kur ajo mësohet vetëm si lëndë e veçantë në shkolla, por megjithatë kjo nuk mund të sillet si një arsye për të shfaqësuar rezultatet e dobëta në përdorimin dhe zotërimin e anglishtes nga studentët malajas. Ajo që nevojitet është dëshira për të mësuar dhe për të përdorur këtë gjuhë edhe jashtë ambienteve shkollore. Përdorimi i anglishtes në këtë mënyrë nuk do të thotë se ata janë duke e hedhur poshtë gjuhën e vet kombëtare apo i japin më pak rëndësi gjuhës malajase si gjuhë. Por refuzimi i mësimin dhe zotërimin të anglishtes apo i gjuhëve të tjera për mendimin tim tregon një personalitet të dobët të tyre që ka frikë të ekspozohet me botën e jashtme.

Në përpjekjet e tyre për të ngritur nivelin e gjuhës së tyre kombëtare, malajasit ishin të detyruar të kundërshtonin dhe ta linin pas dore anglishten si gjuhë, që propagandohej nga qeveria kolonizatore angleze. Pra anglishtja u bë simbol i kolonializimit dhe përdorimi, ashtu si dhe mësimi i kësaj gjuhe, në atë kohë filloi të kundërshtojë rëndshëm. Pranimi i gjuhës malajase si një gjuhë zyrtare do të thoshte se anglishtja nuk mund të përdorej më si një gjuhë e administratës, që do të thoshte se gjuha malajase tani ia hapi dyert edukimit në të gjitha nivelet, të punësimit në të gjitha llojet e punëve, si dhe në administratë ku më përpara mbahej vetëm nga kolonizuesit anglezë.

Megjithatë me pak fjalë mund të themi se “dilema” e edukimit tek malajasit, vjen rreth çështjes së besimit fetar, zgjedhjes së fushave të edukimit apo arsimimit, dhe problemit të gjuhës. Në të vërtetë këto “dilema” janë vetëm diçka e imagjinuar pasi janë të bazuara në keqkuptimin, në keqinterpretimin dhe në logjikën e dobët. Këto “dilema” do të vazhdojnë të ekzistojnë dhe do të bëhen një pengesë për progresin dhe integritetin fetar midis malajasve, derisa ato të analizohen dhe të korrigjohen deri në rrënjë. Por përderisa vetë malajasit, nuk janë në gjendje të ballafaqohen me realitetin, ata do ta kenë të pamundur t’i kapërcejnë këto “dilema” që i kanë pushtuar mendjet e tyre. Dhe padyshim që do të jetë e paevitueshme kur me praninë e këtyre “dilemave” falsifikuese në mendjet e tyre, ata do të mbeten gjithmonë prapa kohës dhe do të dështojnë të kenë edhe identitetin e tyre.

Kapitulli IV

Perëndimi dhe Lindja

Njëzet vjet me parë në qoftë se do t'i thoshim një djali të ri t'i rriste flokët, patjetër që ai do të protestonte. Ai do të arrinte në konkluzion që personi që e urdhëroi të vepronte kështu ishte i lënë mendsh ose jashtë mode. Ai kurrë nuk do ta mendonte se ky person ishte një ultramodern që mund të predikonte ndryshimet që do të sillte koha.

Mirëpo sot, djemtë e rinj me stilet e flokëve si të grave janë një diçka e zakonshme. Ata ecin me kokat lart dhe pa pasur fije turpi. Në shtëpi, zyra, universitete, xhami, shpesh shikojmë këta djem të rinj duke pozuar flokët e gjata. Kur ndonjë prej këtyre të rinjve vendos edhe kapelën e faljes (*kopiah*) duket sikur e vendos mbi një tufë flokësh, dhe e njëjta gjë duket edhe kur ata vendosin kapele të thjeshta, dhe kur i sheh nga prapa ju nuk mund ta dalloni një grua nga një burrë.

Ky fenomen është një evidencë e dominimit perëndimor mbi lindjen, dhe Malajzia me malajzianët nuk qëndron aspak prapa në përuljen përpara kësaj dominance perëndimore. Atë që Perëndimi do të bëjë sot, Lindja do ta bëjë të nesërmen dhe malajzianët ditën tjetër. Në qoftë se Perëndimi do të ndalte, atëherë dhe Lindja do të ndalet mbi të nesërmen dhe malajzianët si pasojë.

E gjitha kjo nuk është një fenomen i ri dhe nuk mund të fokusohet vetëm tek flokët e gjata. Pse zyrtarët

Perëndimorë veshin kostume me kollare gjatë orarit zyrtar, edhe pse veshja malajziane është më e përshtatshme për vetë klimën malajziane, zyrtarët tanë dëshirojnë të veshin kostume me kollare. Dhe nuk është vetëm veshja zyrtare perëndimore që ne kopjojmë, virtualisht çdo gjë që Perëndimi bën në mundohemi më së miri ta kopjojmë.

Faktikisht kopjimi nuk është gjithmonë i keq. Është një mënyrë të mësuar. Fëmijët mësojnë të folur dhe normat e sjelljes nëpërmjet kopjimit. Nga një gjeneratë në tjetrën, kopjimi ruan normat dhe vlerat e njerëzve. Kopjimi bëhet problem kur bëhet pa u menduar, apo pa u peshuar nëse ajo çfarë po kopjohet është e mirë apo e ligë.

Përgjatë historisë së lidhjeve midis Perëndimit dhe Lindjes, shpjegohet pse Lindja kaq shpesh kopjon Perëndimin, apo mundohet t'i bëjë gjërat sipas ideologjisë Perëndimore.

Vendet perëndimore gjithmonë kanë ardhur si pushtues të fuqishëm, duke pushtuar dhe nënshtruar vendet e Lindjes. Superioriteti i tyre u provua jo vetëm me sukseset në pushtimin e vendeve të Lindjes edhe pse me ushtri më të vogla se të Lindjes, por gjithashtu edhe në imponimin e ligjeve koloniale.

Pra suksesi i popujve të Perëndimit ja kaloi vendeve Lindore dhe në qoftë se Perëndimi ishte kaq i suksesshëm kjo mundi të ndodhte për arsye të cilësive të vetë njerëzve. Pra po të bazohemi në këtë pikëpamje, vetë ideja se i njëjti sukses mund të arrihet duke kopjuar cilësitë e vetë Perëndimit, që mund të themi se është një krahasim mjaft logjik. Dhe kështu Lindja kopjon Perëndimin në çdo fushë, nga politika dhe sistemi administrativ, gjuha, feja, kultura dhe shumë aspekte të tjera.

Pra është mjaft e qartë se kopjimi është bërë në mënyrë abuzive pa e peshuar nëse ajo që kopjohet është e mirë apo e ligë, apo nëse ka kontribuar kjo gjë në suk-

sesin e vetë Perëndimit apo jo. Dhe me keqardhje mund të thuhet se kopjimi është bërë edhe në ato gjëra ku është parë se ato kanë sjellë një rënie, humbje apo mos-sukses të vetë Perëndimit.

Një diçka që u kopjua pa u studiuar apo pa u menduar mund të themi se është veshja. Njerëzit në Perëndim, pikërisht burokratët britanikë, kanë pasur ligje apo rregulla shumë të ngurta rreth veshjes. Veshja e ditës ishte ndryshe nga veshja në darkë, dhe veshje të veçanta ishin të detyrueshme në rastet e veçanta. Dhe çdo njeri që nuk i përmbahej këtyre formave shihej me një sy tjetër dhe me një poshtërim nga vetë komuniteti.

Këto rregulla të veshjes, në fakt reflektonin karakterin e një klase të veçante të shoqërisë angleze, të cilët visheshin mjaft me gusto dhe ishin të një shtresë të lartë që i jepnin shumë rëndësi veshjes. Në qoftë se këto rregulla strikte dhe shumë komplekse do të respektoheshin e ndiqeshin me përpikëri, patjetër që ato do të rezultojnë në një vetëdisiplinë të njerëzve. Kështu që për një komb kaq të vogël, që mundi të sundonte një të katërtën e botës patjetër që disiplina ishte shumë e rëndësishme. Pa disiplinë ata asnjëherë nuk do të kishin mundur të kontrollonin situatën, kur ka pasur raste që vetëm dy apo tre prej tyre të kontrollonin me qindra apo me mijëra njerëz të racave të tjera. Pra rregullat e veshjes mund të konsiderohen si një trajnim dhe një praktikë për të arritur këtë disiplinë.

Popujt që kanë qenë të kolonializuar nga anglezët shpesh kanë kopjuar në rregullat e veshjes, për vetë arsyen se ata i respektonin dhe i shikonin anglezët si një popull me i lartë e i civilizuar. Por siç thamë më lart disiplina angleze në ato kohë ishte mjaft e lidhur me veshjen e tyre, kopjimi i veshjes solli në mënyrë indirekte në kopjimin e disiplinës së tyre. Pra mund të themi se edhe pse kopjimi i mënyrës së veshjes nuk ishte shumë i përdor-

shëm në vetvete, trajnimi dhe disiplina e bazuar në rregullat e veshjes pati mjaft të mira dhe dobi tek ata që u munduan ta kopjonin.

Në qoftë se ne do të studionim historinë e popujve të kolonializuar nga Perëndimi, një fakt që do të na bjerë në sy është mungesa e disipline tek këta popuj. Për shembull taktika dhe organizimi i forcave të armatosura të Malakës (njërit prej shteteve të Malajzisë) kur kanë luftuar kundër pushtimit portugez mjaft qartë tregon se ata nuk kishin disiplinë strikte të forcave perëndimore. Rënia e Malakës në duart e portugezëve ndoshta kishte edhe dobësi të tjera që nuk po i përmendim, por e rëndësishme të theksojmë është se në qoftë se forcat e armatosura të Malakës do të kishin një disiplinë të mirë, ata nuk do të kishin rënë aq shpejt në duart e forcave portugeze ose ndoshta forcat portugeze nuk do të kishin mundur t'i mposhtnin dhe t'i pushtonin.

Pra meqë disiplina është një veti e mirë, dhe në qoftë se kopjimi i veshjes angleze sillka disiplinë, atëherë mund të themi se ky kopjim e ka një justifikim. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për veçoritë e tjera të Perëndimit të kopjuara apo të marra nga Lindja në kohët e imperializmit perëndimor. Çfarëdo që u mor apo u kopjua është provuar se ka sjellë dobi dhe asnjë nuk mund ta kundërshtojë faktin se një nga rezultatet më të mëdha ishte çlirimi i territoreve të Lindjes të kolonializuara nga Perëndimi. Popujt e kolonializuar fituan pavarësitë nëpërmjet organizimit dhe taktikave të kopjuara nga Perëndimi. Por i vetmi komb që nuk ka qenë asnjëherë i kolonializuar dhe ka arritur një sukses të jashtëzakonshëm si rezultat i një kopjimi apo marrje sistematike të eksperiencës perëndimore ka qenë Japonia.

Pavarësia e popujve të Lindjes shkaktoi një reaksion zinxhir, i cili përfundoi me humbjen e fuqive Perëndi-

more mbi kolonitë e tyre. Humbja e kolonive dhe e pasurive që vinte prej tyre, çoi në një ndryshim radikal të psikologjisë perëndimore. Tani Perëndimi nuk mund të krekosej më apo të sillej në atë mënyrë si njerëzit më të zgjedhur, të cilët e gjithë bota duhet t'i respektonte dhe të frikësohej. Djelmoshat e tyre adoleshentë në veçanti nuk do të dërgoheshin më në vendet e kolonializuara për t'u bërë administratorë apo padronë të vendasve.

Megjithatë ndryshimi në psikologjinë perëndimore i shkaktuar nga humbja e kolonive nuk u arrit menjëherë, mund të themi se ai u arrit gradualisht, por kalimi i kohës i dha ritme të shpejta. Dhe së fundi të vjetrat u larguan përfundimisht pa pasur ndonjë vlerë të veçantë.

Dhe në qoftë se veshjen do ta merrnim edhe një herë si shembull, kundërshtimi me vlerat e vjetra është reflektuar në ndryshimin e stilit të veshjes. Rregullat e vjetra të veshjes në kohët e sotme janë hedhur poshtë plotësisht. Në qoftë se njëherë e një kohë të gjithë vishnin kostumet me kollare, në ditët e sotme ato quhen si të jashtë mode. Në qoftë se njëherë e një kohë këmishët e grisura nuk përdreshin tani këmishët dhe xhinset grisën para se të përdoren. Në qoftë se njëherë e një kohë këpucët duhet të ishin të një kualiteti të mirë sot konsiderohet diçka moderne të përdoren shapka të vjetra apo dhe të ecësh këmbëzbathur.

Siç e kemi përmendur edhe më lart, vendet perëndimore kanë shkaqe për të kundërshtuar vlerat e tyre të vjetra. Përveç humbjes së kolonive dhe burimeve të pasurisë që vinin prej tyre, lufta në Vietnam pati një efekt mjaft të keq në vetë-konfidencën e këtyre vendeve. Fuqitë e mëdha perëndimore u mundën nga një komunitet i vogël Lindor. Shpirtrat e tyre u ligështuan, u dobësuan dhe tani ata nuk mund të qëndronin më si një model për botën.

Rënia e Perëndimit do të thoshte një fitore për Lindjen, e cila njëherë e një kohë ishte koloni e Perëndimit. Në qoftë se vendet perëndimore do të vajtonin mbi humbjet e kolonisë të tyre, popujt e Lindjes duhet të festonin mbi fitoret e arritura. Në qoftë se vendet perëndimore do të reagonin mbi humbjet e tyre duke kundërshtuar apo hedhur poshtë vlerat e tyre të vjetra, vendet Lindore duhet të tregonin më shumë kujdes në vlerat që sollën për ta sukses. Në qoftë se veçoritë apo tiparet e kopjuara nga Lindja në erën e kolonializmit, si rregulli, disiplina dhe organizimi e çuan Lindjen drejt suksesit, këto veçori duhet të ruheshin. Nuk ka asnjë arsye që vendet e Lindjes duhet t'i hedhin poshtë këto vlera dhe norma të zhvilluara gjatë kolonializimit të tyre nga Perëndimi, ku e kundërta do të ndodhte me popujt e Perëndimit që ishin zhgënjyer nga vlerat dhe normat e tyre të vjetra.

Por, megjithëse Lindja arriti sukses dhe në terma relative mund të themi se Perëndimi humbi, zakoni i kopjimit apo marrjes nga Perëndimi diçka të veçantë nga të gjitha fushat, ka mbetur përsëri. Pra mund të themi se Lindja vazhdon të kopjojë verbërisht çfarëdo gjëje që Perëndimi bën.

Edhe një herë veshjen e marrim si një shembull. Rregullsia në veshje është hedhur poshtë nga gjeneratat e reja perëndimore për arsyet që i kemi shpjeguar më lart, pse e njëjta gjë duhet të ndodhë edhe në Lindje? Hodhën poshtë rregullat mbi veshjen dhe rinia sot guxon të veshë apo të ekspozohet me këmisha apo xhinse të grisura, të arnuara apo të vjetra dhe të pista. Zakoni i kopjimit është kaq shumë i rrënjosur në mendjet e njerëzve të Lindjes sa që ata akoma vazhdojnë të bëjnë, pa i vënë re shkaqet për të cilat perëndimorët i ndryshojnë zakonet e tyre.

Siç u përmend edhe më lart kopjimi i veshjes dhe rregullat e saj i çoi vendet e Lindjes të marrin nga vendet e Perëndimit disa vlera të mira, si disiplinën, por në të kundërtën do të ndodh me marrjen e veshjes së çrregullt. Vlerat e reja që do të vijnë pas saj do të kundërshojnë rregullat e disiplinës dhe ato do të zëvendësohen me një liri të pakufi.

Ne mjaft qartë e pamë se si me anë të kopjimit dhe praktikimit të vlerave dhe sisteme të vjetra të Perëndimit, popujt e Lindjes mundën të arrinin suksese në lidhje me pavarësitë e tyre. Dhe në qoftë se këto vlera dhe sisteme do të ruhen është e logjikshme se suksese të tjera i presin këto vende të pavarura Lindore. Por, në anën tjetër mund të themi se, në qoftë se ky sistem që solli sukses më parë, do të harrohet apo lihet pas dore nga popujt e Lindjes, pa dyshim kjo do të bëjë që këta popuj të kthehen prapa dhe të jenë atje ku ishin.

Është mjaft e qartë se Lindja edhe pse e lirë dhe e pavarur, akoma nuk ka arritur ato suksese si të Perëndimit dhe është shumë larg në këtë aspekt. Në qoftë se pasuria, fuqia-punëtore, dhe cilësitë e tjera të popujve të pavarur të Lindjes do të ishin organizuar apo konsoliduar më mirë drejt zhvillimit të vendit, edhe pse në të kaluarën sistemet perëndimore sollën sukses, Lindja do të ishte më e fortë dhe do të kishte arritur më shumë se Perëndimi. Por Lindja akoma është në fazat e para të zhvillimit, akoma është e pafuqishme, dhe kjo e bën të jetë larg prej Perëndimit në këtë aspekt. Shkaqet për këtë mangësi mund të jenë të ndryshme, por pa dyshim deri në një farë kufiri mund të themi se kjo ka ardhur si rezultat i kopjimit të vlerave të vjetra të Perëndimit nga ana e Lindjes dhe më pas zëvendësimi i tyre me rrugët e mënyrat e reja që mori Perëndimi që pa dyshim janë të pavlefshme edhe për vetë Perëndimin. Në qoftë se Pe-

rëndimi i mëparshëm i fortë dhe i qëndrueshëm tani do të dobësohej nga këto vlera dhe sjellje të reja pa dyshim që këto sjellje dhe vlera do të kenë një efekt akoma me negativ në vendet e reja pa eksperiencë të Lindjes.

Pra edhe rivaliteti midis Perëndimit dhe Lindjes do të jetë akoma në vazhdim. Perëndimi asnjëherë nuk e dëshiron ta shohë Lindjen më të fortë dhe më të avancuar pasi do të ishte një kërcënim për vetë Perëndimin. Kështu që edhe pse vendet perëndimore janë duke i lëshuar kolonitë e tyre njëra pas tjetrës ato përpiqen të mbrojnë vetveten nëpërmjet rrugëve apo mënyrave të tjera. Për shembull në fushën e ekonomisë ata krijuan Komunitetin Ekonomik të Evropës (European Economic Community-E.E.U), i cili do të jetë në gjendje të kontrollojë tregun botëror, kështu që Lindja nuk do të jetë në gjendje të dalë kundër shtypjes ekonomike të shkaktuar mbi ta nga vendet e Perëndimit.

Nëpërmjet ekzistencës së këtij tregu të kontrolluar, Perëndimi është gjithmonë në gjendje ta shtrëngojë Lindjen të pranojë çfarëdo çmimesh që Perëndimi vendos mbi produktet e Lindjes. Pra një formë e re e imperializmi ekonomik erdhi në fuqi si rezultat i bashkimit të vendeve Evropiane në E.E.U, Komunitetin Ekonomik Evropian. Nëpërmjet taksave, kuotave dhe kufizimeve të ndryshme, Perëndimi mundi të ndalonte çmimet e lëndës së parë, dhe të produkteve të industrisë moderne të Lindjes, të cilat ishin një kërcënim për të njëjtat produkte të të njëjtave industri në Perëndim. Kështu që në inflacionin botëror kur çmimet e hekurit dhe të kauçukut që ishin lënda e parë e siguruar nga Lindja, u rritën shumë pak dhe përsëri ranë poshtë, çmimet e produkteve të industrive perëndimore mbetën gjithmonë të larta.

Lindja tani e kishte mjaft të qartë se forcimi ekonomik i popujve të Perëndimit erdhi si rezultat i solidarite-

tit të tyre në tregun e kontrolluar nga E.E.U. Pra Lindja e dinte se ky kooperim ishte shumë efektiv, por popujt e Lindjes nuk ishin të përgatitur të merrnin një veprim të përbashkët për të thyer këtë bllok të krijuar nga Perëndimi, i cili ndodhi vetëm me shpërthimin e luftës së Yom Kipur (feste, festival çifut) në vitin 1973 në Azinë Perëndimore.

Një nga mënyrat për të bllokuar ndihmën e dhënë të Izraelit në luftë kundër vendeve arabe, vendet arabe me prodhim naftë morën disa masa konkrete si, uljen e eksportimit të naftës në vendet perëndimore dhe rritjen e çmimit të saj. Këto veprime treguan një efektivitet më të madh seç pritej sepse vendet perëndimore jo vetëm që ishin të detyruara të ndalnin ndihmën e dhënë më parë tek Izraeli, por gjithashtu ekonomia perëndimore filloi të ndiente inflacionet e para dhe kufizimet e bëra sollën një fund në erën e prosperitetit të këtyre vendeve.

Pra nga ky incident është mjaft e qartë se kooperimi midis popujve të Lindjes do të neutralizonte apo shfuqizonte këtë bashkëpunim të ngushtë të Perëndimit. Por, përveç prodhimit dhe tregtimit të naftës popujt e Lindjes nuk janë të përgatitur të kooperojnë. Në këto vende ekziston konkurrenca midis njëri tjetrit në marketingun e lëndës së parë, edhe pse kontrata tregtie vendosen midis tyre për të bashkëpunuar, ata i thyejnë këto kontrata shumë shpejt. Në përpjekjet për të arritur një imperializëm ekonomik perëndimor, krijimi i një marketi të përbashkët si E.E.U., Komuniteti Evropian ishte e vetmja teknikë e përdorur nga Perëndimi. Por një nga dobësitë e Perëndimit është niveli i jetesës, i cili është mjaft i lartë, dhe bën që puna e krahut të jetë shumë e shtrenjtë dhe si rezultat kostoja e prodhimit të produkteve të manifakturuara të jetë shumë e lartë. Perëndimi mundohet ta zgjidhë këtë problem duke përdorur maki-

na apo teknika më efikase, por të gjitha këto teknika mund të kopjohen nga Lindja.

Në Lindje puna është më e lirë dhe punëtorët e Lindjes janë më të kushtuar pas punës po t'i krahasojmë me punëtorët në Perëndim, dhe kjo bën që produktet nga Lindja të jenë më të lira në kosto dhe ato fare mirë konkurrojnë me sukses nëpër botë përkundrejt mallrave të prodhuara në Perëndim. Pra në qoftë se marketimi i produkteve industriale të Lindjes do t'i mbikalojë ato të prodhuara në Perëndim, industrinë dhe jeta e Perëndimit patjetër që do të ndikoheshin.

Prandaj, përveç krijimit të një tregu të kontrolluar, Perëndimi mundohet që gjithmonë të rrisë koston e prodhimit për prodhimet e manifakturuara të Lindjes. Sindikatat e tregtisë (ose Bashkimet Profesionale) në Perëndim punojnë drejt këtij synimi, nën pretekstin e mbrojtjes se të drejtave të punëtorëve nëpër botë nga shfrytëzimi i punëdhënësve. Këto sindikata tregtare kanë formuar një Union Ndërkombëtar të Tregtisë, dhe i nxisin sindikatat tregtare në Lindje që të bëhen pjesëtare të kësaj organizate.

Por, nëpërmjet këtyre unioneve ndërkombëtare apo të organizatave të tjera ndërkombëtare, udhëheqësit e sindikatave tregtare të Perëndimit, jo vetëm që i shtyjnë punëtorët e Lindjes të kërkojnë një pagesë më të lartë dhe orare punë më të shkurtra, por gjithashtu i nxisin në veprimtari të llojeve të ndryshme që çojnë në dobësimin e industrive në Lindje. Dhe si rezultat i këtyre fushatave të marra nga udhëheqësit e sindikatave perëndimore, popujt e Lindjes nuk mund të konkurrojnë dhe të arrijnë sukses përkundër Perëndimit në botën komerciale.

Një shembull i pastër është ai me materialet e pambukut. Lancashire në Angli ka qenë një herë e një kohë prodhuesi më i madh dhe i famshëm në prodhimet e

pambukut. Veshjet shiteshin në kolonitë angleze dhe ishin në një market të mbyllur që vinin me një përfitim shumë të madh. Kur Hong Kongu filloi prodhimin e materialeve të pambukut gjithashtu, veshjet e bëra në Hong Kong vinin me një kosto më të ulët dhe filluan të konkurronin dhe të kishin mjaft sukses në krahasim me prodhimet e Lancashire.

Në fillim pronarët dhe punëtorët e Lancashire e detyruan qeverinë angleze të ndalonte importin e veshjeve nga Hong Kongu në Angli, por në tregun botëror veshjet e Lancashire nuk po preferoheshin më, dhe si rezultat shumë punëtore të Lancashire u nxorën nga puna pasi fabrikat e pambukut në disa zona ishin të detyruara të mbylleshin.

Ne këtë kohë sindikata e tregtisë angleze filloi një lëvizje simpatie për të sjellë pakënaqësi tek punëtorët e Hong Kongut. Në fillim ata pretenduan se u vinte keq për punëtorët e fabrikave të Hong Kongut, duke u thënë, se ata po shfrytëzoheshin nga punëdhënësit e tyre. Po pse punëtorëve të Lancashire, kur biznesi i tyre ishte në prosperitet, nuk u erdhi keq për kushtet e rënda të punës të punëtorëve të Hong Kongut, por tani që rrezikohej puna e tyre ata me lot krokodili filluan të ngriheshin kundër “vuajtjeve” të punëtorëve hongkongas. Është mjaft e qartë se aktivitetet e sindikatave të tregtisë në Perëndim, megjithëse se nganjëherë u vijnë në ndihmë punëtorëve në Lindje, janë të motivuara nga dëshira për të mbrojtur pozitën e industrive perëndimore në tregun botëror. Sa më shumë që punëtorët e Lindjes dëgjojnë këshillat e tyre, aq më shumë përfitime do të kenë punëtorët dhe industritë e Perëndimit.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se sindikatat janë të pavlefshme. Si gjithmonë çfarë kopjohet nga Perëndimi është e vlefshme, por gjithmonë duhet të dimë nëse

kopjimi bëhet me sy të hapur. Një sindikate punëtorësh që ecën sipas principeve dhe aspiratave të atyre që e kanë formuar në të vërtetë mund të sigurojë drejtësi për punëtorët. Por si çdo armë ajo mund të keqpërdoret dhe mund të sjellë konsekuenca të padëshiruara. Në lidhje me pranimin e këshillave nga sindikatat perëndimore ku liderët e tyre janë zgjedhur nga vetë punëtorët e Perëndimit për interesat e tyre speciale, shpesh nuk mund të garantojnë një sukses në principet dhe aspiratat e punëtorëve të Lindjes, nuk do të trajtohen me atë kujdes si ata të Perëndimit.

Imperializmi perëndimor pjesërisht është ndihmuar të dalë në pah nëpërmjet aktiviteteve të masmedias botërore. Perëndimi e kontrollon masmedian botërore për shkak të gjuhës, anglishtes që flitet e kuptohet në pothuajse në të gjithë rruzullin tokësor. Revistat dhe raportet në anglisht me lehtësi mund të lexohen nga të gjithë, dhe shpesh janë të përkthyer në gjuhët lokale duke përfshirë këtu edhe popujt e Lindjes. Pra reporterët e Perëndimit i propagandojnë raportet e tyre nëpër botë, dhe kështu shpërndajnë dhe krijojnë opinionin nëpër botë për një incident apo një rast të veçantë që ka ndodhur.

Prej disa vitesh reporterët perëndimorë janë duke shkruar dhe duke theksuar për ndodhitë e padëshiruara që ndodhin në vendet që janë në zhvillim dhe në veçanti vendet e Lindjes. Në momentin kur një ngjarje e padëshiruar ndodh, reporterët perëndimorë do të ndodhen menjëherë në vendngjarje me kamerat dhe televizionet e tyre.

Nga raportet e nxjerra prej tyre gjithkush do të mendojë se asgjë e mirë nuk ndodh në Lindje. Se Lindja edhe antidemokratike, e padrejtë, mizore, kaotike në administrim, ka korrupsion, është e pandershme, larg zhvillimit, e pazonja në arritje të suksesit të zhvillimit të ven-

dit, etj. etj. etj. Pra këta reporterë asnjëherë nuk raportojnë mbi sukseset e korrura nga Lindja.

Për shembull Malajzia, nuk ka qenë aq shumë e njohur sa Vietnamit megjithëse për shumë vjet Malajzia ka qenë e suksesshme dhe progresive. Por tani që Vietnamit u mbyll për këta reporterë, eksperiencë e ligë ka filluar për Malajzinë duke u bërë një objekt shënjestre për ta. Të njëjtën gjë mund të themi për suksesin ekonomik të Pakistanit pas ndarjes së Lindjes dhe Perëndimit, asnjëherë nuk tërhoqi vëmendjen e këtyre reporterëve, të cilët ishin më shumë të fokusuar në vuajtjet e Bangladeshit qysh me lindjen e tij si shtet. Gjithashtu në Filipine, qendra e raporteve të tyre ishte më shumë e përqendruar rreth të dënuarve politikë, dhe asnjëherë në raportet e tyre nuk u përmendet zhvillimi i vullshëm i vendit. Në Tailandë, rebelimeve kundër qeverisë iu jepej një interes në detaje, por në qoftë se rebelët do të kishin sukses në marrjen e qeverisë si në disa vende të Azisë Qendrore apo disa vende afrikane, reporterët perëndimorë do të bënin një “ekspozim” të plotë të ngjarjeve.

Lindja në anën tjetër, nuk ka reporterë të vetë të cilët të sillen nëpër botë dhe të shkruajnë mbi aspektet e mira të Lindjes dhe mbi të ligat e Perëndimit. Raportet e bëra nga reporterët e Lindjes kanë një qarkullim të kufizuar për shkak të problemeve me gjuhën. Agjencitë lindore të lajmeve në përgjithësi janë të vogla dhe nuk janë të abonuar në gazetatat apo revistat perëndimore. Gjithashtu agjencitë e njohura perëndimore nuk i punësojnë reporterët e Lindjes të paktën edhe për të mbuluar ngjarjet në vetë vendet e Lindjes.

Pra nëpërmjet shtypit bota perëndimore është në gjendje të kontrollojë median e Lindjes në atë shkallë që i bën të ndihen inferiorë dhe të ndihen fajtorë. Pra njerëzit në Lindje janë të sforcuar të gjykojnë vetveten nëpërmjet

krëterit perëndimor dhe shpesh ndihen shumë poshtë duke u krahasuar me kërkësat e sistemeve perëndimore.

Presioni më i madh i shkaktuar nga Perëndimi mbi Lindjen ndihet në sistemin politik. Vlerat e jetës dhe mënyrat e të menduarit të shoqërisë ndryshojnë nga koha në kohë. Çfarë konsiderohet “e mirë” dhe “e drejtë” nga një epokë në epokën tjetër u bien vlerat. Për shembull në kohët e hershme, kur njerëzimi ishte i ndarë në grupe të vogla ngritja e një sistemi monarkist, i cili i jepte fuqi monarkut mbi jetën apo vdekjen e njerëzve, konsiderohej si diçka e mirë pasi nuk lejonte anarkinë në një shoqëri dhe e mbronte shoqërinë nga të gjithë shtypësit përveç monarkut.

Por me kalimin e kohës, sistemi i monarkisë absolute filloi të sillte në pah të ligat e tij dhe ky qe edhe shkakku përse ky sistem i krijuar filloi të harrohej, e tani njerëzit ishin më të ndërgjegjshëm vetëm ndaj abuzimeve të bëra nga monarkët. Kështu që shoqëria filloi të krijonte opinionin se fuqia mbretërore ishte veçse një kërcënim dhe shtypje dhe se kjo fuqi duhet të zhdukej. Dhe me kalimin e kohës njerëzit krijuan një besim në idetë e reja, të cilat së fundi u bënë opinion i gjithë publikut. Kur kjo fazë ishte arritur, kërkëret dhe vlerat e asaj shoqërie mund të themi se kanë ndryshuar.

Kur një herë e një kohë “drejtësi” do të thoshte të kishe një monark që gjykonte sipas ideve të veta, tani sistemi kishte ndryshuar në monarki kushtetuese, ku monarku nuk kishte me atë fuqi të jepte gjykimin personal, tani monarku ishte vetëm një drejtues kukull. Tani vetë populli kishte të drejtë të vendoste se çfarë ishte e drejtë dhe çfarë nuk ishte e drejtë, dhe vetë populli krijonte mënyra dhe sisteme të ndryshme të cilat ishin të dobi të tij. Megjithëse këtyre sistemeve iu dhanë emra dhe forma të ndryshme, shumica e tyre identifikohej si sisteme demokratike.

Sistemi demokratik u krijua në Perëndim, pas rënies se tiranisë së monarkëve të Perëndimit. Në fillim Perëndimi e praktikoi këtë sistem vetëm për vete. Ky sistem duke qenë pak i komplikuar, përdorimi i tij në administrimin e kolonive do të kishte sjellë mjaft probleme tek Perëndimi. Prandaj edhe administrimi i kolonive bëhej në mënyrë absolute, autokratike, duke i dhënë një fuqi të plotë Guvernatorit apo qeveritareve të emëruar në koloni. Njerëzit e thjeshtë nuk kishin asnjë të drejtë dhe ishin të detyruar të pranonin çdo politikë apo direktivë të dhënë nga qeveritarët apo administruesit e kolonisë. Në vendet e kolonializuara nga Perëndimi, institucionet demokratike si p.sh, sindikatat punëtore etj., nuk ishin të lejuara ose operonin nën një kontroll shumë strikt.

Pra ishte e padyshimtë që qeverisja autokratike apo absolute ishte më e thjeshtë për t'u kontrolluar se një qeveri demokratike. Një qeveri autokratike nuk lejon kritikën dhe përshtatjen sipas opinionëve të dhëna nga populli, dhe kjo qeveri nuk është shumë e interesuar mbi mirëqenien e popullit. Më e rëndësishmja për këtë qeveri është vendosja dhe zbatimi në mënyrë efektive i ligjit dhe moslejimi i anarkisë.

Nga ana tjetër një qeveri demokratike është gjithmonë nën presionin e kritikave. Përveç përpjekjeve për të kënaqur dëshirat e ndryshme të njerëzve, qeveria demokratike duhet të ballafaqohet me kërcënimet për stabilitet gjatë kohës së zgjedhjeve. Gjithë liderët qeveritarë jo vetëm se duhet të drejtojnë me efikasitet dhe aftësi, por gjithmonë janë nën shqyrtimin dhe kritikën e njerëzve. Ata janë të detyruar të praktikojnë vlerat e tyre më të mira dhe në mënyrë të shkëlqyer sikur ata të mos ishin qenie njerëzore dhe të mos kishin asnjë të metë. Dështimi apo paaftësia për të arritur çfarë kërkohet prej tyre do

të sillte konsekuenca tek vetë këta qeveritarë dhe në qeverinë, të cilën ata përfaqësojnë.

Kolonialistët perëndimorë pa dyshim që e kanë kuptuar kompleksitetin e administrimit të një qeverie demokratike. Megjithatë, ata e vendosën si një kusht, që të gjitha kolonitë që kërkonin pavarësinë, duhet të vendosnin një qeveri demokratike. Gjithashtu propagandat e tyre të bëra mbi virtytet e demokracisë kishin për qëllim që edhe ata që nuk e pranuan në fillim si sistemin dhe vlerat e demokracisë të ndiheshin fajtores dhe jonjerëzore. Pastaj masmedia perëndimore do ta akuzonte këtë apo atë qeveri për devijimin nga praktikimi i demokracisë, dhe kështu pjesa tjetër e botës do t'i shihnin këto vende si jo të favorshme dhe qeveritë e tyre do të bëheshin target i përhershëm kritikash. Organizata të ndryshme si për shembull ajo e Amnities Ndërkombëtare janë ngritur nga Perëndimi me qëllim për të keqësuar imazhin e çdo qeverie që nuk shkon me format dhe vlerat e Perëndimit.

Liderët e ish-kolonive të Perëndimit apo dhe popujve të Lindjes që nuk kanë qenë asnjëherë të kolonizuar nuk janë shumë të ditur dhe me përvojë rreth administrimit të qeverisë demokratike. Ata kanë qenë gjithmonë të drejtuar nga një qeveri autokratike dhe kjo ka qenë e vetmja mënyrë qeverisje që ata dinë apo kuptojnë. Por jo vetëm qeveritarët, por edhe vetë populli nuk janë më me shumë eksperiencë në qeverisjen demokratike. Është akoma e vështirë për ta, të kuptojnë dhënien e të drejtës për të formuar unione apo organizata, të drejtën e shtypit, të drejtën e fjalës, të drejtën të marrin pjesë në politikë etj.

Për këtë arsye kur popujt në Lindje që sapo kanë fituar pavarësinë, apo edhe kombet që nuk kanë qenë asnjëherë koloni mundohen të praktikojnë demokracinë, problemet dhe vështirësitë që i shqetësojnë nuk mund të

sipërmerren apo kalohen nga qeveritë e tyre, dhe kështu që konditat në këto vende fillojnë të keqësohen dita ditës, ekonomia fillon të shkatërrohet dhe atmosfera politike fillon të bëhet më e tensionuar. Çdo përpjekje e qeverisë për të zgjidhur problemet bllokohet apo kundërshtohet me organizatat e ndryshme që janë po aq të fuqishme sa edhe qeveria demokratike. Si shembull këtu mund të marrim asamblenë kushtetuese me opozitën, gjykatën e lartë etj. Dhe së fundi kur kushtet e vendit janë keqësuar së tepërmi dhe janë jashtë kontrollit, qeveria është e detyruar të marrë të gjitha fuqitë dhe të vendosë ligjet e emergjencës ose gjendjen e jashtëzakonshme. Kjo do të thotë që demokracia u zëvendësua me autokraci. Dhe kur kjo ndodh e gjithë makineria perëndimore do të përdoret për të dënuar kombin në fjalë, dhe gjithashtu edhe popujt të tjerë të Lindjes do të përfshihen ndër akuza dhe sulmet e tyre.

Përgjatë gjithë historisë se njerëzimit, Lindja dhe Perëndimi kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me njëri tjetrin, të dyja janë qendra të hershme të civilizimit, por lidhjet e tyre shumë rrallë kanë qenë paqësore. Secili mundohet të dominojë mbi tjetrin, dhe kështu ekziston një rivalitet konstant. Shpesh Perëndimi ka pushtuar dhe ka dominuar mbi Lindjen. Kjo ka ndodhur në Vitet e Arta të Maqedonisë së drejtuar nga Aleksandri i Madh, në kohën kur Roma ishte nën sundimin e Cezarëve, dhe me së fundi në epokën e Perandorisë Britanike etj. Disa herë edhe Lindja e ka pushtuar dhe dominuar Perëndimin, si në kohën e Xhengiz Kanit, dhe në shekujt e parë të përhapjes së Islamit.

Çdo herë Perëndimi ka dominuar mbi territoret e Lindjes apo në të kundërtën, dhe efektet e dominimit nuk mund të fshihen shpejt, efekti i tyre do të ndihet dhe shekuj më pas. Për shembull, efekti i pushtimit të

Evropës nga muslimanët, ndihet dhe identifikohet dhe sot e kësaj dite.

E rëndësishme është jo të fshihen të gjitha efektet, por të zgjidhen ato që duhet të ruhen dhe ato që duhet të harrohen. Efekti nga pushtimi musliman mbi Evropën që ekziston edhe në ditët e sotme është mbi njohuritë e dijes, por këto nuk modifikojnë apo ndryshojnë identitetin e Perëndimit. Perëndimi mbetet Perëndim. Por Perëndimi pa dyshim arriti progres dhe u forcua më shumë si rezultat i asimilimit të këtyre dijeve nga Lindja.

Lindja tani është duke kaluar fazën në të cilën pavarësia në sensin fizik është arritur, por influenca e imperiaлизmit perëndimor është akoma në përhapje. Dhe kjo influencë bëhet më efektive nëpërmjet sistemeve të komunikimit modern, të cilat bëjnë të mundur çdo ide apo incident të Perëndimit të bëhet menjëherë i njohur në Lindje. Në qoftë se njëherë e një kohë kur vetëm elitat e shoqërisë ishin të përfshira me kulturën dhe civilizimin e kolonisë, sot të gjitha shtresat janë të ekspozuara nga influenca e huaj. Pra, influenca e ish-kolonialistëve ndihet nga të gjithë sektorët. Kjo e bën edhe më të vështirë frenimin e gjithë kësaj influence për të lejuar vetëm atë që është më e mira në aspektin e asimilimit. Gjithashtu epoka moderne sjell edhe teknika të reja të analizimit dhe të planifikimit mbi zhvillimin. Dhe nuk ka asnjë shkak pse influenca e ish-kolonialistëve, apo më konkretisht pse influenca perëndimore të mos analizohet më sistematikisht dhe më me pjekuri të asimilohet nga një grup apo një popull.

Si shembull këtu mund të sjellim modernizimin e Japonisë gjatë periudhës Meiji, që është një ilustrim i asimilimit të planifikuar të civilizimit të huaj. Asimilimi dhe përdorimi i aspekteve më të mira të njohurive perëndimore, mund të bëhen me mënyrë sistematike dhe të organizuar në ditët e sotme. Por për këtë është vetë Lindja

ajo që duhet të vendosë se cili aspekt mund të merret dhe në çfarë kufijsh mund të praktikohet, dhe Lindja me një të kaluar të shquar civilizimi dhe me vlera të respektuara nga bota, është patjetër në gjendje të bëjë një zgjedhje të mençur.

Në bërjen e kësaj zgjedhjeje, shikimi i ngushtë i varur nga emocionet dhe krenaria e tepërt në identitetin e Lindjes nuk duhet të merret parasysh. E rëndësishme është që, identiteti Lindor duhet të ruhet, por dhe sukcesi dhe arritjet e Perëndimit duhet të merren në konsideratë. Kështu në këtë mënyrë, Lindja do të mbetet Lindje, por do të jetë në gjendje të ruajë identitetin e vet në botën moderne me komunikimin e ngushtë global.

Malajzia dhe malajasit janë direkt të përfshirë në konfliktin Lindje-Perëndim. Jo-malajzianët (kinezët dhe indianët) shumë shpejt i janë përshtatur civilizimit perëndimor, malajasit janë më shumë të tërhequr nga forma, se sa nga substanca e këtij civilizimi. Dhe për këta djem të rinj me flokë të gjata që i hasim nëpër rrugë, me plot bindje mund të themi se njohuritë në dijet e tyre nuk janë në atë shkallë që ata ndjekin modën. Normat e liga të Perëndimit janë asimiluar më shpejt, diçka e tillë nuk ka ndodhur me normat dhe vlerat, të cilat e kanë forcuar dhe e kanë bërë të suksesshëm Perëndimin.

Megjithatë efektet e kolonializimit perëndimor duhet të ishin menduar dhe analizuar më parë. Edhe asimilimi i civilizimit perëndimor duhej bërë me mënyrë më të organizuar, kohë më parë. Megjithatë, më mirë vonë se kurrë, akoma ka kohë për t'u menduar dhe vepruar. Çfarë është e rëndësishme në këto momente: ndërgjegjshmëria. Vallë a ekziston ndërgjegjja tek Lindja apo akoma Lindja është e humbur në fantazi? Kjo është pyetja përkundrejt të gjithë këtij kapitulli, po cila vallë është përgjigjja?

Kapitulli V

Materializmi dhe spiritualizmi

Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos lë mangët atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bëj të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit (Kur'ani, el-Kasas: 77)

Kjo epokë është epoka e materializmit dhe askush nuk e kundërshton një gjë të tillë. Në të gjitha nivelet pasuria materiale është fokusi i interesit dhe i diskutimit. Dhënia me shumë rëndësi e pasurisë materiale ka ardhur dhe si rezultat i krijimit të ideologjive dhe praktikave të ndryshme politike, të cilat janë të bazuara vetëm në botën materiale. Nganjëherë këto ideologji janë kaq shumë tërheqëse dhe joshëse për mendjen e njeriut, sa që e bëjnë të harrojnë edhe besimin, fenë, e cila ka qenë me njerëzimin për shekujsh me radhë për gjatë gjithë historisë së njerëzimit.

Ndër ideologjitë dhe politikat e bazuara në materializëm, që kanë pasur shumë sukses në dobësimin e besimit fetar është komunizmi, socializmi dhe kapitalizmi. Të tria këto ideologji edhe pse janë ndryshe nga njëra tjetra, janë të njëjta në qoftë se i shikojmë nga pikëpamja spirituale. Këto të tria nuk i japin asnjë rëndësi spirituale dhe deklarojnë se njeriu jeton dhe është i lumtur për shkak të pasurisë që ai zotëron.

Kapitalizmi në të vërtetë nuk ka qenë i formuar si ideologji, e ka origjinën nga tregtia e cila është e paevitueshme në shoqërinë njerëzore. Më parë tregtia ishte vetëm një mënyrë e fitimit për të jetuar, si çdo punë apo

profesion tjetër. Por, për ata me mendjempreshtësi biznesi, që kërkonin të fitonin jo vetëm një të ardhur bazike, por gjithashtu një pasuri më të madhe, Revolucioni Industrial theu të gjitha vështirësitë dhe e bëri të mundur për këta njerëz për të fituar një pasuri. Kjo epokë solli dhe lindjen e kapitalizmit modern për të cilin ndjenjat njerëzore ishin të pakuptimta dhe i vetmi qëllim i tij ishte pasuria materiale. Njerëzit filluan të bënin të pamundurën për të arritur një pasuri pa marrë parasysh vuajtjet e punëtorëve, të shoqërisë apo problemet me ndotjen e ambientit. Konsiderimi nuk ekzistonte më tek njerëzimi dhe të gjitha mësimet dhe elementet fetare dhe spirituale u lanë mënjanë.

Mizoria e kapitalistëve dhe shfrytëzimi i punëtorëve nga ana e tyre dënohen nga një shoqëri normale. Por çfarë nuk mund të hedhim poshtë është, se industritë dhe tregtitë e këtyre kapitalistëve hapën shumë mundësi për vende pune për ata të cilët nuk kishin asnjë burim të ardhurash. Pra sa më shumë përparohet tregtia, më shumë mundësi për vende pune për të papunët do të hapeshin.

Pra është e qartë, në qoftë se kapitalistët do të kontrolloheshin ose do të silleshin në shtegun e drejtë, aktivitetet e tyre ishin me përparësi për shoqërinë. Fatkeqësisht kapitalistët janë jo vetëm të pasur, por ata janë edhe më të fuqishëm nga ana e pushtetit. Pra pasuria e tyre kontrollon pushtetin. Por, ky kontroll është një formë korrupsioni dhe shoqëria kapitaliste keqësohet më shumë nga ky korrupsion. Gjithashtu në një shoqëri kapitaliste do të gjejmë dhe dekadencën morale pasi kjo shoqëri është e dhënë më shumë pas materializmit dhe korrupsionit dhe hedh poshtë spiritualen dhe çdo lloj besimi fetar.

Kontrolli mbi kapitalizmin është bërë më i vështirë jo vetëm se kapitalistët mund të përdorin pasurinë për të

fituar fuqinë apo pushtetin, por arsyeja tjetër është se ky sistem zhvillohet më shumë në vendet me një shoqëri joislamike, e cila nuk i jep asnjëfarë rëndësie besimit. Faktikisht, influenca e fesë në vendet e Perëndimit ka rënë shumë kohë para shpërthimit të Revolucionit Industrial, dhe çfarëdo aspekti apo vlere e mirë që ekzistonte nga ana fetare e fituar nga njerëzit e Perëndimit filloi të vyshkej me sjelljen e tyre kapitaliste. Besimi fetar nuk kishte më vend dhe fuqi t'i tërhiqte këto shoqëri në rrugën e drejtë të ndjekur me parë.

Me dobësimin e besimit fetar lakmia për të mirat materiale filloi të kontrollonte kapitalizmin. Koncepti komunist dhe socialist që u krijuan për të luftuar kapitalizmin nuk ishin aspak të influencuara nga spiritualja apo besimi fetar. Të dyja këto ideologji besojnë se vetëm zotërimi i një pasurie mund të sjellë efekt në arritjen e drejtësisë dhe lumturisë midis njerëzve. Dhe në këtë aspekt kapitalizmi, komunizmi dhe socializmi janë të njëjtë. Të tre hedhin poshtë spiritualizmin dhe adhurojnë materialen. Shfrytëzimi dhe shtypja e punëtorëve nga punëdhënësit kapitalistë i çoi ata të ngriheshin në këmbë dhe të organizoheshin në unione, apo në organizata, për të ndaluar këtë shfrytëzim. Punëtorët e kishin tashmë të qartë se gjithë pasuria e punëdhënësve varej drejtpërsëdrejti nga puna e tyre. Pra në qoftë se ata do të pushonin se punuari në masë (*en masse*), pasuria dhe të ardhurat e punëdhënësve do të ishin në rrezik dhe do të zvogëloheshin. Dhe për kapitalistët lakmitarë kjo do të ishte një tmerr i vërtetë. Por, megjithatë grevat nuk ishin të lehta dhe shumë efektive, gjithashtu ato sillnin humbje në burimet e të ardhurave të vetë punëtorëve. Po të krahasonim midis punëtorëve dhe punëdhënësve, punëtorët ishin ata që vareshin më shumë nga të ardhurat që merrnin prej punës se tyre. Megjithëse punëdhënësit kishin

ngritur industrinë dhe fabrikat me qëllimin e vetëm, fitimin prej tyre, ata nuk vareshin drejtpërsëdrejti me jetë a vdekje nga këto përfitime të marra, ata kishin edhe burime të tjera. Pra në konfliktin midis kapitalistëve punëdhënës dhe punëtorëve ishin këta të fundit më të prekurit nga ky konflikt në fillimet e viteve të industrializimit.

Përpara Revolucionit Industrial, faktikisht në shekullin XVII, disa filozofë dhe shkencëtarë politikanë, ndër morën një studim duke analizuar lidhjet midis individit, qeverisë dhe shoqërisë. Si rezultat i këtij studimi shumica e tyre arritën në opinionin se, së pari lumturia dhe mizëria njerëzore është e bazuar në zotërimin e një pasurie, dhe se dyti pasuria e një vendi i takon njerëzve të këtij vendi. Prandaj, për të arritur drejtësi dhe për të vënë balancën në shoqëri kjo pasuri duhet të ndahet në mënyrë të barabartë. Por për të arritur këtë "rregull ekonomik" qeveria duhet të merrte përsipër të gjitha burimet e pasurisë dhe pastaj të bënte një ndarje të barabartë midis njerëzve.

Megjithatë kjo filozofi nuk mund të vihej në praktikë sepse përpara shpërthimit të Revolucionit Industrial dhe për një kohë të gjatë pas saj, të pasurit ishin më të fuqishëm, ndërsa punëtorët dhe të varfrit nuk kishin asgjë, as armë, as pushtet, asnjë gjë me anë të së cilës mund të siguronin njëfarë suksesi apo fitore. Kur numri i punëtorëve u rrit si rezultat i shtrirjes industriale që erdhi si pasojë e Revolucionit Industrial, intelektualët e asaj kohë menduan se grevat në masë, do ta dobësonin ose thyenin këtë fuqi të punëdhënësve të tyre apo kapitalistëve. Pra ishin këta intelektualë që formuluan ideologjinë socialiste dhe komuniste. Të dyja këto ideologji janë identike në thelb, të dyja duan që punëtorët vetë të qeverisin të gjitha burimet e pasurisë. Kur socializmi kërkon që marrja e pushtetit dhe e të gjitha burimeve të pasurisë të bëhet në mënyrë graduale nëpërmjet grevave

apo legjislacioneve të reja, komunizmi beson se ndryshimet mund të vijnë vetëm me anë të revoltave dhe kryengritjeve të punëtorëve dhe fshatarëve kundër punëdhënësve dhe borgjezëve. Dhe me shkatërrimin e kapitalistëve dhe të borgjezëve, pushteti i marrë dhe i kontrolluar nga punëtorët (masa) do të vinte në shfrytëzim të gjitha burimet e pasurisë së vendit në të mirë të popullit.

Intelektualët socialistë deri diku e pranonin se burimet e pasurisë automatikisht do të siguronin pasuri. Ata nuk i dhanë asnjë vlerë dëshirës për biznes dhe motiveve të përfitimit. Por nga një studim i bërë është treguar se suksesi në industrinë e teknologjisë moderne nuk ka ardhur si rezultat i ekspertizës në teknologji, por teknologjia është bërë e suksesshme me anë të biznesmenëve të cilët janë të tërhequr nga lakmia, e cila edhe kontrollon shoqërinë materialiste të Perëndimit në të gjitha kohërat. Në qoftë se nuk do të ishin përpjekjet e tyre, asgjë nuk do të ishte prodhuar nga burimet e pasurisë, qoftë ai hekuri apo petroli, përdorimi i sistemeve të prodhimit në masë, tregtia e import-eksportit, apo teknologjia moderne.

Pra sistemi socialist është thënë se varej nga punëtorët. Por në një analizë të bërë thellë mbi këtë sistem tregon se ai varet drejtpërsëdrejti nga lakmia njerëzore, e cila kontrollon mendjen e shoqërisë duke i dhënë një rëndësi të veçante materializmit. Pra lakmia e njeriut është kudo njëlloj, nuk ka rëndësi në se gjendet në zerrën e punëtorit apo të punëdhënësit, te të pasurit apo te të varfrit, të mbretit apo të një njeriu të thjeshtë. Filozofia e jetës e bazuar në lakminë për pasuri nuk mund të sjellë asnjëherë lumturi të njerëzimit, dhe kjo mund të shikohet tek Perëndimi ku lakmia për të mirat materiale gjithmonë ka sjellë probleme të ndryshme me zgjidhje të porealizueshme.

Anglia është një nga vendet që është përpjekur të implementojë sistemin socialist nëpërmjet demokracisë parlamentare, duke besuar se ky socializëm do të sjellë drejtësi. Demokracia angleze varet nga numri i votave të dhëna tek çdo parlamentar. Intelektualët socialistë anglezë ishin të opinionit se në qoftë se punëtorët, të cilët padyshim që janë në numër më të madh se punëdhënësit do të organizoheshin në një parti, patjetër që ata do t'i fitonin të gjitha zgjedhjet dhe do të ishin në kontroll të qeverisë. Ishin këta intelektualë socialistë që formuan Partinë e Punës dhe bashkimet e punëtorëve në Federatat e Bashkimeve Profesionale, të cilat të organizuara thirrën Kongresin e Bashkimeve Profesionale të Anglisë. Paratë e paguara nga punëtorët për t'u bërë anëtarë të unioneve, përdorshin si fonde për aktivitetet e Partisë së Punës.

Përkrahja e dhënë nga punëtorët për Partinë e Punës, varej nga premtimet e dhëna të partisë se qeveria e formuar do të jepte pasurinë (materiale) tek punëtorët. Votat e punëtorëve përdorshin si një instrument nga partia për të frikësuar punëdhënësit dhe shoqërinë nëpërmjet grevave dhe formave të tjera. Kjo qeveri e punëtorëve do të shtetëzonte burimet e pasurisë si p.sh. industrinë e rëndë, të hekurit, qymyrit, minierave etj. Pra përfitimet kolosale që do të vinin nga këto industri do të shkonin në xhepat e qeverisë se punës, e cila deklaronte se do t'i përdorte këto të ardhura për mirëqenien e punëtorëve, por kjo ishte dhe do të mbetej vetëm një teori.

Si rezultat i përpjekjeve të Partisë së Punës, punëtorët anglezë arritën të bëheshin një forcë politike e frikshme që arritën suksese dhe formuan një qeveri. Kjo qeveri e punës që u formua lëshoi shumë ligje duke u dhënë përparësi punëtorëve dhe duke shumëfishuar pozitat dhe të ardhurat e tyre. Shumë industri u shtetëzuan, por

shpresat për të arritur më shumë drejtësi dhe një shoqëri më të qetë dhe të paqshme nuk u realizuan kurrë.

Megjithëse shumë prej kërkesave të punëtorëve u realizuan, ata nuk ishin asnjëherë të kënaqur dhe filluan të sillnin më shumë kërkesa dhe nganjëherë të shoqëruara me kërcënime apo me greva, kur ata nuk ia arrinin qëllimeve të tyre. Me fjalë të tjera mund të themi se sjellja e tyre përkundrajt zotërimit të një pasurie nuk ishte më ndryshe nga ajo e punëdhënësve të tyre apo e kapitalistëve borgjezë. Për të arritur rritjen e pagave ata ishin të përgatitur të kërcënonin dhe shoqërinë dhe t'i vështirësonin më shumë kushtet. Diferencimi në shoqërinë socialiste është i përhershëm dhe sot e kësaj dite nuk ka asnjë evidencë apo argument se problemet e një shoqërie njerëzore mund të zgjidhen nëpërmjet implementimit të konceptit socialist.

Punëdhënësit do të jenë të njëjtë, qofshin ata privatë apo shtetërorë, edhe pse të zgjedhur nga vetë punëtorët. Industritë e shtetëzuara janë të hapura për kërkesa dhe kërcënimin e grevave, ashtu sikur se, edhe industritë private. Shpresat e ngjallura nga intelektualët socialistë se shtetëzimi i industrive do të zgjidhte problemin e shfrytëzimit nga ana e punëdhënësve, nuk u arritën asnjëherë. Punëtorët filluan të akuzonin industritë e marra nga shteti për padrejtësi dhe se nuk u jepnin këtyre industrive shanse për të dhënë apo për të bërë një shërbim më të mirë. Si rezultat industritë e zotëruara nga shteti filluan të kishin humbje të mëdha më shumë se në kohën kur ato ishin private. Meqenëse industritë që ishin akoma private paguanin taksa tek qeveria, industritë shtetërore filluan të ndihmoheshin prej këtyre taksave dhe në këtë mënyrë mbuloheshin humbjet e tyre.

E gjitha kjo ndodhi për arsye të besimit se një sistem i bazuar në materializëm mund të sjellë lumturinë në

shoqërinë njerëzore. Ishte koncepti socialist se në qoftë se të gjithë burimet e pasurisë që njëherë e një kohë kontrolloheshin nga kapitalistët borgjezë do të jepeshin tek punëtorët, këta do të ishin më të kënaqur. Fatkeqësisht, punëtorët në një shoqëri materialiste janë qenie të thjeshta njerëzore që janë në gjendje të krijojnë lakmi, ashtu sikurse edhe punëdhënësit e tyre. Në një shoqëri të drejtuar nga materializmi, asnjë sasi e dhënë nuk mund të kënaqë dëshirën. Prandaj edhe socializmi nuk mund t'i japë një qetësi shpirtërore apo lumturi shoqërisë. Realiteti është se trazirat apo çrregullimet dhe shtypja do të ekzistojnë në një shoqëri socialiste ashtu si edhe në atë kapitaliste.

A thua ata e përvaktojnë mëshirën e Zotit tënd? Ne kemi përvaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë; Ne kemi dalluar disa në shkallë më të larta se të tjerët, që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin për shërbime. E mëshira e Zotit tënd është shumë më e dobishme se ajo që ata grumbullojnë. (Kur'ani, ez-Zuhruf: 32)

Kur një opinion apo një besim është bërë mjaft popullor mendimi për të hequr dore prej tij nuk është shumë i lehtë. Në këto kohë socializmi është shumë i famshëm, dhe besimi se ndarja në mënyrë të barabartë të të mirave është një gjë e drejtë. Dhe kjo pikëpamje është pranuar jo vetëm nga Perëndimi, por nga e gjithë bota. Kështu që grupet e tjera nuk guxojnë ta ballafaqojnë socializmin në konceptin e barazisë. Ne të vërtetë ata mundohen të sjellin në pamje të parë se edhe ata vetë praktikojnë këtë princip të socializmit ose të paktën kanë parasysh këto mësimet socialiste.

Prandaj edhe disa muslimanë janë munduar të tregojnë se edhe Islami ka disa elemente të socializmit. Ata sjellin si shembull mësimet islame mbi barazinë dhe vëllazërimin e të gjithë muslimanëve si një evidencë se principet e socializmit janë pjesë e Islamit dhe prej

shumë kohësh janë praktikuar nga muslimanët. Ata vijnë edhe me konkluzionin se Islami dhe socializmi janë jo vetëm në pajtueshmëri me njëri-tjetrin, por gjithashtu se Islami është socializëm i vërtetë.

Me një shikim tërthorazi, çdo njeri do të mendojë se kjo mund të jetë e pranueshme, por një studim më i thellë do të tregojë se kjo është një gjë e padrejtë. Barazia e deklaruar nga socializmi është një barazi materiale. Një punëtor është konsideruar vëlla me një punëtor tjetër për të vetmen arsye se puna dhe të ardhurat e tyre pak a shumë janë të njëjta. Dhe një punëtor nuk mund të quhet vëlla me punëdhënësit megjithëse ata i përkasin të njëjtës racë apo besimi fetar. Pra punëdhënësi nuk mund të quhet vëlla pasi të ardhurat e tij (pasuria që ai zotëron) është e pakrahasueshme me atë të këtij punëtori të thjeshtë. Meqenëse punëdhënësi nuk mund të jetë një vëlla edhe kur ai është një njeri i mirë që simpatizon dhe mundohet të kënaqë dëshirat e punëtorëve, ai do të kundërshtohet gjithmonë pasi nuk i takon klasës punëto-re. Me fjalë të tjera kur ekziston një punëdhënës që nuk është vetë shteti, barazia dhe vëllazërimi nuk mund të ekzistojnë në një shoqëri socialiste. Jeta do të ndahet sipas klasave që njerëzit u takojnë. Socialistët kërkojnë që statusi material i punëdhënësve të hiqet nëpërmjet marrjes së pasurisë së tyre nga shteti.

Marrja e pasurisë së dikujt është konsideruar gjithmonë si një akt jo i mirë nga çdo shoqëri njerëzore. Por marrja e pasurisë nga të pasurit (punëdhënësit) është konsideruar si diçka normale nga socialistët edhe pse kjo pasuri është vënë nga vetë të pasurit në baza të pastra ligjore si nga ana fetare, ashtu edhe nga ligjet njerëzore. Teoria socialiste është se pasuria e marrë në emër të qeverisë socialiste i takon legjitimisht popullit (punëtorë-

ve). Më shkurt mund të themi se, shtetëzimi i pasurisë nga të pasurit do të thotë pasuri që u përket punëtorëve.

Pra për këta socialistë marrja e kësaj pasurie nuk konsiderohet si gabim pasi ka për qëllim “drejtësinë”. Por edhe pas shtetëzimit të industrive të minierave në Angli, punëtorët vazhdonin të ngriheshin në greva dhe të kritikonin punëdhënësit edhe pse ata tani ishin qeveria, të cilën vetë punëtorët e kishin zgjedhur. Kjo ndodhi për arsye se socializmi, ashtu si dhe komunizmi ishin të bazuar në materializëm, dhe punëtorët që adhurojnë materialen nuk mund të bëjnë asnjë dallim nëse pagat e tyre paguhen nga një punëdhënës privat apo nga një shtetëror. Ata gjithmonë do të kërkojnë më shumë nga sa kanë, pasi është vetë filozofia materialiste që i nxit gjithmonë në pakënaqësi dhe i çon të kërkojnë me shumë pasuri. Kështu që plotësimi i një kërkesë nuk do të thoshte ndërprerje e kërkesave të tjera. Çfarëdo qoftë përgjigja apo rezultati për kërkesat e tyre, punëtorët do të vazhdonin të agjtonin për të ardhura më të larta.

Të inkurajosh kërkesat për të ardhura më të larta, patjetër që shfrytëzohen dëshirat dhe dobësitë e njeriut. Çfarëdo qofshin të ardhurat e punëtorëve, liderët e tyre gjithmonë do të tregojnë për të tjerët që marrin më shumë dhe kështu nxisin kërkesat për paga më të larta, pra krijohet një slogan për të shkaktuar pakënaqësi dhe lakmi. Edhe pse pagat e punëtorëve do të rriten slogan “te pasurit më të pasur dhe të varfrit më të varfër” do të thirret me të madhe. Do të sillen fakte e evidenca të falsifikuara për të provuar se ky slogan reflekton realitetin.

Rritja e çmimeve të mallrave do të sillet si provë se sloganit socialist është i vërtetë. Një pagë sado e lartë nuk do të mund të blejë më shumë mallra për shkak të rritjes së çmimeve, kështu që në realitet kjo pagë është zvogëluar më shumë. Megjithatë në rrënjë kjo situatë e ka rri-

tur nivelin e jetesës dhe të kërkesave kjo do të harrohet prej tyre. Dhe rezultati i fushatës të bazuar në këtë slogan është një lakmi e pangopshme. Kënaqësia asnjëherë nuk do të arrihet. Xhelozia dhe smira do të bëhen më të pranishme. Pra çdo lloj akti mund të merret parasysh si rezultat i lakmisë. Shoqëria nuk do të jetë asnjëherë e qetë. Grevat dhe kryengritjet do të ndodhin më shpesh për shkak të dëshirës për më shumë. Çfarëdo qofshin kërkesat e plotësuara, gjithmonë do të jetë diçka e re për të kërkuar, duke u bazuar në qëndrimin se të pasurit janë duke u pasuruar më shumë dhe të varfrit janë duke u varfëruar më shumë.

Në fakt në një shoqëri moderne si Malajzia të pasurit janë ata që paguajnë më shumë taksa, por ky fakt nuk merret parasysh apo nënvlerësohet nga këto parti të interesuara. Një qeveri moderne është si një agjent për të zvogëluar shkallëzimin midis jetesës se një të varfëri dhe një të pasuri. Prandaj të pasurit janë të nënshtruar të paguajnë taksa më të larta nga të ardhurat e tyre, nga mallrat që konsumojnë dhe nga pasuritë e tjera që ata kanë. Këto taksa mblidhen nga qeveria dhe përdoren në mënyrë falas në nevojat e ndryshme sociale si edukim, shëndetësi, fe, komunikim, në zhvillimin e vendit, ndihma financiare etj. Në qoftë se ne do të kishin pranuar çdo një prej regjimeve si atë feudal apo sistemin e administrimit kolonialist, të pasurit do të paguanin vetëm për lehtësimet e tyre dhe të varfrit duhet të kujdeseshin për veten e vet në çdo aspekt; dhe në këtë rast do të mund të sillej si i vërtetë slogani “të pasurit më të pasur dhe të varfrit më të varfër”. Të varfrit nuk do të kishin mundur të ngrinin shkolla për vete, apo spitale dhe rrugë, nuk do të kishin mundur kurrë të merrnin bursa, shërbimet shëndetësore falas apo shërbime të tjera, të cilat tani ata mund t’i marrin prej qeverisë. Këtyre fakteve nuk u

është dhënë asnjëherë vëmendje nga ata njerëz që janë kaq shumë të dhënë në përdorimin e sloganit “të pasurit të më të pasur, dhe të varfrit me të varfër”. Mund të themi se në disa vende, ashtu edhe sikur në vendin tonë gjatë periudhës feudale kolonialiste dhe pak pas fitimit të pavarësisë ka qenë me vend përdorimi i këtij slogani, por tipi i demokracisë që mbizotëron sot në Malajzi nuk lejon kushte të tilla të ekzistojnë.

Fatkeqësisht, shumë nga këto fakte nuk merren parasysh apo nuk pranohen nga ata individë të cilët adhurojnë materialen. Këto fakte lihen mënjanë për shkak se janë të interesuar më shumë në dëshirat e tyre. Çdo mënyrë edhe kur bëhet fjalë për fshehje faktesh do të pranohet dhe përdoret për të arritur atë kënaqësi lakmitare për të zotëruar diçka materiale. Dhe pa marrë parasysh të vërtetën ata fillojnë të bërtasin me sloganin e vjetër se të varfrit më të varfër dhe të pasurit më të pasur. Por këto janë vetëm sjellje dhe qëndrime të një shoqërie socialiste.

O ju që besuat, bindjuni Allahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësve nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrone atë të Allahu (te libri i Tij) dhe të i dërguari, po që se i besoni Allahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë. (Kur’ani, en-Nisa’: 59)

Në një shoqëri muslimane, lidhjet midis grupeve dhe shtresave janë të vendosura dhe të frymëzuara nga mësimet e Islamit dhe shtypja apo shfrytëzimi nuk kanë vend. Në qoftë se do të ndodhte ndonjë shtypje apo nënshtrim, kjo nuk do të vinte si pasojë se disa prej grupeve që përbëjnë shoqërinë nuk janë të barabarta në pasuri, por do të ndodhte për shkak se disa individë apo pjesëtarë të kësaj shoqërie nuk i binden apo nuk praktikojnë ashtu siç duhet mësimet dhe vlerat spirituale të Islamit.

S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti). (Kur'ani, el-Huxhurat: 10)

Në një shoqëri të fortë muslimane, ekzistojnë si barazia dhe vëllazërimi. Barazia nuk varet nga ana materiale, por në besimin fetar. Të gjithë muslimanët, si i pasur a i varfër, si mbreti dhe një njeri i thjeshtë janë njëloj. Në adhurim dhe para Zotit, ata janë të gjithë njëloj të barabartë. Pra është kjo barazi që i bën të gjithë vëllezër muslimanë pa marrë parasysh as pozitën ekonomike, as rangun apo statusin, racën apo ngjyrën. Gjithashtu bazat e vëllazërisë në një shoqëri islame nuk varen nga statusi i zotërimit të një pasurie nga njerëzit, por bazohet tek shpirtërorja që vjen si rezultat i besimit në mësimet e Islamit. Dhe mund të themi se ky është një vëllazërim i vërtetë me zemra të pastra, ku nuk ka vend xhelozia apo zilia.

Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e Allahut, e mos u përçani! Përkujtonie nimetin e Allahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së xhebennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu Allahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të jeni të vërtetën e lumtur. (Kur'ani, Ali Imran: 103)

Ky ajet kur'anor tregon se sa e qartë dhe e pastër është thirrja islame për vëllazërim, edhe për ata që më parë kanë qenë armiq të fesë, nxiten apo thirren për t'u bashkuar në rrugën e drejtë. Pra pa dyshim muslimanët nuk thirren për t'u bërë armiq të njëri-tjetrit, derisa barazimi në pasuri të arrihet.

Është mjaft e qartë nga e gjithë sa u përmend më lart se Islami nuk është socializëm, dhe përpjekjet e bëra për të provuar se Islami ka elemente socialiste apo se Islami është i bazuar në socializëm, jo vetëm se do të dështojnë, por ato nuk duhet të ishin bërë në radhë të

parë. Pra ata që mundohen në këtë pikëpamje kërkojnë të degradojnë statusin e Islamit si fe me një ideologji të krijuar prej njerëzve ordinerë. Islami dhe socializmi nuk mund të jenë asnjëherë të njëjtë, përkundrazi Islami dhe socializmi, janë dy gjëra që qëndrojnë në pole komplet të kundërta. Por, kur ideologjia socialiste praktikohet në vendet muslimane, shohim se besimi fetar fillon të dobësohet dhe lufta civile mund të vijë si pasojë.

Mund të gjejmë intelektualë dhe filozofë, të cilët mendojnë se megjithëse Islami dhe socializmi nuk janë të njëjtë, asgjë nuk do të humbnin në qoftë se do të pranonim barazinë materiale, dhe e shtonin këtë mbi barazinë shpirtërore dhe besimin, ashtu siç kërkohet nga Islami. A do të mundej një shoqëri muslimane, pjesëtarët e së cilës janë të përqafuar fort në vëllazërim me anë të lidhjeve shpirtërore, spirituale, të bëhet më e fortë në qoftë se diferencimet në pasurinë e zotëruar do të zhdukeshin një herë e përgjithmonë?

Logjikisht, të arrish një barazi materiale dhe një barazi shpirtërore, ndoshta mund të sjellë qeniet njerëzore më afër me njëri-tjetrin. Por, fatkeqësisht barazia materiale është e pamundur, sepse është përkundër natyrës. Jo dy gjëra janë krijuar të njëjta në botë. Çdo gjë është ndryshe nga tjera. Nga 4 miliardë njerëz që gjenden në rruzullin tokësor, jo dy njerëz mund të jenë komplet identikë.

Kjo është një e vërtetë që nuk mund të kundërshtohet apo të hidhet poshtë. Çdo përpjekje për të arritur barazinë jo vetëm se do të dështojë, por do të sjellë probleme që do të çojnë në konsekuenca të padëshirueshme.

Kur populli i Parisit u ngrit në revoltë në vitet 1789-1793 dhe pa mëshirë vranë mbretin Lujin e XVI, Marie Antoinette, dhe gjithë aristokracinë e Francës, ata erdhën me deklaratën se do të sillnin Liri, Barazi dhe Vëllazërim. Por edhe pse me mijëra ishin vrarë dhe pasuria

e tyre ishte marrë në duart e revoltuesve barazia akoma nuk u arrit, edhe midis vetë revolucionarëve. Në fakt ata filluan të grindeshin me njëri-tjetrin mbi mospajtimet që lindën midis tyre.

Qysh prej Revolucionit Francez, përpjekjet për të arritur një barazi në pasuri dhe atë materiale asnjëherë nuk kanë pushuar. Teori pas teorie janë formuluar dhe mënyra të ndryshme janë provuar për të arritur këtë barazi në shoqërinë njerëzore. Socialistët kanë ngritur një sistem politik që jep fuqi qeverisjeje tek punëtorët e shtypur, kështu që ata mund ta përdorin këtë fuqi për të marrë përsipër të gjitha burimet e pasurisë për të arritur një ndarje të barabartë. Të gjithë do të kenë të drejta të barabarta, të ardhura të njëjta në shtetin socialist dhe askush nuk do të jetë sipër të tjerëve.

Në qoftë se mundësitë për punësim, nuk do të jenë të mjaftueshme, të papunëve do t'u jepen të drejta dhe asistencë nga qeveria. Burimet natyrore janë një pasuri e përbashkët për të gjithë popullin, dhe fitimet prej tyre duhet të jepen të gjitha tek të punësuarit apo të papunët pa dallim.

Fatkeqësisht kënaqësia dhe vëllazërimi nuk mundi të realizohej, dhe problemet sociale filluan të shfaqeshin. Çdo vit, çdo muaj, në të vërtetë çdo ditë do të kishte trazira. Ata që ishin "barazuar" në pozitë dhe nga pasuria materiale ishin në konflikt të vazhdueshëm me njëri-tjetrin. Çfarë do qoftë kriteri që u përdor, çdo njeri besonte se ai nuk kishte fituar në mënyrë të "barabartë" me të tjerët.

Barazia e kërkuar ishte një barazi me atë që kishte më shumë. Midis punëtorëve, ashtu si dhe midis kapitalistëve, asnjëherë nuk ishte kërkuar të bëhej barazimi midis tyre dhe atyre që kishin të ardhura më të vogla.

Në një shtet socialist si Anglia, kërkesat për një "barazi" e kanë kthyer këtë vend nga një vend të pasur në një vend të famshëm për problemet e pafundme. Në ko-

hën e kapitalizmit punëtorët që punonin në minierat e qymyrit ishin një shtresë e shtypur. Puna e tyre ishte mjaft e rrezikshme, shpesh duke marrë jetë njerëzish dhe paga ishte mjaft e vogël.

Si rezultat i sjelljes në skenë të konceptit të barazisë nga socialistët anglezë, në minierat e qymyrit që tani ishin marrë nga shteti, të ardhurat e punëtorëve filluan të rriteshin dhe për rreziqet e punës në minierë filluan të merreshin masa, që çuan në uljen e rasteve të aksidenteve pasi filloi të përdorej teknika e re. Të ardhurat e një punëtori u rritën njëqind herë më shumë nga ajo që merrnin në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Jetesa e punëtorëve të minierave filloi të përmirësohej dhe u bë e një standardi me punëtorët e tjerë, kishte raste edhe më e mirë.

Megjithatë, përsëri punëtorët e minierave nuk ishin akoma të kënaqur. Ata e krahasonin punën e tyre me punën e zyrtarëve dhe konkludonin se përsëri nuk ishte arritur “barazi” apo drejtësi. Për të pasur paga akoma më të larta ata filluan të hidheshin në greva, dhe sidomos gjatë periudhës së dimrit kur puna e tyre ishte shumë kritike. Në Angli, një grevë nga punëtorët e minierave do të thoshte që shumë shtëpi nuk do të kishin lëndën e parë për ngrohje. Këto aktivitete të punëtorëve rrezikonin shëndetin e të moshuarve, të sëmurëve dhe sidomos të varfërve. Disa nga këta të pafat filluan të sëmureshin në gjendje kritike dhe të vdisnin nga të ftohtët. Pra për ta “barazia” dhe drejtësia e kërkuar nga punëtorët e minierave ishte një mizori torturuese. Por ata ishin shumë pak në numër për t’u ngritur në demonstrata dhe për të kërkuar “barazi” dhe drejtësi për veten e tyre. Pra nga ky shembull është e qartë se kërkesat për “barazi” (drejtësi) do të sillnin një mosbalancë në shoqëri.

Por këto incidente të mizorisë që vinin si rezultat i ngritjes për barazi dhe drejtësi, ndodhnin gjatë gjithë ko-

hës. Pacienti është ai që vuan në rastet kur infermierët dhe doktorët ngrihen për të fituar më shumë barazi dhe drejtësi. Një pjesë e punëtorisë do të mbeten të papunë për shkak se pjesa tjetër kërkojnë më shumë barazi dhe drejtësi. Dhe si rezultat zhvillimi i vendit do të ketë pasoja për shkak se grupe të ndryshme punëtorësh veprojnë sipas interesave të tyre.

Pra kur socialistët veprojnë nëpërmjet legjislativioneve dhe grevave, grupi tjetër kërkojnë të arrijnë barazinë nëpërmjet marrjes së fuqisë së pushtetit. Ndryshe për komunistët, ata mendojnë se barazia midis njerëzve mund të arrihet vetëm atëherë kur të eliminohet aristokracia, kapitalistët, borgjezët dhe pushteti të merret dhe të vendoset nga vetë punëtorët.

Ngjashëm si në Revolucionin Francez, masakra makabre ndodhën edhe në kohën e marrjes së pushtetit në Rusi në vitin 1917. Gjatë kësaj kohë u vranë dhe u masakruan jo vetëm aristokratë, kapitalistë dhe borgjezë, por edhe punëtorë dhe fshatarë të thjeshtë në qoftë se ata nuk e pranonin ideologjinë komuniste. Nga koha në kohë njerëzit do të vriteshin apo do të dëboheshin prej vendeve të veta, vetëm e vetëm që ideologjia komuniste, e cila deklaronte se po fshinte diferencimet midis shoqërisë njerëzore të arrinte objektivin e vet.

Por shoqëria komuniste akoma nuk e ka arritur barazinë që ata e propagandojnë aq shumë, përderisa thërresin çdo njërin "shok". Në një shtet komunist ku thuhet se të gjithë janë të barabartë ekziston një shtresë e vogël njerëzish, të cilët përdorin makina, jetojnë në shtëpi moderne dhe janë në gjendje të udhëtojnë jashtë shtetit, kur 90 % e popullsisë nuk kanë asnjë nga këto lehtësime.

Influenca e materializmit, e cila motivon përpjekjet e bëra për të arritur barazinë nuk është kufizuar vetëm të socialistët dhe komunistët. Në një shtet kapitalist gjith-

ashtu, ka kërkesa për forma të ndryshme të barazisë materiale. Përveç të drejtave në politikë, në kontekstin e një ekonomie të lirë, të gjithë shtetasit kërkojnë të drejta të njëjta për liri dhe pasuri. Por diçka është e çuditshme, se sa herë që “barazia” është arritur, drejtësia dhe lumturia nuk kanë mundur të shihen. Dhe në atë vend me shumë “diferencime” do të shihen dhe kështu që kërkesat për “barazi” asnjëherë nuk do të pushojnë dhe shoqëria do të jetë në trazira të përhershme.

Këtë fenomen të çuditshëm fare qartë mund ta shohim nga ilustrimi i mëposhtëm. Ngjyra e lëkurës së njeriut, që asnjëherë nuk ka pasur problem tek muslimanët, por që është bërë një çështje shumë e madhe për ndjekësit e çështjes së “barazisë” në Perëndim. Vëmendja është tërhequr jo vetëm në diferencimet e të drejtave dhe pasurisë midis të bardhëve dhe zezakëve, por gjithashtu përpjekje bëhen në uljen e diferencave të paraqitjeve të tyre. Zezakët mundohen të kopjojnë gjuhën, fenë, vlerat dhe mënyrën e jetesës të të bardhëve, ndërsa të bardhët mundohen të marrin nga stilet e flokëve, të kopjojnë mënyrat e të folurit dhe kulturën e zezakëve.

Dhe të gjitha këto përpjekje për të arritur një barazi do të dështojnë pasi barazia e kërkuar nuk është spirituale, shpirtërore, por është vetëm e jashtme. Edhe pse ata janë të njëjtë në fe, gjuhë dhe tradita, të bardhët dhe zezakët ndryshojnë në zemrat dhe mendjet e tyre dhe kështu ky mosbalancim do të vazhdojë me gjithë përpjekjet e bëra.

Një tjetër barazi që kërkohet nga shoqëritë në Perëndim është barazia e gjinive. Ne fillim ishin vetëm gratë që agjtonin për barazi në të drejtën e votës, por sot kërkesat për “barazi” janë rritur. Gratë mbajnë flokë të gjata edhe burrat gjithashtu. Burrat veshin pantallona dhe gratë duan të bëjnë të njëjtën gjë. Por me gjithë përpjekjet e bëra ata

nuk do të duken kurrsesi të njëjtë. Dhe në përpjekjet për të zvogëluar diferencat midis gjinive, përdorimi i rrobave të ashtuquajtura “për të dy sekset” është si në modë. Por prapë edhe pse burrat mbeten burra dhe gratë gra, çuditërisht përpjekjet e tyre akoma vazhdojnë.

Tani kërkesa të tjera kanë dalë. A ka të drejta të njëjta ndërmjet vetë grave? Pse prostitutat të shihen me një sy tjetër? A nuk është kjo një diferencë në të “drejta”? Dhe prostitutat fillojnë të demonstrojnë dhe të sulmojnë Kishat derisa priftërinjtë të ndalin diskriminimin e bërë midis këtyre grave të përdala dhe grave të thjeshta. Pastaj përfaqësues prej këtyre grupeve marrin pjesë në Asamblëtë Ndërkombëtare të Grave, dhe aty marrin lëvdata e falënderime për përpjekjet e bëra në kërkesat për të arritur të “drejta” dhe “drejtësi”.

Fatkeqësisht të gjitha këto prapë do të dështojnë në sjelljen e barazisë në shoqërinë perëndimore.

Pse gratë duhet të martohen me burrat? Çfarë të lige ka nëse burrat martohen me burrat dhe gratë me gratë? Çfarë të lige ka nëse një burrë kërkon një burrë tjetër dhe e kundërta?

Pra kërkesat për “barazi” nuk njohin më limite. Çfarëdo kërkesë që bëhet në emër të barazisë, duhet të konsiderohet e drejtë dhe do të bëhet e pamundura për t’u arritur. Në këtë mënyrë morali perëndimor është degraduar e shkatërruar në emër të arritjes së barazisë.

Pra në këto vende meqë fëmijët dhe prindërit janë të barabartë, fëmijët nuk është e nevojshme t’i respektojnë prindërit e tyre. Meqenëse nxënësit dhe mësuesit janë të barabartë, nxënësit nuk e kanë për detyrë t’i dëgjojnë, apo t’u binden mësuesve të tyre. Meqenëse, liderët dhe ndjekësit e tyre janë njëllor, ndjekësit nuk është e nevojshme t’i ndjekin liderët e tyre, në fakt janë liderët ata që duhet të bëjnë çfarë ndjekësit e tyre thonë.

Problemi është, se kur ndjekësit duhet të ndjekin liderët dhe se kur liderët duhet të dëgjojnë ndjekësit e tyre nuk mund të vendoset. Dhe kështu shoqëria kthehet në një shoqëri kaotike, sepse liderët dhe ndjekësit kanë të drejta të njëjta për të udhëhequr, por pikëpamjet e tyre nuk janë asnjëherë në përputhje.

Megjithëse fakte janë sjellë se “barazia” nuk është e dëmshme për shoqërinë, por në fakt është e pamundur për t’u arritur, ajo sillet në formën e “drejtësisë” që duhet të jetë në shoqëri. Muslimanët gjithashtu, shikojnë me homazhe mbi këtë kualitet të Perëndimit, dhe e pranojnë si “drejtësi” dhe si rezultat, diferencat që ndodhën në shoqërinë perëndimore fillojnë të shfaqen edhe në shoqërinë muslimane.

Klasat, apo shtresat nuk ekzistojnë në një shoqëri muslimane. Megjithëse ka të pasur dhe të varfër, në këtë shoqëri nuk ka ndarje klasash. Muslimanët e vlerësojnë familjen, ku përfshihen edhe kushërinjtë e largët. Familja muslimane, e kundërta me një familje perëndimore, nuk përfshin vetëm prindërit dhe fëmijët. Aty përfshihen nga stërgjyshërit deri të stërnipat, të gjithë janë të lidhur nën një lidhje familjare.

Pra nga e gjithë kjo strukturë e familjes nuk mund të jenë të gjithë të pasur apo të gjithë të varfër. Secila nga këto familje ka pjesëtarë të pasur dhe të varfër, por edhe pse disa janë të pasur dhe disa të varfër të gjithë pa dallim i përkasin të njëjtës familje. Pra kjo lidhje nuk mund të hidhet poshtë me ndryshimet në statusin ekonomik të këtyre pjesëtarëve.

Por kur muslimanët pranojnë konceptin socialist, materializmin dhe fillojnë të kërkojnë “barazi” materiale, solidariteti dhe vëllazëria islame do të fillojë të dobësohet, dhe lidhjet familjare do ta humbasin rëndësinë e tyre. Tani klasave dhe zotërimit të pasurisë i jepet me

shumë prioritet. Të varfrit dhe të pasurit do të bëhen armiq të njëri-tjetrit. Të varfrit synojnë të marrin atë çfarë të pasurit zotërojnë, dhe këto pasuri më pas duhet të ndahen në mënyrë të barabartë, pasi kjo është e “drejtë” dhe “drejtësi” do të thotë “barazi”.

Vallë a nuk e aprovon vetë feja drejtësinë? Në qoftë se diferencat midis të varfërve dhe të pasurve do të ishin të padrejta, pa tjetër që vetë feja do të ishte kundër këtyre diferencave. Marrja e pasurisë së tjetrit është plotësisht e ndaluar nga feja, kurse në këtë rast pasuria merret për të arritur të ashtuquajturën drejtësi! Në qoftë se drejtësia kërkohet nga feja, patjetër që edhe marrja e kësaj pasurie do të mbrohej nga vetë feja!

Dhe kështu shkon mendimi i muslimanëve të cilët kanë pranuar materializmin perëndimor. Të ngulitur me idetë e barazisë, ata mundohen të modifikojnë interpretimet dhe mësimet fetare, për të eliminuar konfliktin midis të drejtave dhe drejtësisë në Islam dhe të drejtave dhe drejtësisë në materializmin perëndimor.

Sot disa nga vendet muslimane janë kthyer në vende socialiste dhe një pjesë tjetër e tyre e kanë zëvendësuar Islamin me ideologjinë komuniste. E gjitha kjo ndodh për arsye të keqkuptimit që ndodh në lidhje me materializmin dhe spiritualizmin.

Prandaj materializmi dhe spiritualizmi apo shpirtërorja duhet të shpjegohen dhe përkufizohen më qartë. Pasuri nuk do të thotë materializëm dhe varfëri nuk do të thotë fuqi shpirtërore. Pasuria dhe varfëria nuk janë të lidhura drejtpërsëdrejti me materializmin dhe spiritualen. Materializmi mund të ekzistojë në një shoqëri të varfër dhe spiritualizmi mund të jetë më i fortë dhe të praktikohet më mirë në një shoqëri të pasur.

Ky fakt duhet të kuptohet mirë nga muslimanët. Përndryshe ideologjitë e ndryshme të krijuara nga nje-

rëzit, do të ngatërrohen me fenë si ligj i Zotit, dhe kjo do të bëjë që muslimanët të humbasin dhe fenë e tyre. Armiqtë e Islamit nuk mundohen ta sulmojnë këtë fe vetëm në fushën e betejës, por ata sillen dhe në mendjet e njerëzve. Mungesa e vigjilencës mund të bëjë që Islami të influencohet me filozofitë dhe ideologjitë perëndimore dhe fundi nuk do të jetë me Islam. Kjo do të sjellë rënien e Islamit.

Në qoftë se besimi dhe spiritualizmi do të ruheshin, patjetër që ky besim do të forcohej. Kur dikush vuan dhe është i forcuar të harrojë të respektojë veten e vet, është mjaft e vështirë për të, të besojë se ai në të vërtetë është duke bërë një jetë të mirë, dhe është më me fat se komshiu i tij që nuk ka besim në asnjë fe, megjithëse është i pasur. Për këtë njeri realiteti konfliktuohet me besimin. Mendja e tij nuk mund ta pranojë këtë si të vërtetë.

Në qoftë se këtij njeriu do t'i duhet të lypë apo të jetë i varur nga ndihma e komshiut të tij ateist, besimi i tij do të fillojë të lëkundet, të dobësohet. Në qoftë se edhe të tjerët në rrethin e tij janë duke vuajtur dhe nuk mundën ta ndihmojnë të dalë nga kriza, besimi i tij do të dobësohet akoma me shumë. Dhe së fundi në qoftë se ai është në këtë gjendje besimi dhe ai do të ndihmohet nga materialisti, besimi i tij fetar do të humbasë fare.

Kjo që mund të ndodhë tek një njeri, mund të ndodhë edhe tek një grup njerëzish, shoqëri dhe së fundi tek një komb i tërë. Dhe kjo është ajo çka në jemi duke parë tani. Realiteti nuk mund të fshihet apo të hiqet nga "mendja" se besimi në vlerat spirituale ka pasuar një rënie. Përpjekjet për të ringjallur besimin dështojnë, për shkak se nuk jemi në gjendje të sjellim prova të qarta se në atë që u besua më parë është e vërtetë. Dhe duke qenë në këtë gjendje depresioni, shumë grupe mundohen të gjejnë ngjashmëritë midis fesë apo spirituales dhe ideo-

logjisë materialiste perëndimore. E gjitha kjo ndoshta do të ulë dyshimet rreth fesë, por nga studimet e bëra është treguar se kjo gjë nuk është gjë tjetër veçse një proces i ngadaltë që çon në humbjen e besimit, dhe eventualisht ideologjia materialiste do të zëvendësojë spiritualen.

Grupet e tjera mundohen të ruajnë spiritualen duke mbyllur sytë dhe veshët para realitetit. Ata mundohen të hedhin poshtë çdo gjë që ka lidhje me këtë botë dhe mundohen të izolojnë nga influencat e jashtme. Për të mbajtur të gjallë besimin dhe vlerat spirituale, ashtu si në kohën e Profetit, këto grupe mundohen të praktikojnë atë mënyrë jetese si të atyre kohëve.

Por kjo mund të themi se është e pamundur. Kush-tet kanë ndryshuar kaq shumë sa që askush nuk mund të ikë prej realitetit të botës moderne apo përfshirjes në botën moderne. Kohët dhe rrugët e shkuara nuk mund të ringjallen. Çdo përpjeke për të arritur në këtë gjë do të dështonte dhe dështimi do të rrezikonte më shumë vlerat spirituale që këto grupe mundohen t'i ruajnë apo t'i mbajnë të freskëta.

Kjo ndodh edhe për arsyen se, këta njerëz, këto grupe që mundohen të praktikojnë atë mënyrë jetese të atyre ditëve do të bëhen armiq me të tjerët, të të njëjtës fe, por që nuk janë të gatshëm të praktikojnë dhe të pranojnë mënyrat e vjetra. Ky armiqësim do të sjellë konflikte me spiritualen dhe do të sjellë çrregullime në solidaritetin e besimtarëve në spiritualen. Dhe kjo patjetër që do të dobësojë edhe më shumë këto grupe, dhe së fundi ata do të dështojnë për të arritur atë, për të cilën ata u përpoqën kaq shumë dhe gjithashtu do të humbasin dhe ato çfarë ata kishin më parë.

Kjo është duke ndodhur sot në Malajzi. Ata që deklarojnë se janë ndjekësit e vërtetë të mësimëve dhe vlerave spirituale islame, do të shikojnë me sy të vrëngët dhe

do të dënojnë ata që nuk u bashkëngjiten atyre. Ata do të ngrenë akuza mbi ata njerëz që i përkufizojnë “si grupi që kanë dalë nga rruga e drejtë” dhe mundohen të demonstrojnë atë çka ata mendojnë se është e drejtë dhe mirë. Gjithashtu “spiritualja” nuk i ndalon aspak këta njerëz nga thënia e gjërave të vrazhda dhe jo të vërteta. Por ata harrojnë se të gjitha këto i minojnë dhe rrezikojnë vlerat spirituale.

Meqenëse, ballafaqimi i këtyre kohëve moderne nuk mund të arrihet me vetizolim, dhe vlerat materiale nuk mund të përputhen me spiritualen pa rrezikuar ndjekjen e tyre, atëherë si do të mbrohen vlerat spirituale nga shkatërrimi i materializmit që i kanoset në këto kohë moderne? Ose më qartë mund të shprehemi: cili është qëndrimi i muslimanëve që besojnë në spiritualitetin islam lidhur me përballjen me sfidën e kohëve moderne?

Duke e parë nga sa thamë më lart, se materializmi është baza e jetës moderne perëndimore mund të dobësojë ose mund të shkatërrojë një spiritualitet të brishtë, është e rëndësishme të arrihet një forcim i besimit dhe vlerave spirituale. Në përhapjen dhe në propagandimin e spirituales, është e rëndësishme që vlerat e saj duhet të shpjegohen shumë qartë, sepse një ngatërrim i thjeshtë do të çonte në lidhjen midis spirituales dhe statusit ekonomik të një individi. Varfëri nuk do të thotë forcim spiritual, dhe pasuri nuk do të thotë dobësim spiritual. Pra “klasat” nuk ekzistojnë në një shoqëri që është e brumosur me idetë spirituale. Pasi “klasat” nuk ekzistojnë atëherë edhe problemet që lindin me diferencat e klasave nuk do ta kërcënonin pastërtinë dhe mirëqenien e një shoqërie që u përmbahet vlerave spirituale.

Tjetër është përkufizimi i materializmit. Pasi materializmi dhe interesi për çështjet e kësaj bote shpesh shfaqen së bashku, ato shumëherë mund të ngatërrohen

dhe të definoohen apo jepen me të njëjtin përkufizim. Në fakt ashtu siç e shpjeguam edhe më lart të dyja janë sinonime të njëra tjetrës. Kur një person zotëron një pasuri, nuk do të thotë se ai e ka hedhur poshtë spiritualen dhe është i lidhur me materializmin. Në qoftë se kjo do të ishte e vërtetë atëherë të gjithë ata që deklarojnë se u përmbahen vlerave spirituale duhet të heqin dorë prej çdo gjëje materiale përveç atyre që janë më të nevojshme për një jetesë minimale dhe që ndihmojnë në kryerjen e riteve dhe të adhurimit të Zotit. Por ne fare mirë e dimë se edhe atyre që ju dha detyra për të propaganduar vlerat spirituale kanë nevojë për diçka më shumë për detyrën që ata kryejnë. Sa më i madh që është ky shpërblim nuk do të thotë që ata e kanë humbur besimin e tyre në vlerat morale, por është e rëndësishme të dihet se pasuria dhe të ardhurat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me spiritualen.

Prandaj materializmi duhet të përkufizohet më me qartësi dhe të mbahet në distancë nga zotërimi i një pasurie, pasuria dhe interesi i çështjeve të kësaj bote. Një person mund të ketë një sjellje pozitive apo një sjellje normale për sa i përket gjërave dhe çështjeve të kësaj dynjaje dhe gjithashtu mban një qëndrim serioz në vlerat spirituale. Me fjalë të tjera një balancë mund të arrihet midis interesave dhe gjërave spirituale dhe interesave dhe gjërave që i përkasin kësaj bote. Por duhet të theksojmë këtu se ky balancim nuk mund të vihet midis spirituales dhe materializmit.

Pra meqenëse zotërimi i një pasurie nuk do të thotë humbje e vlerave spirituale, mund të vendoset diçka si mënyra më e drejtë për ata që mundohen t'u përmbahen vlerave spirituale. Nuk është e nevojshme për ta të hedhin poshtë këtë pasuri apo të hedhin poshtë përpjekjet e bëra për të arritur këtë pasuri, gjithashtu mos të kundërshtojnë as njohuritë për të ruajtur dhe për të mbroj-

tur pozitën e tyre në këtë botë të egër kërcënuese. Meqenëse besimi i tyre në vlerat spirituale mbahet dhe ushqehet çdo ditë, ata duhet të punojnë dhe të vihen në konkurrencë me grupet e tjera që kërkojnë pasuri dhe të kërkojnë dije në të gjitha fushat.

Puna dhe këmbëngulja për të arritur diçka dhe mosdhënia shpejt para vështirësive do të thotë të arrish një sukses në këtë botë, dhe meqenëse të gjitha këto nuk janë aspak në konflikt me mësimet dhe vlerat spirituale të Islamit nuk ka asnjë shkak pse muslimanët nuk duhet të punojnë më shumë për të arritur diçka.

Ne e kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Levi Mahfudh), se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robtë e Mi të mirë. (Kur'ani, el-Enbija': 105)

Pra është e qartë edhe nga ky ajet kur'anor, se kjo botë (toka), u takon atyre që janë më të drejtë. Por më të drejtë këtu nuk do të thotë më të varfrit apo më të pasurit, por çdo musliman që praktikon me sinqeritet mësimet e Islamit, dhe ai do të pranohet nga Zoti si një ndër të drejtët pa u diskriminuar i pasur apo i varfër qoftë. Por në qoftë se kjo diferencë e pozitës do të ishte marrë parasysh, vetë Kur'ani që është dhe fjala e Allahut do ta kishte përmendur.

Pra thëniet si, puna që të çon në prosperitet dhe në të qenit në një influencë do t'i çonte njerëzit drejt lakmisë për gjërat materiale nuk duhet t'i ndalojë muslimanët nga përpjekjet për të punuar, përderisa ata i kryejnë detyrat e tyre fetare, dhe u përmbahen vlerave spirituale. Të punosh nuk do të thotë të harrosh detyrat fetare. Në fakt kur energjitë dhe mendimet harxhohen dhe fokusohen për të kryer një punë, do të lësh më pak kohë për të menduar dhe për t'u ankuar mbi problemet e jetës.

Kur çdo njeri nga ne mundohet të mendojë për fatin e tij në këtë botë, patjetër që do të ndihet nën presi-

on. Gjithmonë do të këtë diçka mangët në pasuri apo në mundësi, apo në gjëra të tjera që dikush tjetër do të këtë avantazhe më shumë. Dhe personi i dytë, që personi i parë iu referua dhe që iu duk më fatlum se vetja, do ta krahasojë veten e vet me një person të tretë që ka më shumë dhe atij të dytit vetja do t'i duket më prapa e më fatkeq e kështu me radhë. Dhe në qoftë se pjesëtarët e shoqërisë do të humbisnin kohën në këtë mënyrë, ata jo vetëm që do të jenë joproduktivë, por dhe atmosfera shoqërore do të bëhet më e zymtë nga mosbalancimi imagjinar i tyre.

Dhe (përkujtoni) kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: Nëse falënderoni, do t'ua shtoj të mirat, e nëse përbuzni, s'ka dyshim, dënimi Im është i vështirë! (Kur'ani, Ibrahim: 7)

Ky ajet kur'anor thekson mbi rëndësinë se çdo musliman duhet të jetë falënderues për çdo gjë që ai ka. Në të vërtetë asnjë qenie njerëzore e sjellë në këtë botë nuk do të jetë larg një fati të mirë në qoftë se ai punon për fatin e tij me një ndershmëri. Çdo musliman në radhë të parë duhet të jetë falënderues se ai është më fatlumi pasi i përket fesë se vërtetë. Duke u bazuar në këtë gjë, patjetër që ai ka diçka më shumë, që të tjerët nuk e kanë, qofshin ata të pasur apo të varfër. Një njeri i pasur, por me një shëndet të keq, jeton gjithmonë me frikën se ai do të sulmohet dhe ai i frikësohet humbjes së pasurisë se tij, kështu që ai asnjëherë nuk është i lirë, dhe nuk është aspak më me fat se një njeri i varfër që mund të themi është larg këtyre tensioneve. Por, në aspektin tjetër atë të pasurisë, ky i pasur është më me fat se i varfëri.

Të qenit mirënjohës për çfarë dikush ka bërë nuk do të thotë të mos punosh për të mbajtur atë çfarë ke fituar. Mos të punuarit do të thotë se dikush manifeston mungesë mirënjohjeje, dhe sidomos për ata persona që janë në gjendje të punojnë. Një njeri i shëndoshë që nuk i ve

në përdorim shanset e dhëna për të punuar tregon një mosmirënjohje për shëndetin e tij. Ky person që Zoti i ka dhuruar një talent apo një aftësi për të kryer një punë në çdo fushë qoftë, nuk mund të quhet mirënjohës për dhuratën që Zoti i ka bërë atij kur ai nuk e vë në përdorim këtë talent apo aftësi.

Pra talenti dhe aftësia e dhënë nuk mund të përdoren vetëm me qëllim për të arritur merita për vete për në jetën tjetër. Të varesh nga të tjerët për të siguruar jetesën tënde, kur ti të kalosh kohën duke kryer çfarë konsiderohet “rituale të adhurimit për të garantuar një vend për në jetën tjetër” patjetër që do të tregojë lakmi. Por, Islami detyrimisht kërkon më shumë se kaq. Ata që japin zekat dhe që falin lëmoshë, ata që i shërbejnë një çështjeje të drejtë, dhe që kontribuojnë në njohuritë njerëzore, janë duke vepruar në lidhje me parimet e Islamit, pasi të gjitha këto akte të tyre janë të lidhura me shoqërinë dhe me këtë botë. Të gjitha këto akte do të sjellin lumturi në këtë botë dhe për jetën tjetër, jo vetëm për atë që i kryen, por gjithashtu tek të tjerët dhe tek mbarë shoqëria. Përdorimi i dhuratave të bëra nga Zoti jo vetëm për qëllimet e veta, por për një numër më të madh njerëzish tregon një mirënjohje për këto dhurata të dhuruara nga vetë i madhi Zot. Dhe kjo pa dyshim që është në vijë me mësimet e Islamit.

Dështimi apo zhgënjimi që shumë shpesh po çirret nga gjeneratat moderne është në konflikt me shpirtin e Islamit. Pak më shumë a pak më pak, dështimi është një manifestim i mosmirënjohjes. Një njeri gjithmonë e ndryshon fatin e vet në qoftë se do të punojë për këtë gjë. Prej tij nuk kërkohet të lëngoje për mangësitë në fatin e tij të mirë. Këtë botë me plot sfida, askush nuk mund ta kapërcejë pa pasur një fatkeqësi të vogël. Në të

vërtetë këto do të jenë sfidat që do të testojnë një njeri në besimin dhe vlerat e tij spirituale.

Allahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre. Po, kur Allahu vendos ta ndëshkojë një popull, atë nuk ka kush që ta zbrapsë. Ata (njerëzit) nuk kanë mbrojtës tjetër pos Tij. (Kur'ani, er-Ra'd: 11)

Duke gjykuar se çfarë çdo kush dëgjon dhe lexon në këtë vend, zhgënjimi dhe dëshpërimi do të shihen vazhdimisht në fytyrat e malajzianëve, përfshirë këtu edhe ata që flasin mbi rëndësinë e vlerave spirituale, dhe sa i keq materializmi është. Në qoftë se disa nga punët e kësaj dynjaje nuk do të ishin në mendjet dhe zemrat e tyre, fjalët dëshpërim dhe zhgënjim do të përsëriteshin prej tyre shpesh e më shpesh. Dhe kjo tregon se besimi i tyre në këto vlera spirituale nuk është aq i fortë, sepse ata që kanë një besim të fortë nuk do të ndjehen asnjëherë të zhgënjyer.

Nga një studim i bërë mbi përpjekjet e Profetit Muhamedit në propagandimin e fesë islame, tregohet se edhe pse sfidë pas sfidash iu bënë për të testuar besimin e tij ai asnjëherë nuk ishte i dëshpëruar apo i mërziur për atë që po bënte. Ai vazhdonte të përpiquej, duke përdorur mënyra dhe metoda të ndryshme duke ndjekur me këmbëngulje rrugët e tij.

Në historinë e përhapjes së Islamit, edhe pas ndërimit jetë të Profetit, si shembull tjetër do të shikojmë përpjekjet e bëra nga kalifët, sfidë pas sfide pa u mposhtur apo të ndiheshin të zhgënjyer a të dëshpëruar. Gjithashtu edhe islamizimi i malajasve, ka qenë një sfidë e jashtëzakonshme për tregtarët arabë dhe indianë në kohën e Muzaffer Shahut (shekulli XV). Në qoftë se ata do të ishin thyer apo zhgënjyer shpejt atëherë malajzianët e sotëm nuk do të kishin arritur në këtë nivel të Islamit dhe ata sot nuk do të ishin muslimanë.

Pra nga këta shembuj është mjaft e qartë se, në qoftë se sfidat e kësaj bote do të ballafaqoheshin me ata që i përmbahen vlerave spirituale, ata do të jenë të pamposhtur dhe do t'i kalojnë me sukses, në zemrat e tyre nuk do të ketë vend për dëshpërim apo mërzi. Por problemi në këtë botë qëndron se kur ata njerëz që besojnë në vlerat materiale duket se janë më të avancuar dhe më të suksesshëm nuk duhet të sjellin mërzi apo dëshpërim në fytyrat e atyre besimtarëve që besojnë në vlerat spirituale. Dhe edhe pse këta besimtarë do të gjejnë se diçka u mungon në vetvete ata si mbajtës të vlerave spirituale asnjëherë nuk duhet ta lëshojnë veten dhe të mposhten para dëshpërimeve dhe mërzi. Në të kundërtën ata duhet t'i fokusojnë të gjitha energjitë, forcat dhe mendimet në përpjekjet për t'i kaluar këto vështirësi që u dalin para dhe të arrijnë gjithmonë suksese.

Pra duke e parë se pasuria dhe frytet e materializmit, mund të kërcënojnë në çdo kohë mbijetesën e vlerave spirituale, besimtarët që i përmbahen këtyre vlerave duhet ta kenë të qartë në mendjet e tyre qëndrimin që ata duhet të mbajnë ndaj këtyre pasurive dhe të mirave të kësaj dynjaje. Këta besimtarë duhet të përqendrohen në ato metoda dhe rrugë legjitime për të arritur pasuri dhe çdo lloj njohurie, të cilat do t'i shërbejnë për t'i forcuar në fuqi dhe në pozitë të tyre. Dhe rëndësia për të arritur të gjitha këto forcohet edhe me shumë në ditët e sotshme në luftën për ekzistencë në botën e teknologjisë moderne.

Në këto kohë moderne, muslimanët janë duke u ndeshur me mundësi që vendet dhe shoqëritë e tyre të pushtohen dhe të kolonializohen nga kategori të ndryshme materialistësh, qofshin këta kapitalistë, socialistë apo komunistë, ata kanë vetëm një qëllim të shkatërrojnë përpjekjet dhe besimin në vlerat spirituale. Në vendet muslimane të Azisë Qendrore, që janë pushtuar nga ko-

munistët dhe që vazhdojnë të jenë nën regjimin komunist feja islame është duke i humbur besimtarët e vet.

Ky fat është edhe për muslimanët në vendet e Azisë Lindore, dhe asaj të Jugut. Një fe është e pakuptimtë pa besimtarët e saj. Gjithashtu theksimi ose dhënia rëndësi vetëm e jetës tjetër, si e vetmja gjë e rëndësishme është e pakuptimtë. Një fe ekziston kur ajo ndiqet nga besimtarët e saj. Pa dyshim mund të themi se muslimanët janë gabim, kur si rezultat i mungesës së disa prej aftësive të tyre, ata i lenë vendet e tyre muslimane të pushtohen dhe shumë prej besimtarëve muslimanë të vriten, torturohen apo të ndryshojnë idetë e tyre me propaganda antiislame dhe së fundi të humbin besimin e tyre dhe si rezultat në këto vende nuk do të mbeten më muslimanë, apo fe islame.

Për këtë arsye mund të themi se është një nga detyrat e muslimanëve që të përpiqen për të përfituar dhe jo vetëm për të përdorur armatimet moderne, por edhe të hartojnë dhe të prodhojnë këto armatime. Të punosh për mbrojtjen e vendit dhe të komunitetit musliman, muslimanët duhet të kenë një pasuri të mjaftueshme, që do t'i ndihmojë për ta vënë në përdorim për mbrojtjet më moderne, të cilat padyshim kërkojnë edhe një alokim shumë kolosale.

E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake) e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të, (me përgatitje) ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e Allahu i di ata. Çkado që shpenzoni për rrugë të Allahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë. (Kur'ani, el-Enfal: 60)

Në Azinë Perëndimore, muslimanët përherë ishin në humbje derisa ata mundën të krijonin një pasuri nga industria e naftës. Edhe tani kur teknologjia e luftës është në çështje, ata përsëri e kthejnë veten në lypsarë.

Pozita e muslimanëve në këto vende është akoma e pasigurt, sepse pasuria pa një mendje të shëndoshë nuk është efektive. Përveç kësaj, kjo pasuri nuk do të zgjasë shumë në qoftë se ata nuk do të dinë si të ruajnë dhe ta vënë në përdorim këtë pasuri. Në një vend të shquar musliman, gjithë arsenali mbrojtës është në duart amerikane.

Këtu është për t'u përmendur rasti se shumë nga këto vende kanë humbur çdo pasuri parash që u fitua nga industria e naftës dhe kjo për të vetmen arsye se ata kanë shpenzuar pa kontroll, dhe nga injoranca në metodat e administrimit të biznesit.

Një fe nuk do të mbrohet dot pa pasur një pasuri dhe të ardhura. (Hadith)

Është me të vërtetë një fenomen interesant se ata njerëz që nuk janë të aftë dhe që nuk dinë si ta vlerësojnë dhe ta menaxhojnë pasurinë, këta njerëz kanë dhe pasuri të pakufi. Pasuria nga nafta (petroli) për shembull nuk ka bërë asnjë dëm në ekonominë dhe në vlerat e popujve që u janë përmbajtur vlerave spirituale. Përpara se nafta të bëhej një burim pasurie, vendet e Azisë Qendrore, nuk kishin këtë nivel të lartë jetese. Por sot ngritja e çmimeve të petrolit ka sjellë një inflacion të pakontrolluar, i cili e ka bërë më të vështirë për muslimanët që të kryejnë detyrat e tyre fetare, një ndër të cilat, që varet nga ky fenomen, është kryerja e haxhit. Gjithashtu, sjelljet dhe mënyrat e qëndrimit të këtyre pasanikëve të rinj (nouveau riche) e ka shkatërruar imazhin e muslimanëve.

Kjo botë në të vërtetë nuk është një realitet përfundimtar. Çdo njeri do të vdesë një ditë dhe pasurinë që e ka krijuar apo e zotëron ai nuk do ta marrë me vete në varr. Në kohën e Faraonit, e praktikonin si rit dhe e merrnin pasurinë e kësaj bote me vete në varr, por kjo ishte vetëm një ëndërr, dhe kjo ëndërr nuk ka vend në fenë islame. Qëndrimi islam në këtë çështje është i bazu-

ar në vlerat spirituale. Një musliman i mirë nuk duhet të harrojë asnjëherë se pasuria e kësaj bote kërkohet vetëm në këtë botë. Lumturia e përjetshme varet në në ibadetin që ai bën, përpjekjet e tij për të marrë sa më shumë nga mësimet fetare, dhe si e për çfarë qëllimi pasuria e tij është përdorur.

Por megjithëse pasuria e kësaj bote nuk e ndihmon njeriun për të arritur ahiretin, kjo pasuri mund të ndihmojë për të zgjidhur problemet e jetesës jo vetëm për familjen e tij, por edhe për komunitetin musliman ku ai jeton. Vetëm një materialisti lakmitarë do t'i vinte keq që nuk e merr dot këtë pasuri me vete edhe kur të vdesë. Një njeri që beson në vlerat spirituale nuk do të këtë ndjenjë, sepse ai e di dhe e ka pranuar faktin se jeta e pasur e kësaj bote është vetëm kalimtare. Në të vërtetë ai është në paqe dhe i qetë kur e di se përpjekjet e tij në këtë botë kanë qenë një formë e ibadetit, shërbime për në rrugën e Zotit, dhe gjithashtu njerëzit që do të jetojnë pas tij do të kenë përfitim nga pasuria e tij.

Pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote, kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë të Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë. (Kur'ani, el-Kehf: 46)

Në Islam të ndihmosh të tjerët është një virtyt dhe muslimanët janë të nxitur të veprojnë në këtë mënyrë. Kur dikush vdes dhe le pas njëfarë pasurie, kjo pasuri do të ndahet sipas ligjeve të Islamit, që do të ketë të njëjtën vlerë si vlera e zekatit, apo ndihmës, dhe do të përdoret për të rregulluar mirëqenien e pasardhësve të tij apo komunitetin mbanë. Një njeri që e di fare mirë që pasurinë që ka nuk mund ta marrë me vete në botën e përtejme, por ai prapë punon me ndërgjegjshmëri për të fituar më shumë, nuk mund të akuzohet se është lakmitar. Ajo që duhet të gjykohet nuk janë përpjekjet e tij për të arritur këtë pasuri, por sjellja e tij dhe besimi. Në qoftë se ai

është një musliman i mirë që u përmbahet vlerave spirituale, dhe në të njëjtën kohë përpiqet me mish e shpirt për të arritur një pasuri në rrugë të ndershme, të cilën ai e di se së fundi do të ndahet sipas rregullave e ligjeve islame, ky njeri duhet të respektohet dhe të inkurajohet edhe më shumë.

Në anën tjetër, në qoftë se një njeri, refuzon të punojë për të arritur diçka nga pasuria e kësaj bote, sepse kjo pasuri nuk merret me vete në jetën tjetër, ky njeri duhet të shikohet me sy tjetër, sepse ky njeri e vlerëson pasurinë e kësaj bote më shumë dhe se ai është një vetjak që punon vetëm për vete dhe nuk mendon për të tjerët apo shoqërinë. Sjellja e tij është sjellje materialiste, që nuk mund të përputhet aspak me spiritualen.

Në këto kohë materialiste, ata që u përmbahen vlerave spirituale ballafaqohen me sfida të mëdha. Në disa nga vendet muslimane është evidente se sfidat janë të pakapërcyeshme. Muslimanët janë ndarë në dy alternativa: në një grup që i hedhin poshtë dhe në grupin tjetër që i pranojnë vlerat dhe rrugët e kësaj bote materialiste. Hedhja poshtë pa e kuptuar pse-në, e potencialeve të ndryshme për pasuri, ka sjellë edhe disfatën e këtyre grupeve spiritualiste. Dhe në anën tjetër ata që i kanë pranuar vlerat materiale ua kanë kthyer shpinën vlerave spirituale. Vetëm një studim në thellësi i materializmit modern dhe një edukim i fortë spiritual mund të sigurojë mbijetesën dhe integrimin e spirituales në një shoqëri.

Në të vërtetë ky kapitull të mos kuptohet si një fetva (vendim i autoriteteve fetare). Kjo është vetëm një analizë për të kuptuar dhe bërë më të qartë se spiritualja dhe vlerat fetare mund të ruhen pa u larguar nga përdorimi i rrugëve e mënyrave moderne, të cilat mund të ruajnë dhe të forcojnë në të vërtetë pozitën e muslimanëve sot kudo në botë. Megjithatë, duhet ti

kushtojmë me shumë vëmendje qëndrimin ndaj vlerave materiale. Dhe qëndrimi mbi kapitalizmin, socializmin dhe komunizmin si sisteme që janë të bazuar dhe të drejtuar nga materializmi të bëhen të qarta se janë ideologji të gabuara.

Gjithashtu ngatërresat apo mendimet e gabuara midis “pasurisë së kësaj bote” dhe “materiale” duhet të korrigjohen. Pasuria e kërkuar në këtë botë nuk do të thotë lakmi për pasuri. Pasuria e vënë në këtë botë është një dhuratë nga Zoti, dhe jo të gjithë muslimanët mund ta kenë këtë dhuratë. Përbuzja apo hedhja poshtë është një akt arrogance dhe mosmirënjohje e dhuratave të Zotit. Ajo çfarë një musliman duhet të bëjë është: të pranojë dhe të vlerësojë këtë dhuratë, pa harruar se ata kanë detyra për të bërë në këtë botë për të fituar të përjetshmen.

A do të mundet çdo musliman ta ruajë më mirë spiritualen në qoftë se ai do të ketë njëfarë pasurie dhe ekspertizën për këtë botë moderne? Do t'i humbasin ata vlerat e tyre duke u toksikuar nga kënaqësitë dhe influencat e kësaj bote? Do të dobësohen përpjekjet e tyre për të kërkuar dhe punuar më shumë për mësimet fetare pasi ata do t'i kushtojnë më shumë kohë dhe energji asaj për të arritur të mirat e kësaj bote? A do të shkojë Islami në atë rrugë që vetë kristianizmi ka kaluar?

Fare mirë e kemi parë se sa shpejt pasuria e fituar nga ngritja e çmimeve të naftës ka dëmtuar ekonominë dhe moralin e disa muslimanëve. Prandaj fare mirë mund të themi se gjithmonë ekziston rreziku i shkatërrimit të vlerave spirituale nga pasuria materiale. Por në qoftë se besimtarët e këtyre vlerave spirituale, i kuptojnë ndryshimet midis materializmit dhe pasurisë së fituar në këtë botë, dhe lidhjes se tyre me spiritualen, besimi i tyre as nuk do të dobësohet dhe as nuk do të cenohet të shkatërrohet.

Midis të krishterëve, besimi në vlerat spirituale është shkatërruar, apo është shembur nga presioni i vlerave materiale. Dhe kjo ka ndodhur pasi ata nuk u përballën me kohën e materializmit me sytë hapur e vigjilencë. Ata shumë shpejt u pushtuan nga vlerat shekullare që ishin të lehta për t'u kuptuar dhe për t'u pranuar. Për të ruajtur vlerat spirituale, ata e ndanë Kishën (fenë) nga jeta normale. Si rezultat, kristianizmi filloi të mos ishte në gjendje për të mbrojtur pozitën e vet nga kërcënimet e jetës moderne, dhe vlerat materialiste të filozofëve dhe politikanëve filluan të zëvendësonin çdo gjë spirituale në kristianizëm.

Në të kundërtën ndodh me fenë islame, ku feja nuk ndahet nga jeta normale. Gjithashtu Islami, të paktën në këtë vend (Malajzi), nuk është i ndarë plotësisht nga forcat e tjera politike të qeverisë. Islami prapë ka influencën e vet, dhe në disa vende ai kontrollon edhe administratën e këtyre vendeve. Me vetëdijshmërinë e situatës, Islami akoma siguron se përmbajtja në vlerat spirituale do të vazhdojë të jetë më e fortë në përpjekjet për t'u ballafaquar me sfidat e botës së sotme moderne.

Shpresat akoma janë se spiritualja do të ruhet atëherë edhe kur muslimanët do të kërkojnë dhe fitojnë kontrollin e pasurisë materiale dhe të njohurive moderne. Në të vërtetë, vetëm kur muslimanët të plotësohen me të gjitha mjetet dhe mjeshtritë e kësaj bote moderne, mund të sigurohet se ata do të vazhdojnë t'u përmbahen vlerave spirituale, që do t'iu sjellin lumturinë në këtë botë dhe në atë të përjetshme. Pa pasuri dhe efektshmëri, muslimanët do të jenë një pre e lehtë për t'u shtypur dhe se fundi vlerat e tyre spirituale do të humbasin, pasi kjo është lidhja midis spirituales dhe materializmit dhe efektet e të dyjave mbi shoqërinë njerëzore, dhe në veçanti shoqërinë muslimane.

Kapitulli VI

Malajzianët dhe influenza komuniste

Përqëndro vetëveten tënde singërisht në fenë, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fé), feja e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit. S'ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga Allahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë. (Përqëndrohuni në atë fé) Të kthyer singërisht tek Ai, kini frikë prej Atij dhe falni namazin e mos u bëni nga idhujtarët (Kur'ani, er-Rum: 30-31)

Partia Komuniste Malajziane (MCP) dështoi në planet e saj për të marrë pushtetin në këtë vend nëpërmjet kryengritjeve të armatosura gjatë viteve 1948-1960, dhe kjo për të vetmen arsye se vetë malajzianët refuzuan të bashkoheshin apo të ndihmonin lëvizjet e guerilasve komunistë. Shumë besoj se komunistët në Malajzi u mundën vetëm nëpërmjet përpjekjeve të bëra nga forcat e armatosura të Anglisë dhe të vendeve të tjera që bëjnë pjesë në Commonwealth. Por ne e pamë për shembull se si në Vietnam forcat e armatosura të Amerikës u shkatërruan dhe u mposhtën nga komunistët. Amerikanët humbën në Vietnam se populli i Vietnamit të Jugut nuk ishte i lidhur pas qeverisë. Ata nuk patën një qëndrim rezistent e serioz ndaj komunistëve, dhe besimi fetar në këtë vend nuk e ndalon ateizmin që është një nga shtyllat e ideologjisë komuniste.

Kurse, në Malajzi, me bindje mund të themi se ishin malajzianët ata që luftuan në një anë kundër komunistëve, dhe në anën tjetër anglezët me ndihmën e vendeve të

tjera. Në përgjithësi malajzianët ishin kundër komunistëve. Partia Komuniste Malajziane pas humbjes në 1960, vendosi dhe planifikoi të bënte edhe një përpjekje të fundit, të shtrëngonin radhët e tyre me ndihmën e marrë nga vetë malajzianët. Dhe në qoftë se ata do të fitonin në këtë përpjekje, për ta do të ishin shanset më të mëdha për të marrë pushtetin në Malajzi.

Por qëndrimi antikomunist i malajzianëve qëndronte dhe bazohej në faktet fetare. Mësimet e Islamit janë në një kundërshtim të theksuar me konceptet dhe ideologjinë komuniste. Komunistët hedhin poshtë ekzistencën e Zotit dhe të fesë, kurse feja islame është feja që beson në qenien dhe ekzistencën e një Zoti, dhe gjithashtu kjo fe e përsosur flet mbi rregullat sociale dhe i prek të gjitha aspektet e jetës dhe lidhjeve të muslimanëve. Pra të gjitha këto ishin në kundërshtim me ideologjinë komuniste. Prandaj mund të themi se malajzianët ishin muslimanë dhe kjo ishte edhe arsyeja që ata as nuk do ta ndihmonin komunizmin dhe as do të inkuadroheshin në radhët e komunistëve.

Por nuk mund të mbetemi për një kohë të gjatë të sigurt se feja islame e malajzianëve do të mbeste një kala e pathyeshme te komunistët. Megjithëse jo shumë, një numër i vogël prej këtyre malajzianëve ishin të përgatitur për të hyrë në radhët e komunistëve. Në Indonezi për shembull, shumë muslimanë mohuan fenë dhe u bashkuan me aspiratat komuniste. Në disa vende arabe dhe në Shqipëri, muslimanët e braktisën, e mohuan fenë islame dhe u bashkuan në qeveritë e ngritura nga komunistët. Kurse në pjesën jugore të Bashkimit Sovjetik, pasardhësit e muslimanëve në këtë vend nuk besonin më në fenë islame si rezultat i ndërrimit të pikëpamjeve nga komunistët pasi ata i pushtuan këto vende.

Dhe në të vërtetë, rrënjosja e komunizmit tek muslimanët nuk është më diçka e pazakontë apo e vështirë, gjë që nuk mendohej se do të ndodhte lehtë dhe sidomos në mënyrë direkte. Por mos të harrojmë se në mënyrë indirekte kjo rrënjosje nuk është shumë e vështirë. Dhe në Malajzi ka pasur shenja se ky proces ka kaluar shumë kohë dhe efektivisht e ka ndihmuar kauzën komuniste.

Pra komunistët në Malajzi u përpoqën të influencenin malajzianët në hedhjen poshtë të fesë islame dhe në kundërshtimin e ekzistencës së Zotit. Një ndër evidencat për të provuar pranimin e ideologjisë komuniste nga malajzianët, në të cilën komunistët u bazuan më shumë, ishte forcimi i ngrënies së ushqimeve të ndaluara nga feja. Kështu për muslimanët që donin të bashkoheshin e inkuadroheshin me komunistët ata nuk do t'i besonin asnjëherë se këta muslimanë do të mohonin fenë e tyre në qoftë se ata nuk ishin të gatshëm të hanin ushqimin e dërrit dhe vetëm atëherë komunistët do të kishin konfidencë me ta.

Për malajzianët në përgjithësi, i praktikojnë mësimet e islamit apo jo, ngrënia e mishit të dërrit, ishte një nga gjërat më të vështira që ata mund të bënin. Prandaj edhe ata nuk ishin të gatshëm të merrnin këtë sfidë komuniste dhe filluan ta hidhnin poshtë komunizmin. Kështu që megjithëse komunistët insistuan dhe u përpoqën mjaft në mënyrat e tyre për t'i bërë njerëzit të mohonin besimin në Zot, ishte e vështirë për malajzianët të pranonin komunizmin.

Pra komunistët u ballafaquan mjaft mirë me qëndrimin e malajzianëve në çështjen për të hequr dorë nga feja islame dhe për të pranuar ideologjitë e tyre komuniste. Duke dështuar në këtë aspekt, ata e koncentruan vëmendjen dhe energjitë e tyre në shkatërrimin e unitetit midis malajzianëve. Ata u përpoqën të "provonin" se kauza e tyre komuniste nuk ishte shumë ndryshe nga kauza

muslimane, dhe kështu ata mundën të ulnin rezistencën e malajzianëve në pikë.

Islami i nxit të gjithë muslimanët të jenë të bashkuar. Çdo musliman është vëlla me muslimanin tjetër. Kjo vëllazëri nuk do të thotë se të gjithë muslimanët janë të të njëjtës pozitë apo status, dhe i përkasin vetëm një grupi. Islami e pranon realitetin se në një shoqëri njerëzore është e paevitueshme të mos kemi të pasur dhe të varfër, mbret dhe njerëz të thjeshtë, liderë dhe pasuesit e tyre etj. etj. Por rregulli në lidhjen midis një grupi dhe grupit tjetër është vendosur nga feja islame në atë mënyrë që të sjellë drejtësi dhe vëllazërim midis njerëzve.

S'ka dyshim se besimtarët janë vëllazër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllazërve tuaj dhe kinie frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti). (Kur'ani, el-Huxhurat: 10)

Në fenë islame flitet mbi procedurat ligjore dhe shkallët e dënimit në rastet e krimeve apo të gabimeve të bëra. Gjithashtu kjo fe diskuton dhe përcakton sjelljen, mënyrat e qëndrimit të njerëzve ndaj autoriteteve. Pra në fjalë të shkurtra, shoqëria muslimane është një shoqëri e organizuar në mënyrë të rregullt, e pajisur me mënyra dhe rrugë të ndryshme për t'u marrë me problemet, gjithashtu dhe me zgjidhje për këto probleme të cilat janë të paevitueshme në një shoqëri njerëzore.

Megjithëse kemi rangje të ndryshme në një shoqëri muslimane, të gjithë janë të barabartë dhe të gjithë janë të devotshëm para Zotit, dhe askush nuk mund të bëjë ndërmjetësim midis një muslimani dhe Krijuesit. Siç e dimë, fetë e tjera kanë priftërinjtë apo persona të tjerë të rangjeve të larta fetare, të cilët në emër të njerëzve të thjeshtë bëjnë lutjet apo apelojnë tek zotat e tyre. Në islam, nuk ka as papë, as kardinal, as peshkop, as pasardhës apo përfaqësues të Zotit, dhe të Profetit të tij, ashtu siç ka në fetë e tjera. Në qoftë se në këtë fe ka di-

ferenca, ato janë të bazuara vetëm në shkallën e devotshmërisë ndaj Zotit, dhe vetëm Zoti i di këto diferenca e askush tjetër.

Arabët nuk janë më të mirë se kombet e tjera apo joarabët, përveç devotshmërisë së tyre fetare. (Hadith)

Kjo thënie e nxjerrë nga jeta e Profetit Muhamed, tregon mjaft qartë se në qoftë se mësimet e këshillat e Islamit kuptohen dhe praktikohen në mënyrë korrekte, asnjë shoqëri muslimane nuk do të përçahet, apo të penetrohet nga asnjë besim i huaj fetar apo ateist. E gjitha kjo do të thotë se megjithëse shumica e muslimanëve janë nën qeverisjet e qeverive jomuslimane në përgjithësi, ata nuk do ta mohojnë aq lehtë apo të heqin dorë në mënyrë vullnetare nga feja islame. Dhe malajzianët janë ndër ata popuj që kanë mundur të ruajnë me sukses besimin e tyre në fenë islame, megjithëse toka malajziane është pushtuar dhe kolonializuar për vite me radhë nga budistë, të krishterë etj.

Ashtu siç e përmendëm edhe më lart, komunistët tani e kanë mjaft të qartë rolin e fesë islame si një pengesë, në përpjekjet e tyre për të rrënjosur komunizmin tek malajzianët. Në përpjekjet e tyre për t'i ndarë malajzianët, dhe për të dobësuar rezistencën e tyre ndaj ofensivës komuniste, komunistët përdorën edhe grupe simpatizantësh komunistë që e kundërshtonin Islamin jo në mënyrë të hapur. Ata përdorën edhe konceptet dhe ideologjitë socialiste meqenëse kjo ideologji nuk është shumë e dhënë pas çështjeve të fesë siç është e dhënë mbi rëndësinë e sistemit ekonomik dhe lidhjet midis klasave të ndryshme në shoqëri. Socialistët në veçanti diskutojnë pikëpamjen e të pasurve si shfrytëzues të të varfërve dhe sidomos të punëtorëve, dhe si rrjedhojë punëtorët dhe të varfrit asnjëherë nuk mund të bëhen miq apo shokë me të pasurit. Ata janë armiq të përbetuar të

të pasurve dhe duhet të përpiqen të zhdukin pasurinë individuale, gjë që mund të arrihet me marrjen ose konfiskimin e pasurisë nga qeveria.

Por në Islam, marrja apo konfiskimi i pasurisë nuk është mënyra për të siguruar barazinë dhe vëllazërimin. Gjithashtu pasuria nuk është e ndaluar në Islam, në qoftë se të pasurit u përmbahen rregullave islame për dhënieën e zekatit, fitrës, apo të ndihmave të tjera financiare që ata bëjnë. Por socialistët mundohen të ngrenë njerëzit emocionalisht, duke u tërhequr atyre vëmendjen në vështirësitë që të varfrit kalojnë e vuajnë duke i vënë këto në kontrast me jetën e mirë të të pasurve. Për këtë diferencë midis të varfërve dhe pasurve dhe për vuajtjet e të varfërve dhe shfrytëzimin që u bëhet ata akuzojnë të pasurit. Dhe kjo për ta është një detyrë shumë e thjeshtë për t'u demonstruar, pasi dhe kapitalistët janë jomuslimanë, dhe shfrytëzimi është si diçka normale për ta. Faktikisht kjo pikëpamje e socialistëve pranohet dhe në veçanti nga të rinjtë idealistë. Dhe kur kjo fazë është arritur, principet islame në lidhje me rregullat sociale, dhe lidhjet midis një grupi social dhe një grupi tjetër nuk janë më duke u zbatuar apo duke u ndjekur. Pra sipas pikëpamjes socialiste, nuk ka rëndësi nëse të pasurit janë shfrytëzues apo jo, të varfrit duhet të jenë në konflikt me ta. Pra në fjalë të tjera, konflikti midis klasave nuk vjen si rrjedhojë e shfrytëzimit të të varfërve, por është thjesht ideologjik. Dhe ky konflikt nuk shkon sipas rrugëve të vendosura nga feja islame, por sipas procedurave të vendosura nga socialistët perëndimorë.

Dhe si rezultat i këtij konflikti midis të pasurve dhe të varfërve, punëtorëve dhe punëdhënësve, në solidaritetin islam do të ketë një përçarje. E në këtë fazë është e lehtë për socialistët të trajtojnë të pasurit si më të fuqishmit, d.m.th. liderët e një shoqërie që mbajnë frenat e një

qeverie, dhe si rrjedhojë e kësaj ideologjie ata do të akuzojnë qeverinë për bashkëpunim me të pasurit. Dhe muslimanët e varfër (punëtorët, fshatarët etj.) do të korruptohen në kryengritjen kundër qeverisë. Por kjo do ta keqësojë edhe më shumë përçarjen në solidaritetin dhe vëllazërimin islam.

Me bindje themi se një proces i tillë ka ndodhur midis vetë malajzianëve edhe pse janë të përqafuar në fenë islame. Megjithëse e gjithë filozofia apo pikëpamja e diskutuar më lart është nga socializmi, ato nuk quhen me terma socialiste. Këto pikëpamje propagandohen nga grupe të ndryshme malajzianësh si mësim të Islamit. Po kështu edhe interpretimet e Kur'anit dhe hadithet e Profetit janë modifikuar nga këto grupe në atë mënyrë që t'u përshtaten qëllimeve të tyre.

Lind pyetja: Cilat ishin efektet e ndryshimit të malajzianëve në Malajzi në përpjekjet e tyre kundër komunistëve? Siç e theksuam edhe më lart shkak për humbjen e MCP, Partisë Komuniste Malajziane, në vitet 1948-1960, ishte mospërkrahja e kësaj partie nga malajzianët. Edhe sot e kësaj dite malajzianët fuqishëm kundërshtojnë komunizmin. Besimi i tyre në fenë islame është akoma i fortë. Dhe nga evidencat konkrete mund të konkludojmë se malajzianët sot janë duke i dhënë më shumë se më parë rëndësi besimit të tyre në fenë islame. Megjithatë, nuk e hedhim poshtë, ky ndryshim i rëndësishëm ka ardhur si rrjedhojë e pikëpamjes nga lufta kundër komunizmit.

Një përçarje ekziston në solidaritetin malajzian, dhe kjo përçarje është midis pjesës më të madhe malajziane dhe liderëve të tyre që janë duke mbajtur qeverinë. Një herë e një kohë, vetëm komunistët ishin ata që e kundërshtonin qeverinë (me një përkrahje shumë të vogël nga jomalajzianët) por sot malajzianët vetë janë duke e kun-

dërshtuar qeverinë dhe duke ngritur lloje të ndryshme akuzash për qeveritarët.

Në taktikat e luftës, bashkimi midis dy grupeve që sulmojnë një armik të përbashkët nuk është i domosdoshëm. Ajo çka i bën sulmet e tyre me efektive është se ata sulmojnë në të njëjtën kohë. Komunistët kundërshtojnë qeverinë, edhe malajzianët e kundërshtojnë qeverinë. Megjithëse malajzianët nuk janë as shokë, as aleatë me komunistët, me kundërshtimin dhe sulmet që ata bëjnë kundër qeverisë në të njëjtën kohë, kur qeveria është nën sulmet e komunistëve, këta malajzianë janë duke ndihmuar kauzën komuniste.

E pamë këtë fenomen të ndodhte në Vietnamin Jugor. Për shkaqe totalisht të ndryshme me ato të komunistëve budistët kundërshtonin qeverinë e Vietnamit të Jugut. Përpyekjet e tyre gjithashtu ishin të përkrahura edhe nga lëvizjet studentore që ishin me pikëpamje të ndryshme nga ato të budistëve. Demonstrime të shumta u mbajtën dhe si rezultat i akuzave ndaj qeverisë urretja u bë edhe më e madhe për këtë qeveri në pozitë. Qeveria vetë nga ana e saj u mundua të mbante nën kontroll opozitën duke përdorur policinë dhe ushtrinë, por urretja u nxit edhe midis grupeve që e kundërshtonin qeverinë dhe si rezultat forca luftarake u vu në dispozicion. Më vonë pamë se morali i forcave të armatosura ra për shkak të humbjes së konfidencës së tyre ndaj qeverisë. E sulmuar nga çdo anë dhe e lënë në mëshirën e fatit pasi forcat e armatosura nuk e mbronin më, qeveria e Vietnamit të Jugut ra.

Shumë mund të thonë se rënia e qeverisë së Vietnamit Jugor ishte e merituar pasi kjo qeveri ishte totalisht e korruptuar, por humbja e qeverisë së Vietnamit të Jugut nuk do të thoshte fitore për liderët budistë apo studentët. Ishin komunistët ata që fituan. E kështu Vietnamit i

Jugut humbi jo vetëm lirinë e opozitës, por ata humbën edhe lirinë e fesë. Budistët dhe studentët jo vetëm që nuk fituan asgjë për të cilat ata u ngritën, por ata humbën edhe ato liri që kishin.

E njëjta gjë mund të ndodhë edhe në Malajzi. Në qoftë se malajzianët, duke u fshehur pas principeve islame siç supozojnë ata, vazhdimisht do të sulmojnë dhe shqetësojnë qeverinë do të vijë një ditë që qeveria do të dobësohet dhe kjo dobësi do të përhapet edhe tek forcat e armatosura. Kur administrata dhe mbrojtja janë të dobëta, komunistët do ta kenë më të lehtë për ta marrë në dorë dhe një qeveri komuniste nuk do të lejojë asnjë besim fetar, e as Islam por në të kundërt do të kërkojë ta shkatërrojë Islamin si fe.

E provokimi (kundër muslimanëve) është edhe më i madh se mbytja. Ata do t'u luftojnë juve vazhdimisht për t'ju zbrapsur, nëse munden, nga feja juaj. E kush zbrapset prej jush nga feja e tij dhe vdes si pabesimtar, ata i kanë zhdukur veprat e veta në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Të tillët janë banorë të zjarrit dhe në të do të qëndrojnë përjetshëm. (Kur'ani, el-Bekare: 217)

Posibiliteti i asaj që përshkruam më lart nuk është as sajim i imagjinatës dhe as propagandë. Kjo ka ndodhur në shumë vende arabe të cilat një herë e një kohë kanë qenë qendra të zhvillimit dhe të edukimit islam. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe në Shqipëri, ashtu sikurse ka ndodhur në shumë territore të Bashkimit Sovjetik, dhe Azinë Jug-Lindore. Dhe malajzianët nuk janë muslimanë më të vendosur, sesa kanë qenë këta popuj. Por vetëm ndërgjegjshmëria me mundësinë e ndodhjes mund t'i mbrojë malajzianët nga ligësitë e influencës komuniste.

Kapitulli VII

Sistemi i vlerave dhe malajasit

Ekzistenca e një shoqërie njerëzore varet nga sistemet e vlerave, të cilat kanë ardhur spontanisht apo janë krijuar nga vetë shoqëria. Pa sistem vlerash, qeniet njerëzore nuk do të mund të jetonin se bashku në grup sepse lidhjet midis tyre si pjesëtarë të grupeve nuk do të mund të vendoseshin pa këto sisteme. I “mirë” apo i “keq” sistemi duhet të ekzistojë dhe të pranohet nga një pjesë e madhe shoqërisë në mënyrë që të bëhet i mundur ekzistimi dhe vazhdimi i tij.

E “mira” dhe e “keqja” janë relative. Përkufizimet e të “mirës” dhe të “keqes” nuk vijnë me natyrën e gjërave, por ato janë krijuar dhe pranuar nga shoqëria. E “mira” dhe e “keqja” formojnë bazën e një sistemi vlerash të një shoqërie, që ndryshojnë nga ato të një shoqërie tjetër dhe në kohë tjetër.

Që ta bëjmë më të qartë me fjalë të tjera mund të themi se: çfarë konsiderohet e “mirë” nga një shoqëri, ndoshta do të konsiderohet si e “ligë” nga shoqëria tjetër, dhe se çfarë mund të ketë qenë e “mirë” për një shoqëri shumë kohë më parë, tani mund të konsiderohet e “ligë” nga po e njëjta shoqëri.

Ndërgjegjshmëria e përkohshmërisë së një sistemi vlerash dhe variacionet e tij nga një shoqëri në tjetrën është shumë esenciale në këto kohë, sepse jo vetëm sistemet e vlerave të të gjitha shoqërive janë në një proces ndryshimi, por disa janë duke kaluar edhe në faza çoro-

ditjesh ku vlerat e “mira” po pranohen si të “liga” dhe të “ligat” si të “mira”.

Shembuj të kësaj çoroditjeje apo zvetënimi të vlerave, mund të gjenden kudo në botë. Për shembull, lakuriqësia një herë e një kohë konsiderohej si e “ligë” pothuajse nga çdo shoqëri në botë, kurse sot shumë shoqëri në Perëndim e konsiderojnë lakuriqësinë si diçka “normale” dhe të shëndetshme. Dhe në disa shoqëri të Perëndimit plazhet nudo janë bërë si diçka normale, nuk janë më të ndaluara. Gjithashtu jo shumë kohë larg, marrja e marihuanës, konsiderohej si diçka e “ligë” dhe ishte e ndaluar, por në vitet ’60, përdorimi i marihuanës filloi të përhapej si diçka normale në Amerikë. Dhe kjo nuk do të ishte konsideruar si e “ligë” derisa ky fenomen filloi të kërcënonte shoqërinë amerikane dhe i bëri të ndërgjegjshëm autoritetet që ta konsideronin si të tillë dhe të merrnin masa kundër atyre që merrnin marihuanë. Por shumë nga njerëzit më të arsyeshëm që nuk merrnin marihuanë shpesh pyesnin vetveten: “A është marrja e marihuanës e ligë”?

Në qoftë se marihuana bën një njeri të humbë vetveten dhe pija alkoolike e bën të njëjtën gjë? Në qoftë se pija nuk është e ndaluar, pse është e ndaluar marrja e marihuanës? Dhe kur njerëzit e arsyeshëm fillojnë të pyesin “besimin” e tyre d.m.th. të pyesin këtë vlerë të pranuar nga shoqëria e tyre, kjo shoqëri do të humbasë senset e orientimit. Në këtë situatë të gjendur, ata që mundën të mbanin nën kontroll marrjen e marihuanës do të vazhdojnë të veprojnë kështu në mënyrë më të hapur dhe më të bujshme, kurse ata që iu përmbajtën vlerave të vjetra do të quhen të modës së shkuar, prapanikë, dhe ata që argumentuan mbi vlerat e vjetra do të konsiderohen liberalë dhe përparimtarë.

Një shoqëri që ballafaqohet me këtë sfidë nuk mund të marrë një akt të përgjithshëm masiv, sepse detyrimisht forca e një shoqërie varet e gjitha nga dëshirat e shumicës. Me shfaqjen e grupit përparimtar ose grupit liberal të mbështetur në mënyrë indirekte nga grupi asnjës, mbajtësit e vlerave të vjetra nuk kanë më shumicën në shoqëri. Kështu që vlerat e shoqërisë në lidhje me çështjen e marihuanës do të kalojnë në një farë ndryshimi.

Individët pasivë apo asnjës luajnë një rol efektiv, megjithëse ata veten nuk e shprehin. Ata pa vetëdije mund të japin një ndihmë apo përkrahje te personat aktivë apo agresivë. Një vlerë shoqërore është efektive kur ajo mbrohet dhe ruhet nga shumica. Në rastet e shumicës asnjëse, kur kjo vlerë nuk mbrohet apo ruhet, ajo fillon të humbasë si vlerë e shoqërisë në fjalë. Dhe kjo është çfarë ka ndodhur me shoqëritë e Perëndimit në lidhje me marrjen e marihuanës. Ajo nuk konsiderohet më si diçka e ligë nga shoqëria.

Por është shumë e rëndësishme të kuptohet roli që luajnë shumica që nuk flasin, dhe sidomos në demokraci. Për këtë shumicë mos të thonë asgjë, kur diçka e mirë ndodh është diçka normale, por a duhet të veprojnë ata në këtë mënyrë, të kalojnë pa thënë asgjë edhe kur diçka e ligë ndodh? Ata të gjithë do t'i kalojnë konsekuencat. Por fatkeqësia qëndron në atë se, për shumë njerëz është shumë e vështirë të vendosin nëse ajo diçka që po ndodh me shoqërinë është e ligë apo e mirë. Dhe në këtë rast njerëzit kompetentë duhet të jenë të përgatitur të shpjegojnë situatën e vërtetë.

Një nga vështirësitë që haset në demokraci është garancia e se drejtës së çdo njeriu. Pra demokracia e pranon opozitën, dhe mbron të drejtat e pakicës dhe të individëve. Çfarë lloj opozite duhet të lejohet dhe se kur pakicat duhet të mbrohet, këto janë pyetje të cilat nuk

kanë asnjëherë përgjigje të sakta. Kështu që kur një grup në një shoqëri hedh poshtë ndonjë nga vlerat e shoqërisë, për shembull marrjen e marihuanës, shoqëria nuk është më në gjendje të marrë veprime të tjera. Individë të shumicës do të debatojnë mbi këtë çështje, jo në termat se marrja e marihuanës është diçka e mirë apo e ligë për shoqërinë, por ata do të diskutojnë nga pikëpamja e praktikimit të demokracisë që i jep të drejtën çdo individ apo pakicë të diskutojë në një shoqëri. Nëse kjo e drejtë sjell një të ligë apo një të mirë në skenën e shoqërisë nuk merret fare parasysh për t'u diskutuar. E rëndësishme për ta është se të drejtat e individit dhe të pakicës duhen mbrojtur, pasi kjo është një nga bazat e praktikimit të demokracisë.

Por duhet të kemi parasysh se kjo sjellje devijuese e pakicës, mund të jetë ngjitëse dhe gradualisht kjo pakicë do të rritet në numër. Dhe kur bëhet një pakicë me të vërtetë e madhe, atëherë edhe shumica nuk do të mundë ta kontrollojë edhe me anë të metodave jodemokratike. Kur kjo shkallë është arritur, atëherë vlerat e vjetra kanë humbur dhe vlerat e pakicës janë përhapur në shoqëri dhe ato do të bëhen pjesë e vlerave të tërë shoqërisë. Është mjaft e qartë se fenomeni i dhënies shumë rëndësi të drejtave të pakicës në demokraci, mund të na çojë në viktimizimin e shumicës.

Sot kudo në botë mund të gjejmë çoroditje apo kolapse, sisteme valutash të shoqërive njerëzore. Rregullat dhe ligjet një herë e një kohë konsideroheshin si të domosdoshme dhe të mira, dhe respektoheshin nga të gjithë, kurse sot, rregullat dhe ligjet shihen si pengesa për lirinë, dhe kjo sjell një efekt të keq në vlerat e tjera të mbajtura me kujdes nga shoqëria.

Për shembull, në universitetet e Perëndimit, rregullat kundër djemve studentë për të vizituar vajzat nëpër dho-

mat e konvikteve shihen si një pengesë nga shkollarët në lirinë e tyre. Presioni i ushtruar prej tyre tek administrata dhe mësuesit i bëri këta të fundit të rimendoheshin dhe së fundi të hapnin dyert e lirisë për studentët. Dhe sot në Perëndim kemi konvikte ku meshkujt me femrat jetojnë bashkë ose vizitojnë njëri-tjetrin nëpër dhoma pa asnjë pengesë, dhe nën një liri të plotë. Por nuk ishin vetëm rregullat për në konvikte që u kundërshtuan në universitetet amerikane nga studentët, ata çdo rregull apo ligj e shikojnë si një pengesë për liritë e tyre dhe do të ngrihen fuqishëm çdo herë për të arritur diçka. Dhe si rezultat nuk ka mbetur më asnjë rregull për ta. Studentët mund të bëjnë çfarëdo gjëje që ata dëshirojnë. Dhe si rezultat i këtyre lirive të shfrenuara zyrat e universiteteve u morën nga studentët dhe çdo dosje apo dokument apo mjetet e zyrave u shkatërruan.

Shkatërrimi i zyrave konsiderohej si një liri dhe çdo gjë që studentët bënë nuk u quajt gabim dhe asnjë akt legal nuk u mor kundër tyre. Asnjë nga këta shkatërrimtarë nuk u mor në gjyq dhe asnjë kompensim nuk u bë për shkatërrimet e ndodhura.

Nga incidenti i mësipërm është e qartë se kjo ishte e tëra, rënia e një sistemi vlerash. Një herë e një kohë rregullat e ligjet konsideroheshin të mira për shoqërinë, kurse sot rregullat e ligjet nuk konsiderohen më si të tilla, kurse trazirat, shkeljet e ligjeve, vandalizmat, kërcënimet e të tjera të ngjashme me këto shikohen si diçka normale që nuk duhet të ndalen apo të merren masa ligjore.

Hedhjen poshtë të rregullave dhe të ligjeve nuk e kufizojmë vetëm nëpër universitete. Ne të gjithë shoqërinë perëndimore, shohim ndryshim të vlerave normale. Në qoftë se më parë veshja e rrobave të pastra, të rregullta, ishte një normë sociale apo një praktikë normale e shoqërisë, sot veshjet e grisura, të çrregullta dhe të shqy-

era konsiderohen si diçka moderne. Në qoftë se përpara shoqëria të kërkonte me flokë të prera dhe të krehura bukur, sot është moderne të mbahen flokët e gjata, të pista dhe jo të krehura, ata tregojnë një prioritet që i jepet “lirisë” në vlerat sociale të një shoqërie. Pra kjo është ndryshimi i vlerave në një shoqëri perëndimore, kur ata njerëz me flokë të gjata, të pista, të pakrehura, dhe me veshje të çrregullt konsiderohen si të “bukur e të pashëm”, kurse ata njerëz me flokët e shkurtra, dhe të krehura mirë me fytyra të pastra e të rruajtura dhe që veshin kostume e veshje të rregullta gjykohen si të “shëmtuar”.

Ndryshimet midis grave dhe burrave janë hedhur poshtë gjithashtu. Çfarë burrat bëjnë, gratë duhet të jenë në gjendje t’i bëjnë gjithashtu. Dhe kjo fillon me veshjen, kur të dy sekset veshin veshje të njëjta, p.sh në qoftë se burrat veshin pantallona, gratë duhet të veshin pantallona. Pra hedhja poshtë e vlerave të vjetra çoi më së fundi në pranimin e prostitucionit, p.sh në qoftë se burrat shkojnë me femrat prostituta pse mos të shkojnë edhe gratë me burrat prostituta.

Martesa në lidhje me fenë dhe ligjet civile po kundërshtohet, dhe bashkëjetesa e cila po merr vendin e saj po konsiderohet si diçka normale. Por jo të kënaqur edhe me këtë, po shohim se burrat po “martohen” me burra, ose gjithashtu ka lidhje ku burri bashkëjeton me një burrë tjetër dhe një grua është e dashura e të dyve.

Pra të gjitha këto janë si rezultat i hedhjes poshtë të vlerave “normale” sociale. Por do të shikojmë jo vetëm kundërshtimin e rregullave dhe ligjeve, por gjithashtu ata që imponojnë apo mbështesin ligjet abuzohen dhe keq-trajtohen. Policët thirren me nofkën “derra” dhe roli i policit në mbajtjen e rendit dhe qetësisë, konsiderohet si një shtypje.

Po çfarë është lidhja midis kundërshtimit të vlerave sociale nga ana e Perëndimit dhe Malajzisë dhe në veçanti malajzianëve që janë muslimanë? Meqenëse asnjë individ apo shoqëri nuk mund të qëndrojnë të izoluar, dhe me mënyrat e sotme moderne të komunikimit, ajo çka ndodh është se, çfarë ndodhin në pjesën tjetër të botës do të influencojnë edhe jetën këtu. Në qoftë se Perëndimi, kundërshton vlerat e vjetra dhe përkrah vlerat e reja të prishura, së shpejti shoqëria jonë do të shkojë me të njëjtat ndryshime.

Në fakt kjo ka ndodhur edhe pse ndryshimet më të shpejta kanë qenë në stilet e veshjes. Por megjithatë ndryshimi në stilin e veshjes nuk paraqet ndonjë problem shumë serioz, por bëhet i tillë kur ndiqet dhe nga ndryshime të vlerave të tjera. Për shembull, kur stilet në veshje ndiqen me marrje e marihuanës, nënvlerësimin e punës dhe praktikime të vlerave të tjera të reja.

Bashkëjetesa jashtëmartesore nuk është shumë e përhapur në Malajzi, por raste të tilla mund të gjejmë, ka evidenca. Lejimi dhe pranimi i seksit jashtëmartesor, ekziston sot në Malajzi, dhe shumë forma të tjera të sjelljes që më parë kanë qenë konsideruar si të ndaluara dhe të liga, nga vetë shoqëria malajziane, por që tani janë duke u marrë shumë lehtë si dhe po pranohen si diçka normale.

Rënia e vlerave në lidhje me fenë dhe opinionet e shoqërisë janë evidente në incidente të shumta. Për shembull një vajzë malajziane shkon jashtë shtetit për të studiuar dhe atje martohet me një djalë të racës tjetër. Sipas zakoneve të vjetra, kjo martesë mund të quhet e vlefshme vetëm kur djali të pranojë fenë islame, dhe fëmijët të rriten nën ndikimin e fesë islame. Në të vërtetë kjo mund të ndodhë shumë rrallë, vetëm si formë, pasi në substancë nuk është e mundur të dihet nëse burri apo fëmijët janë muslimanë të vërtetë. Pra është shumë e

vështirë të dallojmë një musliman të vërtetë nga të tjerët. Asnjë njeri nuk mund të lexojë apo të dijë se çfarë tjetri ka në zemër, vetëm Zoti e di të vërtetën.

Pra në rastin e martesës së vajzës malajziane, ajo çfarë ndodh është se: burri nuk do të konvertohet, dhe kjo për arsyen pasi vetë vajza beson në “lirinë” *a la* Perëndim, kur bëhet fjalë për besimin fetar, çdo njeri duhet të jetë i lirë të zgjedhë. Por në qoftë se burri i saj do të pranojë të konvertohet, kjo do të bëhet sa për sy e faqe të shoqërisë, pra do të jetë një veprim hipokrit për të gënjyer shoqërinë, kështu që vetë vajza si një “person i sinqertë” e hedh poshtë këtë mendim.

Të brumosur me këtë liri besimi, kur çifti do të ketë fëmijët e vet, nëna nuk do t’i rrisë nën influencën e mësimëve të Islamit. Ajo mendon se edhe fëmija duhet të lihet i lirë të vendosë se çfarë besimi fetar dëshiron të ndjekë. Pra është e drejta e tij të vendosë nëse dëshiron të ndjekë besimin fetar të nënës apo të babës.

Pra ky shembull tregon mjaft qartë ndryshimin e vlerave që ndodhin tek malajzianët. Ndoshta është një rast ekstrem, por ndryshimet që po shkojnë përtej kufijve zakonisht fillojnë me devijime të vogla. Ne asnjëherë nuk do të jemi në gjendje të tregojmë se ky ndryshim i vogël vlerash u ndoq nga ky ndryshim tjetër i vogël, dhe më pas shpërthimi i tyre do të çojë në rënien e plotë të vlerave të vjetra, ashtu sikurse edhe ndodhi në rastin që përmendëm më lart.

“Ndryshimet e vogla” të vlerave në shoqërinë malajziane ndodhnin shpesh dhe jo të gjitha janë të liga. Nuk e mohojmë faktin se një pjesë e tyre janë të mira, por meqenëse ndryshimet e vlerave në Perëndim janë më shumë drejt të këqijave, sesa të mirave, dhe meqenëse të marrësh të ligat është më e lehtë, shoqëria malajziane pa dyshim që po tregon ndryshime për të keq.

Sjellim një shembull tjetër për ilustrim. Malajzianët e respektojnë moshën, domethënë të vjetërit konsiderohen si më të mençur dhe shihen me një sy tjetër. Por duhet të kemi kujdes se jo të gjithë të vjetrit janë të mençur apo të ditur, ka shumë që janë të paditur dhe shumë prapa në mënyrën e të menduarit.

Pra t'i respektosh të gjithë të moshuarit në princip, ndoshta nuk është gjithmonë e drejtë. Por edhe mos të respektosh të vjetrit nuk është e drejtë gjithashtu, se edhe këta të vjetër kanë qenë një herë e një kohë të rinj vetë. Në qoftë se në kohën e tyre ata kanë qenë të respektueshëm, rritja në moshë nuk do të thotë t'ia humbësh këtë të drejtë. Por fatkeqësisht sot tek të rinjtë, të moshuarit janë njerëz të shëmtuar, të pistë, dhe që s'ia vlejnë t'i respektosh.

Ndryshimi nga një shoqëri që i respektonte më të vjetrit, në një shoqërinë që tani i shikon të vjetrit shumë poshtë dhe me neveritje, na tregon një rënie të vërtetë të sistemeve të vlerave tek malajzianët. Në qoftë se përpara babai do të ruante fëmijët e tij prej ndonjë rreziku, tani kur ndonjë rrezik i kanoset babait, fëmija i tij vetëm i bërtet "hap sytë". Sot të rinjtë dhe sidomos ata që janë të shkolluar shkojnë tek prindërit e tyre duke i kujtuar se çfarë duhet të bëjnë, pra janë fëmijët ata që i dirigjojnë prindërit. Por nga ana tjetër, çfarëdo ideje apo drejtimi prindërit mundohen t'u japin fëmijëve, këta fëmijë do t'i hedhin poshtë duke i trajtuar prindërit e tyre si të paditur.

Ky ndryshim në vlera, vallë a do t'i ndihmojë për të mirë një shoqërie? Logjikisht kjo nuk mund të ndodhë. Këta të rinj që janë sot do të vjetërsohen dhe do të keq-trajtohen nga të rinjtë e tyre, për çfarëdo që ata luftuan dhe u munduan të arrinin në rininë e tyre do t'iu shkojë kot. E kështu ndarja midis të rinjve dhe më të moshuarve do të vazhdojë të rritet, dhe e mira nuk do të gjykohet

më nga merita, por nga burimi i saj, prandaj çdo gjë e bërë nga më të vjetrit do të konsiderohet si jo e mirë, dhe po e njëjta gjë në qoftë se bëhet nga të rinjtë patjetër që do të konsiderohet e mirë.

Përveç çështjes se të rinjve dhe të vjetërve, kemi plot shembuj të tjerë të vlerave të mira të malajzianëve të zëvendësuara me të ligat që i marrin prej Perëndimit. Disa prej këtyre vlerave të Perëndimit që janë asimiluar nuk janë dhe aq serioze në konsekuencat që sjellin, por disa prej të tyre një ditë do të shkatërrojnë komplet shoqërinë malajziane.

Një shoqëri e shëndoshë, nuk mund të ekzistojë apo të vazhdojë të veprojë kështu pa pasur ligje dhe rregulla. Por ligje dhe rregulla do të thotë limit në liritë e individit. Liria e tij do të jetë e limituar, sepse shumë liria e një personi do të sjellë probleme në të drejtat e të tjerëve, dhe në qetësinë dhe sigurinë e mbarë shoqërisë.

Për shembull, një individ duhet të jetë i lirë të shprehë hapur mendimin e tij, por në rast se ai këtë liri e abuzon dhe e përdor kundër të tjerëve, shoqëria nuk do t'ia lejojë këtë të drejtë apo këtë liri. Në të njëjtën kohë, një individ mund të përpiqet t'i ruajë çfarë ai beson se janë të drejtat e tij, por aktet e tij nuk duhet të kenë ndonjë efekt negativ tek të drejtat e të tjerëve apo vetë shoqërisë.

T'i japësh mundësi çdo pjesëtari të shoqërisë, të arrijë të drejtat e veta, pa ndikuar apo cenuar mbi të drejtat e të tjerëve, dhe të drejtat kolektive të shoqërisë në tërësi, për të arritur këto, rregulla dhe ligje janë vendosur për t'i kontrolluar këto të drejta nëpërmjet "metodës" së kërkimit të të drejtës. Por këto ligje dhe rregulla nuk ngrihen ashtu vetë, duhet që shoqëria të krijojë aparatet apo organet e posaçme që ato të funksionojnë dhe që të bëjnë të mundur imponimin e tyre, kurse për çdo individ

të shoqërisë është i detyruar ti nënshtrohet të gjitha udhëzimeve të dhëna nga këto aparate apo organe.

Por këtu lind dilema. Në qoftë se kjo aparaturë funksionale do të ketë fuqi të palimituara, mund të ketë mundësi që njerëzit këtu të abuzojnë me këto mundësi. Por për të kontrolluar mbi fuqitë e këtij trupi apo aparati, një tjetër aparat më i madh se ky në funksionim ngrihet për të kontrolluar të parin në rastet e abuzimeve. Ky aparat kontrolli është “policia”. Pushteti i dhënë tek policia është i mbrojtur nga ligji, pasi vetë puna e tyre është shumë vitale dhe e rëndësishme për shoqërinë. Por në qoftë se ata abuzojnë në detyrën e vet, ka metoda të ndryshme që ky abuzim të ndalohet. Megjithatë në përpjekjet e tyre për të ruajtur interesin e gjithë shoqërisë, do të ketë palë që do të ndiejnë presion në imponimin e ligjeve. Këto palë do ta përkufizojnë këtë presion si një “shtypje”, por meqenëse janë vetëm këta njerëz që do ta shikojnë punën e bërë nga policia si një “shtypje” nuk do të ketë shumë probleme.

Por në qoftë se një shoqëri do ta keqtrajtojë policinë, për shkak të zbatimit të detyrave të tyre të ngarkuara, kjo shoqëri patjetër që do të jetë në probleme dhe nuk do të ketë qetësi. Kur policët do të thirren me nofkën “derra” dhe kjo vetëm e vetëm për të ndjekur rrugën e studentëve amerikanë, ligjet që e mbanin këtë shoqëri në qetësi nuk do të ketë kush ti imponojë. Dhe të kesh ligje që nuk mund t’i imponosh apo zbatosh, është më keq se të mos kesh ligje fare. E në një shoqëri ku ligjet nuk zbatohen kjo do të thotë se së shpejti kjo shoqëri do të shpërbëhet. Do të jetë një shoqëri ku do të mbizotërojë anarkia, s’do të ketë asnjëherë rregull apo qetësi, do të dominojë dhuna dhe mizoria.

Sjellja e rinisë perëndimore ndaj policisë nuk është aspak korrekte. Në Malajzi, sistemi i vlerave i trajton

njerëzit e administratës si të një niveli të lartë, duke i respektuar sipas rangjeve, statusit dhe pushtetit që ata kanë. Dhe policia është pjesë e kësaj administrate dhe në Malajzi nuk ka evidenca të keqtrajtimit të tyre apo të shkuarjes përtej limitive legjitime, kurse qeveria e zgjedhur nga populli ka fuqi mbi policinë. Në vende të tjera ku sistemet nuk janë të organizuara mirë, policët edhe terrorizojnë popullin, dhe në këto raste është e drejta e popullit ti konsiderojë ata si “shtypës”. Po ashtu në këto vende policia e justifikon më së miri nofkën e të ashtuquajturit “derra”. Por, në Malajzi, një “shtypje” e tillë mund të themi se ka qëllim për të siguruar interesin e shumicës, të cilët nuk duan të jenë nën presionin apo shtypjen e atyre që duan të prishin qetësinë.

Por që të quash policinë “derra” dhe “shtypës” do të thotë se këtu kemi një formë të rënies të sistemit të vlerave. Çfarë duhet të respektohet, shikohet me mospërfillje e përbuzje, dhe se çfarë duhet të përbuzet, shikohet me respekt. Pra në qoftë se vlerat e reja do të lejohen të përhapen, dhe të bëhen zakone të shoqërisë në tërësi, dy gjëra do të ndodhin me këtë shoqëri. Së pari policia do t’i kthehet shtypjes dhe forcës për të ruajtur fuqinë e pushtetin e tyre, dhe kjo mund të ndodhë paparitmas (*coup d’etat*) ose gradualisht, por rezultati do të jetë i njëjtë një “shtet policor”.

Dhe së dyti, policia dobësohet, dhe nuk është në gjendje të mbajë qetësinë, pushteti i dhënë policisë nuk përdoret për arsye të frikës se ata mund të akuzohen. Dhe së fundi policia do ta humbë efektshmërinë e saj dhe ligjet e shoqërisë do të thyhen pa u nisur të zbatohen. Rezultati i gjithë kësaj do të jetë kolapsi i vlerave të shoqërisë dhe shpërbërja e shoqërisë në tërësi.

Dhe shembujt që dhamë më sipër tregojnë kolapse, sisteme vlerash në shoqëri të ndryshme kudo në botë,

por një rast tjetër që është me meritë për t'u përmendur si një evidencë e rënies së vlerave të përmendura më lart vijon më poshtë.

Në Angli një i ri, u arrestua, në përpjekje për të eksploduar "gaz qeshës" në sallën e gjyqit. Pra ta imagjinosh se gjyqi është përgjatë një procedure serioze dhe çdo ndërprerje do të konsiderohet si përbuzje e punës së tyre dhe ndjekja penale për këtë gjë është e një shkalle të lartë.

Por në këtë rast, kur i riu u gjykua para gjyqit, avokati i tij solli si shembull që në qoftë se polici mund të përdorë gazin lotsjellës, kur është në krye të detyrës, ky djalosh nuk mund të gjykohej për përdorjen e "gazit qeshës".

Por në të vërtetë ku gjykim i dhënë sjell vetëm një "zvetënim të vlerave", ku e keqja interpretohet si diçka e mirë. Pra duke u mbështetur në logjikën e këtij avokati, arrijmë në konkluzion se çdo kush mund të përdorë çfarë do lloj mjeti që përdoret nga policët për çfarëdo qëllimi që ai kërkon të arrijë. Pra përdorimi i gazit lotsjellës, makinat e blinduara, armët e zjarrit etj. nuk mund të jenë të ndaluara të askush dhe se çfarë do të ndodhë me rendin e qetësinë e vetë shoqërisë kjo është mjaft e qartë dhe nuk ka nevojë të shpjegohet.

Megjithatë mund të themi se me sa janë përmendur shembujt dhe diskutimet, janë përqendruar rreth konsekuencave të liga të ndryshimit të sistemit të vlerave, por siç edhe e përmendëm më lart jo të gjitha ndryshimet e vlerave janë të liga për një shoqëri. Në fakt në shoqëritë njerëzore sot e mira e gjetur që vjen nga ndryshimet e vlerave është si p.sh., rritja e moralit dhe kthimi nga një sjellje e ligë në një sjellje të mirë.

Islami është një nga influencat më të fuqishme në zëvendësimin e të keqes me të mirën. Në vendet arabe para ardhjes së Islamit, vrasja e vajzave qysh foshnje konsiderohej si një praktikë normale, por Islami e konsi-

deroi si një krim të tmerrshëm. Pra shoqëria arabe e pranoi këtë vlerë të re me ardhjen e Islamit dhe tani vrasja e foshnjave vajza është e ndaluar. Çdo përpjekje për të praktikuar këtë zakon të vjetër tani dënohej ashpër nga vetë shoqëria, që tregonte se ndryshimi për të mirë kishte ndodhur në sistemin e vlerave arabe. Përfitimet dhe dobitë në shoqërinë arabe që erdhën si rezultat i ndryshimit të sistemeve të vlerave apo zakoneve pas pranimit të besimit islam, tregon se ndryshimet nuk janë gjithmonë për keq. Problemi qëndron me njerëzit, kur vjen për t'i studiuar, testuar apo kur konsiderohet efektshmëria dhe konsekuencat e këtyre ndryshimeve, dhe kur ata ballafaqohen në përpjekjet për të ndryshuar këto zakone në veçanti.

Në kohën tonë moderne, një vlerë që i jepet shumë rëndësi është “Të drejtat bazike të njerëzimit”. Në fillim koncepti se çdo qenie njerëzore ka të drejta u pranua me lehtësi. Pra njeriu nuk duhet të shtypej, shfrytëzimi i një personi nga një person tjetër nuk duhet lejuar duke u nisur nga logjika, kjo konsiderohet si diçka jo e drejtë. Por “logjika” në këtë kontekst është “logjika” në lidhje me sistemin e tashëm të vlerave, dhe në qoftë se ky sistem do të ndryshojë, “logjika” nuk do të jetë me logjika e parë.

Kur ky koncept u formulua së pari, patjetër që do të ketë pasur shkaqe të forta që i është dhënë kaq prioritet. Në kohën e skllavërisë robërve nuk u është dhënë asnjë e drejtë dhe statusi i tyre nuk ishte me i lartë se statusi i një bishe. Pra sistemi i vlerave të asaj kohe konsideronte statusin ligjor jonjerëzor mbi skllavërit si diçka normale dhe aspak si një diçka të ligë apo jo të drejtë.

Por në çdo shoqëri ka pasur individë me shpirt human të cilët nuk mund ta duronin dhe të shikonin qeniet njerëzore të trajtuara si kafshët. Këta individë ishin të pakënaqur kur shikonin trajtimin mizor që u bëhej skllavërve. Në fillim këta individë ishin pak në numër, por me kalimin

e kohës numri i tyre u rrit. Pikëpamjet e tyre u bënë më të forta, dhe së fundi ata ishin edhe gati të luftonin për të arritur fitoret për këta skllavër të shkretë. Dhe mendoj se ishte në këtë fazë kur opinioni i shoqërisë ndryshoi, dhe ata pranuan se trajtimi i skllavërve në këtë mënyrë ishte diçka e ligë. Me pak fjalë të tjera, vlerat e vjetra në lidhje me trajtimin mizor të skllavërve u zëvendësuan me vlera të reja ato më humane, dhe sot është diçka normale të dënosh skllavërinë. Pra askush nuk mund të thotë se ndryshimi i vlerave këtu është për të keq.

Zhdukja e skllavërisë ishte një ndryshim radikal, i cili në ato kohë u pa si një veprim ultimatium që solli fundin e problemeve me skllavërinë dhe shtypjen e njerëzve. Dhe opinioni kudo botëror është se me zhdukjen e skllavërisë, njerëzimit iu dha një respekt i veçantë në vlerat “njerëzore”.

Por kohë pas zhdukjes së skllavërisë, ndjenjat e kënaqësisë mbi atë që u arrit filluan të veniteshin. Tani skllavërit e lirë si dhe pasardhësit e tyre edhe pse të lirë, nuk mund të gëzonin ato të drejta apo të kishin të njëjtin status si të ish-padronëve të tyre apo të pasardhësve të ish-padronëve. Dhe kjo pabarazi filloi të konsiderohej si një formë shtypjeje. Çështja u mor në konsiderim dhe u luftua për këtë çështje derisa shoqëria e pranoi dhe filloi të praktikojë konceptin e barazisë midis ish-skllavërve dhe pasardhësve të tyre dhe shtresave të tjera. Pra një tjetër vlerë e shoqërisë ndryshoi.

Për një farë kohë ky ndryshim i vlerave i kënaqi të gjitha palët, por kjo nuk zgjati shumë. Barazia nuk ishte e mjaftueshme. Pasardhësve të skllavërve duhet t'u jepej shansi për t'u bërë liderë e bosë tek pasardhësit e ish-zotërinjve të tyre. Dhe kështu përpjekjet për të ndryshuar vlerat shoqërore do të vazhdojnë dhe do të shkojnë kështu përgjithmonë.

Por ndryshimi i vlerave në lidhje me shfrytëzimin e njeriut nga njeriu nuk mbaroi me zhdukjen e skllavërisë. Megjithëse skllavëria nuk ekzistonte më, forma të tjera shfrytëzimi e shtypjeje filluan të lulëzonin. Për shembull kolonializimi i një vendi nga një vend tjetër ishte një lloj shfrytëzimi. Përpyetje të mëdha u bënë për të zhdukur imperializmin, dhe rënia e kolonializmit si rezultat i këtyre përpjekjeve solli një ndryshim tjetër të vlerave për të mirë.

Megjithëse kolonializmi i një vendi nga një vend tjetër nuk është më i përhapur, shfrytëzimi i njeriut nga njeriu prapë ekziston. Qeveria e një vendi shpesh mundet të shtypë njerëzit e këtij vendi megjithëse të dyja palët i përkasin të njëjtës racë. Por këtu çështja qëndron në shkallën e shfrytëzimit, çfarë lirisht duhet të jepen tek individit dhe cili duhet të vendosë në shkallët e këtyre lirive të dhëna?

Në një demokraci, shumica vendos në shkallën e lirisë që duhet të jepen, dhe njerëzit këtu nuk mund të ngrihen për çdo shkak sado i vogël qoftë, por që sipas tyre sjell tirani. Kështu që shumica do të jenë ata që vendosin të kenë një qeveri dhe kësaj qeverie i japin të drejtën të vendosë se çfarë lirisht mund të lejohen dhe çfarë nuk mundet. Gjithashtu në një sistem demokratik të drejtat e minoritetit apo pakicës janë të garantuara dhe të mbrojtura. Por lind pyetja: kush do të vendosë në çështjet e ngritura midis qeverisë që përfaqëson mazhorancën, dhe minoriteteve apo individëve?

Në qoftë se një individ dëshiron të bëjë diçka, por që është e ndaluar nga ligji, a nuk është kjo e njëjlojtë me shtypjen që i bën mazhoranca një pakice? Filozofët do të diskutojnë dhe njëzëri do të thonë se nga paraqitja, një detyrim apo pengesë legale në dëshirat e një individit do të thotë "shtypje". Dhe pasi shoqëria vlerëson liritë dhe të drejtat humane dhe e dënon shtypjen, shoqëria nuk mund të shkojë kundër dëshirave të individit.

E njëjta mund të thuhet kur “një zakon” i shoqërisë i ndalon disa akte, dhe individë të veçantë duan t’i kryejnë këto akte. Shoqëria nuk mundet t’i ndalojë këta individë pasi do të akuzohet për shtypje e shkelje të të drejtave të njeriut.

Një shqyrtim i hollësishëm do të tregojë se sot, ndryshimi i vlerave ka shkuar shumë larg, dhe liria nga çdo lloj “shtypje” vjen e para duke dalë mbi ligjin apo traditat dhe zakonet. Ky ndryshim ka ndodhur si rezultat i një procesi të vazhdueshëm, nga përpjekjet për të zhdukur skllavërinë, e cila ishte padyshin një kauzë e mirë për t’u arritur. Dhënia e një prioriteti kaq të madh të lirisë nga “shtypja” vallë a është aq e mirë si vlerë sa edhe liria ndaj skllavërisë? Por që të kuptojmë dhe ti përgjigjemi kësaj pyetjeje, na nevojitet që të studiojmë praktika dhe interpretime të ndryshme të të drejtave të njeriut dhe efektet e tyre në shoqëri.

Në Evropë si kudo në botë, lidhjet midis homoseksualëve janë ndaluar dhe dënohen nga shoqëria. Por disa njerëz përsëri preferojnë të përfshijnë veten në këto sjellje të pështira, dhe sipas tyre traditat sociale, zakonet dhe ligjet janë një formë “shtypjeje”, dhe në vitet e fundit ka pasur shumë lëvizje që luftojnë për të mbrojtur “të drejtat bazike” për këto grupe. Në fillim shoqëria qëndroi e patundur përballë përplasjeve me këto grupe, por kur çështja e të drejtave dhe shtypjes së pakicës nga shumica erdhi në diskutim, disa supozojmë “individë të arsyeshem” filluan të krijonin dyshime për qëndrimin e shoqërisë në këtë çështje. Në qoftë se një shoqëri me të vërtetë vlerëson të drejtat e njeriut dhe hedh poshtë të gjitha format e shtypjes, a sillet kjo shoqëri në mënyrë të ndërgjegjshme në qoftë se lejon ligje apo zakone që pengojnë dëshirat e një grupi të veçantë? Kjo pyetje filloi të çorodisë shoqërinë. Dhe së fundi si rezultat i një besimi

fanatik në sovranitetin e të drejtave të njeriut zakonet dhe ligjet u hoqën ose nuk u përfillën duke lejuar kështu këto sjellje të pështira dhe jonjerëzore. Ky ishte zhvillimi logjik i zhdukjes së skllavërisë. Në të ashtuquajturën kauzë njerëzore, njerëzit u kthyen në bisha.

Por shoqëria prapë ka plot zakone dhe ligje të tjera, dhe për ata që nuk i pëlqejnë disa zakone apo ligje në veçanti, me keqardhje mund të themi se si rezultat disa prej dëshirave të tyre do të pengohen. Dhe kjo do të thotë se përderisa zakonet dhe ligjet ekzistojnë, do të kemi shtypje të pakicës apo individëve të veçantë në një shoqëri. Meqenëse në sistemin modern njerëzor, lirisë nga të gjitha llojet e shtypjeve i është dhënë një prioritet i veçantë, zakonet dhe ligjet mund të flaken në mënyrë flagrante nga çdokush, pa pasur asnjë masë ndëshkimore.

Në situata të tilla, rregullat dhe zakonet e veshjes së rregullt, sjelljes së mirë, respektimi i fesë, martesë, familja, puna, respekti reciprok, ndershmëria dhe një numër vlerash të tjera nuk kanë më vend në shoqërinë njerëzore. Prioriteti, devotshmëria, dhe lajkatimi i jepen të “drejtave bazike”. Dhe çdo gjë që interpretohet nga çdokush si “të drejta bazike” duhet të lejohet, pa marrë parasysh efektet dhe konsekuencat që këto mund të sjellin.

Por nga analizat e bëra një fakt i çuditshëm është se “të drejta bazike” dhe liritë nga shtypja” janë në të vërtetë një formë shtypjeje, shtypje e pakicës apo individëve nga shumica. Për shembull në një sistem demokratik, punëtorëve u është dhëna e drejta të shkojnë në greva për të ndaluar shtypjen nga punëdhënësit. Së pari kjo do të mbrojë të drejtat e punëtorëve, nga padrejtësitë e bëra nga punëdhënësit, dhe punëdhënësit do të ndëshkohen me humbjet financiare si rezultat i grevës. Por rritja e unioneve të punëtorëve është aq e madhe sa që greva do të ketë efekt jo vetëm tek punëdhënësit, por edhe tek

pjesa tjetër e shoqërisë. Pra sot kur punëtorët shkojnë në greva është publiku i pafajshëm ai që i vuan konsekuencat. Prandaj, mund të themi se grevat sot janë bërë një armë potenciale për punëtorët dhe e drejta për të shkuar në greva është bërë shumë e fuqishme. Dhe kjo fuqi e jashtëzakonshme është pronë për abuzim.

Kur punëtorët e minierave në Britani futen në greva, e gjithë popullata e Britanisë do të vuajë si rezultat i mungesës së lëndës së parë për ngrohje dhe të sëmurët dhe të vjetrit ndoshta edhe vdesin nga të ftohtët. Kur infermierët dhe doktorët hyjnë në greva pacientët që janë në numër më të madh janë ata që i vuajnë konsekuencat. Kur punëtorët e fabrikave që prodhojnë motorët e makinave hyjnë në grevë, punëtorët në fabrikën tjetër që i përdorin këto pjesë dhe që varen nga puna prej kësaj fabrike do të shkurtohen, si rezultat i papunësisë. Kështu që e drejta për të shkuar në greva, së pari është sjellë për qëllim të mbrojtë punëtorët nga shtypja, tani kjo u kthye në një armë të përdorur për shtypje ndaj të tjerëve.

Një tjetër shembull e marrim në Shtetet e Bashkuara. Në një lagje ku jetonin familje të thjeshta, dhe me një jetë të qetë e pa probleme, pas pak kohësh vjen një biznesmen dhe ndërton një kinema ku shfaqen filma të pahijshëm. Komuniteti i gjithë kësaj zone banimi u ngrit në këmbë pasi mendonte se kjo do të sillte imoralitet dhe do të shkatërronte paqen në ambientin ku jetonin. Por çuditërisht, gjyqi ishte i mendimit, se e drejta e pronarit të kinemasë, nuk duhet të hidhej poshtë. Pra e drejta e komunitetit të kësaj lagjeje, edhe pse më e madhe në numër, për të mbrojtur vetveten nga shfaqet e huaja nuk u mor në konsideratë. Me fjalë të tjera “të drejtat bazike” të një individi fituan dhe hodhën poshtë të drejtat bazike të shumicës.

Këta shembuj të marrë, tregojnë se “të drejtat bazi-ke të njeriut” dhe “liria nga shtypja” megjithëse shumë të respektuara për qëllimet e tyre, kur merren dhe interpretohen në mënyra ekstreme, mund të bëhen një formë padrejtësie dhe shtypjeje.

Kjo është si rezultat i evolucionit të vlerave në lidhje me të drejtat e njeriut. Në fillim ndryshimi i vlerave solli një përmirësim të gjendjes, por me kalimin e kohës çoi në të kundërtën e situatës së mëparshme; kur një herë e një kohë pakica ishte e shtypur nga shumica, sot është shumica që është e shtypur nga pakica apo individë të veçantë. Megjithatë besimi në vlerat e reja është shumë i fortë, që do të thotë shenjtërimi i të “drejtave dhe lirive të individit” dhe shtypjes së shumicës nuk i jepet asnjë vëmendje dhe as një konsideratë e veçantë. Pra le të vdesin të sëmuret apo të moshuarit, le të korruptohet morali i familjeve, le të shkatërrohet ekonomia e një vendi, të gjitha këto nuk kanë rëndësi por janë të “drejtat e njeriut” që duhet të mbahen lart.

Malajzianët duhet t'i kushtojnë vëmendje historisë së transformimit të vlerave, sepse sistemet e vlerave një-rëzore në pjesë të ndryshme të botës nuk mund të mbahen më të shkëputura nga njëra-tjetra. Pushtimi i sistemit të vlerave malajziane nga sistemet perëndimore ka ndodhur, dhe kjo me kontaktin e parë midis shteteve malajase dhe ato të Perëndimit. Në përgjithësi rezultati i këtij pushtimi nuk ishte shumë i keq. Disa prej vlerave të vjetruara malajziane janë zëvendësuar me vlera pozitive të marra nga Perëndimi, por dhe në të kundërtën mos të harrojmë se shumë nga vlerat e padëshiruara perëndimore kanë hyrë në sistemin malajas.

Në këto vite të komunikimit modern, malajzianët nuk mund të izolojnë veten nga sistemet e tjera. Por çdo popull që ka besim në vetvete, mund të përdorë dhe

censurën në elementet e padëshiruara, pra vlerat apo zakonet e një shoqërie tjetër mund të mos lejohen të përhapen pa u kontrolluar së pari. Pra është në dorë të çdo shoqërie të vendosë kufijtë deri ku këto influenca të huaja mund të shkojnë.

Në fillim të këtij kapitulli thamë se ekzistenca e çdo shoqërie njerëzore i ka rrënjët në sistemet e vlerave që zhvillohen ose janë zhvilluar nga kjo shoqëri. Pra ky kapitull theksoi në atë se çdo shtet apo shoqëri, sado i avancuar apo i prapambetur qoftë, është i kushtëzuar nga sistemi i vlerave. Pasi sistemi i vlerave është shumë i rëndësishëm e vital në vendosjen e fatit të një shoqërie, ndryshimi në sistemin e vlerave, do të thotë ndryshim në gjendjen e shoqërisë.

Duke marrë parasysh rëndësinë e sistemit të vlerave, një shoqëri duhet të jetë shumë vigjilente dhe e kujdeshme për sistemin e vet të vlerave, dhe për ndryshimet apo kërcënimet që mund të vijnë si rrjedhojë e këtij ndryshimi që mund të ndodhë çdo kohë. Kjo do të thotë se këto ndryshime nuk duhet të lejohen të ndodhin ashtu thjeshtë, pa asnjë kontroll. Ata njerëz që kanë eksperiencë apo autoritet në shoqëri duhet të luajnë një rol të veçantë në përzgjedhjen, e seleksionimin e këtyre vlerave të reja, dhe vendosjen e tyre mbi vlerat e vjetra. Se në një situatë ku gjithkush mund të sjellë ndryshim do të çojë në konsekuenca të padëshirueshme.

Në shoqërinë malajziane, ashtu si në çdo shoqëri tjetër, sistemet e vlerave luajnë një rol të rëndësishëm në fatin e saj. Sot vlerat dhe zakonet malajziane janë duke ndryshuar pa një studim sistematik, dhe pa një parim drejtues. Çdokush mund të sulmojë sistemin e tanishëm dhe ta zëvendësojë atë me vlera të reja, por kjo do të çojë në një konflikt të pakuptimtë dhe në çoroditje. Pra është koha që malajzianët duhet ta kuptojnë dhe të men-

dojnë për hapat e zgjedhur që duhet të hedhin, në mënyrë që të sigurojnë që ky mjet kaq i rëndësishëm dhe potencial si sistemi i vlerave të përdoret në mënyrë sa më të përsosur në të mirë të gjithë komunitetit malajas.

Kapitulli VIII

Shpirtërorja dhe sfida moderne

Ti përmbaju fuqimisht fesë së drejtë, para se të vijë dita që nuk ka kthim, pse prej Allahut është caktuar, atë ditë ata (njerëzit) ndahen. Kush nuk besoi, barrën e mosbesimit të vet e ka kundër vetes, e kush bëri punë të mirë, ata vetvetes i përgatitën vendin (xhennetin). Që t'i shpërblejë Ai (Allahu) nga të mirat e veta, ata që besuan dhe bënë vepra të mira, vërtet, Ai nuk i do jombesimtarët. (Kur'ani, er-Rum: 43-45)

Këto ajete kur'anore, i nxisin besimtarët (muslimanë) të bëjnë vepra të mira dhe t'u binden urdhrave të Zotit. Por problemi këtu qëndron në faktin se liderët dhe interpretuesit e ndryshëm të mësimëve islame, kanë mënyra të ndryshme të interpretimit të këtyre ajeteve. Megjithatë në përgjithësi të gjithë bien dakord në atë se vepra të mira duhet të bëhen. Në disa çështje kemi opinione të ndryshme në atë se çfarë është e mirë dhe çfarë nuk është. Dhe këto diferenca në opinione janë kaq të shumta saqë i bëjnë muslimanët armiq të njëri-tjetrit.

Pra megjithëse muslimanët janë udhëzuar të shikojnë njëri-tjetrin si vëllezër, realiteti është se muslimanët e një vendi gjithmonë do të hapin luftë me njëri-tjetrin (të ndihmuar nga jomuslimanët) ose vetë muslimanët brenda për brenda një vendi do të jenë të ndarë dhe janë në gjendje të shkatërrojnë e copëtojnë njëri-tjetrin.

Për shembull në Egjipt, qeveria e përkrahur nga një numër i madh muslimanësh, kundërshtohet nga një grup i vogël njerëzish që pretendojnë se janë muslimanët e

vërtetë dhe se vetëm ata kanë të drejtën të vendosin mbi qeverinë që duhet të drejtojë Egjiptin. Dhe për të arritur objektivat e tyre, ata janë në gjendje dhe të vrasin liderë të ndryshëm muslimanë që përkrahin qeverinë, dhe gjithashtu mundohen të dobësojnë pushtetin duke i nxitur muslimanët e tjerë në ushtri apo në institucionet fetare që mos t'u binden direktivave të qeverisë. Në situatën kur Egjipti ishte nën sulmin e Izraelit, këto përpjekje në qoftë se do të ishin të suksesshme, do të sillnin pa dyshim fitoren e Izraelit. Por, akoma të paqartë ndaj këtyre pikëpamjeve, pjesëtarët e kësaj pakice mbeten të mendimit se çfarë do që ata bëjnë është e mirë dhe në vijë me mësimet e Islamit.

Pra duke pasur një lider që devijon nga normat, kjo mund të sjellë një keqinterpretim të një diçkaje të ligë si të mirë nga ana e muslimanëve. Dhe sa përmendëm më lart janë konsekuencat. Gabimi nuk qëndron me Islamit, por me liderët islamikë, të cilët nuk janë të jashtëzakonshëm për mos të bërë gabime. Në qoftë se të gjithë liderët muslimanë do të kishin dhe do të ndiqnin një interpretim të njëjtë të mësimëve të Islamit, bota muslimane nuk do të ishte e ndarë, ashtu siç është sot. Dhe ata besimtarë midis muslimanëve që nuk janë aq shumë të ditur ndaj fesë nuk do të kishin pse të zgjidhnin midis interpretimeve apo midis liderëve. Por, meqenëse vetë këta ekspertë të fesë nuk bien dakord midis njëri-tjetrit, muslimanët e thjeshtë që nuk janë të specializuar në këtë fushë duhet të bëjnë një përzgjedhje të bazuar nga një dituri e pamjaftueshme. Kjo është edhe dilema e vetë malajzianëve (shumica e të cilëve janë muslimanë). Dhe kjo sjell edhe ngatërrimin e malajzianëve sot në interpretimin e “shpirtërores”, kur ata mundohen të gjejnë drejtimin tek liderët e tyre. Në demokraci, ku secili ka të drejtën e zgjedhjes, në realitet kjo sjell më shumë hutim,

tek njerëzit, pasi logjika dhe besimi janë në konflikt. Dhe si rezultat i këtij hutimi, njerëzit do të bëjnë një zgjedhje që ose nuk është një zgjedhje e mençur ose është e rrezikshme për vetë individin dhe shoqërinë.

Që materializmi nuk mund ta bëjë shoqërinë të lumtur dhe të kënaqur, këtë e diskutuam në kapitullin “Materializmi dhe spiritualizmi”, por a mundet një shoqëri që mban dhe praktikon shpirtëroren të arrijë këtë lumturi në këto kohë moderne?

Në kohët e hershme kur një shoqëri mund të izolonte veten në vende të veçanta, duke u shkëputur nga të gjitha lidhjet me shoqëritë e tjera dhe botën e jashtme, praktikimi i filozofisë së orientuar në shpirtëroren mund të sillte kënaqësi tek njerëzit. Por në kohët tona moderne është shumë e vështirë që një shoqëri të shkëputet dhe ta mbyllë veten nga bota e jashtme. E pëlqejnë këto shoqëri apo jo, njerëzit do të ballafaqohen me botën e jashtme, është diçka që shoqëria as nuk mund ta largojë e as mund ta ndalë.

Sa më i lehtë që është komunikimi midis një grupi njerëzish dhe një grupi tjetër, aq më e vështirë është të ndalosh shkëmbimet ndërmjet tyre. Meqenëse jo të gjitha shoqëritë njerëzore praktikojnë vlerat shpirtërore, çdo një nga këto shoqëri që vepron kështu i duhet të ko-eperojë edhe me influencën materialiste. Si rezultat vlerat shpirtërore të shoqërisë do të errësohen nga lakmia për gjërat materiale, e cila është dhe baza e filozofisë së shoqërisë moderne materialiste.

Por është e rëndësishme të theksojmë se interesi në çështjet e kësaj bote nuk është i njëjlojtë me materializmin, sepse nga natyra njeriu nuk mund të heqë dorë prej zotërimit të pasurisë. Edhe një lypës në rrugë zotëron diçka, megjithëse janë vetëm rrekat e tij të trupit ato janë për të pasuria e tij, dhe ai kujdeset dhe i shikon ato si gjënë më të

çmueshme që ka. Por kjo nuk do të thotë se ai është lakmitar për gjërat materiale apo është materialist.

Ashtu sikurse lypësi që gjithmonë mundohet të shtojë diçka në pasurinë e tij, e njëjta gjë ndodh edhe me çdo njeri tjetër që zotëron diçka, gjithmonë do të mundohet të shtojë diçka të re në të. Por këto përpjekje për të shtuar diçka më shumë në pasuri nuk e bëjnë njeriun materialist.

Megjithatë një lypës apo një milioner bëhet materialist kur ai është i gatshëm të bëjë çdo gjë për të shtuar pasurinë e tij dhe jeta e tij dominohet vetëm nga mendimet dhe punët se si e si të shtojë këtë pasuri. Dhe këta lloj njerëzish kurrë nuk do të japin një pjesë nga pasuria e vet për shoqërinë në mënyrë vullnetare apo kontributi, për të ndihmuar ata që janë në nevojë. Për shkak të lakmisë se madhe që kanë, ata, do të mundohen me mish e shpirt të largojnë çdo kontakt apo përgjegjësi sociale.

Pra është mjaft e qartë se zotërimi i një pasurie apo përpjekjet për të shtuar këtë pasuri nuk e bëjnë një njeri materialist në qoftë se ky njeri nuk është i dhënë aq shumë pas pasurisë, sa që harron çdo përgjegjësi shoqërore që ai ka për shoqërinë ku ai jeton. Në fjalë të tjera ai është jo i njerëzishëm. Është e rëndësishme ta kuptojmë këtë sa u tha më lart, sepse më pas do të jetë e lehtë për njerëzit që të mos ngatërrojnë nocionet si; varfëri do të thotë forcë shpirtërore, dhe zotërimi i një pasurie në këtë botë është sinonim i materializmit.

Nga historia islame mësojmë se varfëria dhe pasuria nuk kanë asnjë lidhje me shpirtëroren dhe materializmin. Pra pa dyshim që varfëria dhe pasuria nuk do të definojnë besimin fetar të një njeriu dhe sjelljen e tij. Shumë liderë muslimanë janë të pasur, por asnjë nuk mund të vërë në dyshim devotshmërinë e tyre në mësimet e Islamit, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në vlerat shpirt-

tërore. Othmani një nga katër kalifët që udhëhoqën pas ndërrimit jetë të Profetit ishte shumë i pasur. Gjithashtu Hatixhja, bashkëshortja e parë e Profetit Muhamed, ishte një tregtare shumë e pasur. Pra nga shembujt e marrë shikojmë se këta persona ishin shumë të pasur, por nuk ishin të devotshëm në materializëm. Në të kundërtën këta dhe shumë liderë apo shokë e miq të tjerë të Profetit e përdorën pasurinë e tyre në ndihmë të përhapjes së fesë islame. Malajzianët sot janë muslimanë dhe kjo për shkak të një pjesë të pasurisë që tregtarët arabë dhe indianë e përdorën për tregti këtu në Malajzi dhe bashkë me tregtinë ata sollën edhe fenë e tyre.

A nuk të gjeti ty jetim, e Ai të bëri vend (të dha përkrabje). Dhe të gjeti të paudhëzuar e Ai të udhëzoi. Dhe të gjeti të varfër, e Ai të begatoi. (Kur'ani, ed-Duha: 6-8)

Feja islame asnjëherë nuk e ka nxitur hedhjen poshtë të pasurisë së kësaj bote. Por një balancë duhet vendosur midis kësaj bote (dynjaje) dhe botës tjetër (ahiretit). Prandaj edhe muslimanëve u kërkohet të punojnë, sikur do të jetojnë përjetë dhe të kryejnë detyrat e tyre fetare, sikur do të vdesin nesër.

Punoni për këtë botë sikur do të jetoni për gjithmonë, dhe për botën tjetër sikur do të vdisni nesër. (Hadith)

Gjithashtu ajetet kur'anore të sjella me poshtë na sjellin një pasqyrim më të mirë.

E, kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni begatitë e Allahut, por edhe përmendnie shpeshherë Allahun, ashtu që të gjeni shpëtim. (Kur'ani, el-Xhumua: 10)

Feja islame nuk i shikon gjërat e kësaj bote me përbuzje si disa besime të tjera. Gjithashtu feja islame nuk u kërkon besimtarëve të vet të mbyllen nëpër manastire apo ungjëtore, të mos martohen, ose të bëhen oshënarë. Në krishterizëm për shembull, kemi plot shembuj kur ky be-

sim e hedh poshtë dhënien pas kësaj bote. Priftërinjtë e Kishës Katolike Romake nuk janë të lejuar të martohen. Në disa besime të tjera fetare, urdhrat fetarë u kërkojnë ndjekësve të këtyre besimeve të izolojnë fenë e tyre nga shoqëria, të hedhin poshtë çdo gjë që ka lidhje me këtë botë, dhe ta kushtojnë jetën e tyre vetëm në detyrat dhe ritet fetare. Shumë nga këto besime i kemi parë se kohëve të fundit nuk i japin më dhe aq shumë rëndësi këtyre riteve të ngurta fetare, por për Romano-Katolikët mbetet në të njëjtën pozitë koncepti i hedhjes poshtë të gjërave të kësaj bote. Sipas këtyre feve, hedhja poshtë e kësaj bote (të cilën Zoti e ka krijuar) është një formë e devotshmërisë fetare që do t'iu sjellë atyre më shumë merita shpirtërore.

Kurse në Islam nuk kemi as ungj e as rende fetare që të hedhin poshtë këtë botë, sepse hedhja poshtë e kësaj bote dhe e të mirave të kësaj bote nuk është e thënë të ndryshojë apo të forcojë vlerat shpirtërore. Megjithëse sufizmi (misticizmi islam) kërkon për të arritur vlerat më të larta shpirtërore, sufizmi nuk është urdhër fetar që i hedh poshtë të mirat dhe gjërat e kësaj bote.

Në Islam nuk ka vend për teori apo praktika ekstreme, dhe kjo është mjaft e qartë nga ajetet kur'anore që vijojnë më poshtë:

Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni se Allahu nuk i do ata që e teprojnë (e fillojnë luftën). (Kur'ani, el-Bekare: 190)

O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. (Kur'ani, el-Maide: 90)

Atë çfarë feja islame kërkon, nuk është hedhja poshtë e kësaj bote, por ndërgjegjshmëria dhe humanizmi. Adhurimi i Zotit nuk është gjë tjetër veçse për t'i kujtuar muslimanët se sado të pasur janë, sado qoftë pushtet të kenë, apo të shkëlqyer të jenë, prapë mbizotëron një fuqi

që është më e madhe se çdo gjë në botë, dhe kjo është fuqia dhe pushteti i Krijuesit. Gjithashtu adhurimi në Zot na kujton se, i pasur apo i varfër, mbret, lider apo njeri i thjeshtë qofsh të gjithë jemi njëloj para Krijuesit. Dhe kjo rrugë na shpëton nga krenaria që shumë thjeshtë mund të rrëmbejë mendjen e shumë të mençurve, shumë të fuqishmëve apo shumë të pasurve. Vetëm në këtë mënyrë shoqëria do të bëhet më e drejtë, më e lumtur dhe e paqshme, dhe do të largohen keqkuptimet dhe urrejtjet midis njerëzve.

Agjërimi, që është i detyrueshëm për të gjithë muslimanët, i bën ata më të ndërgjegjshëm në vuajtjet e atyre njerëzve të varfër që nuk kanë. Dhe gjatë këtij muaji të agjërit muslimanët, jo vetëm kalojnë një eksperiencë në dhimbjet e urisë, por gjithashtu u kërkohet që të largohen prej mendimeve, qëllimeve dhe akteve që janë të ndaluara dhe jo të vlefshme për fenë dhe shoqërinë. Dhe kjo për ta është një përvojë e fortë, një përvojë efektive shpirtërore. Pra edhe pse nën presionin e urisë dhe të etjes, nga muslimanët pritet të kontrollojnë epshet e tyre dhe çdo gjë që është e dëmshme për ta dhe shoqërinë. Dhe ky ushtrim patjetër që i bën muslimanët më në gjendje për t'u ballafaquar me sfidat e jetës më me sukses dhe në tërësi e bën shoqërinë muslimane më të rregullt dhe paqësore. Përveç kësaj, rrit te ata, mirënjohjen për bukën dhe ushqimin e përditshëm që ata fitojnë dhe kanë në sofrat e tyre dhe të hedhin poshtë arrogancën që influencon ata njerëz që nuk dinë se çfarë do të thotë vuajtje dhe përpjekje për të mirat që ata kanë.

Detyra fetare e pagimit të zekatit, ose taksës mbi pasurinë, bën të mundur të ulë diferencat ekonomike që ekzistojnë midis grupeve në një shoqëri, duke ruajtur kështu paqen dhe duke ulur konfliktet. Pra dhënia e zekatit, krijon dhe ushqen ndjenjat e përgjegjësisë, dhe të

konsiderimit midis muslimanëve, duke ulur kështu ndjenjën e zilisë që shpesh krijohet në shoqëri dhe sjell çrregullime të formave të ndryshme.

Dhe së fundi kryerja e haxhit, ose shkuarja në Tokën e Shenjtë është kulmi i të gjitha këtyre ushtrimeve dhe detyrave fetare. Pa dallim race, ngjyre, klase apo diferencash të tjera që ekzistojnë tek njerëzit, këtu të gjithë muslimanët janë njëloj, dhe kjo bën të rritet tek ta ndërgjegjshmëria e vëllazërimit në Islam.

Është mjaft e qartë se ritualet e adhurimit dhe detyrat fetare ose ibadetet, në fenë islame, janë krijuar për të bërë muslimanët më të vetëdijshëm për sjelljet e tyre, dhe për përgjegjësitë që ata kanë ndaj shoqërisë dhe përpara Zotit. Pra këto sjellje e përgjegjësi, mund të kryhen me efektivitet nga muslimanët në qoftë se ata do të luajnë rolin e tyre të plotë në shoqëri. Dhe në qoftë se ata do të tërhiqeshin nga shoqëria, dhe do të bëheshin murgjër apo të kryenin këto rituale në izolim të plotë vetëm për vete sigurisht që nuk do të ishin në gjendje të luajnë ndonjë rol në shoqëri. Me fjalë të tjera, muslimanët nuk janë të inkurajuar të kundërshtojnë këtë botë dhe të izolojnë veten nga shoqëria. Çfarë feja islame kërkon është që çdo musliman mos t'i lërë çështjet apo të mirat e kësaj bote të monopolizojnë mendjen e tij, dhe kohën e tij, dhe ta bëjë atë të pandërgjegjshëm, të papërgjegjshëm, dhe johuman.

Ritualet e adhurimit në fenë islame janë shumë ndryshe nga ato të besimeve të tjera fetare. Në disa nga këto besime të tjera fetare, ka rituale adhurimi të posaçme që praktikohen sepse thuhet se ato sjellin lumturi tek individit dhe e bëjnë atë person më të devotshëm, dhe më të preferuar nga Zoti. Dhe kjo bën që grupe njerëzish përpiqen për ta harxhuar të gjithë kohën e tyre në këto rituale të adhurimit duke e hedhur poshtë botën,

për shkak të asaj që të arrijnë në nivelet e larta fetare, apo të fitojnë titujt e “shenjtorëve”.

Një person që e hedh poshtë botën e hedh poshtë dhe shoqërinë. Ritualet fetare që ai kryen janë vetëm për të mirën e tij. Por në qoftë se çdo kush në shoqëri do të vepronte kështu atëherë kushtet e një shoqërie do të keqësoheshin derisa të sillnin shpërbërjen e gjithë shoqërisë. Për shembull në qoftë se në një shoqëri të gjithë meshkujt do të bëhen murgjër dhe të gjitha femrat do të bëheshin murgesha, do të kemi një shoqëri me njerëz shumë të devotshëm, por së shpejti kjo shoqëri do të zhduket. Kur shoqëria do të zhduket pa dyshim që edhe besimi fetar do të zhduket, sepse feja pa njerëz është e pakuptimtë. Pra një fe do të mbijetojë kur edhe besimtarët e kësaj feje do të jetojnë.

Mbijetesa e grupeve të devotshme varet nga ata që nuk janë shumë të devotshëm, dhe që nuk i hedhin poshtë punët e kësaj bote. Pra pa përpjekjet në punët e kësaj bote të atyre njerëzve të thjeshtë (jo shumë të devotshëm), këto grupe apo individë, të cilët kërkojnë lumturinë vetëm për vete nuk do të ishin në gjendje të bënin të gjitha këto detyra. Dhe kjo tregon edhe një herë se sa të rëndësishme janë “punët apo çështjet e kësaj bote” edhe për ata që mundohen t’i hedhin poshtë të gjitha këto.

Në qoftë se përpjekjet për të mirat në këtë botë, janë të nevojshme dhe të rëndësishme edhe për kryerjen e ritualeve të adhurimit dhe të forcimit të vlerave shpirtërore, atëherë në çfarë limitesh duhen ndjekur këto përpjekje? A do të ishte e mjaftueshme për të punuar për të arritur një pasuri vetëm për shkak që të ndihmojë në kryerjen e riteve të adhurimit? Ku është e mira e punës për të kërkuar që të vënë më shumë pasuri nëse kjo nuk do të ndihmojë më shumë në kryerjen e këtyre adhurimeve fetare?

Në qoftë se një individ do ta shikonte kërkimin e pasurisë vetëm me qëllim fitimi dhe pa asnjë qëllim tjetër, është e vërtetë që pasuria e tepërt nuk do të jetë e domosdoshme për të në qoftë se ai është plotësisht i dhënë pas vlerave shpirtërore. Por po të flasim nga pikëpamja e shoqërisë, pasuria e tepërt, e zotëruar nga një pjesëtar i kësaj shoqërie do të sjellë të mira për këtë shoqëri. Në qoftë se taksa të larta do të vendoseshin, në të ardhurat e tij gjatë kohës që ai është gjallë, dhe në pasurinë që ai lë pas vdekjes së tij, kjo e ardhur që do të fitohet nga taksat do të përmirësojë kushtet e atyre që nuk janë të pasur në këtë shoqëri. Pa qenë këta të pasur, taksat për të financuar administratën e një shoqërie do të vireshin mbi të varfrit, dhe kjo ngarkesë mbi ta, nuk do ta bënte shoqërinë më të gëzuar.

Prandaj në fenë islame, të pasurit luajnë një rol të rëndësishëm në pagimin e zekatit. Zekati do të ishte i pakuptimtë në shoqërinë islame në qoftë se nuk do të kishte të pasur. Qëllimi i zekatit dhe i fitrës (një taksë tjetër që jepet gjatë Kurban Bajramit) është që ajo pjesë e pasurisë e akumuluar nga individët duhet të shkojë në ndihmë të atyre që janë më me pak fat. Gjithashtu ndarja e pasurisë midis pasardhësve të tij pasi një individ ndërrohet jetë, do të thotë se kjo pasuri nuk është e kufizuar të shkojë vetëm tek një person apo një pasardhës i vetëm i tij, të gjithëve u takon nga pak. Dhe kjo metodë e ndarjes së pasurisë, direkt apo indirekt, ndihmon në realizimin e përgjegjësive që një shoqëri ka ndaj pjesëtarëve të vet. Dhe në një mënyrë apo tjetër edhe diferenca midis të varfërve dhe të pasurve do të zvogëlohet në një shoqëri, kur trashëgimia ndahet nëpërmjet *feraidit* (mënyra islame e ndarjes së trashëgimisë).

Zotërimi i një pasurie nga një individ apo një grup në shoqëri, luan një rol të rëndësishëm pasi, kjo do të

ndihmojë në zhvillimin e shoqërisë dhe do të zhdukë varfërinë. Pra pasuria është një formë shumë potente e pushtetit. Nëpërmjet kanaleve ekonomike dhe sociale, të ligjshme, pasuria mund të ndryshojë mënyrat e të menduarit dhe të sjelljes në një shoqëri. Por, qeveria vetë nuk është immune ndaj influencës së pasurisë.

Në të vërtetë, ideologjitë politike perëndimore, direkt apo indirekt, janë të bazuara në pasuri. Sistemi i lirë kapitalist, u krijua si rezultat i dominimit të pasurisë në mënyrat e mendimit të shoqërisë. Në anën tjetër, sistemet socialiste dhe komuniste, u ngritën si rezultat i reaktionit të lakmisë mbi pasurinë e vënë nga një grup i vogël në shoqëri. Pra të tre sistemet ose ideologjitë janë identike të njëra tjetrës, të tria janë të bazuara në lakminë për gjërat materiale.

E dimë se pasuria materiale luan një rol të rëndësishëm në krijimin e identitetit të një shoqërie, gjithashtu cili individ apo grup në shoqëri që e zotëron këtë pasuri është i një rëndësie të veçantë. Në qoftë se një grup që adhuron gjërat materiale, d.m.th., është i drejtuar vetëm nga vlerat materialiste, monopolizimi i pasurisë herët a vonë, do ta kthejë këtë shoqëri në një shoqëri kapitaliste, socialiste apo komuniste. Por, kur një shoqëri kthehet në një shoqëri kapitaliste, socialiste apo komuniste, do të thotë se edhe ata që mbanin vlerat shpirtërore, janë të detyruar të kthehen gjithashtu në kapitalistë, socialistë apo komunistë.

Ky transformim është vënë re në disa vende arabe, të cilat e hodhën poshtë Islamin. Monopoli i pasurisë nga materialistët e rriti më shumë lakminë tek të varfrit, megjithëse ndihma e dhënë nga ideologjitë socialiste dhe komuniste u pranua nga këto vende. Pra meqë këto ideologji janë të bazuara në materializëm, Islami dhe vlerat shpirtërore u lanë pas dore. Sot në disa nga vendet që

më përpara ishin shtete islame, tani besimi fetar dhe shpirtërorja janë lenë mënjanë dhe çdo pjesëtar i kësaj shoqërie është i interesuar më shumë në “drejtësinë” për ndarjen e pasurisë.

Në qoftë se zotërimi i pasurisë nga adhuruesit materialistë, do të çonte në prishjen e shoqërisë, zotërimi i pasurisë nga mbajtësit e vlerave shpirtërore a nuk do të sillte të njëjtin rezultat? Gjithashtu a nuk do të ndryshojë pasuria sjelljen dhe psikologjinë e jetës për këtë grup?

Ne nuk mund të garantojmë që devotshmëria në vlerat shpirtërore, nuk do të brehet nga influenza për pasuri, pasi kjo është nga natyra lakmitare e vetë njeriut. Por, kur trajnimi i vlerave shpirtërore është i një niveli të lartë, gjithashtu dhe kur shoqëria është e dominuar nga vlerat shpirtërore, mundësia është shumë e vogël që lakmia për pasuri të mbizotëroje mendjet e njerëzve. Pra sa më i lartë të jetë niveli i trajnimit shpirtëror, aq më të vogla janë shanset dhe mundësia e influencës materialiste të dominojë vlerat shpirtërore.

Megjithatë, zgjidhja përpara adhuruesve të shpirtërores nuk do të jetë midis hedhjes poshtë dhe pranimit të kësaj bote dhe pasurisë. Bota me pasurinë dhe një sërë aktiviteteve sociale do të ekzistojë pa marrë parasysh se çfarë janë filozofitë për jetë a vdekje që dominojnë mendjet njerëzore. Alternativa apo zgjidhja përpara grupit të spiritualistëve, është nëse ata do të lejojnë materialistët lakmitarë të zotërojnë të gjithë pasurinë e kësaj bote dhe pushtetin që vjen si rrjedhojë e saj, apo do të punojnë për të arritur edhe vetë diçka nga kjo pasuri? Në qoftë se materialistët do të zotërojnë të gjitha pasuritë, për grupin e spiritualistëve, ata duhet të ballafaqohen me shpërbërjen apo shkatërrimin. Kurse në anën tjetër në qoftë se spiritualistët do të zotëronin këtë pasuri, ka shpresa që ata mund të mënjanë dekadencën morale.

Nga kjo zgjidhje nuk ka shmangie, asnjë shoqëri moderne nuk është absolutisht homogjene në këtë respekt. Në çdo shoqëri do të gjejmë grupe njerëzish që janë të dhënë plotësisht pas gjërave materiale dhe grupe njerëzish që janë të dhënë pas shpirtërores. Konkurrimi midis të dy grupeve është i paevitueshëm, secili mundohet të dominojë mbi tjetrin. Pra kjo zgjidhje do të bëhet edhe më e rëndësishme pasi në kohët e sotme moderne asnjë shoqëri nuk është immune nga influenza e botës së jashtme. Dhe gjithashtu bota e jashtme nuk mund të kontrollohet nga një shoqëri që synon të mbajë vetëm vlerat shpirtërore. Në të kundërtën realitet është se çfarë muslimanët e përkufizojnë si “bota e jashtme” nuk është më e influencuar nga besimi fetar se sa është e dhënë pas gjërave materiale.

Edhe në Meke, në Tokën e Shenjtë, ndihen efektet e ideve dhe aktiviteteve të botës së jashtme. Për shembull, asnjë nuk e kundërshton faktin se shpejtimi dhe përmirësimi komunikacionit i ka ndryshuar kushtet brenda dhe jashtë Mekës. Numri i haxhinjve është rritur në përmasa që problemet e akomodimit dhe të mirëqenies së tyre kanë nevojë për çdo lloj masash të reja për të arritur kënaqësinë dhe për t’iu siguruar atyre një kryerje sa më të sigurt të haxhit. Gjithashtu edhe impakti i inflacionit global është ndjerë edhe në Mekë, ashtu si kudo në botë, me efektet e tij në numrin e njerëzve që kërkojnë të kryejnë obligimin e haxhit.

Pra kur Toka e Shenjtë e ndjen presionin e çështjeve të kësaj bote, a mundën shoqëritë e tjera që mundohen të mbahen në vlerat shpirtërore të mbajnë shpresa për t’iu larguar këtij realiteti? Situata në Azinë Perëndimore është një shembull i qartë. 70 milionë arabë, të cilët më së shumti janë muslimanë, nuk zotëronin asnjë pasuri (as pasuri materiale dhe as mundësi për të arritur këtë pasuri

materiale), por ata ishin në gjendje të mbronin vetveten pa ndihmën e komunistëve apo të kapitalisteve. Kurse, sot ata kanë pasurinë materiale (nga nafta, petroli), por vazhdojnë akoma t'u mungojnë aftësitë dhe kjo për shkak të pazotësisë së tyre për të marrë sa më shumë njohuri të kësaj bote. Sulmet nga 2 milionë izraelitë akoma i kërcënohen botës arabe, dhe arabët përsëri varen për mbrojtje tek (kapitalistët) amerikanë dhe (komunistët) rusë.

Kjo situatë pasigurie i dobëson edhe më shumë lidhjet vëllazërore midis muslimanëve, se për të shpëtuar veten e vet ai harron për vëllain e tij të shtypur. E kështu direkt apo në mënyrë indirekte, presioni i problemeve të kësaj bote dalëngadalë do të fillojë të brejë devotshmërinë në shpirtëroren. Dhe është e ngjashme se me vazhdimin e këtij presioni dhe me keqësimin e tij mund të sjellë që vetë besimi fetar të shkojë drejt rënies. Prapë këtë e shohim të ndodhë në disa nga vendet arabe, ku feja islame i ka humbur shumë nga besimtarët e vet dhe kjo fe nuk është më feja e shumicës dhe nuk është më as feja zyrtare që të njihet në këto vende si më parë.

Në qoftë se grupi që mbante vlerat shpirtërore islame do të kishte qenë i pasur dhe të zotët të përgatitur në fusha të ndryshme të kësaj bote ("bota" këtu nuk është sinonim me "materializmin") me gjithë ato pasuri të mëdha që Zoti i ka dhuruar shteteve arabe, këta muslimanë do të kishin qenë të sigurt nga kërcënimi izraelit, ose ndoshta Izraeli nuk do të kishte ekzistuar fare. Është me të vërtetë një turp i madh që 70 milionë njerëz nuk mundën të mbrojnë dot vetveten dhe integritetin e vet nga 2 milionë njerëz që nuk kanë asnjë prej këtyre pasurive që muslimanët zotërojnë.

Ky është realiteti. Disa mund të thonë se e gjithë kjo është një e mirë e fshehtë apo një mençuri për situatën e sotme që gjendet Azia Perëndimore, dhe se ne nuk du-

het as të shqetësohemi dhe as të marrim mësimë prej saj dhe se ne nuk na duhet as të ndryshojmë mënyrën e sjelljes dhe as të përpiqemi për të ruajtur vlerat shpirtërore islame të grupeve të tjera nga i njëjti fat! Këta njerëz ndoshta edhe thonë se megjithëse Perëndimi, i ka tejkaluar vendet islame në pasuri dhe në pushtet, vendet islame vazhdojnë të ekzistojnë dhe gjithashtu Islami vazhdon të ruhet në zemrat e besimtarëve të vet.

Por, përsëri mund të themi se realiteti e përgënjeshtrohet këtë nocion. Shumë prej vendeve islame në Azinë Qendrore kanë rënë në duart e komunistëve, dhe gjeneratat e reja në këto vende nuk besojnë në fenë islame dhe as nuk mbahen për vlerat shpirtërore. Si komunistë që janë ata besojnë se rruga për lumturinë njerëzore vjen si rrjedhojë e diktaturës së proletariatit, dhe e ndarjes në mënyrë të barabartë të pasurisë. Për ta besimi fetar është një ëndërr boshe. Prandaj ata shkatërrojnë xhamitë ose i kthejnë ato në shtëpi muze për të ekspozuar mbi civilizimin e shkuar.

Në disa nga vendet arabe gjithashtu, socializmi dhe komunizmi e kanë nxjerrë jashtë fenë islame dhe vlerat shpirtërore. Xhamitë dhe shkollat fetare janë zvogëluar shumë në numër dhe emri i Allahut nuk përdoret më si më parë. Në kundërshtim me përhapjen e Islamit nëpër botë, ashtu siç bënë paraardhësit e tyre, këta popuj, po e hedhin poshtë fenë islame dhe në vend të saj janë duke përhapur ideologji që janë komplet të kundërta me Islamin.

E gjitha kjo ndodh për arsyen se vetë “liderët” islamikë janë në konflikt me realitetin. Në këtë botë moderne ku muslimanët shikojnë vetëm avancimin material dhe pasuritë e komuniteteve të tjera, vetëm të deklarosh se Islami dhe vlerat shpirtërore do të sjellin lumturi nuk mund të pranohet aq lehtë nga këta muslimanë që nuk janë aq të fortë në besimin e tyre fetar. Por këto deklara-

ta duhet të përkrahen me fakte që demonstrojnë se vlerat shpirtërore mund të ndihmojnë të devotshmit të gjejnë lumturinë e kërkuar dhe të mos jepen pas materiales.

Sot nuk mund të kundërshtohet fakti se muslimanët janë të detyruar të përrulen përpara materialistëve, për të kërkuar ndihmë dhe mbrojtje. Dhe me këto fakte në dorë është e pamundur të bindësh dikë se shpirtërorja është ajo që sjell lumturinë. Për refugjatët palestinezë që sulmohen, vriten dhe zhvendosen nga të dyja palët si çifutët izraelitë ashtu edhe nga disa muslimanë, është e vështirë të pranohet se vlerat shpirtërore janë ato që sjellin lumturinë. Gjithçka që ata dinë është, se ata janë të shtypur nga materialistët dhe se ata që flasin për lumturinë e sjellë nga vlerat shpirtërore janë mjaft të dobët për t'u dhënë atyre ndihmën e duhur.

Sot shpesh bëhen thirrje për të ruajtur vlerat shpirtërore dhe për të hedhur poshtë materializmin. Gjithkush bie dakord se vlerat shpirtërore janë ato më të dëshiruara, por akoma ka shumë çoroditje midis përkufizimeve dhe roleve që luajnë shpirtërorja dhe materializmi. Gjithashtu, akoma nuk është i qartë kuptimi i sfidës që ballafaqohet nga shpirtërorja në këto kohë. Dhe në këtë gjendje të mjegullt, të paqartë të mendjes është shumë e vështirë të merren vendime të sakta në masat dhe qëndrimet efektive që duhen marrë.

Rezultati është një rang i gjerë i sjelljeve dhe masave të marra nga grupe të ndryshme që mbrojnë vijën e shpirtërores. Ka disa që konsiderojnë veshjen, ngjyrat, TV, makinat apo lehtësimet e tjera moderne si simbol të materializmit (botërores) dhe mundohen të hapin sa më shumë luftë kundër këtyre simboleve të materializmit. Disa të tjerë mundohen të izolojnë veten nga të tjerët duke dënuar apo duke i parë me sy tjetër ata që nuk bashkohen në “përpjekjet” e tyre. Gjithashtu, kemi edhe

disa prej atyre që janë në gjendje të torturojnë apo dhe të vrasin muslimanët e tjerë (p.sh. vrasja e ministrit egjip-tian) nën deklaratat se ata janë duke luftuar nën kauzën e Islamit dhe vlerave të vërteta morale.

Njeriu si një krijesë inteligjente që është, do të mundet të shkatërrohet lehtë në qoftë se ai do të lërë emocionet dhe dëshirat ta kontrollojnë. Mirëpo njeriu si një krijesë inteligjente është e nevojshme të studiojë dhe të investigojë me qetësi problemet që i dalin përpara.

Sfida e vlerave shpirtërore në këto kohë moderne është evidente dhe është mjaft e qartë. Kjo sfidë mund të ballafaqohet dhe historia e ka treguar se si, në kohët e para ardhjes së Islamit (*shabilijjet*) ku dëshirat dominonin sjelljet shoqërore. Historia gjithashtu na tregon se si për 23 vjet me radhë feja islame mundi të kontrollonte këto dëshira njerëzore dhe e çoi shoqërinë në rrugën e drejtë, në rrugën e vërtetë. Gjithashtu historia na ka treguar se si në shekujt që pasojnë feja islame vazhdoi të përhapej dhe të shkatërronte vlerat e padëshiruara, në pothuajse 2/3 e botës se atëherëshme.

Pra në qoftë se sot vlerat shpirtërore ballafaqohen përsëri detyra e mbrojtjes dhe e mbajtjes lart të këtyre vlerave duhet të mbështetet në analiza dhe veprime të mençura. Një luftë simbolike është e pakuptimtë dhe pa dyshim që nuk do të sjellë ndonjë sukses apo dobi. E njëjta gjë mund të themi se do të ndodh në qoftë se mundohemi ta izolojmë vetveten dhe të shqetësojmë unitetin e muslimanëve, të cilët janë besimtarë të vlerave shpirtërore.

Armiqtë e vlerave shpirtërore nuk janë vetëm materialistët. Armiqtë më të dëmshëm, janë pasionet e shthurura dhe njohuritë e cekëta të atyre që dëshirojnë të mbajnë shpirtëroren, por janë të paqartë rreth ballafaqimeve që i bëhen dhe që e dobësojnë shpirtëroren. Pra shpirtërorja nuk ballafaqohet vetëm nga vlerat materia-

liste. Shpirtërorja gjithashtu ballafaqohet edhe nga mangësia e njohurive dhe dijes, dhe nga krenaria e pavend e besimtarëve të vet. Pra përderisa do të ballafaqohemi me këtë të vërtetë, detyra për të mbrojtur vlerat shpirtërore do të mbetet një detyrë e vështirë për ne.

Kapitulli IX

Grupet presioniste në demokraci

Në çdo sistem politik, kemi grupe të veçanta që përpiqen të vendosin pikëpamjet e tyre mbi qeverinë në pushtet. Këto grupe janë quajtur grupe presioni pasi ata mundohen të imponojnë idetë dhe pikëpamjet e tyre tek qeveria nëpërmjet rrugëve të ndryshme sistematike apo çfarëdo lloj qofshin ato. Shumica e këtyre grupeve nuk sjellin probleme dhe mund të jenë shumë të përdorshme. Por ndërmjet tyre ka edhe nga ato grupe presioniste, që mund të kenë efekt të kundërt për qeverinë dhe për gjithë vendin.

Në një sistem demokratik gjejmë me shumicë grupe presioni që punojnë në lobe në asamblenë kushtetuese, veprimtari kjo që quhet lobim. Këto lobe, apo grupe me influencë janë pjesë integrale e sistemit demokratik..

Mirëpo kohët e fundit kemi vënë re se disa nga këto grupe presioni nuk janë të kënaqura me mënyrën e operimit (modus operandi) në lobe. Ata duan që pikëpamjet e tyre të mbizotërojnë tek përfaqësuesit e zgjedhur të popullit dhe qeveria, pa marrë parasysh nëse këta përfaqësues të popullit apo qeveria bien dakord me pikëpamjet e tyre apo jo.

Demokracia është e udhëhequr nga pikëpamjet dhe konsensusi i arritur midis mazhorancës. Grupi që ushtron presionin është pakica. Prandaj një grup i presionit nuk është shumë efektiv kur ai është jashtë lobit të

asamblesë kushtetuese, por bëhet i tillë përderisa ai përdor çdo armë apo rrugë antidemokratike.

Një rrugë apo armë antidemokratike, e cila konsiderohet mjaft efektive në kohët e sotme është demonstrimi. Në fillim demonstrimi përdorej në mënyra paqësore, por me lejimin nga autoritetet, një proces i tillë u mbajt nga pjesëtarët e këtij demonstrimi me mbajtje pankartash dhe me thirrje të sloganeve të ndryshëm kundër njerëzve në pushtet. Në Japoni, studentët demonstrojnë duke mbajtur një vallëzim gjarpër, siç e quajnë ata duke formuar katër-pesë rreshta dhe kërcëjnë duke imituar lëvizjet e gjarpërit.

Ndonjëherë vetë qeveria i përdor demonstrimet për të treguar përkrahjen e publikut në politikë, reformat apo ngjarje të ndryshme.

Sukarno, mbante demonstrime të shpeshta në përkrahje të konfrontimeve me qeverinë e tij. Por njëri prej këtyre demonstrimeve shpërtheu me zjarrvënie, ku disa prej demonstruesve vunë zjarre nëpër ndërtesat e ambasadave të huaja në Xhakarta.

Në Amerikë, demonstrimet u përdorën nga studentët dhe të rinjtë për të mënjeluar luftën në Vietnam dhe për të shpëtuar prej reprzaljeve të luftës. Amerika gjithmonë është njohur për fitore të shpejta, por lufta në Vietnam pati një zgjatje prej shumë vjetësh, që tregonte se fitorja e tyre kësaj radhe ishte shumë larg dhe se ata që vuajtën më shumë ishin të rinjtë amerikanë, ku shumica e tyre gjetën vdekjen, u plagosën dhe shumë prej tyre u zhdukën pa lënë gjurmë pas kapjes nga forcat e Vietnamit.

Të rinjtë amerikanë nuk mund ta shprehnin haptas frikën e tyre për të shkuar në luftë me Vietnamin, kështu që me demonstrimet e tyre ata mundoheshin të shprehnin gjoja keqardhjen për popullin vietnamez, i cili po barbarizohej nga fuqia e militariste amerikane. Demon-

strimet e këtyre të rinjve shkuan deri atje ku ata filluan të digjin letërnjoftimet e tyre, duke bërë të mundur kështu që të humbin gjurmë në regjistrimet e shërbimeve ushtarake. Dhe në të vërtetë ky ishte edhe motivi i tyre i vërtetë, për të mënjeluar shërbimet ushtarake në Vietnam., gjë që ata mundën ta arrinin duke e detyruar qeverinë amerikane të ulte marrjen pjesë të forcave amerikane në Vietnam, dhe se fundi kjo çoi në fitoren e Vietnamit të Jugut mbi forcat amerikane.

Populli i Vietnamit akoma është duke i hequr pasojat e kësaj lufte, por të rinjtë amerikanë nuk janë më të interesuar në çështjet e Vietnamit, pasi ata e kishin arritur qëllimin e tyre për të cilin këta të rinj u ngritën pikë së pari. Tani të rinjtë amerikanë filluan të koncentroheshin më shumë në studimet për të siguruar një të ardhme më të mirë për veten dhe familjet e tyre dhe gjithashtu për një të ardhme më të mirë për vendin. Ishte shumë e qartë se demonstrimet e tyre nuk ishin të motivuara nga keqardhja për popullin e Vietnamit, ashtu siç u deklarua prej tyre, por ishin thjeshtë të bazuara në interesat personale.

Megjithëse forca studentëve në Amerikë nuk është më aq e egër si më parë, studentët janë pranuar si grup presioni dhe ata gjithmonë janë krahasuar me pushtetin dhe praktikat e studentëve në vendet e tjera. Në Francë dhe në shumë vende të tjera evropiane, studentët janë duke luajtur vazhdimisht rolin e grupeve presioniste. Por zakonisht objektivat e tyre janë gjithmonë të kufizuara dhe ato asnjëherë nuk përfshijnë marrjen e pushtetit politik, apo marrjen në dorë të qeverisë në pushtet.

Në Lindje, efektshmëria e tyre si grupe presioni është ndjerë më shumë pasi ato ndihmuan në hedhjen poshtë nga pushteti Sukarnon në Indonezi dhe Thanom Kitikachorn-in në Tailandë. Pra suksesi i studentëve indonezianë dhe atyre tajlandezë, i inkurajoi studentët e ven-

deve të tjera për të vepruar si një grup presioni, duke përdorur demonstrimet si një vegël politike në vendet e tyre.

Në një vend ku qeveria është e korruptuar dhe e kalbur dhe kur kjo qeveri është duke shkatërruar, jo vetëm vendin, por edhe vetë jetën e popullit, demonstrimet janë mjaft me vend. Dhe studimet në këtë fushë kanë treguar se demonstrimet do të sjellin jo vetëm ndryshimin e qeverisë, por gjithashtu korrupsioni dhe paaftësia mund të zhduken me lehtësi.

Por në një vend kur qeveria është duke punuar në baza të shëndosha dhe është larg korrupsionit, përdorimi i demonstrimeve nga grupet presioniste vetëm se do të keqësojë gjendjen edhe më shumë. Nuk ka rëndësi nëse demonstrimet janë të lejuara nga ligjet e këtij vendi apo jo, rezultatet do të jenë të njëjta, në fund do të kemi shkatërrimin e ligjit dhe anarki në vend.

Këtë mund ta provojmë me shembuj të marrë nga historia, nga demonstrimet e vetë studentëve malajzianë nga fillimi duke ndjekur kështu kursin e tyre logjik e duke arritur në fund. Në fillim ata nisën me forume dhe dialogë ku të ftuarit filluan të kritikoheshin nga të rinjtë studentë, pastaj filluan demonstrimet e para të furishme, me djegie portretesh, me pankarta kërcënuese kundër figurave prominente të vendit, me kryengritjet në masë nëpër kampet studentore dhe përhapjen edhe jashtë tyre, përleshjet me policinë, përdorimi i dhunës dhe shqetësimi i paqes.

Për të gjetur një shkak për t'u ngritur në demonstrim nuk ishte asnjëherë problem. Problemet ishin të shumta, si rënia e studentëve në provime, pagesat për shkollën, rregullat e ndryshme etj., dhe shkak i gjetur do të ndryshonte natyrën në "grevë urie". E prej këtu do të shkonte në zyrat e qeverisë dhe kështu do të kërkohej të zgjidhej çështja sa më shpejt, por kur qeveria merrte veprime do të përshiheshin edhe veprimet nga policia,

që do të përfundonin me arrestime dhe me ngritje akuzash kundër studentëve.

Demonstrimet e studentëve më vonë filluan të mbaheshin edhe në lidhje me Repartet Rezervë të Shtetit (Federal Reserve Units). Zëvendësimi i këtyre reparteve (FRU) me Forcat e Rendit (Field Forces, FF) ishte një shkak tjetër për demonstrim. Në qoftë se policia do të hynte në komplekset shkollore kjo do të provokonte edhe me shumë demonstrimet dhe kur policia dilte jashtë, përsëri demonstrimet vazhdonin. Ishte e qartë se çdo gjë mund të përdorej si një shkak për demonstrim. Ajo që kishte rëndësi nuk ishte shkaku, por rëndësi kishte të tregonin fuqinë e tyre tek qeveria.

Po vallë a do të pushonin demonstrimet në qoftë se qeveria do të ndryshonte qëndrimin e saj ndaj tyre. Përgjigja ishte se kur Qeveria mendohej të plotësonte kërkesat e demonstruesve, demonstrime më të mëdha do të ndodhnin. Për shembull kur kërkesa e demonstruesve studentë u plotësua në lidhje me dekanin e universitetit, demonstrime të tjera shpërthyen për statusin universitar të ITM-së, dhe më pas demonstrime për ndryshime në të ardhurat e tyre pasi të mbaronin universitetin, e të tjera demonstrime me kërkesa të natyrave të ndryshme.

Kur studentët e shikonin se nga “grevat e tyre të urisë” do të fitonin diçka, atëherë ata do të përdornin demonstrime të tjera akoma më të mëdha. Dhe në disa prej këtyre demonstrimeve pjesëmarrja e popullatës prej qyteteve të Kuala Lumpurit dhe Kedahut i bën edhe më të vështira për policinë t’i vinte nën kontroll këto demonstrime. Në Kedah për shembull, shumë prej dyqaneve u plaçkitën dhe u përdorën edhe armë zjarri, flamuri u keqtrajtua, zyrat dhe shtëpitë e zyrtarëve u vandalizuan, gjithashtu edhe familjet e tyre u keqtrajtuuan.

Vendosja e fëmijëve dhe të miturve në vijën e frontit e bëri akoma më të vështirë për policinë për të kryer detyrën për mbajtjen e qetësisë. Që të sulmonin fëmijët kjo do të thoshte të krijonin një egërsim më të madh mbi këta demonstrues. Por në të njëjtën kohë mosmarrja e masave të duhura do të rezultonte në rritjen e dhunës nga ata njerëz që vinin pas frontit të fëmijëve dhe duke e keqësuar kështu gjendjen akoma më shumë.

Pra pasi populli e krijoi bindjen se nëpërmjet demonstrimeve në masë ata jo vetëm që shpëtonin prej akuzave për kryerje të akteve kriminale, por gjithashtu në të njëjtën kohë ata do të siguronin të fitonin kërkesat e tyre, do të shikonim se grupet njëri pas tjetrit do të demonstronin derisa të plotësonin qëllimet e tyre. Punëtorët, fshatarët, peshkatarët, mësuesit, bashkimet profesionale, partitë e ndryshme politike dhe shtresat e tjera të popullit ishin grupet që ngriheshin në demonstrata për të arritur interesat e tyre dhe kur këto grupe bashkoheshin në demonstrime të përbashkëta kjo e bënte më të vështirë punën e policisë në ruajtjen e rendit.

Demonstrimet nuk mbaheshin vetëm nga popullata civile, nganjëherë do të ngriheshin në demonstrime edhe vetë policia apo armata e shtetit. Dhe kur ndodhin këto demonstrime patjetër që në vend nuk kishte më disiplinë. E në një vend pa disiplinë nuk do të kishim qetësi dhe kjo do të sillte anarki në vend. Por në një situatë anarkie asnjë njeri nuk është më i sigurt, tani çdo njeriu i duhet të shikonte pas vetes së vet.

Ne në Malajzi, mund të mendojmë se çfarë është duke ndodhur në disa vende nuk mund të ndodhë në vendin tonë, por mos të harrojmë se jo më larg po një dekadë më parë ne as nuk mund ta kishim imagjinuar se demonstrimet e studentëve do të mund të ndodhnin edhe këtu. Një dekadë më parë as nuk mund ta kishim

imagjinuar konsumimin e drogës, përdorimin e Islamit për kauzën komuniste dhe fenomene të tjera që as mund të kishim ëndërruar ndonjëherë se mund të ndodhin në vendin tonë. Mirëpo të gjitha këto kanë ndodhur edhe tek ne, dhe asnjë nuk mund ta hedhë poshtë faktin duke thënë se në këtë vend nuk do të shikojmë kurrë as anarki dhe as thyerje të rregullave apo ligjeve.

Natyrisht ajo çfarë duhet bërë është, se aktivitetet dhe veprimtaritë e këtyre grupeve presioniste duhet të kontrollohen më mirë nga qeveria. Dhe është e rëndësishme dhe efektive në qoftë se njerëzit vetë janë më vigjilentë. Heqja apo ardhja e një qeverie përfshin vetëm një grup të vogël njerëzish, por në qoftë se grupet presioniste do të lejohen të vendosin për vënien e ligjeve apo të makinerisë së pushtetit, kjo do të sjellë vetëm anarki dhe atëherë pasojat do të bien mbi të gjithë popullin. Nga anarkia nuk ka më kthim tek një jetë e qetë e normale. Qeveri pas qeverie do ta marrin pushtetin në dorë dhe kur kjo të ndodhë do të jetë shumë vonë për vendin të vendoset prapë nën paqe dhe qetësi.

Pra duke u mbështetur nga e gjithë kjo që diskutuam më lart, mund të themi se grupet presioniste luajnë një rol të veçantë, por si çdo armë tjetër politike keqpërdorimi i tyre do të jetë me pasoja për vendin.

Kapitulli X

Shtetëzimi i industrive të huaja

Një nga masat e zakonshme që merret nga vendet e reja të pavarura, është shtetëzimi (nacionalizimi) i industrive të huaja dhe i pronave e pasurive të tyre. Kjo bëhet për të provuar se pavarësia dhe liria që janë arritur janë të vërteta dhe se tani asgjë nuk mund t'i ndalojë këto vende të reja të pavarura të bëjnë çdo gjë që ato dëshirojnë. Gjithashtu shtetëzimi mund të bëhet edhe për vetë qëllimin e vërtetë për të shpëtuar ekonominë e këtij vendi nga prangat e huaja, duke besuar se të gjitha profitet e marra nga këto industri të huaja do të shkojnë në ekonominë e vetë vendit që i shtetëzoi.

Dhe askush nuk mund ta kundërshtojë se kjo është një lëvizje popullore dhe qeveria që e merr në zbatim këtë vendim do të fitojë përkrahjen e popullit, të cilët janë mjaft të kënaqur me arritjet e vendit të tyre të pavarur.

Të mbuluar nga euforia për arritjen e pavarësisë dhe marrjen e pasurive dhe pronave të këtyre industrive, anët pozitive dhe negative të shtetëzimit të këtyre industrive shumë rrallë do të merren parasysh të studiohen dhe të diskutohen. Çdo njeri që do të tërheqë vëmendjen për ndonjë disavantazh do të quhet zëri i kundërshtimit dhe ky do të abuzohet dhe do të lihet në harresë. Pra është mjaft e rrallë që ndonjë do të guxojë të flasë kundër marrjes se këtyre koncerneve komerciale dhe industrive të huaja nga shteti.

Përveç idesë së krijuar se pavarësia dhe sovraniteti i këtyre vendeve shkon me kontrollin e industrive të huaja në tokën e tyre, shtetëzimi i industrive gjithashtu është një koncept socialist mjaft i lavdëruar që shpesh implementohet apo zbatohet jo vetëm nga vendet që sapo kanë fituar pavarësinë, por edhe nga vende të tjera që nuk kanë qenë asnjëherë të kolonializuara ose nën sundimin e një vendi tjetër. Kur në Angli Partia e Punës (Partia Laburiste) u vendos në qeveri, ajo shtetëzoi hekurudhat, minierat, industritë e hekurit dhe industritë e rëndë, të cilat zotëroheshin nga kompani private që u takonin shtetasve anglez. E gjitha kjo ishte bërë për të plotësuar principet socialiste, për të vënë barazinë e të ardhurave dhe “drejtësinë”.

Megjithëse në Malajzinë e pavarur dhe sovranë, shtetëzimi nuk është as ndonjë nga mënyrat politike dhe as frymëzim i qeverisë, për ta bërë, shpesh është folur dhe gjithmonë ka pasur përkrahjen e një grupi apo të një grupi tjetër nga populli. Shumë njerëz besojnë se me marrjen përsipër të këtyre industrive të huaja, profitet do të shkojnë vetë tek vendi. Një numër i madh beson gjithashtu se me shtetëzimin e industrive, pasuria e këtyre industrive do të bëhet pasuri e vetë punëtorëve, dhe ata do të gëzojnë frytet që më parë gëzoheshin nga punëtorët e huaj.

Kohët e fundit u mor në shqyrtim çështja e shtetëzimit të industrive të huaja. Disa nga grupet janë të lëkundura, por gjithashtu janë të përgatitura të bashkëpunojnë me ata që veprojnë në frontin e kauzës komuniste. Ata e kundërshtojnë mendimin se kjo lëvizje mund të shkatërrojë ekonominë e vendit dhe mund të sjellë situata politike që mund të bëjnë të mundur fitoren e lëvizjes komuniste. Aq të dhënë janë këto grupe pas ëndrrës së fitimit të një pasurie të arritur nëpërmjet marrjes se pasuri-

ve të industrive saqë ata nuk i marrin asnjëherë parasysh dështimet e këtyre metodave në vendet e tjera. Ata e bëjnë një sy qorr mbi këto realitete dhe verbohen me atë që duket si rrugë e lehtë pasurimi. Shtetëzimi vetë ka implikime të ndryshme që mund të ndikojnë tek njerëzit, prandaj ai duhet të jetë i hapur për studim dhe analizim më të thellë. Njerëzit duhet të dinë anët pozitive dhe negative të kësaj lëvizjeje, kështu që ata mund të vendosin në mënyrë më serioze mbi këtë çështje.

Një spekulim, industrial apo komercial, nuk mund të ketë sukses vetëm me kapital dhe planifikim. Për shembull, në qoftë se një njeri me një kapital që ka do të hapë dyqane të ndryshme në një vend, ai nuk mund të jetë absolutisht i sigurt se do të ketë fitim. Shumë njerëz që kanë pasur eksperiencë në hapjen e bizneseve të ndryshme, mund të flasin mbi të vërtetën e kësaj që thamë. Suksesi mund të arrihet vetëm atëherë kur pronari i dyqanit, di mbi intrigat e tregtisë, është kompetent në financim, furnizim dhe shitblerje. Me fjalë të tjera sukse- si i kësaj ndërmarrje komerciale, varet shumë në mendjemprehtësinë për biznes.

Por për bizneset që janë me komplekse si ato që përfshijnë fabrikat industriale, import-eksportin, tregtimin me jashtë vendit, etj., kërkojnë një mendjemprehtësi më të madhe gjithashtu, kërkojnë mundësinë materiale dhe personalitet të vërtetë. Pa një mendjemprehtësi dhe pa një mundësi materiale, biznesi nuk do të mund të sjellë profite. Në tregti, një rritje e shitjes se mallit nuk do të thotë gjithmonë profit, ajo mund të sjellë edhe humbje. Pra shitjet jo gjithmonë mund të sjellin profite.

Rastet në vendet e tjera mund të studiohen për të provuar të vërtetën e kësaj thënieje. Për shembull, industritë e qymyrit dhe të hekurit ishin ndër industritë angleze që sollën profite mjaft të mëdha tek aksionarët e

kompanive që merreshin me këto industri para Luftës së Dytë Botërore. Këto industri bënë të mundur që shumë prej këtyre anglezëve të bëheshin milionerë, prosperiteti filloi të lulëzonte në Britani dhe kjo solli një rimëkëmbje të industrisë së vendit.

Partia e Punës që ishte në pushtet në atë kohë duke parë profitet e mëdha të fituara nga këto industri, me një përkrahje shumë të përzemërt edhe nga punëtorët i shtetëzuan këto industri. Qeveria dhe punëtorët besuan se nëpërmjet shtetëzimit të këtyre industrive, të gjitha përfitimet do të shkonin tek pushteti dhe do të përdroreshin për të mirat e punëtorëve dhe të gjithë popullit.

Por historia na tregon se kjo periudhë është koha më e vështirë për këto industri ku provuan dhe humbjet më të mëdha. Dhe më e çuditshmja ishte se punëtorët që ishin aq të kënaqur në fillim me marrjen përsipër të këtyre industrive nga qeveria, tani filluan të mos e pëlqenin qeverinë dhe nuk e shihnin me syrin e një punëdhënësi të mirë. Sjelljet e tyre ndaj qeverisë si punëdhënëse ishin më keq se sjelljet që ata mbanin ndaj punëdhënësve kapitalistë.

Çdo vit filluan të mbaheshin greva dhe kjo bëri që këto industri të mos ishin më me profit. Nuk kishte më rëndësi nëse qeveria ishte ajo e Punës apo ajo Konservative, grevat filluan të mbaheshin njëra pas tjetrës, dhe në një kohë shumë kritike. Për shembull, punëtorët e minierave të qymyrgurit filluan të shkonin më shpesh në greva dhe kjo ndodhte gjatë periudhës së dimrit, duke vënë një numër të madh njerëzish të pafajshëm në rrezik, bënte që qeveria të mundohej të plotësonte kërkesat e tyre sa më shpejt.

Pra me përpara qeveria kishte pasur mjaft fitime nga taksat e marra prej këtyre industrive, kurse tani qeveria nuk mund të mblidhte asgjë prej tyre pasi këto industri ishin gjithmonë e më shumë në humbje. Në fakt qeveria

mandohej të plotësonte mbi humbjet e tyre për t'i mbajtur këto industri akoma në gjendje pune. Pra megjithëse këto industri ishin në humbje, qeveria nuk mund t'i mbyllte pasi kjo do të sillte konsekuenca akoma më të liga për vendin. Kjo lëvizje do të rezultonte jo vetëm në uljen e prodhimit të qymyrit dhe hekurit, por gjithashtu numri i të papunëve do të rritej gjë që do të rrezikonte më shumë qeverinë. Prandaj qeveria duke mos pasur rrugë tjetër duhet të mbulonte këto industri duke përdorur taksat e marra nga industritë e tjera që nuk ishin të shtetëzuara.

Në Britani qeveria akoma ndihmon industritë e shtetëzuara sepse akoma ka industri të tjera që janë private dhe prej profitit të këtyre industrive qeveria merr një të ardhur të mirë taksash. Në qoftë se të gjitha industritë do të ishin shtetëzuar dhe do të kishin humbje, qeveria nuk do të kishte të ardhura nga taksat për t'i mbuluar këto humbje.

Përveç mundësisë që të gjitha industritë e shtetëzuara do të ishin me humbje, gjithashtu këto industri pengonin dhe suksesin ekonomik të vendit. Për shembull në qoftë se qeveria do të shtetëzonte të gjitha industritë e prodhimeve të pambukut, në lidhje me ideologjinë socialiste, çmimet do të ishin shumë të ulëta për arsye se qëllimi i shtetëzimit ishte për të mirën e punëtorëve. Dhe në qoftë se qeveria nuk do të dëshironte të rriste pagat e punëtorëve, ata do ta shtrëngonin qeverinë të bënte rritje pagash se punëtorët menjëherë do të shkonin në greva për çdo vit.

Të pasurit nuk do të ekzistonin në një shtet të plotë socialist, kështu që prodhimet e pambukut të prodhuara duhet të ishin me ato çmime që punëtorët mund t'i blinin. Por, me një kosto prodhimi shumë të lartë dhe me një çmim shitjeje shumë të ulët, profitet e marra nga

këto prodhime do të ishin shumë minimale ose nuk do të kishte fare profite.

Mirëpo profitet janë shumë të domosdoshme në një biznes se jo vetëm që e pasurojnë biznesin, por gjithashtu prej këtyre profiteve do të paguhen taksat, dhe do të bëhen investime të tjera për zgjerimin e biznesit. Taksat e marra janë të nevojshme për qeverinë, e cila me këto të ardhura do të financojë administratën dhe angazhime të tjera të saj, ndërsa investimet për zgjerimin e biznesit janë të rëndësishme se mbajnë kërkesat për prodhim të jenë gjithmonë në rritje. Qeveria si pronare nuk mund të mënjojë kërkesën e rritjes për prodhim, por e rëndësishme është se rritja e kërkesës do të krijojë më shumë mundësi punësimi. Në qoftë se të gjitha industritë e shtetëzuara do të ballafaqoheshin me të njëjtat probleme, qeveria nuk do të ishte në gjendje ta përballonte gjithë këtë barrë. Me pagat e larta, profite të ulëta, nevoja për të zgjeruar dhe për të hapur industri të reja, nevoja për taksat dhe ndarja e profiteve të marra nga qeveria si pronare për të financuar mirësitë e tjera sociale si arsimin, shëndetësinë, sigurinë, komunikimin dhe një sërë nevojash të tjera shoqërore, padyshim që qeveria nuk do të ishte në gjendje të siguronte një ecje të vendit.

Për të zgjidhur problemin e shkurtimit të fondeve për administratën, qeveria duhet të vendosë taksa mbi të ardhurat. Përsëri në qoftë se nuk do të kishim industri dhe tregti private, nuk do të kishim as industrialistë të pasur dhe taksat do të vendoseshin vetëm mbi të ardhurat e punëtorëve. Por, në qoftë se, punëtorët do të ishin vetëm ata që paguanin taksat, përveç absurditetit të pagesës se pagave të larta do të ishte e pakuptimtë, pasi qeveria do të merrte mbrapa gjysmat e këtyre të ardhurave. Dhe kjo ishte ajo çfarë ndodhi në Britani. Punëtorët hidheshin në greva për të marrë paga më të larta dhe afro

gjysma e këtyre (rreth 60 %) do të merreshin nga qeveria nëpërmjet taksave të ndryshme. Do të ishte më mirë dhe më e lehtë sikur të paguheshin paga më të ulëta dhe mos të merreshin taksa, pasi rezultati do të ishte i njëjtë si me pagat e larta dhe marrjen e taksave të ndryshme, d.m.th. profitet e marra nga qeveria në rastin e parë do të jenë të njëjta me taksat e marra nga pagat e larta. Pra pagat e larta nuk janë në të vërtetë të larta pasi taksat e ndryshme të vendosura nga qeveria duhet të paguhen nga punëtorët, prandaj mund të themi se është e palogjikshme të shkosh në greva për paga më të larta, të cilat do të paguhen prapa tek qeveria në formë taksash.

Kjo do të thotë se ideologjia socialiste nuk mund të aplikohet në asnjë vend, pasi është një fakt i vërtetë se shtetëzimi i të gjitha industrive dhe bizneseve, jo vetëm që do të shkatërronte ekonominë e vendit, por gjithashtu do të sillte pasoja edhe në prodhimin e gjërave të nevojshme.

Në një shtet socialist, shtetëzimi i industrive mund të bëhet, por kjo të kufizohet në një numër industrish apo biznesesh që janë të rëndësishme dhe shumica e tregtisë apo industrive të tjera të mbahet nga sektori privat. Kështu që profitet e marra nga taksat do të përdoren për të mbuluar këto industri të shtetëzuara. Me fjalë të tjera, principet socialiste mund të praktikohen vetëm kur të kemi treg të lirë. Socializmi që varet nga kapitalizmi është një diçka hipokrite.

Megjithatë industritë e shtetëzuara nuk janë gjithmonë me humbje. Për shembull industritë e shtetëzuara të petrolit sjellin gjithmonë profite të mëdha për vendin, por kjo ndodh pasi në botë ka shumë vende kapitaliste të cilat praktikojnë tregun e lirë dhe kanë nevojë të konsumojnë sasi të mëdha naftë. Por, në qoftë se, furnizimi i naftës do të ishte më i madh se kërkesat, do të kishim të bënin me një tjetër situatë. Pra vendet e prodhimit të

naftës nuk mund të bëhen të pasura vetëm duke u bazuar në marketin e brendshëm, ato varen në mënyrë të drejtpërdrejt nga vendet që nuk janë duke praktikuar principet socialiste. Shkurt mund ta themi se socializmi dhe shtetëzimi mund të ekzistojnë vetëm me qenien e kapitalizmit. Çfarë është e qartë është se industritë e shtetëzuara në principe apo në ideologji, pa ju bërë një studim më në thellësi për konsekuencat që mund të sjellin, janë të pavlera dhe të padobishme.

Këta shembuj ndoshta provokojnë replikë për vendet komuniste që i shtetëzojnë të gjitha industritë, ashtu siç ka ndodhur në Bashkimin Sovjetik, dhe e njëjta gjë mund të thuhet edhe për Republikën e Kinës.

Nuk mund të hedhim poshtë edhe faktin se një vend komunist mund të jetë në gjendje të shtetëzojë të gjitha industritë pa pasur pasoja në ekonominë e vendit, por megjithatë mos të harrojmë se faktori kryesor në suksesin e kësaj nuk është shtetëzimi, por pushteti diktatorial që ushtron qeveria, e cila nuk lejon grevat apo ngritjen e një opozite në asnjë farë mënyre.

Duke pasur një pushtet absolut, qeveria u paguan punëtorëve paga të ulëta dhe gjithashtu ua ndalon atyre ndarjen e pasurisë së vendit. Kjo pasuri që vjen si rezultat i mundit dhe djersës së punëtorëve merret e gjitha nga qeveria për t'u përdorur për makinerinë që e mban nën fre zemërimin e popullit dhe gjithashtu përdoret për forcat e armatosura. Pra s'ka rëndësi nëse qeveria është popullore apo jo, nëse qeveria është e drejtë apo jo, populli nuk do të ketë asnjëherë mundësinë dhe të drejtën për të kundërshtuar apo për ta ndryshuar këtë qeveri.

Në këtë sistem qeveritar do të kemi elitën e vendit që përbëhet nga liderët e partisë në pushtet dhe një numër i vogël njerëzish që janë komunistët, anëtarët e partisë komuniste. Natyrisht kjo pakicë ka pushtetin dhe

vendos për shumicën. Me fjalë të tjera në qoftë se shumica do të ishin të lumtur që ishin të skllavëruar nga kjo pakicë, shtetëzimi i industrive ndoshta do të punonte në këtë vend, por do të ishte e pamundur për ta, t'i kishin të dyja, prosperitetin dhe shtetëzimin e industrive.

Shtetëzimi i industrive ndoshta do të bëhej i mundur në një shtet jokomunist, në qoftë se të gjithë punëtorët do të ishin të kënaqur me faktin se pagat do të ishin të ulëta, se ata nuk mund të shkonin në greva, nuk mund t'i ndryshonin vendet e punës nën një liri të plotë, nuk mund të ballafaqonin punëdhënësit në tyre (në këtë rast do të ishte vetë qeveria) nuk mund të ishin ekstravagant, nuk mund të blinin prodhime që nuk ishin të nevojshme si TV, makina, motoçikleta etj., nuk mund të përkrahnin dhe të futeshin në radhët e asnjë partie tjetër përveç partisë në pushtet e kështu me radhë.

Në qoftë se një sistem i tillë do të mbahej në Malajzi, punëtorët duhet të kënaqeshin me faktin e pagave të ulëta, mosshkuarjen në greva dhe mospërfshirjen në asnjë lloj aktiviteti që është i dëmshëm për qeverinë. Në politikë do të lejoheshte vetëm një parti, e cila do të fitonte në zgjedhje me një fitore votash prej 99% . Vetëm liderët e partisë në pushtet do të gëzonin influencë dhe të mira. Pasuria e fituar nga djersa e popullit do të merrej nga qeveria dhe të bënte me të çfarë dëshironte, ku shumica e saj do të shkonte për forcimin e sektorëve që siguronin pushtetin e kësaj qeverie. Pra në fjalë të tjera në qoftë se Malajzia do të dëshironte të shtetëzonte të gjitha industritë, sistemi i saj politik do të ndryshonte në një sistem diktatorial.

Pra, pa pasur një diktaturë apo një sistem komunist, shtetëzimi i industrive dhe pikërisht në Malajzi do të sillte një shkatërrim të plotë të ekonomisë. Shkaku do të ishte shumë i thjeshtë, lënda e drurit, e kauçukut dhe e

kallajit nuk janë po aq të rëndësishme, sa nafta. Dhe në qoftë se çmimi në botë i këtyre produkteve do të binte, ashtu siç ndodh ndonjëherë, këto industri janë të destinuara të vuajnë pasoja humbjeje. Akoma më tej në qoftë se prodhimi i produkteve do të ullej dhe çmimet do të ishin të pavolitshme, vendet konsumuese (që janë të gjitha vendet komuniste) do të përdornin materiale zëvendësuese dhe kështu që çmimet do të duhet të ulen akoma më shumë, dhe në çfarëdo mënyre ekonomia e Malajzisë do të ishte ajo që do t'i vuante pasojat.

Industritë e tjera ose ato të dyta, që të zhvillohen u duhet mundësia teknike. Elektronika, makineritë, tekstilet dhe prodhime të ndryshme të manifakturuara, nuk janë të disenjura në Malajzi, kështu që mundësia teknike nga vendet e tjera dhe sidomos nga vendet kapitaliste është e nevojshme. Kjo mundësi teknike mund të blihet megjithëse çmimet janë të larta, por metodat, sistemet dhe disenjet do të ndryshojnë me modernizimin e shpeshtë dhe kështu që kjo mundësi teknike do të jetë e papërdorshme, në qoftë se nuk është ajo më modernia. Prandaj edhe në industritë e shtetëzuara kanë nevojë të vazhdueshme, të rriten në kapital në qoftë se do të jetë e suksesshme. Por kjo është shumë e vështirë pasi siç e shpjeguar dhe e demonstruar edhe më lart një industri e shtetëzuar nuk mund të bëjë profite të mëdha.

Në Malajzi mund të themi se disa prej bizneseve apo koncerneve komerciale janë industrializuar, si hekurudhat, elektriku, MAS (Kompania Ajrore e Malajzisë), PERNAS, PETRONAS, industri të tjera që janë nën Korporatat e Zhvillimit Ekonomik të Shtetit si MARA, FIMA, FAMA, FELDA etj. Disa prej këtyre bizneseve të shteteve të tjera të Federatës, kanë një kapital të mjaftueshëm dhe këto lloj industrish jo vetëm që janë mjaft të zhvilluara, por nganjëherë krijojnë dhe monopole.

Megjithatë shumë rrallë ne dëgjojmë për profitet e tyre të mëdha dhe për të ardhurat e marra nga taksat. Por ajo që ne e dimë është se hekurudhat, industria e konservimit të ananasit, dhe disa prej industrive të tjera janë duke pasur humbje prej qindra milionë dollarësh çdo vit. Ne dyshojmë se kjo ndodh për shkak të mungesës se një mendjemprehtësie për biznes në menaxhmentet e këtyre industrive, por çfarëdo qoftë shkak, është një fakt evident se shtetëzimi i tregtisë në Malajzi nuk do të jetë me avantazhe. Në të kundërtën mund të çojë në rënien e ekonomisë në një shkallë të katastrofike.

Por, më së fundi kemi motivimin. Tregtia rritet për shkak të motivit të profitit, ku në një industri të shtetëzuar menaxherët nuk kanë këtë motiv profiti. S'ka rëndësi nëse industria ku ata bëjnë pjesë, do të sjellë profite apo humbje, menaxheret do të marrin të njëjtën të ardhur dhe ata nuk mund ta ndryshojnë këtë gjë, pasi me shtetëzimin kjo është një nga rrugët që socializmi mundohet të vërë barazinë në të ardhurat e punëtorëve. Pra shtetëzimi do të jetë i pakuptimtë në qoftë se menaxherët do të kishin të ardhura më të mëdha se punëtorët e tjerë. Por e gjitha kjo do të ulte iniciativën dhe si rrjedhojë, suksesin në biznes. Por pa një iniciativë të fortë dhe një motivim, biznesi pa dyshim që do të ketë humbje.

Me fjalë të tjera e gjithë kjo tregon se shtetëzimi i industrive, nuk është një çështje e lehtë dhe është shumë e ngjashme të sjellë disavantazhe, megjithatë, kjo nuk do të thotë se e gjithë tabloja e dhënë është 100% e saktë. Ka industri që duhet të nacionalizohen. Sot nafta është komoditet jetik. Dija, kapitali dhe aftësitë menaxhuese mund të fitohen edhe në industritë pjesërisht të shtetëzuara. Të njëjtën gjë mund të themi për telekomunikacionin, elektrikun, hekurudhat, aviacionin, dhe industri të tjera që mund të monopolizohen. Në këto raste pikë-

synimi nuk është marrja e profitit, por interesi kombëtar dhe veçanërisht në kohët e emergjencës apo të gjendjes së jashtëzakonshme dhe në kohë lufte.

Nga pikëpamja praktike, në qoftë se ne do të shtetëzohim këto industri, për shembull menaxhimin e shtetit, import-eksportin, distributorët dhe agjencitë për importet e ndryshme, etj., problemi kryesor është studimi dhe kuptimi i të gjitha fushave të këtij biznesi në veçanti. Zakonisht këtu do të kemi shkurtim të zyrtarëve në qeverisje, por gjithmonë do të kemi një “ngushtim” të zyrtarëve në trupat ekzekutive dhe kjo ndodh për arsyen se nuk është e lehtë të mbushësh postet e rëndësishme në një industri të shtetëzuar. Por, megjithëse këto poste do të arrijnë të mbushen përsëri, sukcesi nuk mund të garantohet. Dhe në qoftë se trupi ekzekutiv i kësaj industrie, edhe pse për një kohë të gjatë nuk do të jetë akoma në gjendje të sigurojë profite të mëdha që do të kontribuojnë tek qeveria nëpërmjet pagimit të taksave, është e pamundur të thuhet se profitet nga industritë e tjera mund të arrihen nga shtetëzimi dhe sidomos kur këto industri kanë vështirësi në menaxhim. Dhe nga eksperiencia është treguar se zakonisht tregtia, për të cilën bëhet fjalë, do të jetë gjithmonë në rënie dhe humbje të vazhdueshme.

Nocioni i një grupi njerëzish në shoqëri mbi shtetëzimin është marrja e pasurisë apo e industrisë pa dhënë asnjë kompensim tek pronarët. Kjo mund të themi se është vetëm një iluzion, sepse në qoftë se nuk do të paguanin kompensimet, atëherë kompanitë e huaja mund të vendosnin sanksione mbi qeverinë nëpërmjet qeverive në vendet e tyre në lidhjet tregtare. Dhe si rrjedhojë kjo mund të dëmtojë tregtinë në fjalë, në veçanti në qoftë se kjo do të ishte një komoditet primar që mund të zëvendësohej dhe të mos ishte i një rëndësie të veçantë.

Çdo vit, Qeveria Malajziane duhet të paguajë rreth 5-6 miliardë dollarë për administratën dhe zhvillimin, dhe shumica e këtyre parave vijnë nga të ardhurat e marra nga taksat e industrive të ndryshme. Eventualisht, në qoftë të se të gjitha këto biznese dhe industri do të ishin të shtetëzuara dhe do të ishin në humbje, jo vetëm që qeveria nuk do të ishte në gjendje të mbahej nga buxheti i saj normal, por gjithashtu nuk do të kishte as të ardhura të mjaftueshme për të paguar kompensimet dhe çfarë do takse e marrë duhej të përdorej për të ndaluar rënien apo humbjet e industrive të shtetëzuara.

Dhe në këto situata në qoftë se punëtorët do të kërkojnë paga më të larta, dhe do të shkojnë në greva kur kërkesat e tyre nuk do të plotësohen, problemi do të komplikohet edhe më shumë për qeverinë. Kështu që në disa industri të shtetëzuara si hekurudhat, MAS (Agjencia Ajrore Malajziane) dhe Bordi Elektrik Kombëtar etj., ballafaqohen në mënyrë të vazhdueshme me grevat e punëtorëve të tyre. Humbjet e një industrie nuk i kanë penguar asnjëherë punëtorët nga kërkesat e tyre për paga më të larta apo nga shkuarja në greva.

Megjithatë këto probleme janë hasur nga të gjitha vendet demokratike që janë inkuadruar në shtetëzimin e tregtisë dhe industrive. Por konsekuencat e këtyre akteve emocionale dhe popullore mund të vihen re, vetëm nga ata që duan dhe që kujdesen për to. Kemi edhe nga ata që mendojnë dhe ndiejnë se ne duhet të jemi të përgatitur për t'u ballafaquar me rënien ekonomike, për hir të "drejtësisë" dhe kënaqësisë. Por si mund të arrihet kjo kënaqësi kur një vend që vepron kështu si mendojnë ata, pa emocione, në fund është i detyruar të dërgojë kryeministrin çdo vit jashtë shtetit të kërkojë ndihmë nga vendet që praktikojnë kapitalizmin dhe tregtinë e lirë.

Kjo është vështirësia e të gjitha vendeve në zhvillim që me aq krenari e bujë shtetëzojnë bizneset dhe industritë e huaja menjëherë me arritjen e pavarësisë. Kështu që këto vende që dikur ishin kaq krenare për socializmin dhe shtetëzimet e tyre, sot mund të jenë krenare vetëm për ndërtesat e ngritura me ndihmat e vendeve të tjera. Pa pasur lëmoshën apo bamirësinë e fuqive të huaja të interesuara mbi këto vende, vetë këto vende nuk kanë asgjë për të treguar nga sukseset e tyre qysh pas marrjes përsipër të industrive të huaja.

Por rreziku më i madh qëndron se ekonomia e shkatërruar do të sjellë një varfëri dhe vuajte tek shumica e popullit dhe në këtë atmosferë është shumë e lehtë për këdo të korruptojë popullin dhe të shkaktojë çrregullime. Pa dyshim që komunistët do ta kishin më të lehtë për ta marrë kontrollin, dhe nuk ka rëndësi nëse ata do të kenë sukses apo jo, populli dhe vendi do të kalojnë një kohë të vështirë dhe të rëndë. Për shumicën, jo vetëm që ata do të dështojnë në përpjekjet për të arritur barazinë në standardin e jetesës, por siguria e tyre do të kërcënohet dhe ata do të jenë të shtypur nga vetë liderët e tyre.

Kjo analizë është bërë mbi vetë qëllimet se shumë herë janë bërë thirrje që kanë pasur edhe përkrahjen e publikut për një shtetëzim të industrive të huaja në vend. Emocionet e këtyre thirrjeve shumë lehtë mund të sipërmarrin konsideratën e arsyeshme mbi këtë çështje, por përpara se populli i Malajzisë t'u përgjigjet këtyre thirrjeve, kur ekonomia të jetë e fortë duke e krahasuar këtë me ekonomitë e vendeve me market jo të lirë, populli duhet së pari të kuptojë ndërlikimet dhe konsekuencat që mund të sjellë shtetëzimi i këtyre industrive.

Kapitulli XI

Organizimi dhe disiplina

Nga shekulli XV kur Vasko de Gama lundroi në Lindjen e Largët dhe deri në fillim të shekullit XX, historia e Azisë është e mbushur plot me pushtime dhe marrje tokash e territoresh nga vendet perëndimore. Pothuajse të gjitha vendet aziatike kanë pasur eksperiencën e pushtimeve dhe kolonializimeve, me përjashtim të Tailandës, Kinës dhe Japonisë. Por megjithatë edhe këto vende kanë qenë në disa kohë të përulura përpara fuqive perëndimore.

Mëse e vërtetë se në këto shekuj imperialistët perëndimorë me pushtimet e tyre u shpërndanë kudo në botë, përfshirë këtu edhe Afrikën dhe Amerikën e Veriut e Jugut, por diçka duhet e kemi parasysh se Afrika dhe Amerika e asaj kohe ishin të banuara vetëm nga fise primitive (me përjashtim këtu vetëm të Fisit të Inkave) kurse popullsia e Azisë kishte një kulturë të njohur dhe një civilizim më të hershëm se vetë civilizimi evropian, gjithashtu aziatikët ishin më shumë në numër dhe banonin në territore më të mëdha.

Dhe më e çuditshmja se forcat perëndimore që pushtuan vendet aziatike ishin shumë më të vogla në numër po ti krahasonin me forcat aziatike. Efektshmëria dhe suksesi i forcave perëndimore ndoshta ka qenë edhe si rezultat i armëve më të mira të përdorura nga ana e tyre, por megjithatë, nga studimet e bëra do të tregojnë

se faktor më i rëndësishëm për fitoret e tyre ishin organizimi dhe disiplina.

Nga sa mësohet prej historisë edhe midis forcave Lindore duhet të ketë pasur njëfarë organizimi, megjithatë ky organizim duhet të ketë qenë më pak sistematik dhe konsistent në krahasim me atë organizim që mbizotëronte në forcat perëndimore. Për shembull në ushtrinë që mbrojti Malakën kundër pushtimit portugez, megjithëse kjo ushtri kishte një gjeneral, midis ushtarëve dhe gjeneralit nuk kishte asnjë lloj komande. Ushtritë aziatike kishin vetëm gjeneralë, nuk kishin as kapitenë, togerë apo rreshterë që të siguronin se të gjitha komandat e dhëna arrinin në rangje dhe në fushën e betejës sa më me efektshmëri.

Komandat direkte nga gjenerali tek ushtarët mund të funksionojnë kur kemi një ushtri të vogël, por në rastet e armatave të mëdha, komandat nuk mund të shkojnë në rangje dhe në fushëbetejë me efektshmëri dhe në kohën e kërkuar. Edhe sistemi i komunikimit midis batalioneve nuk ishte i ndonjë niveli të dëshiruar, duke bërë kështu të vështirë ose nganjëherë të pamundur komunikimin e veprimeve të duhura. Një armatë e madhe është mëse e qartë se nuk mund të jetë efektive pa një sistem koordinimi të mirë midis batalioneve.

Pra megjithëse ushtritë kishin oficerë të rangjeve të ndryshme, postet e tyre, titujt dhe përgjegjësitë nuk ishin asnjëherë të qarta apo të qëndrueshme. Postet e rangjet e oficerëve ndryshonin nga vendi në vend. Qeveria e Malakës në kohën e pushtimit nga Portugalia, nuk kishte asnjë person të emëruar si gjeneral. Sulltani, Kryeministri (the Bendahara) dhe Ministri i Punëve të Brendshme apo Shefi i policisë (Temenggong), të gjithë këta kishin pushtet mbi ushtrinë. Dhe jo vetëm kaq, por disa prej djemve të Sulltanit gjithashtu kishin të drejtën të koman-

donin forcat e ushtrisë, megjithëse nuk diheshin qartë postet e tyre.

Gjithashtu ushtria nuk kishte ushtarë të rregullt. Shumica e tyre ishin njerëz të thjeshtë që komandohe-
shin dhe thirreshin nga sundimtari i vendit nga koha në
kohë kur ishte e nevojshme për të mbrojtur vendin.
Kështu që këta të ashtuquajtur ushtarë nuk kishin ndo-
një stërvitje të mirë ushtarake, dhe nuk kishin as idenë
më të vogël rreth pozicioneve që kishin në ushtri. Ata
nuk kishin as uniforma të rregullta ushtarake dhe lufta
që bënë ishte njëloj sikur luftonin në duele.

Nga tregimet e betejave të atyre ditëve, ushtria ishte
më shumë e udhëhequr nga shembujt, sesa nga koman-
dat. Kur gjenerali ishte i pari që nisej për të luftuar të
gjithë do të ndiqnin shembullin e tij, kur ai dorëzohej
edhe ushtarët do të bënin të njëjtën gjë. Pra me këtë më-
nyrë luftimi vdekja e gjeneralit do të thoshte humbje e
betejës, megjithëse ushtria e tij mund të ishte më e
madhe në numër dhe mund të ishte në gjendje të vazh-
donte betejën.

Në Bali (Tailandë) për shembull, vdekja e Mbretit
gjatë luftimit me forcat holandeze, u ndoq me vetëvras-
jen e shumë prej ushtareve të tij, megjithëse ata ishin në
gjendje të shkëlqyer për të vazhduar këtë betejë dhe ku-
rajoja e tyre mund të themi i kalonte kufijtë.

Në kontrast me sa pamë më lart, forcat perëndimo-
re që pushtuan vendet e Lindjes, edhe pse të vogla në
numër, ishin mjaft mirë të organizuara. Normalisht, në
ushtritë perëndimore, repartet e vogla nën komandat e
oficerëve të thjeshtë formonin reparte më të mëdha dhe
këto nën komandat e oficerëve më me përvojë. Dhe së
fundi të gjithë gjeneralët dhe të gjitha repartet nën ko-
mandat e tyre, ishin nën një administratë militare, e cila
siguronte koordinimin e lëvizjeve për luftë, gjithashtu

koordinonte dhe planifikonte strategjinë e luftimit prej rezultateve të sjella nga fushëbeteja prej inteligjencës ushtarake të ngarkuara me këto detyra.

Në forcat perëndimore, pozitat dhe titujt ishin të gjitha fikse dhe sipas kësaj u vinin detyrat dhe përgjegjësitë që kishin. Gjithashtu i gjithë personeli ushtarak ishin në kohë të përhershme dhe ushtria nuk bazohej nga puna e tyre sezonale, apo gatishmëria e tyre e përkohshme. Ushtarët gjithashtu ishin të stërvitur dhe të trajnuar të vepronin në grupe dhe jo në mënyrë individuale. Metodrat dhe teknikat e luftimit ishin të organizuara dhe stërvitja e tyre ishte e detyrueshme për të gjitha nivelet. Pra ishte ky rregull dhe ky organizim që solli fitoren e forcave të vogla perëndimore. Me fjalë të tjera organizimi ka luajtur një rol efektiv në suksesin e forcave ushtarake perëndimore.

Përveç organizimit të mirë, forcat perëndimore kishin dhe një disiplinë strikte. Rangjet dhe pozitat ishin fikse dhe kjo për të siguruar se çdokush e dinte detyrën e tij dhe secili duhet ti bindej komandës së eprorëve të vet.

Gjithashtu ushtarët nuk pritnin të ndiqnin shembujt e eprorëve, por detyra e tij ishte t'u bindeshin komandave të eprorit. Çështja e trimërisë së liderëve në fushëbetejë nuk sillej si shembull. Eprorët duhet të qëndronin në vende më të sigurta për arsye të vazhdimit të dhënies së komandave në mënyrë që ta bënin betejën më efektive, por vdekja e tij nuk do të thoshte humbje për forcat, zëvendësi i tij do të merrte menjëherë komandën dhe do të vazhdonin betejën. Gjithashtu disiplina në ushtritë perëndimore garantonte se jo gjithkush kishte të drejtën për të marrë vendin e eprorit të vvarë.

Pra pa dyshim se disiplina kishte rolin më efektiv në fitoret e forcave perëndimore. Në betejën e Brigada e Dritës, ku forcat e vogla të Britanisë u ndeshem me një

numër të madh të artilerisë ruse, komanda për britanezët u dha të hidheshin në një sulm të avancuar. Megjithëse kjo do të thoshte vdekje për shumicën e tyre, ata iu bindën urdhrat të dhënë, edhe pse shumë prej tyre u vranë dhe forca britanike u mund. Shembulli i tyre ishte heroik dhe i tregoi armiqve të Britanisë, që të mos mendonin dhe shpresonin për një fitore të lehtë me forcat britanike, edhe pse të vogla në numër qofshin ato. Roli i disiplinës në pushtimet e suksesshme të vendeve aziatike nga forcat perëndimore ishte i padiskutueshëm, por gjithashtu organizimi i mirë dhe lëvizjet e mprehta ushtarake arritën mposhtjen e forcave të mëdha aziatike. Sjelljet e padëshiruara shiheshin shumë rrallë në radhët e forcave perëndimore. Këto forca ishin si një makinë luftime, kurse forcat aziatike luftonin të shpërndara dhe në mënyrë individuale, pa një koordinim apo një sistem organizimi. Ndër forcat perëndimore urdhrat dhe komandat e dhëna dëgjoheshin dhe zbatoheshin në mënyrë të përpiktë, ndërsa në forcat aziatike, nuk kishte as një sistem të rregullt të dhënies së komandave, dhe urdhrat dhe komandat nuk zbatoheshin me efektshmëri dhe shumë herë nuk përfillehin.

Mësimi i sjellë nga Perëndimi për malajzianët në veçanti dhe për aziatikët në përgjithësi është se, organizimi dhe disiplina janë shumë të rëndësishme dhe efektive në çfarëdo lloj sipërmarrje. Organizimi dhe disiplina mund t'i japin fuqi edhe një të dobëti apo një të vogëli. Mirëpo, roli i organizimit dhe disiplinës nuk mund të kufizohet vetëm tek forcat ushtarake apo në luftë, megjithëse në këto fusha kanë luajtur rolin më vital, gjithashtu ato janë shumë të rëndësishme në fushat e tjera të jetës dhe mund të garantojnë suksese.

Vendi i parë që e ka parë dhe e ka analizuar organizimin dhe disiplinën si baza e suksesit ka qenë Japonia.

Edhe pse është e vërtetë se japonezët kishin baza të disiplinës përpara se ata të binin në kontaktet të para me Perëndimin, prapë disiplina e tyre kishte mangësira të sistemit dhe organizimit efektiv. Krahas bazave që ata kishin në disiplinë ata asimiluan me përpikëri organizimin dhe disiplinën perëndimore në të gjitha aspektet e jetës. Në një kohë shumë të shkurtër, suktesi i stilit perëndimor të organizimit dhe disiplinës bënë që Japonia të bëhet një nga fuqitë e njohura botërore. Duke marrë parasysh se Japonia nuk ka burime natyrore të cilat të ndihmojnë procesin e modernizimit, organizimi dhe disiplina luajtën një rol të rëndësishëm në zhvillimin e vendit. Kaq shumë efektive ishin sistemi dhe disiplina perëndimore sa që mangësia në burimet natyrore nuk solli asnjë pengesë për zhvillimin e shpejtë të vendit.

Gjithashtu ja vlen të përmendim se përpjekjet e vendeve aziatike për të fituar pavarësinë nga kolonializmi perëndimor, ia detyrojnë suksesin e tyre falë organizimit dhe disiplinës. Në Indi, Gandi, organizoi Partinë e Kongresit e në sajë të vijës së mësimëve të marra nga Perëndimi dhe sepse pjesëtarët ishin të gjithë të gatshëm për t'iu bindur direktivave, d.m.th. ishin të gjithë të gatshëm të pranonin disiplinën e partisë, edhe pse të paarmatosur nëpërmjet bojkotimeve joviolente në masë, Gandi arriti sukses në dobësimin e administratës indo-britanike. Fuqia ushtarake, mundësia administrative dhe pasuria nuk mundën të ndesheshin me disiplinën dhe lëvizjet sistematike joviolente të udhëhequra nga vetë Gandi.

Për sa i përket shteteve të gadishullit të Malajzisë, malajzianët fituan në luftërat kundër Unionit Malajas dhe në përpjekjet e tyre për pavarësi sepse ata ishin të gatshëm të bashkoheshin nën një organizim politik dhe gjithashtu, ishin plotësisht të gatshëm të zbatonin urdhrat dhe direktivat e dhëna nga vetë liderët. Aktualisht,

UMNO ose Organizata Kombëtare e Malajzianëve të Bashkuar që u ngrit me synimin për të kundërshtuar Unionin Malajzian, kishte mungesa të mëdha fondesh, mungesa për liderë të shkolluar dhe mungesa në shumë aspekte të tjera. Por, megjithatë anëtarët të gjithë ishin më të organizuar se në të kaluarën dhe ishin të gjithë të gatshëm për t'iu bindur direktivave të dhëna dhe kjo bëri që qeveria britaneze që funksiononte në vend nuk mundi të kundërshtonte asnjë gjë prej kërkesave të parashtruara nga UMNO.

Fakti që malajzianët patën sukses në çlirimin e vendit nga zinxhirët e kolonializmit, nuk do të thotë se ata nuk kanë më nevojë të praktikojnë organizimin dhe disiplinën që ata fituan nga përvoja, sepse malajzianët akoma përbëjnë një komunitet të vogël dhe shumë të prapambetur në vendin e tyre.

Meqenëse organizimi dhe disiplina mund të japin fuqi edhe tek i dobëti, është me shumë rëndësi që malajzianët të vazhdojnë të praktikojnë këto virtyte të mira dhe jo vetëm në politikë, por edhe në fusha të tjera si edukim, biznes, etj., ku malajzianët janë akoma të pafuqishëm.

Për shembull në tregti apo në biznesin modern, organizimi është shumë i rëndësishëm. Këtu përfshihen jo vetëm organizimi i zyrtarëve dhe punëtorëve, por edhe organizimi i detyrave, kështu që çdo gjë duhet do të shkojë sipas planifikimit dhe njohurive të biznesmenit që është në fuqi. Organizimi i detyrave të nevojshme është po aq i rëndësishëm për një tregtar që hyn i vetëm në biznes sa edhe për një kompani të madhe. Alokimi apo ndarja e përgjegjësive midis personelit është një tjetër pjesë e rëndësishme e organizimit të biznesit. Pa këtë organizim, biznesi do të varej vetëm tek marramendjet apo iluzionet dhe humbjet do të ndodhin pa u kuptuar.

E një rëndësie të njëjtë mund të themi se është edhe disiplina në një biznes, edhe pse mund të jetë biznes i zotëruar nga një person. Një tregtar që e mbyll dyqanin e tij sipas dëshirave dhe qejfeve të tij shumë shpejt do t'i humbë klientët. Kurse në një biznes që përdor punëtorët me pagë, në qoftë se punëtori nuk dëshiron t'u bindet urdhrave dhe direktivave të dhëna kjo do të sjellë dështimin e këtij biznesi. Një restorant varet shumë nga shërbimi i mirë që bëhet, dhe në qoftë se kamarierët nuk do të kryejnë detyrat e tyre sipas udhëzimeve të dhëna, klientët nuk do të vijnë për herë të dytë në të njëjtin restorant, megjithëse ushqimi mund të jetë i cilësisë së mirë dhe i gatuar në mënyrë të shkëlqyer. Me mijëra janë shembujt që mund të marrim për të provuar rëndësinë e disiplinës në biznes. Dhe nuk do të ishte as ekzagjerim po të themi se dështimi i malajzianëve në biznes, është si rezultat i mungesës së disiplinës nga ana e biznesmenit dhe punëtorëve të tij.

Roli i disiplinës dhe i organizimit në fushën e edukimit mendoj se nuk ka nevojë të diskutohet. Por megjithëse organizimi dhe disiplina në përgjithësi janë shumë të mira, në raste të veçanta, mund të çojë në shkatërrimin e atyre që e praktikojnë. Kështu që kur njerëzit sillen së bashku në një organizim të fortë dhe me një praktikë strikte të disiplinës, udhëheqja e gabuar do të jetë shumë fatale për ta.

Disiplina dhe organizimi në Gjermani nën sundimin hitlerian dhe në Japoni nën regjimin militaritar të Tojos, janë shembuj mjaft të qartë të konsekuencave të tmerrshme për shkak të udhëheqjes së gabuar. Disiplina rigoroze e bën të pamundur kundërshtimin e liderëve edhe kështu e bën të vështirë dallimin e gabimeve të bëra.

Kur Hitleri bëri ristrukturimin e Gjermanisë pas humbjes në Luftën e Parë Botërore, shumica e gjërma-

nëve nuk e hodhën poshtë faktin se masat e marra dhe metodat ishin shumë të suksesshme dhe bënë që shumë shpejt Gjermania të rimëkëmbej nga ana e pasurisë dhe fuqisë. Brengosja e gjermanëve mbi humbjet e tyre në Luftën e Parë Botërore, u zëvendësua me një shpirt pozitiv dhe me një konfidencë në vetvete. Kështu që ata ishin plotësisht të gatshëm dhe të përgatitur të pranonin pushtetin e Hitlerit me disiplinën e tij strikte dhe e përkrahën atë në skemën për pushtimin dhe dominimin e të gjithë botës. Kurse ata që kishin dyshime nuk guxonin të ngrinin zërin, por edhe pse disa prej tyre guxuan ata ishin vetëm një pakicë. Kritikkat e tyre edhe pse ishin të pavlera dhe të pafuqishme, ndoshta sollën dënimin mbi kokat e tyre për thyerje të disiplinës.

Kur Lufta e Dytë Botërore filloi me një agresion të suksesshëm nga makina e luftës gjermane Wehrmacht, asnjë gjerman, asnjë anëtar apo lider i Partisë Naziste nuk mund të thonin se Hitleri e kishte keqpërdorur organizmin dhe disiplinën gjermane. Hitleri personalisht e drejtoi vetë luftën megjithëse ai nuk ishte ndonjë gjeneral i stërvitur. Por, disiplina që ai asnjëherë nuk e kundërshtoi, bëri të arrinte disa suksese, megjithëse historia na tregon se taktikat e luftës dhe strategjia e ndjekur nga Hitleri e çuan Gjermaninë në humbje.

Pra me kalimin e kohës u bë mjaft e qartë në popull se udhëheqja e Hitlerit do ta çonte Gjermaninë në humbje dhe shkatërrim. Megjithatë akoma disiplina i ndalonte ata persona që ishin të ndërgjegjshëm nga faktet të sillnin mendime kundërshtuese tek Hitleri. Vetëm atëherë kur humbja e ballafaqoi më së miri Gjermaninë, disiplina u thye dhe Hitleri u dënua dhe u kundërshtua edhe nga ndjekësit e tij më besnikë. Por atëherë ishte shumë vonë për ta të shpëtonin Gjermaninë. Miliona

ishin gjermanët që kishin pësuar vdekje apo vuanin plagosjet dhe gjendja e tyre ishte shumë e tmerrshme.

Kjo tregon se si disiplina dhe organizimi mund të sjellin rënien e një grupi të veçantë. Por askush nuk mund të shkojë pas këtij shembulli, pasi shumica e evidencave dhe fakteve tregojnë se disiplina dhe organizimi janë shumë të dobishme. Pra një rast i veçantë nuk mund të provojë apo të kundërshtojë një ligj. Një rast i veçantë nuk mund ta bëjë të pavlefshëm principin, edhe pse disiplina i solli gjermanët në atë degradim, ata prapë nuk e hedhin poshtë këtë virtyt. Ata e përdorën disiplinën përsëri më pas për të rindërtuar vendin, edhe pse më vonë i ndarë në dy pjesë, Gjermania Perëndimore arriti suksese të mëdha, duke bërë kështu të mundur të fitonin mbi vendet si Britania, e cila edhe pse fitoi Luftën e Dytë Botërore, tani është e njohur si vendi që e ka humbur disiplinën që kishte në kohën kur korrën fitoret e lavdishme.

Nga disiplina dhe organizimi nuk do të ketë asnjëherë të këqija, përkundrazi të mirat do të jenë më të mëdha. Të hedhësh poshtë apo të lësh pas dore disiplinën dhe organizimin, do të thotë të pengosh suksesin. Ti adoptosh ato nuk do të garantohet një sukses i plotë, por të paktën sukcesi nuk do të pengohet dhe shanset janë më të mëdha, se do të fitosh diçka.

Deri tani ne e kemi parë organizimin dhe disiplinën nga pikëpamja botërore. Vallë a janë besimi dhe shpirtërorja të lidhura me organizimin dhe disiplinën? Përgjigja mendoj se është e thjeshtë. Propagandimi i suksesshëm i Islamit nëpër botë i ka bazat në organizimin dhe disiplinën e shoqërisë islame duke e krahasuar me shoqëritë e prapambetura të periudhës së xhahilijetit (injurancës), dhe mbi gatishmërinë e muslimanëve për t'u inkuadruar me organizimin dhe disiplinën. Ritualet e adhurimit apo ibadeti, në Islam janë shumë mirë të organizuara. Në të

vërtetë mund të themi se nuk ka asgjë më të organizuar dhe më të disiplinuar se ritualet në Islam. Në kryerjen e faljes dhe në veçanti të faljes së xhumasë, miliona malajzianë, ashtu sikurse edhe vëllezërit e tjerë muslimanë nëpër botë, kthehen me fytyrë nga Meka, nga Shtëpia e Zotit, dhe të gjithë ndjekin udhëzimet e dhëna nga Profeti pothuajse 1400 vjet më parë.

Ritualet e adhurimit janë një manifestim fizik i organizimit dhe disiplinës në fenë islame. Por më shumë se në besimet e tjera fetare, feja islame siguron se të gjitha aspektet e jetës janë të organizuara në mënyra të disiplinuar me ligje dhe rregulla të veçanta. Por ligjet dhe rregullat fetare, ashtu sikurse dhe ligjet dhe rregullat e tjera, janë efektive dhe të kuptimta, vetëm kur besimtarët apo shoqëria që është e interesuar për to, u bindet të gjitha këtyre ligjeve dhe rregullave me përpikëri. Kjo do të thotë se organizimi dhe disiplina janë shumë vitale në esencën e fesë islame, si një fe e vërtetë.

Mund të marrim një shembull për të treguar konsekuencat tek muslimanët kur këto ligje dhe rregulla janë lënë pas dore apo janë mospërfillur. Në betejën e Uhudit, shigjetarët që ishin në vijën e parë të frontit i ndoqën me bindje vetëm një pjesë nga komandat e dhëna nga Profeti. Kur armiku mendohej se kishte humbur, ushtarët i lanë menjëherë pozicionet e tyre dhe u lëshuan për të marrë dhe ndarë pre të luftës. Në të vërtetë pjesa tjetër e armiqve të fshehur u ranë nga pas dhe si rezultat i disorganizimit forcat muslimane patën humbje të shumta, duke përfshirë këtu edhe humbjen e strategut të madh Hamzait.

Kjo ishte vetëm një konsekuencë nga mungesa e disiplinës në historinë e mbrojtjes së fesë islame. E njëjta gjë ndodhi edhe në Betejën e Hunejnit, ku ushtria e fortë dhe e madhe muslimane shkaktoi humbje të mëdha tek armata

e armikut si rezultat i mungesës se organizimit dhe disiplinës së tyre, në marshimin për në Luginën e Hunejnit.

Të dy shembujt e dhënë, negativë dhe pozitivë, besoj se janë të mjaftueshëm të tregojnë rëndësinë e madhe që feja islame i jep organizimit dhe disiplinës. Në të vërtetë asnjë ritual adhurimi dhe asnjë rregull fetar nuk do të ishin të kuptimta në fenë islame po të mos kishin këtë organizim dhe disiplinë.

Njeriu zakonisht jeton në shoqëri. Dhe shoqëria njerëzore, nuk do të mund të ekzistojë pa një organizim dhe disiplinë. Nuk ka rëndësi sa primitive është një shoqëri, ata përsëri do të kenë ndarjen midis liderëve dhe njerëzve të thjeshtë, por sa më i madh dhe i lartë të jetë civilizimi, më kompleks duhet të jetë edhe organizimi në shoqëri. Mbijetesa e çdo shoqërie i detyrohet organizimit të kësaj shoqërie dhe gatishmërisë së pjesëtarëve të kësaj shoqërie për t'iu bindur, urdhrave dhe komandave të vëna nga kjo shoqëri. Me fjalë të tjera siguria e një shoqërie i detyrohet organizimit dhe disiplinës të vet kësaj shoqërie.

Disiplinë në këtë kontekst do të thotë kufizim i dëshirave dhe interesave të individit dhe dhënies prioritet interesave të shoqërisë. Interpretimet se çfarë do të thotë interes i individit, dhe interes i shoqërisë mund të ndryshojnë nga një shoqëri në tjetrën. Por çfarë do interpretimi apo vlerësimi mund t'i jepet, qëllimi i qëndrimit "kufizim të interesave të individit" do të thotë edhe ruajtje e shoqërisë.

Për çdo anëtar të shoqërisë, kufizimet e vendosura tek ai si një individ, ndoshta për një kohë të shkurtër do të thotë një pengim, por siguria shoqërore e arritur do të sjellë pa dyshim më shumë përfitim tek ky si individ.

Kjo mund të argumentohet me llojin e shoqërisë që u krijua në ditët e para të perëndimit të egër në Amerikë.

Një shoqëri anarkiste, ku sundonte “ligji i ekzekutimit”, “ligji i turmës” dhe i vrasjes. Kushdo i akuzuar për vrasje i jepej një gjykim i rreptë nga komuniteti dhe më pas do të varej nga vetë njerëzit që e kishin gjykuar. Në qoftë se personi e kishte kryer aktin e vrasjes gjykimi mund të ishte me vend, por kishte shumë raste kur akuzime të rreme me motive xhelozie apo mbi motive të tjera bëheshin mbi njerëz të pafajshëm, dhe kur organizimi në gjykimin e personit mungonte pa dyshim kishim edhe raste të dhimbshme të vdekjeve të njerëzve të pafajshëm.

Në një shoqëri të organizuar, edhe pse një i pafajshëm mund të akuzohet në akuzë të rreme dhe të merret nga policia, rregulli i procesit gjyqësor do të sigurojë lirinë dhe pafajësinë e tij për të mos rënë viktimë e sistemit. Pikat e kësaj çështjeje janë se, megjithëse formimi i një rregulli social ndoshta në fillim do të duket si shtypje, më së fundi anëtarët e shoqërisë do të jenë ata që do të përfitojnë më shumë nga ky rregull. Pa këtë rregull social, do të ishte shumë e vështirë të kontrolloheshin vrasjet dhe krimet e ndryshme në shoqëri.

Koncepti i një shoqërie të organizuar dhe të disiplinuar, kundërshtohet vetëm nga anarkistët, të cilët përdorin qëndrimin se njerëzimi nuk duhet të kontrollohet nga asnjë lloj organizimi apo discipline sociale. Teoritë e sjella nga anarkistët si Proudhon, Bakunin, dhe Kropotkin, janë se konshienca e njeriut do të sigurojë vetë paqën dhe qetësinë në shoqërinë njerëzore, prandaj qeveria (apo administrata) nuk janë të rëndësishme, shoqëria njerëzore do të ndahet vetë në grupe të vogla, të cilat do të funksionojnë pa pasur nevojë për ndonjë organizim dhe gjithashtu këto grupe nuk do të jenë subjekte të asnjë pushteti qendror. Është me të vërtetë ironike dhe e palogjikshme të mendosh se ata që nuk besojnë në organizimin e shoqërisë, do të organizojnë vetveten në lloje

grupesh më të vegjël për të promovuar kauzën e tyre. Pra ishte kjo lëvizje që i dha shkak ngritjes së sindikatave, lëvizjes punëtore, socializmit dhe së fundi komunizmit.

Por ashtu siç e dimë, kushdo që përpiqet të krijojë një shoqëri anarkiste ka dështuar. Në qoftë se ndonjë shoqëri në botë do të vinte më afër gjendjes së anarkisë është shoqëria britaneze sot. Në Britani, qeveria jo vetëm që është e pafuqishme të kontrollojë grupet anarkiste të punëtorëve, por gjithashtu këto grupe nuk dëgjojnë apo binden as liderëve të tyre. Dhe rezultati i të gjithë kësaj është se shoqëria kërcënohet në mënyrë të vazhdueshme nga pasiguria e furnizimit në të mirat apo shërbimet. Çmimet rriten, transporti tokësor, detar apo ajror, është i pasigurt, shërbimi mjekësor nuk mund të merret nga të gjithë, kemi terrorizma të formave të ndryshme, që shumë lirshëm punojnë në terren pasi asnjë pushtet apo forcë nuk ekziston për të siguruar interesin e shoqërisë si diçka primare.

Teoria anarkiste se një shoqëri pa qeveri dhe pa ligje do të jetë në të mirë të publikut, nuk ka mundur të provohet si një teori e saktë deri tani me këto raste të anarkisë në shoqëritë socialiste. Por në të kundërtën një shoqëri plotësisht në anarki do të jetë më shumë kaotike dhe e kërcënuar nga forma të ndryshme të shtypjes dhe dhunës, ashtu siç ndodh në shoqërinë socialiste angleze.

E parë nga çdo pikëpamje nuk mund ta kundërshtojmë faktin se shoqëria njerëzore ka nevojë për organizim dhe disiplinë. Edhe ata që besojnë në teorinë e anarkisë përsëri kanë një formë organizimi dhe disiplinë, por këtu çështja nuk është nëse duhet të ekzistojë i ashtuquajtur i organizim apo disiplinë. Ata diskutojnë në natyrën dhe limitet që duhet të vendosen këto virtyte, nëse ato duhet të jenë minimale, ashtu siç kërkohet nga vetë anarkistët apo duhet të jenë të ngurta si në një re-

gjim diktatorial. Përgjigja ndoshta qëndron midis këtyre dy ekstremeve. Por diferencat midis këtyre dy ekstremeve janë shumë të mëdha dhe shumë të vështira për t'i verifikuar. Socializëm *a la* Britani ndoshta i parë si i moderuar, por që është shumë afër me anarkinë, dhe sjell me vete të ligat e anarkisë. Komunizëm *a la* Jugosllavi, që ndoshta konsiderohet si i moderuar është shumë afër me diktaturën. Midis këtyre të dyjave hije të ndryshme të modernizimit ekzistojnë, por kurrë elementët e organizimit dhe të disiplinës janë të forta, kjo ndoshta ka tiparet e një diktature dhe në anën tjetër kur organizimi dhe disiplina mungojnë elementet anarkiste e kërcënojnë shoqërinë.

Kjo është dhe dilema e shoqërisë njerëzore kudo në botë. Por meqenëse shoqëria ka nevojë të jetë e organizuar dhe e disiplinuar, është e rëndësishme kuptimi nga ana e shoqërisë se në çfarë bazash do të praktikojnë këtë organizim dhe disiplinë të kërkuar. Në qoftë se çdo anëtar i shoqërisë e kupton rëndësinë dhe rolin e organizimit dhe disiplinës dhe ai luan pjesën e tij në përgjegjësitë që mban, kjo shoqëri do të jetë shumë e qëndrueshme dhe progresive. Por në të kundërtën në qoftë se çdo anëtar apo të gjithë anëtarët e shoqërisë, do të refuzonin të komoditoheshin me organizimin dhe disiplinën dhe do të insistonin të veprojnë jashtë limiteve dhe kufijve të dhëna, çrregullimet dhe zhurma do të jenë të paevitueshme mbi këta individë në veçanti dhe në të vërtetë tek e gjithë shoqëria në tërësi.

Kapitulli XII

Korrupsioni

Asgjë nuk mund të gjykohet si e ligë dhe e ndaluar nga shoqëria pa një shkak, dhe të njëjtën gjë mund të themi edhe për ato gjëra që shoqëria i gjykon si të mira. Këto dy vlera janë vendosur nga shoqëria si rezultat i eksperiencës në vite. Por njeriu si një krijesë e Zotit, me aftësi për të menduar dhe për të kaluar njohuritë nga një gjeneratë në gjeneratën tjetër nuk është e nevojshme të vendosë për çdo gjë sipas eksperiencës së tij. Eksperienca e fituar, e cila trajton mendimet dhe vlerat, jo vetëm që ndahet me shoqërinë ku jetojmë, por gjithashtu kalohet edhe tek gjeneratat që vijnë më pas. Dhe këto vlera zakonisht pranohen dhe asimilohen gjeneratë pas gjenerate si pjesë e traditave apo zakoneve. Por nuk përjashtohet edhe fakti se një gjeneratë e re mund të ngrejë dyshime mbi vlerat e vjetra, e cila mund të rezultojë në krijimin e vlerave të reja.

Koncepti i të mirës dhe të keqes në një grup njerëzor, është midis vlerave që përjetësohen nga një gjeneratë në gjeneratën tjetër si pjesë e traditave dhe zakoneve të grupit. Për shembull, një herë e një kohë arabët i varrosnin të gjalla foshnjat vajza të porsalindura. Kjo nuk ishte zakon i vetëm një gjenerate, por ishte zakon prej gjeneratash të tëra në kohën e xhahilijetit (në kohën paraislamike). Por, sot ky zakon shikohet si diçka e tmerrshme, e pashpirt, mizore që i kalon kufijtë e një qenieje njerëzore dhe shumë e padrejtë. Pra për këtë gjë nuk

është e nevojshme që të mësojmë se çfarë të ndjejmë ndaj këtij akti, pasi është e padiskutueshme që është një akt mizor. Megjithatë, këto ndjenja me koshiencë apo pa koshiencë janë të bazuara në sistemin e vlerave të sotme, të cilat e konsiderojnë si diçka të ligë aktin e vrasjes dhe sidomos vrasjen e një foshnje.

Por në qoftë se ne, do të jetonim në Arabi, në kohën para ardhjes së Islamit, ne gjithashtu do të kryenim këto akte mizore. Ne do të vepronim kështu sepse në atë kohë ky akt nuk konsiderohej si i keq apo mizor nga shoqëria. “Ndjenjat njerëzore” nuk do të na kishin shqetësuar aq shumë, pasi vetë akti i vrasjes së vajzave foshnje në atë kohë nuk konsiderohej si diçka që i kalonte kufijtë e “ndjenjave njerëzore”.

Ne ndoshta mund ta marrim me mend se 1400 vjet më parë njerëzit ishin shumë ndryshe nga njerëzit sot. Kështu që ata mund të kryenin çfarë do lloj akti mizor pa ngurrimin më të vogël. Gjithashtu në Kinë, jo shumë kohë më parë se 100 vjet, nënat i mbysnin vetë foshnjat vajza. Kurse në Indi, ndjekja e traditës “suttee”, i djegies për së gjalli gratë veja pasi u vdisnin burrat, edhe pse kjo traditë apo praktikë ishte e ndaluar prej kohësh akoma vazhdohej të ndiqej në mënyrë të fshehtë nga disa fanatikë të kësaj tradite deri në vitet e fundit. Edhe sot mund të gjejmë praktikimin e të njëjtës traditë në qoftë se policia nuk do të ishin aq vigjilentë për ta mbajtur nën kontroll këtë lëvizje.

Në qoftë se vlerat e një shoqërie do të formoheshin komplet nga vetë kjo shoqëri gjatë kohës që shoqëria ka ekzistuar dhe sipas eksperiencës së kaluar, këto praktika mizore si vrasja e foshnjave, apo djegia e vejushave, për së gjalli, ndoshta nuk do të kishin ekzistuar për një kohë kaq të gjatë. Por meqenëse vlerat si e mira dhe e keqja kalohen nga një gjeneratë në tjetrën si tradita apo si kode

të etikës, pa u shpjeguar shkaqet e ardhjes së tyre, vlerat dhe zakonet si vrasja e foshnjave apo djegia e vejushave është pranuar dhe praktikuar për një kohë të gjatë në këto vende.

Korrupsioni është një nga praktikat e konsideruar si e ligë nga të gjitha shoqëritë njerëzore në botë. Si i tillë korrupsioni është përkufizuar më shumë nga traditat dhe zakonet e shoqërive, sesa nga studimet e bëra apo eksperiencia e pasur. Kushdo në çdo shoqëri e dënon korrupsionin si krim. Megjithatë, edhe pse çdo kush e dënon korrupsionin, kjo nuk do të thotë se çdo kush pranon të njëjtin interpretim të termit “korrupsion” apo se çdo kush i di në të vërtetë konsekuencat e liga që vijnë si rezultat i korrupsionit.

Korrupsioni më mirë mund të përkufizohet si marrja e shpërblimeve në mënyrë jo të drejtë apo jo legjitime nga një person prej dikujt tjetër. Për ta bërë më të qartë marrim shembullin e një zyrtari, i cili nga kryerja e detyrave të ngarkuara merr një të ardhur të caktuar, por për bërjen e detyrave që janë në favor të dikujt, ai pranon dhurata nga ai person për këtë favor që i ka bërë. Megjithëse ky akt është interpretuar si korrupsion, në vështrim të parë ndoshta nuk sjell konsekuenca të padëshirueshme, pasi dhuruesi i dhuratës mund ta këtë dhënë dhuratën me kënaqësi dhe me dëshirën e lirë, dhe vetë zyrtari që e pranoi këtë dhuratë mund të kryejë të njëjtin favor edhe për qytetarët e tjerë, të cilët nuk i ofrojnë dhurata.

Mirëpo, me dhënien e dhuratës, zyrtari është i obliguar të ketë më shumë preferenca në kryerjen e favorit për dhuruesin, se sa për qytetarin tjetër. Pra kjo do të thotë se ata që nuk ofrojnë dhurata do t’ju shërbehet jo në atë shkallë si qytetarin në rastin e parë. Pra kur arrihet në këtë shkallë deprivimi i shërbimit të zyrtarit do të ndihet vetëm tek qytetari që është në nevojë të shërbimit të tij, kurse

publiku dhe vendi nuk janë dhe aq direkt të lidhur me këtë çështje. Kur kundërefektet e korrupsionit nuk ndihen nga shoqëria, atëherë shoqëria nuk vepron mbi këtë akt, nuk e merr si diçka serioze, dhe sidomos në qoftë se të ardhurat e zyrtarëve do të konsiderohen të ulëta.

Por për zyrtarët e tjerë detyrat e të cilëve nuk u sjellin ndonjë përfitim apo marrje dhuratash si tek zyrtarët në rastin e parë, do të ndihen xhelozë dhe do të jenë të pakënaqur. Kështu që për të arritur një pjesë të këtyre dhuratave ata mbyllin apo bllokojnë rrugët, të cilat mund të çojnë në realizimin e favoreve me qëllim që dhuratat të ndahen në mënyrë proporcionale. Dhe kjo bën që korrupsioni të arrijë te shkalla më aktive e tij: që do të thotë se është vepruar dhe janë marra masa me qëllim që të promovojnë korrupsionin.

Kjo fare mirë mund të shihet në zhvillimin e sistemit të dhënieve të ryshfeteve dhe bakshisheve. Në fillim bakshishet jepeshin tek kamarierët nëpër restorante kur ata u shërbenin klientëve. Dhe sasia e dhënë e bakshishit varej nga vetë dëshira e klientit, nga sa i mbante atij buxheti dhe në lidhje me shërbimin e marrë. Në fillim “bakshishi” shikohej si diçka e jashtëzakonshme por megjithatë shërbimet kryheshin në mënyrë perfekte pa marrë parasysh se jepej apo jo bakshish. Por kjo nuk zgjati shumë pasi tani sjellja e kamerierëve ndryshoi ndaj klientëve, që do të thoshte se klientëve nuk do t’ju shërbehej apo do të kishin një shërbim më të varfër në qoftë se ata nuk do të paguanin bakshish. Kjo do të thotë se në këtë shkallë bakshishi e ndryshoi funksionin e tij. Në qoftë se më parë bakshishi jepej për një shërbim të mirë, tani shërbimi i mirë do të jepej vetëm kur kishte bakshish.

Nga kjo shkallë “dhënia e bakshishit” kaloi në shkallën tjetër, kur taksa u bë fikse, kështu që klientët tani nuk e kishin më të drejtën të jepnin aq sa të donin, por duhej të

paguanin atë çka ishte e caktuar në taksën e dhënë, që zakonisht ishte 10-15% të çmimit të shërbimit të kryer.

Fakti se nga ky bakshish përfitonin vetëm kamariet, të cilët ishin në kontakt direkt me klientët zgjoi një xhelozia tek punëtorët e tjerë, të cilët nuk kishin kontakt direkt me klientët, por që ishin të përfshirë në shërbimet e kryera për klientin. Për shembull, shefi i kuzhinës ishte përgjegjës për cilësinë e ushqimit që i shkonte klientit megjithatë ai nuk përfshihej në marrjen e bakshishit. Në të vërtetë të gjithë punëtorët në restorant direkt apo në mënyrë indirekte janë të lidhur me shërbimin që i bëhet klientit, megjithatë nuk ishin të përfshirë në marrjen e bakshishit.

Xhelozia e tyre ndikoi në mënyrë negative në shërbimin ndaj klientëve, dhe kur diçka e tillë ndodhi patjetër që duhej gjendur një rrugë e ndërmjetme ku të gjithë të kishin një pjesë apo përqindje nga ky bakshish i dhënë. Dhe si rrjedhim kjo bëri që bakshishi të bëhej në mënyrë zyrtare i vlefshëm, si një përqindje e shtuar mbi çmimin e ushqimit, por me tarifa të caktuara. Mbledhja e këtyre në fund të ditës do të shpërndahej midis të gjithë punëtorëve që kishin lidhje me shërbimin e kryer ndaj klientit.

Tani dy gjëra dolën në pah: Së pari, mbledhja në mënyrë zyrtare e bakshishit do të ndahej midis stafit të hotelit apo restorantit, në lidhje me pagat e marra prej tyre. Kjo do të thoshte se ata që merrnin paga të larta do të merrnin edhe përqindje më të lartë nga ndarja e bakshishit, sesa në krahasim me ata që i kishin pagat më të vogla, kur fare mirë e dimë se ishin këta të fundit që ishin më nevojtarë për këto fitime ekstra. Dhe së dyti, ata që kishin kontakt direkt me klientët përsëri do të gjenin mënyra për të fituar një bakshish më tepër prej klientit.

Me fjalë të tjera, edhe pasi bakshishet u bënë zyrtare, ato në mënyrë jozyrtare përsëri do të ekzistonin dhe

kjo do të rrisë xhelozinë midis punëtorëve që nuk janë në kontakte direkte me klientët. Pra e gjitha na çon në fillimet e pikënisjes dhe biznesi përsëri kërcënohet nga akte jo të hijshme, të cilat mund të sjellin humbje tek biznesmeni. Kështu që përsëri në fund është klienti ai që do të penalizohet për një pagesë më të lartë të tarifave për shërbimet e kryera.

Në qeverinë e një vendi, korrupsioni ka konsekuenca të liga, të cilat mund të çojnë deri në rënien e qeverisë dhe të çojnë vendin në kaos. Në qoftë se një zyrtar që merret me mbledhjen e taksave apo tarifave është i përfshirë në korrupsion, qeveria është ajo që vuan nga mos marrja e të ardhurave të taksave. Pakësimi i të ardhurave kombëtare do të thotë se qeveria nuk do të jetë në gjendje të paguajë pagat e punëtorëve. Dhe kur pagat nuk do të paguhen në kohë atëherë korrupsioni do të vazhdojë në mënyrë më të theksuar nga zyrtarët.

Korrupsioni do të bëhet shprehi, do të bëhet zakon, që më në fund nuk do të ketë farë lidhje me të ardhurat e marra nga një person, por mos të harrojmë se dëshirat e njeriut nuk njohin kufij. Ata që do të kenë të ardhura të vogla do të thonë se në qoftë se ata do të kishin të ardhura më të mira do të ishin më të kënaqur, dhe njerëz me të ardhura aq të larta në shoqëri do të gjejmë, po këta njerëz që i kanë të ardhurat e larta a janë të kënaqur me to dhe a janë të paprekur nga korrupsioni? Përgjigja do të jetë se edhe këta njerëz jo vetëm që nuk janë të kënaqur, por ata kërkojnë ryshfete më të mëdha duke i krahasuar ato me të ardhurat e marra.

Pra me fjalë të tjera, rritja e pagave nuk është një rrugë e sigurt që do të na çojë në ndalimin e korrupsionit. Në një vend ku korrupsioni është bërë si normë, si diçka praktike, rritja e pagave do të çojë vetëm në rritjen e nivelit të korrupsionit.

Mirëpo mos të harrojmë se korrupsioni ndodh kudo, nuk mund të gjejmë asnjë vend ku të mos praktikohet korrupsioni, kështu që zhdukja e tij një qind për qind do të jetë e pamundur. Megjithatë, efektet e tij mund të lehtësohen sado pak kur korrupsioni mos të këtë arritur në fazat kritike.

Faza e parë kritike është kur korrupsioni mbahet sekret, por lidhjet janë formuar midis zyrtarëve të rinj dhe atyre më të vjetërve. Në këtë fazë zyrtarët e rinj i pranojnë ryshfetet dhe i ndajnë me zyrtarët më të vjetër ose e kundërta. Dhe kur kjo fazë është në zhvillim të gjithë zyrtarët e mbrojnë njëri-tjetrin, të rinj apo të vjetër qofshin. Kjo mund të përfshijë edhe zyrtarët shumë të lartë si ministrat dhe politikanët e tjerë.

Efektet e kësaj faze të korrupsionit janë shumë të dukshme. Raportet e bëra nga palët që i vuajnë pasojat do të jenë të kota, ato do të bien në vesh të shurdhët. Më e keqja është se edhe kur masa e popullit duan të marrin masa për të pastruar sistemin, nuk do të jetë askush i pastër për të marrë këto masa konkrete, pasi të gjithë janë të përfshirë në këtë korrupsion skandaloz. Ministrat dhe zyrtarët mund të ndërrohen, por edhe ata që do t'i zëvendësojnë shumë shpejt do të përfshihen nën çadrën e korrupsionit. Edhe kur disa prej tyre do të refuzojnë të përfshihen, ata do ta shikojnë se veprimet e tyre shumë shpejt do të jenë të paralizuara, pasi pjesa tjetër e stafit të cilët janë të përfshirë nuk do t'i binden urdhrave dhe direktivave të tyre. Por që të ndryshosh tërë stafin qeveritar dhe rekrutët e tyre është diçka e pamundur, por edhe në qoftë se do të provohet, rezultatet do të çojnë qeverinë dhe shtetin në një kaos të vërtetë që do ta keqësojë gjendjen edhe më tepër.

Faza e dytë kritike e korrupsionit është kur ai nuk është më i fshehtë dhe pranohet si një diçka normale

nga shoqëria. Në këtë fazë, zyrtarët do të flasin për rrogat e pamjaftueshme si një shkak për të cilin duhet të paguhen ryshfetet. Por në qoftë se kjo do të ishte e vërtetë, atëherë qeveritarët e lartë apo ministrat që marrin paga të larta nuk duhet ti pranojnë ryshfetet. Fakti qëndron se ata që i kanë pagat e larta, nuk ka rëndësi sa të larta i kanë gjithmonë do të kërkojnë ryshfete të larta. Lakmia njerëzore nuk njih kufij.

Kur korrupsioni praktikohet apo bëhet në mënyrë të hapur dhe nuk është më i paligjshëm, efektet e tij në vend do të jenë shkatërrimtare. Së pari, qeveria do të jetë ajo që do të dobësohet sa herë që një bakshish apo ryshfet do të merret, pasi qeveria do të humbasë të ardhurat që mund të fitohen, ose do të bëjë të dalë nga kursi i duhur i veprimit. Për shembull kur një taksë është vendosur në mënyrë fikse për një mall të caktuar, dhënia e bakshishit nuk do të rëndojë xhepat e marrësit, ato para që duheshin dhënë për taksën tani do të ndahen midis atij që e jep bakshishin dhe marrësit. Por në qoftë se kjo do të ndodhë për çdo taksë të vendosur dhe që duhet paguar, atëherë qeveria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë asnjë të ardhur nga taksat, dhe në mënyrë reciproke nuk do të jetë as një gjendje të merret me ecurinë e vendit. Kjo do të sjellë gjithashtu edhe vonesën në pagimin e pagave që qeveria u detyrohet punëtorëve dhe për të plotësuar mangësitë në pagat e pamarra, zyrtarët do të synojnë tani të marrin ryshfete akoma më të larta. Pasi lakmia njerëzore nuk njih kufij dhe korrupsioni merret fare lehtë nga njerëzit, më shumë ryshfete do të merren dhe të ardhurat për qeverinë sa do të vijnë e do të pakësohen dhe konsekuencat e gjendjes që do ta pasojë, nuk kanë nevojë për një shpjegim më të hollësishëm.

Por në qoftë se qeveria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë këto fonde nga të ardhurat e taksave, atëherë

shërbimet sociale si edukimi, shëndetësia dhe shërbimet e tjera publike, nuk mund të jepen tek populli. Dhe kjo do të bëjë për vendin, jo vetëm të pamundur të arrijë progres, por gjithashtu diferencat midis të pasurve dhe të varfërve do të theksohen edhe më shumë. Dhe kjo për vetë arsyen se shërbimet sociale të dhëna nga shteti zakonisht ndihmojnë në uljen e shpenzimeve të të varfërve.

Në një situatë kur të varfrit varfërohen më shumë, gjendja e tyre do të keqësohet më shumë me praninë e korrupsionit, pasi ata nuk janë në gjendje të ofrojnë këto ryshfete, ata do të privohen nga kryerja e shërbimeve të zyrtarëve. Kjo gjendje e krijuar do të vështirësohet me kalimin e kohës, drejtësia do të humbasë kuptimin dhe shumica e popullatës do të bien në gjendje depresioni.

Ashtu siç e theksuam edhe më lart, lakmia njerëzore nuk njih kufij, edhe kur ekonomia e një vendi është duke u shkatërruar nga korrupsioni, zyrtarët dhe të tjerët të përfshirë në praktikimin e këtij vesi nuk do të ndalen asnjëherë. Dhe më së fundi korrupsioni nuk do t'u sjellë atyre asnjë nga përfitimet dhe të mirat që ata gëzonin më parë. Në një vend ku njerëzit kanë njëfarë pasurie, dhe kur vendi është në gjendje të mirë ekonomike, konsumatorët mund të jenë në gjendje të blejnë gjërat që dëshirojnë. Por kur ekonomia është në rënie (si rezultat i korrupsionit) konsumatorët do të kenë të ardhura të vogla dhe bizneset do të shkojnë drejt humbjes. Dhe kur biznesi humb, biznesmeni nuk është më në gjendje të ofrojë ryshfete tek zyrtarët, kështu që edhe këta vetë do ta vuajnë rezultatin e korrupsionit në mënyrë të anasjelltë. Në një vend kur korrupsioni praktikohet haptazi, edhe kur zyrtarët marrin ryshfete të mënyrave të ndryshme, jetesa e shumicës së tyre nuk është më e mirë se të tjerët.

Pra është shumë e rëndësishme të identifikojmë këto dy faza kritike të korrupsionit, sepse kur vendi

është i mbërthyer në këto faza, nuk ka më shpresa për përmirësim. Publiku në përgjithësi dhe grupe të veçanta në shoqëri do ta dënojnë korrupsionin, do ta ngrenë zërin dhe do të protestojnë kundër praktikimit të tij, do të kërcënojnë se do të marrin masa kundër zyrtarëve që janë të përfshirë në korrupsion, do t'i kërcënohen qeverisë duke e detyruar të marrë masa për gjendjen e krijuar. Por të gjitha këto do të jenë një përpjekje e kotë nga ana e tyre sepse, edhe në qoftë se zyrtarët dhe qeveria do të ndryshojnë, reforma e bërë do të jetë e vlefshme vetëm për një kohë të shkurtër. Sëmundja e korrupsionit do të infektojë edhe zyrtarët dhe qeveritarët e rinj të ardhur në fuqi, megjithëse këta ishin ata që luftuan dhe e dënuan korrupsionin. Virusi i kësaj sëmundje do të përhapet në të gjitha kohët, dhe ndryshimi i vetëm i bërë do të jetë vetëm ndryshimi i personave që do të përfitojnë nga ky korrupsion. Për popullin dhe për vendin, zëvendësimi i zyrtarëve të vjetër më të rinj, apo ndryshimi i gjithë qeverisë me një të re, nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe asnjë të mirë.

Kjo mund të vërehet në çfarëdo lloj faze kritike që hyn korrupsioni. Sjellja e një qeverie të re do të sjellë fytyra të reja dhe ideologji të reja, por shumë shpejt edhe këta do të akuzohen për përfshirje në korrupsion. Deklarata pas deklaratash janë bërë për hedhjen poshtë të korrupsionit, fushata të tëra janë mbajtur, por përsëri korrupsioni do të vazhdojë të ekzistojë. Nganjëherë janë bërë ndryshime qeveri pas qeverie dhe përsëri korrupsioni ka mbijetuar.

Shkaku se përse korrupsioni nuk mund të eliminohet më kur arrin në këto faza është se ai nuk konsiderohet më si një akt kriminal, por është bërë një mënyrë jetesë për shoqërinë ku ekziston. Ata që e dënojnë si një akt kriminal veprojnë kështu pasi nuk kanë mundësi ta

praktikojnë edhe vetë, sepse me t'iu dhënë mundësia edhe këta vetë do të përfshihen në praktikimin e tij. E njëjta gjë ndodh si me ata që dënojnë favorizimin dhe nepotizmin, kur ata vetë gjejnë dikë të njohur në dikasteret e larta, ata do të mundohen me gjithë shpirt të përfitojnë nga kjo njohje. Dhe kur akuzohen ashtu si edhe të tjerët për përdorimin e këtyre personave, ata do të sjellin si shkak se dhe të tjerët janë duke përfituar nga lidhjet e përse mos të arrijnë edhe ata vetë diçka. Me fjalë të tjera, kur të tjetër e kryejnë një krim, edhe ata kanë të drejtë ta kryejnë të njëjtin krim, dhe kur të tjerët e praktikojnë korrupsionin çdo kush që i jepet mundësia ka të drejtë ta praktikojë gjithashtu. Por në qoftë se kjo do të jetë mënyra e të menduarit për njerëzit, kjo shoqëri asnjëherë nuk do të jetë në gjendje ta zhdukë korrupsionin. Praktikant korruptues do të kalojnë nga një individ në tjetrin dhe do të transferohen nga një grup në tjetrin.

Në fillim të këtij kapitulli, diskutuam se asnjë gjë nuk mund të konsiderohet si e ligë nga një shoqëri pa patur një shkak. Nga diskutimi i mësipërm, del si konkluzion se korrupsioni është i keq vetëm për ata që nuk kanë as mundësinë dhe as kapacitetin të përfitojnë nga korrupsioni. Ata që kanë mundësinë dhe që kanë përfitim prej tij, nuk kanë asnjë mendim kundër praktikimit të tij. Dhe në një situatë kur shumë nga individët e shoqërisë janë të përfshirë në korrupsion, nuk është e lehtë të flasësh për të ligat dhe anët negative të korrupsionit. Kur një pjesë e madhe e kësaj shoqërie kanë përfitime nga praktikimi i tij, si mundet korrupsioni të shihet si një akt kriminal i shëmtuar.

Në Kinë, nën sundimin perandorak, korrupsioni nuk është parë me këtë sy. Të gjithë zyrtarëve duhet t'u jepej një dhuratë monetare kur u kërkohet të kryenin ndonjë shërbim dhe pagesa bëhej haptazi. Shpesh nje-

rëzit që kishin nevoja për shërbimin e këtyre zyrtarëve do t'u duhej kohë më parë të mblidhnin paratë për dhuratat që duhet të ofronin.

I gjithë personeli qeveritar ishte i përfshirë në këtë praktikë. Në të vërtetë mbledhja e këtyre parave si dhuratë nuk kishte ndonjë diferencë nga ajo e mbledhjes së taksave, ndryshimi i vetëm midis këtyre të dyjave ishte vetëm mënyra e dhënies. Në qoftë se taksat do të mblidheshin nga qeveria dhe pastaj do të ndaheshin midis zyrtarëve dhe stafit në formën e pagave, paratë e marra si dhurata do të ndaheshin menjëherë, pra ai që i mblidhte do të merrte menjëherë pjesën e tij dhe të tjerat do t'i kalonte tek zyrtarët më të lartë e kështu me radhë.

Në këtë mënyrë, zyrtarët do të përfitonin një të ardhur më tepër në formë monetare që u vinte si diçka ekstra mbi pagat e ulëta që merrnin, kurse publiku do të përfitonte në formën e shërbimeve efektive që do të merrte prej këtyre zyrtarëve. Meqenëse të gjithë pak a shumë, kishin një përfitim të vogël nga kjo praktikë, të ligat e këtij lloj korrupsioni nuk viheshin shumë re. Gjithashtu nuk quhej as me emrin korrupsion, por me eufemizma të ndryshme.

Por edhe në këtë situatë, të ligat e korrupsionit do të shiheshin po të bëhej një studim me i thellë, por në Kinën e asaj kohe nuk ishin vetëm zyrtarët ata që kërkonin ryshfete, edhe liderët e tjerë si liderët e Shoqatave të të Vobektëve, shoqëritë sekrete dhe ato të hajdutëve dhe të gangsterëve do të kërkonin ryshfete gjithashtu, në mënyrë që mos të terrorizonin shoqërinë.

Me kaq shumë grupe, të cilat shtypnin popullin, i cili kërkonte të bënte një jetë të qetë, kjo shoqëri nuk mund të këtë asnjëherë progres, pasi askush nuk dëshironte të punonte më shumë, se sa ishte e nevojshme për jetesën e tij, pasi frutat dhe munda i punës se tij do të merreshin

nga zyrtarët dhe kriminelët. Pra shumica e popullsisë do të punonte sa për të fituar një jetesë minimale, pasi çdo gjë që do të kishte ekstra do të shkonte në xhepat e shfrytëzuese të tyre. Shoqëria ishte gjithmonë nën një kërcënim të vazhdueshëm, njerëzit jetonin kudo me frikë, drejtësia nuk mund të shijohej nga pjesa e popullit që ishin të ndërgjegjshëm dhe të pastër pasi kjo drejtësi nuk do të ekzistonte në një shoqëri ku praktikoheshin kaq shumë korrupsioni.

Dhënia e ryshfeteve tek zyrtarët bëhet për shkak që të ulen pagesa e taksave të vëna nga shteti, dhe kjo do të thotë se qeveria nuk do të marrë të gjitha të ardhurat e planifikuara nga taksat e vëna. Por pa këto të ardhura të mjaftueshme, qeveria nuk do të jetë në gjendje të sigurojë shërbimet publike tek populli, përfshirë këtu edhe mundësinë për të luftuar korrupsionin. Vendi pa diskutim do të dobësohet nga ana ekonomike dhe mund edhe të bëhet kollaj prehë e pushtimeve dhe njerëzit të jenë gjithmonë të shfrytëzuar.

Praktika e korrupsionit dhe rezultati i tij, dobësimi i vendit bëri një herë e një kohë që Shtetet Malajase të ishin një pre e lehtë tek çdokush që dëshironte ta pushtonte. Shpesh këto pushtime erdhën në formën e kërcënimeve, por nuk përjashtohet fakti kur disa prej pushtimeve erdhën si rezultat i gjoja ndihmës së ofruar nga këto vende.

Plot shembujt mund të gjejmë nga historia e Shteteve Malajase. Jo larg po në shekullin XIX, të huajt e shikonin me mjaft interes Malajzinë. Ishte e qartë se ky vend kishte një potencial të lartë pasurie, por që prijësit e këtij vendi, ashtu sikurse edhe njerëzit, nuk kishin as interesin dhe as aftësinë ta vlnin këtë pasuri të vendit të tyre, dhe sidomos në pasuritë e minierave.

Të huajt filluan të sillnin propozime të ndryshme tek prijësit dhe kryetarët e këtyre shteteve për pagesa të rre-

gullta mujore që ata do t'i nxirrnin në qoftë se i linin të huajt, apo ua jepnin atyre të drejtën për të zhvilluar këto burime natyrore në vend. Duke rënë dakord mbi këtë joshje që të huajt i bënë, për një kohë shumë të shkurtër prijësit dhe kryetarët filluan të grumbullonin një pasuri të jashtëzakonshme për veten e vet. Pa dyshim që këto të ardhura që paguheshin tek prijësit dhe kryetarët nuk konsideroheshin si taksa të paguara tek shteti, megjithëse toka që shfrytëzohej nuk u përkiste as prijësve apo kryetarëve, kjo tokë ishte plotësisht një pasuri kombëtare.

Nga industria e minierave, ky bashkëpunim u zgjerua me dhënien e tokave tek të huajt edhe për qëllime të tjera, për monopole të ndryshme, si tregtinë e opiumit, për mbledhjen e taksave etj. Të ardhurat e kryetarëve nga ky bashkëpunim me të huajt filloi të rritej jashtë normave normale duke i krahasuar me popullin e thjeshtë, që nuk po përfitonte asgjë, dhe kjo bëri që ata të harrojnë edhe ndjenjën e përgjegjësisë që kishin ndaj popullit dhe vendit. Për ata tani primare ishin realizimi dhe plotësimi i dëshirave të tregtarëve të huaj.

Në këtë fazë shumë nga masa filluan të ndjenin xhelozin, gjithashtu tregtarët e tjerë të huaj të cilëve nuk u ishte dhënë e njëjta mundësi si të tjerëve filluan jo vetëm që të mbillnin farën e pakënaqësisë në popull, por përpiqeshin të rrëzonin nga pozita çdo një prej këtyre tregtarëve të pasur, duke i ofruar një farë të ardhurash çdo kujt që mund ta bënte këtë gjë. Si rezultat, gjithë kjo solli armiqësimin midis kryetarëve apo udhëheqësve të vendit dhe tregtarëve të huaj që shpesh përfunduan në përplasje të fuqishme, midis këtyre grupeve. Me këtë situatë në vend, Shtetet Malajase filluan të binin një nga një në duart e anglezëve, nëpërmjet të ashtuquajturave traktate për ndihmë.

Rënia e Shteteve Malajase në duart e anglezëve, ndoshta mund të shikohet si një shembull ekstrem i konsekuencave të ardhura si rezultat i praktikimit të korrupsionit, por askush nuk mund ta hedhë poshtë faktin se korrupsioni e çoi vendin në këtë shkallë. Duke e parë se korrupsioni nuk mund të zhduket plotësisht, dhe fakti se ai ka mundësi të shkatërrojë edhe shoqërinë njerëzore, lind pyetja se çfarë qëndrimi duhet mbajtur dhe çfarë mase mund të merret ndaj tij?

Megjithatë prezenca e korrupsionit, ashtu si prezenca e çdo krimi tjetër në shoqëri nuk do të thotë se vetë shoqëria e ka pranuar këtë ves si diçka normale. Por jo si krimet e tjera, korrupsioni në qoftë se do të lejohet të rritet, mund të pranohet si diçka e zakonshme dhe do të fillojë të praktikohet haptazi. Por ashtu siç e shpjeguam edhe më lart, kur korrupsioni shihet si diçka e zakonshme dhe fillon të praktikohet haptazi, jo vetëm që nuk është e lehtë të luftohet kundër tij, por ai do të bëhet një rrezik për të gjithë. Pra në qoftë se një shoqëri edhe pse e pranon se korrupsioni nuk mund të zhduket plotësisht, nuk duhet të lejojë në asnjë mënyrë që praktikimi i tij të bëhet diçka e zakonshme. Çfarë do qoftë e vërteta pas ekzistimit të korrupsionit, ai vazhdon të jetë një krim i shëmtuar që nuk mund të konsiderohet si diçka normale.

Duke e parë se shoqëria e konsideron korrupsionin si një krim, vetëm dënimi pa marrë asnjë masë, sado i zhurmshëm të jetë nuk do të jetë i mjaftueshëm për ta ndaluar atë. E rëndësishme dhe efektive është, që shoqëria duhet në mënyrë direkte apo indirekte të pastrojë vetveten nga ky korrupsion. Por që të sigurohet ky pastrim të gjithë duhet të kuptojnë se çfarë do të thotë në radhë të parë korrupsion.

Në përgjithësi, korrupsioni kuptohet si dhënie e diçkaje te dikush që është në fuqi apo në pushtet, kështu që

ai mund të abuzojë me detyrën e vet për të favorizuar dhënësin e kësaj dhurate apo ryshfeti. Që ta bëjmë më të qartë marrim rastin e dhënies së licencave, midis aplikuesve për të marrë licencat, njëri i jep ryshfet personit në detyrë dhe si rezultat ai do të marrë licencën edhe pse nuk e meriton atë duke e krahasuar me aplikuesit e tjerë. Por në qoftë se marrësi i licencës e meriton marrjen e licencës dhe përsëri ai dëshiron t'i japë diçka personit në detyrë, dhe po kështu veprohet edhe nga të tjerët, a do të quhet kjo një formë korrupsioni?

Përsëri kjo do të futet në kategorinë e korrupsionit, por edhe dhënia mbrapa e dhuratave nuk është gjë e lehtë. Dhuratat e dhëna nga udhëheqësit e një vendi për një udhëheqës të një vendi tjetër, mund të merren si simbol miqësie, ose si një formë korrupsioni për të nxitur favorizimin e këtij vendi mbi politikën dhe shtetasit e vendit dhurues. Por gjithmonë pyetja do të lind, cili është mendimi i publikut për dhënien e dhuratave në ditët e shënuara apo nëpër festa?

Shpërdorimi i fondeve të qeverisë, pa dyshim që do të konsiderohet si një formë korrupsioni pasi kjo do të thotë shpërdorim i detyrës. Në qoftë se një zyrtari i është dhënë e drejta të kërkojë mbi shpenzimet e harxhuara gjatë kryerjes së detyrës, dhe ky zyrtar do të kërkojë më shumë nga sa ka shpenzuar në të vërtetë, kjo është një formë e qartë korrupsioni. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për një zyrtar, i cili përdor fondet e qeverisë për të përfituar për vete, për shembull me ndërtimin e një rruge publike që kalon afër shtëpisë së tij. Në qoftë se një ministër përdor pushtetin që ka për të arritur lehtësime për të përfituar për vete, për familjen e vet dhe ata që e përkrahin, pa dyshim që ky do të quhet korrupsion. Edhe kur një student aplikon për marrjen e një burse duke premtuar se ai do ta përdorë për të vazhduar

studimet dhe e përdor këtë bursë për qëllime të tjera edhe kjo është quajtur gjithashtu korrupsion.

Po t'i hedhin një vështrim të shpejtë të gjithave sa u përmenden më lart janë raste të qarta të korrupsionit, por po t'i bëhet një shqyrtim i hollësishëm ajo që është e qartë do të fillojë të mjegullohet, pra çfarë u pa të ishte një rast i pastër dhe i qartë korrupsioni, fillon të kthehet në diçka normale që nuk ka lidhje me korrupsionin. Ministri, i cili u premtonte përkrahësve të vet se do të sigurojë për ta lehtësimet e kërkuara, duhet medoemos të mbajë fjalën dhe në bazë të drejtësisë përkrahësit e tij duhet ta marrin ndihmën e premtuar. Edhe pse ka pasur raste kur turmat janë bërë viktime të zyrtarëve qeveritarë, duke i neglizhuar kërkesat e tyre, përsëri është detyra e ministrit të merret me përmirësimin e këtyre gabimeve. Por në rastet kur edhe pse një kërkesë është mjaft e drejtë për t'u kërkuar, dhe kjo cenon emrin e pozitën e ministrit, ai do ta hedhë poshtë, edhe pse të gjithë do ta vuajnë këtë gjë, ai kërkon të mbajë lart imazhin e tij të pastër. Kujt do që ata i shërbejnë duhet të këtë njëfarë lidhje apo kontakti me ta, kështu që shërbimi i kryer do të jetë një favorizim ose ka raste edhe që nuk mund të jetë i tillë.

Është e qartë nga ky diskutim, se çfarë do gjeje që përfitohet le të jetë ajo licencë, bursë apo një lehtësim, kur përfshin shumë aplikues dhe për çdo aplikues që arrin sukses do të këtë shumë të tjerë që nuk do të jenë aq të suksesshëm sa ai dhe do të jenë të pakënaqur. Personi që është i ngarkuar me detyrën e dhënies të çfarë do gjeje që përmendëm më lart e ka bërë zgjedhjen e vet, por a do të jetë e lehtë të vendoset nëse ai ka favorizuar ndonjë prej tyre apo jo? Aplikantët që nuk do të jenë të suksesshëm do të thonë se ky person ka bërë padrejtësi duke favorizuar disa prej tyre, por në qoftë se ata do të ishin në grupin e atyre që do kishin sukses do të thoshin

me bindje të plotë se vendimi i tij ishte plotësisht i drejtë. Dhe më e keqja është se këta aplikantë po të kishin mundësinë të kontaktonin këtë person apo zyrtar, ata do të kërkonin prej tij të ishin të favorizuar dhe nuk do të kishin hezituat aspak të vepronin në këtë mënyrë.

Nga i gjithë diskutimi i bërë më lart, pika më spikatese është definicioni apo përkufizimi i korrupsionit, që edhe pse mund të duket i lehtë në pamje të parë, nuk mund të themi se është kaq i lehtë pasi u përmendën shembujt e marrë. Lufta kundër korrupsionit ka dilemat e veta, dhe kjo nuk vjen vetëm nga fakti se disa nga aktet e përmendura si korrupsion mund të mos jenë në të vërtetë të tilla. Por gjithashtu është e nevojshme të jepen mundësi dhe pushtet edhe tek ato grupe që dëshirojnë të çrrënjosin korrupsionin. Megjithatë kjo mundësi dhe fuqi do të jetë materiale, dhe si çdo fuqi tjetër do të abuzohet. Me fjalë të tjera, edhe personeli antikorrupsion duhet të jetë mjaft i kujdesshëm në përpjekjet që do të bëhen për t'i korruptuar dhe ata vetë. Nga rangjet më të ulëta e deri tek ato më të larta, këta zyrtarë do të ballafaqohen me këto përpjekje, edhe në qoftë se ata do ta mbajnë veten e tyre të pastër, prapë akuzime mbi ta do të hidhen nga të gjitha anët. Në se këto akuzime do të kenë baza apo jo, kjo nuk do të ketë rëndësi, pasi ato do ta arrijnë qëllimin e tyre në dobësimin e përpjekjeve për antikorrupsion. Por kur këto akuza kanë baza, por ato nuk bëhen, atëherë makineria e antikorrupsionit, mund të transferohet në një makineri që e promovon korrupsionin. Pra me fjalë të shkurtra kjo është dhe dilema e korrupsionit, asnjë sistem nuk mund të përdoret për të luftuar korrupsionin, pa ekspozuar më përpara veten nën presionin e korrupsionit.

Për të gjetur një rrugëdalje për këtë dilemë, faktori kryesor nuk është medota apo makineria që duhet të

përdoret kundër korrupsionit. E rëndësishme dhe efektive është sistemi i vlerave të shoqërisë në fjalë. Është e vërtetë se të gjithë e pranojnë se korrupsioni është një krim dhe që nuk duhet të praktikohet, por askush nuk thotë se e konsiderojnë korrupsionin si diçka të ligë dhe si një sëmundje të tmerrshme që mund të infektojë të gjithë shoqërinë. Megjithatë kur një mundësi hapet për të përfitur diçka edhe pse me anë të korrupsionit, ajo çka u tha është shumë larg me atë çka veprohet.

Për shembull në demokraci, mundësitë për njerëzit e thjeshtë të praktikojnë korrupsionin janë shumë të favorshme, dhe sidomos gjatë fushatave të zgjedhjeve. Në fakt funksioni primar i zgjedhjeve është zgjedhja e liderëve që janë më të aftë, më të kualifikuar dhe më të sinqertë e më të ndershëm. Pyetjet primare që duhet të bëhen janë: A mundet ky kandidat dhe partia e tij të drejtojnë në mënyrë sa më të ndërgjegjshme vendin? Do të jetë shoqëria dhe vendi më shumë progresiv dhe paqësor nën udhëheqjen e këtij kandidati. A do të mund të përmirësohen kushtet e liga në zonat elektorale? Do të zbatohet drejtësi në ndarjen e pushtetit qeveritar dhe ndihmave të dhëna në popull? Me pak fjalë, zgjedhja e kandidatit duhet të vendoset duke parë efektet që ai do të sjellë në mirëqenien dhe progresin e vendit duke e parë në të gjitha aspektet.

Por zakonisht gjatë fushatave elektorale, shumë nga votuesit, do t'u japin rëndësi gjërave të veçanta që ata do të mund të përfitojnë në qoftë se kandidati i zgjedhur prej tyre do të fitojë, por mos të harrojmë se këto përfitime të veçanta nuk do të kenë aspak lidhje me konceptin e drejtësisë së zbatuar. Në fakt ato do të jenë dhurata direkte të bëra nga kandidati për votuesit e tij. Sa më shumë të jenë gjërat e premtuara, aq më e fortë do të jetë përkrahja nga votuesit e tij për këtë kandidat.

Qysh prej fillimit personi që hedh kandidaturën, u premtion votuesve të vet për plotësimin e kërkesave të tyre edhe kur ato nuk janë të drejta, kandidati mund edhe të arrijë të premtojë tek votuesit e tij për të neglizhuar mbi ata të cilët votuesit nuk i pëlqejnë, edhe pse kjo do të ishte diçka e padrejtë, kandidati është në gjendje ta bëjë vetëm e vetëm për të marrë votat e tyre. Pra ashtu si ai aplikanti që i duhej të plotësojë dëshirat e zyrtarit që merret me dhënien e licencave, ashtu edhe për kandidatin i duhet të premtojë të plotësojë të gjitha dëshirat e votuesve të tij.

Mirëpo, kur kandidati fiton, ai është i detyruar t'i plotësojë të gjitha premtimet e dhëna, dhe sidomos kur ai bën pjesë në partinë që është në pushtet. Por kjo nuk është e gjitha, meqenëse ky kandidat e di se mund t'i marrë votat duke u premtuar dhe duke i plotësuar dëshirat e votuesve, ai fillon të përgatisë situatën përpara kohës së zgjedhjeve të tjera. Sidomos kandidatët e partive që janë në pushtet do të nisin të plotësojnë dhe të kryejnë shumë nga premtimet e dhëna pak para fushatave elektorale. Dhe kjo padyshim është një formë korrupsioni, pasi më përpara votuesve iu bën premtime për gjërat e veçanta të kërkuara prej tyre, kurse tani, gjëra të veçanta bëhen për elektoratin në mënyrë për t'i kënaqur dhe për të marrë votat e nevojshme.

Por nuk mund të themi se kjo praktikohet vetëm nga kandidatët e partisë në pushtet, edhe kandidatët e tjerë praktikojnë të njëjtat gjëra të kësaj natyre. Ata do të vizitojnë zonën e tyre elektorale dhe do të marrin pjesë në çfarëdo shërbimi të mbajtur, do të marrin pjesë në festat e vetë zonës, do të falen nëpër qendrat fetare të vetë zonës së bashku me elektoratin, do të japin ndihmë monetare sado e vogël qoftë ajo, dhe do të bëjnë çdo gjë që ata kurrë nuk do të kishin dashur ta bënin në qoftë se ata nuk

do të hidhnin kandidaturën për në fushatën e ardhshme elektorale. Kjo është një hipokrizi e vërtetë, një shtirje e vrazhdë, dhe në lidhje me shërbimet e kryera ato do të ndalen menjëherë pas mbylljes së zgjedhjeve.

Në qoftë se një shoqëri nuk e dëshiron korrupsionin, ajo nuk duhet të krijojë klimën dhe atmosferën e përshtatshme apo të japë shkaqe për iniciativën në këtë korrupsion. E drejta e votuesve për të votuar është një lloj si fuqia apo pushteti në duart e një zyrtari. Pra janë votuesit ata që vendosin fatin e një personi deri në atë pikë të bërjes se tij kryeministër dhe kjo do të thotë se votuesit në të vërtetë kanë një fuqi shumë të madhe mbi vete. Por fuqia apo pushteti të korrupton, dhe sa më absolute të jetë kjo fuqi, aq më absolut do të jetë edhe korrupsioni. Fuqia tek votuesit mund të bëhet absolute, dhe kjo fuqi absolute do të çojë në korrupsion.

Një shoqërie që i jepen fuqi të mëdha shumë lehtë mund të korruptohet dhe shenjat janë se megjithëse të gjithë mundohen ta dënojnë korrupsionin, çdokush do ta dënojë atë formë të korrupsionit që ai vetë praktikon. Në qoftë se shoqëria do të dëshirojë të zhdukë korrupsionin vetë kjo shoqëri nuk duhet ta praktikojë as në mënyrë direkte apo indirekte gjatë zgjedhjeve elektorale. Në qoftë se korrupsioni do të ekzistojë gjatë votimeve, shanset janë që kandidati i zgjedhur do të tentojë më shumë nga korrupsioni, dhe liderët që tentojnë të përdorin korrupsionin gjatë zgjedhjeve, pa dyshim që janë të influencuar nga korrupsioni.

Pra ky problem duhet menduar me kujdes se si mund të luftohet. Çdo kandidat dhe çdo parti, shpenzojnë me miliona dollarë për të marrë pjesë në fushatën elektorale. Më përpara nuk ishte e nevojshme të shpenzohej kaq shumë, pasi shumica e kandidatëve ishin të përgatitur të shërbenin në baza vullnetare pasi ata beso-

nin në principet e vetë partisë, apo në individë të veçantë ose sepse ata ishin të frymëzuar nga shpirti i një shërbimi të mirë. Por sot një i varfër nuk mund të hedhë kandidaturën e tij për zgjedhje përderisa të mos nominohet nga një parti e pasur.

Në këto situata, votuesit shumë lehtë tentojnë të marrin vendime jo të mençura. Në qoftë se ata do të konsiderojnë pasurinë e partisë që do të thotë është sinonim me korrupsionin, pa peshuar faktorët e tjerë, ata do të vendosin të zgjedhin kandidatin e varfër, megjithatë ky është një qëndrim negativ ndaj çështjes tonë, pasi vetë kandidati i varfër nuk do të jetë në gjendje apo nuk do të ketë aftësi për asgjë që të luftojë korrupsionin. Dhe ky qëndrim negativ ndaj çështjes në diskutim tregon se vetë shoqëria nuk është e përgatitur të ballafaqohet me problemin që i kanoset.

Sëmundja që është duke iu kanosur shoqërisë është korrupsioni, i cila praktikohet nga vetë shoqëria. Shërimi i shoqërisë nga kjo sëmundje (korrupsioni) nuk vjen vetëm me hedhjen poshtë të simboleve që u vendosën si rrjedhojë e këtij korrupsioni, pra të kundërshtohen kandidatët dhe partia e zgjedhur, por që të largohen efektet e korrupsionit dhe korrupsioni vetë, pothuajse të gjithë pjesëtarët e shoqërisë duhet të shmangin të gjitha format e korrupsionit. Në kontekstin e zgjedhjeve, ato duhet të bëhen në bazë të aftësisë së kandidatit, ndershmërisë së tij dhe jo në bazë të premtimeve të bëra prej tyre për të dhënë këtë apo atë gjë. Dhe ata që duan që të fitojnë kandidatët e mirë duhet të jenë të përgatitur të bëjnë punë vullnetare, pa kërkuar të ardhura, apo të premtojnë për përfitime të veçanta.

Ne e kemi parë se si demokracia në Shtetet e Bashkuara u rrezikua të shkatërrohej nga format e ndryshme të korrupsionit, të cilat u nxorën në pah në rastin e Wa-

tergate. E vërteta ishte se Nixon nuk ishte i vetmi person që praktikonte këtë sistem, të gjithë kandidatët për president dhe presidentët përpara tij, kanë bërë pothuajse të njëjtat gjëra. Dhe kjo rrjedh nga vetë fakti se votuesit e bëjnë shumë të nevojshme shpenzimin e shumave jashtëzakonisht të mëdha në zgjedhjet për president, ndërsa përkrahësit e thjeshtë dhe votuesit nuk janë të përgatitur të kontribuojnë në mënyrë vullnetare. Të ballafaquar me shkurtimin e fondeve, kandidati dhe partia, janë të detyruar ta pranojnë ndihmën e dhënë nga palët e pasura të interesuara në dhënien e kësaj ndihme. Ndoshta kjo ndihmë e dhënë nuk do të këtë qëllim përfitimi nga pikënisja e saj, por marrësi i kësaj ndihme do të ndihet gjithmonë borxhli ndaj dhënësit. Edhe pse shoqëria e hodhi poshtë këtë president, në të vërtetë sëmundja e korrupsionit e promovuar apo e praktikuar nga vetë shoqëria përsëri do të ekzistojë. Dhe kjo u provua akoma më shumë kur edhe presidentit Karter iu zbulua përfshirja në skandalin me Bert Lance, këshilltarin e tij të financës.

Mos të harrojmë se korrupsioni nuk është një sëmundje e re, korrupsioni është një sëmundje e vjetër e njohur si një pjesë e sistemit të vlerave dhe kulturave të shoqërive kudo në botë. Ashtu si të gjitha vlerat e tjera që janë të inkuadruara në kulturë, deklaratat mbi korrupsionin se është i keq apo i mirë nuk do të nënkuptojnë asnjë kuptim të thellë të tij si çështje. Dhe jo vetëm që do të këtë mangësi në kuptimin dhe efektet e korrupsionit, por gjithashtu çdo person do të arrijë një kuptim dhe vlera për vete, ashtu si të tjerët që do të arrijnë një kuptim tjetër dhe vlera të tjera për veten e tyre. Kështu që personi, i cili e dënoi favorizimin nuk do të këtë ndrojtje të kërkojë një favor ndaj tij kur ky person do të gjejë mundësinë.

Një kapitulli si ky që sapo diskutuam nuk është e lehtë të shkruhet, pasi reaksioni i shkrimit nga ky kapitull

do të tregojë nëse vetë shkrimtari e praktikon apo jo korrupsionin. Por me dhënien e një interpretimi më të gjerë të vetë nocionit të korrupsionit, askush nuk mund të lavdërojë veten si të pastër. Për një politikan që të shkruajë një artikull të tillë do të thotë dështim i sigurt për të ardhmen e tij si politikan, edhe ata që do të ishin në gjendje ta ndihmonin do të ndërrojnë mendim nga frika e akuzimeve që mund të ngrihen për ndihmën e dhënë për qëllime të korruptueshme, apo se ata e kanë të qartë se me ndihmën e dhënë në këtë pikë ata nuk do të përfitojnë asgjë. Megjithatë është mjaft e rëndësishme që të njohim korrupsionin jo vetëm si një pjesë e kulturës, por edhe si një sëmundje me konsekuencat që i vijnë nga pas.

Luftimi i korrupsionit kërkon ndershmëri. Dhe kush do që do të mundohet të përdorë këtë kapitull për interesat politike të veta apo të partisë se tij, jo vetëm që nuk është i ndershëm, por ai është duke përdorur një formë të korrupsionit, dhe ky është abuzimi i fuqisë që vjen si rezultat i njohurive që ai ka. Korrupsioni që mundohet të luftojë korrupsionin është forma më e ligë e praktikuar e të gjitha korrupsioneve.

Kapitulli XIII

***Quo Vadis* Malajzia (Për ku është duke shkuar Malajzia)**

Fitorja e Partisë së Aleancës në vitin 1955 i dha Tunku Abdurrahman Putra-së mundësinë për t'u bërë Kryetar i Federatës Malajase. Nga këto zgjedhje doli edhe delegacioni i drejtuar nga vetë Tunku Abdurrahman që u nis për në Britaninë e Madhe për të bërë negociatat për pavarësinë e Shteteve Malaje me Anglinë.

Delegacioni së pari u nis për në Evropë me një mandat nga populli dhe Kryetarët e Shteteve Malajase, për të kërkuar për t'u garantuar pavarësia në vitin 1959. Megjithëse UMNO (Organizata Kombëtare e Malajzianëve të Bashkuar) kishte caktuar këtë datë, Tunku Abdurrahmanit i ishte kërkuar me forcë nga vetë Organizata e Rinisë që të kërkonte për pavarësinë 2 vjet më herët se kjo datë.

Kur Delegacioni i Pavarësisë u kthye në Malajzi u prit me një ceremoni historike mirëseardhje në Shtetin e Malakës, ku aty vetë Tunku Abdurrahman shpalli lajmin se anglezët kishin rënë dakord për dhënien e pavarësisë për Gadishullin e Malajzisë në vitin 1959, por ai shprehu edhe kërkesën nga Organizata e Rinisë se në qoftë se ishte e mundur pavarësia të shpallej në vitin 1957. Dhe me gjithë përpjekjet e bëra më së fundi pavarësia e Federatës Malajase u shpall në vitin 1957, megjithatë kishte edhe nga ata që të organizuar në organizata të ndryshme

politike haptazi e kundërshtuan pavarësinë dhe këtë e sollën edhe në platformën për zgjedhjet e vitit 1955.

Këto dyshime apo probleme politike është shumë e vështirë të kuptohen nga gjeneratat e sotme të rritur në Malajzinë e pavarur. Por dyshimet nëse Federata Malajase do të mund të ekzistonte dhe a do të kishte një stabilitet pas shpalljes së pavarësisë vazhduan të qarkullonin. Shkaqet e këtyre dyshimeve ishin edhe zhvillimet politike në Gadishull pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, si dhe situata ekonomike dhe ajo raciale që mbizotëronte në atë kohë.

Vetë historia e kolonializimit anglez në Malajzi karakterizohet nga një shfrytëzim që i është bërë këtij vendi. Shumë punëtorë hamallë u sollën nga India dhe Kina për të punuar në çifliqet, fermat dhe minierat. Këto politika apo reforma të ndjekura për një emigracion të hapur, tërhoqën shumë të huaj të emigronin në Malajzi dhe kjo në ato shifra saqë për një kohë emigrantët e tejkaluan numrin e vetë malajasve. Kur Japonia e pushtoi Gadishullin Malajas në vitin 1942, popullsia e këtij vendi ishin të ndarë në tre grupe kryesore, malajtë, kinezët dhe indianët. Midis të tre komuniteteve jo vetëm që nuk kishte unitet, por lidhjet dhe kontaktet ndërmjet tyre ishin shumë të varfra dhe për gjënë më të vogël ata mund të bëheshin dhe armiq të njëri-tjetrit. Dhe me pushtimin japonez, diferenca dhe largimi i komuniteteve nga njëri tjetri u thellua akoma më shumë.

Fitorja mbi japonezët dhe vonesa e ardhjes së trupave angleze për të marrë në dorë pushtetin mbi Shtetet Malajase, u dha një mundësi veprimi guerilasve komunistë, të cilët ishin pothuajse 100 % kinezë, për të kryer akte barbarizmi mbi popullsinë e të gjitha komuniteteve. Si rezultat i këtyre barbarizmave malajasit filluan t'i urrenin kinezët dhe si rezultat i kësaj urrejtjeje ndaj racës së

tyre kinezët filluan të urrenin malajasit dhe kjo armiqësi midis këtyre dy komuniteteve shumë herë përfundoi edhe me incidente të ndryshme. Kurse komuniteti indian, e kishte vëmendjen më shumë të tërhequr në përpjekjet për arritjen e pavarësisë në Indi, kështu që ata jo vetëm ishin mjaft të tërhequr nga incidentet e konfliktet, por qëndruan edhe jashtë lëvizjeve politike që ndodhën në gadishullin malajas, sikur të mos ishin fare në këtë vend. Në këtë situatë, anglezët erdhën me një propozim, për t'i trajtuar të gjithë komunitetet nën një status, e quajten koloninë Bashkimi Malajas, e cila ishte krijuar i Whitehall nga Londra, por që nuk ishte aspak një zgjidhje e mirë se kjo thelloi më shumë ndarjen raciale dhe rriti më shumë tensionin në gadishull. Dhe kushtet u keqësuan edhe më shumë kur komunistët, që siç e theksuam edhe më lart ishin të gjithë kinezë, morën një ofensivë në shkallë të gjerë në vitin 1948, për të marrë pushtetin nga anglezët.

Në mes të gjithë këtij tensioni të ngritur dhe duke qenë nën "Gjendjen e jashtëzakonshme", Shteteve Malaje u duhej të rimëkëmbnin shërbimet dhe lehtësimet publike, të cilat ishin dëmtuar pothuajse komplet gjatë pushtimit dhjetëvjeçar japonez dhe siamez. Numri i zyrtarëve anglezë u rrit në një shkallë shumë herë më të madhe se numri i atyre që ishin para luftës, dhe si rezultat çështjet e rëndësishme administrative ishin pothuajse të gjitha në duart e zyrtarëve të huaj. Zyrtarët lokalë nuk kishin asnjë mundësi për t'u trajnuar dhe për të treguar aftësitë e tyre.

Pra ishte shumë e qartë se kushtet në Shtetet Malaje pas lufte ishin në një gjendje të mjerueshme, jo të stabilizuar dhe kërcënoheshin nga shumë probleme. Kur kërkesat për pavarësi u shtruan para kolonizatorëve anglez, këto probleme ishin shumë serioze. Megjithëse proble-

met ishin të lidhura njëra me tjetrën, ato mund t'i ndajmë në katër kategori.

Një, ndjenjat bashkësinore ishin shumë të forta dhe lidhjet midis komuniteteve ishin në një tension ekstrem.

Dy, guerilasit komunistë ishin akoma aktivë, dhe lufta kundër tyre kërkonte jo vetëm një udhëheqje të fortë dhe të zonjën, por ishte e shtrenjtë edhe nga ana monetare edhe pse anglezët ishin akoma vërdallë dhe ofronin ndihmën e tyre. Në zonat pak më larg qyteteve, quheshin si “zona të zeza” pasi lëvizjet ishin shumë të vështira dhe jetesa ishte shumë e kufizuar.

Tre, ekonomia e vendit ishte shumë e varfër dhe e dobët dhe shumë e vështirë për t'u rimëkëmbur për shkak të kushteve të liga politike që ndodhej vendi. Industria e manufakturave pothuajse nuk ekzistonte fare, industritë tradicionale si ajo e hekurit dhe e kauçukut nuk ishin komplet të rehabilituara. Industritë e eksport-importit dhe forma të tjera të tregtisë, sapo kishin filluar të zhvilloheshin në vend dhe ato akoma nuk ishin në gjendje ti siguronin qeverisë të ardhura nga taksat.

Dhe së fundi, stafi i qeverisë lokale ishin shumë i vogël në numër dhe nuk kishte asnjë mundësi për të pasur poste të rëndësishme në qeveri, të cilat mbaheshin nga zyrtarët anglezë, të cilët kishin përgjegjësi vetëm për qeverinë e kolonisë dhe aspak për popullin. Por nga ana tjetër, në qoftë se zyrtarët anglezë do ta linin vendin, qeveria do të paralizohej dhe nuk do të ishte në gjendje të funksiononte.

Pra me gjithë këto probleme të mëdha, besimi në arritjen e pavarësisë ishte një shpresë shumë e vogël nga të gjitha grupet dhe shtresat përveç grupit të Rinisë së UMNO-s. Zyrtarët dhe biznesmenët anglezë, së bashku me një numër të madh njerëzish të vetë Gadishullit besonin se Federata Malaje do të shihte ditë të zeza ose

nuk do të kishte mundur të ekzistonte në qoftë se ajo do të fitonte pavarësinë. Në veçanti ata prisnin një luftë midis vetë komuniteteve etnike që si rezultat do të sillte ndërprerjen e të gjitha aktiviteteve industriale dhe të biznesit. Dhe me këtë gjendje rrënuje e trazirash, makina qeveritare nën udhëheqjen e zyrtarëve lokalë dhe në veçanti zyrtarëve malajë, do të ishte shumë e dobët dhe e korruptuar, kështu që kjo qeveri nuk do të kishte atë aftësi dhe dinjitet, ashtu sikurse Qeveria Kolonizatore Angleze në kohën e saj.

Shpresat dhe pritjet se Federata Malaje e pavarur do të shkatërrohej menjëherë nuk ishin të bazuara aspak në imagjinatën e njerëzve, pasi kishte plot shembuj të vendeve të tjera, të cilat kishin dalë nga kolonializmi perëndimor me situatë kritike si kjo. Qeveritë e këtyre vendeve të reja të pavarura ose nuk ishin të afta të vepronin për një kohë të gjatë ose ato ktheheshin në qeveri diktatoriale ose tiranike. Rënia e ekonomisë dhe gjendja e mjeruar e popullit ishin më keq se në kohën e kolonializimit. Por megjithatë kjo do të ndodhte edhe sikur Federata Malaje të mos kishte të bënte me problemet që u përmendën më lart në kohën e kërkimit të pavarësisë.

Dhe sikur të katër problemet që përmendëm mos të ishin boll për qeverinë e re, anglezët vendosën si kusht që dhënia e pavarësisë do të bëhej e mundur vetëm kur qeveria e re të zbatonte një sistem demokratik në vend.

Demokracia nuk ishte shumë e njohur si sistem qeveritar në regjion në atë kohë, dhe udhëheqësit e ardhshëm të Federatës Malaje të pavarur nuk kishin aspak eksperiencë në ndërlikimet e saj. Qeveria Angleze Malaje nuk kishte qenë as vetë demokratike të paktën të shërbente si një model për liderët e rinj. Pra tani kjo qeveri që duhej të merrte në konsideratë pikëpamjet e të gjithë popullit nuk mund të qeveriste si një qeveri autoritare,

ashtu siç kishte bërë qeveria në kohën e anglezëve. Megjithatë kushti ishte vendosur për këtë qeveri, një demokraci e plotë, ashtu siç praktikohej nga vendet evropiane të cilat kishin qenë të pavarura prej shekujsh dhe kjo u shkrua edhe në Kushtetutën e re të Federatës Malaje.

Përveç shqetësimit me këto probleme, Federata Malaje e arriti fitoren e pavarësisë pa vuajtur asnjë nga konsekuencat e tmerrshme që ishin parashikuar për të. Përplasjet raciale u zhdukën, gjithashtu ofensivat e guerillasve komunistë u dobësuan dhe pas tre viteve të pavarësisë u asgjësuan komplet. Fitorja mbi komunistët ishte një arritje e jashtëzakonshme për qeverinë e re. Në Vietnam dhe në shumë vende të tjera asgjësimi i komunistëve nuk mundi të arrihej për një kohë të gjatë edhe me ndihmën e dhënë nga Amerika dhe fuqitë e tjera.

Natyrisht, suksesi dhe fitorja mbi komunistët nuk u arrit vetëm nga ndihma angleze, por kjo fitore i kishte rrënjët në aftësinë e qeverisë së pavarur të vet Federatës Malaje dhe bashkëpunimit dhe përkrahjes nga shumica tjetër e popullit.

Pas mbarimit të Gjendjes së Jashtëzakonshme, qeveria e fokusoi të tërë vëmendjen në zhvillimin e vendit në sensin më të gjerë botëror. Në periferitë dhe në zonat e thella për herë të parë iu kushtua vëmendje përmirësimit të shërbimeve dhe lehtësimeve publike si rrugëve, shkollave, spitaleve, furnizimit me ujë dhe me energjinë elektrike. Nëpër qytete, tregtia dhe industrinë filluan të inkurajoheshin nëpërmjet iniciativave të ndryshme të marra nga qeveria, ku për shembull në shumë raste qeveria vendoste kapitalin e vet në disa prej tregtive dhe industrive të reja të hapura. Si rrjedhojë shumë fabrika dhe industri u hapën si kërpuhat pas shiut dhe kjo bëri që ekonomia të rritej me hapa shumë të shpejtë. Malajve që më përpara nuk kishin zotëruar as edhe një kiosk të

vogël për të bërë pak tregti, tani qeveria ju dha mundësinë me ndihma të shumta të zhvilloheshin dhe të arrinin suksese. Pra ata që patën suksese nga kjo ndihmë e dhënë jo vetëm që arritën diçka për vete, por zgjuan edhe smirën tek malajët e tjerë për të hyrë në këto biznese dhe për të arritur diçka edhe ata vetë.

Por megjithatë arritja që vlerësohet më shumë është administrimi i vendit nga vetë zyrtarët lokalë nën sistemin kompleks demokratik. Shumë larg nga përmbysja, ashtu siç u predikua në fillim për këtë qeveri, makineria qeveritare jo vetëm që u forcua, por u sofistikua akoma më shumë pas dhënies fund të shërbimeve nga qeveria angleze.

Pra të gjitha këto duhet të regjistrohen, por megjithatë kujtesa dhe memoria njerëzore janë shumë të dobëta dhe ky vend tani që i pavarur për afro pesë dekada. Në këto pesë dekada, shumë nga ata që tani janë të mosshuar dhe të vjetër kanë qenë shumë të vegjël të kujtojnë gjendjen që ishte përreth tyre para fitores së pavarësisë. Ata nuk e kanë shijuar as jetën e hidhur dhe shumë të vështirë si njerëz të kolonializuar, pa dyshim që nuk ishin edhe nga ai brez që patën dyshimet për fitoren e pavarësisë dhe mbijetesën e vetë qeverisë. Për ata, kolonializimi nga vendet e tjera nuk do të thotë ndonjë gjë, dhe për ta është shumë vështirë të bëjnë edhe krahasimin midis qeverisjes nga njerëzit e tyre dhe qeverisjes nga të huajt. Ata mundet të krahasojnë vetëm kushtet që ekzistojnë sot dhe dëshirat e zemrave të tyre, dhe meqenëse dëshirat e zemrës së njeriut nuk mund të përmbushen asnjëherë, ata do të kenë gjithmonë probleme në këtë pikë.

Dhe ky problem do t'i bëjë gjithmonë gjeneratat të jenë në lëvizje dhe të kenë keqkuptime dhe përplasje opinionesh dhe sa më i madh të jetë keqkuptimi, aq më i fortë bëhet edhe konflikti midis dy gjeneratave. Ky kon-

flikt apo konfrontim, që vjen si rezultat i keqkuptimit patjetër që do të sjellë më shumë probleme se të mira në shoqëri. Megjithatë përgjegjësia bie mbi gjeneratën e vjetër, të cilët duhet t'i stërvitin dhe t'u japin formë gjeneratave të reja, të cilat do të marrin stafetën prej të vjetërve një ditë. Kurse gjeneratat e reja i shikojnë përpjekjet e gjeneratave të vjetra si një shtypje për ta dhe ata mundohen gjithmonë "t'i luftojnë" këto gjenerata të cilat për opinionin e tyre kanë mbetur jashtë kohe.

Nën udhëheqjen lokale, e cila përbëhet nga shumica e malajasve, Shtetet Malaje të Gadishullit dhe ato të Sabahut dhe të Sarawakut (që janë pjesa Perëndimore e Malajzisë) kanë arritur një sukses dhe një progres që i ka kaluar edhe parashikimet e bëra. Sot, opinioni i gjerë në vend dhe ai mbarëbotëror, është se Malajzia ka potencialin dhe kapacitetin për të qëndruar progresive dhe e fortë në qoftë se vazhdon ta mbajë stabilitetin e arritur. Por çështja qëndron nëse çarja midis gjeneratave të reja dhe të vjetra do t'i dobësojë Shtetet Malaje të Gadishullit? A do të munden pikëpamjet e majta dhe të djathta midis gjeneratave të shkatërrojnë organizimin që për kaq kohë ka patur sukses në ruajtjen e pavarësisë, integritetit dhe stabilitetit në Malajzi? Me fjalë të tjera: Për ku është duke shkuar Malajzia sot?

Megjithëse problemet e përmendura më lart nuk e dobësuan dhe as nuk patën ndonjë efekt në sukseset e Malajzisë se pavarur, këto probleme akoma nuk janë zhdukur plotësisht, pra të gjithë faktorët, të cilët kërcënojnë Malajzinë akoma ekzistojnë. Megjithatë efektet e tyre janë mbajtur nën kontroll të përhershëm dhe ato nuk kanë mundur të pengojnë progresin, por të jemi gjithmonë vigjilentë se ato ekzistojnë.

Komunalizmi është ende një kërcënim për paqen e vendit, një akt i pamenduar mirë nga një komunitet

mund të provokojë prishje dhe trazira publike. Qeveria duhet të jetë shumë e kujdesshme në aktet e marra prej saj për të kontrolluar implikimet midis komuniteteve. Në qoftë se kontrolli është shumë i shtrënguar ose shumë i lirë, problemet midis komuniteteve mund hapen. Pra është e qartë se nevojitet një modernizim, po pyetja del çfarë do të konsideronim vallë modernizim? Pasi modernizmi nga ana e qeverisë për një komunitet do të konsiderohej si shumë ekstrem nga vetë ky komunitet dhe shumë i lirë nga komuniteti tjetër.

Mos të harrojmë gjithashtu se aktivitetet komuniste akoma janë një kërcënim i gjallë për vendin. Në qoftë se një herë e një kohë Malajzia përdori edhe ndihmën angleze në shtypjen e lëvizjes komuniste, sot jo vetëm që nuk mund ta gjejë këtë ndihmë, por edhe mbrojtja nga ana e malajzianëve nuk do të jetë në atë shkallë si më parë. Dhe mos të përjashtojmë faktin se guerilasit komunistë nuk janë më ata guerilasit e parë të pashkolluar, sot ata janë të gjithë të arsimuar. Ata mund t'i planifikojnë lëvizjet e tyre në mënyrë sistematike, mund të bëjnë vetë armatimin e tyre, duke përdorur edhe armatimin modern duke përdorur rrugë dhe mënyra, të cilat mund të mos diktohen nga shtresat e tjera të shoqërisë. Kapacitetit dhe aftësisë së qeverisë në shkatërrimin e përpjekjeve dhe skemave të guerilasve komunistë sot i jepet një rëndësi më e madhe se më parë, por lind pyetja nëse kjo aftësi dhe kapacitet që ekziston mund të veprojnë më shpejt dhe në mënyrë më efektive për të mundur taktikat komuniste?

Në ekonomi, problemet janë rritur në numër dhe në kompleksitetin e tyre. Numri i nxënësve që braktisin shkollat dhe kërkojnë punë rritet me ritme të shpejta nga viti në vit, por që të përballohet kjo situatë tregtia dhe industria duhet gjithashtu të lëvizin me hapa të shpejta. Mirëpo tregtia dhe industria duhet të kontrollohen, ato

duhet të shkojnë sipas reformave të zhvillimit ekonomik të balancuar midis komuniteteve dhe duke pasur gjithmonë parasysh të mos lejohet monopolizimi nga të huajt i shpërndarjeve industriale. Gjithashtu veprimet e sindikatave të bashkuara duhet të kontrollohen në mënyrë që të qetësojnë gjendjen rreth investimeve të reja. Në qoftë se një herë e një kohë çështjet ekonomike kufizoheshin vetëm me rehabilitimin e industrive të hekurit dhe kauçikut, sot sektorë të tjerë të ndryshëm janë të përfshirë në mënyrë direkte apo indirekte. Midis nevojës për të shpërndarë aktivitetet ekonomike për të rritur mundësitë e punësimit dhe të ardhurave të vendit në një anë dhe arritja e reformave të reja ekonomike në anën tjetër, ka bërë që administrimi i ekonomisë së vendit të bëhet më i vështirë dhe më kompleks se në vetë vendet e tjera të zhvilluara. Dhe është e padiskutueshme që Malajzia asnjëherë nuk mund të mënjanojë konkurrimin me këto vende të avancuara.

Megjithëse problemet e përmendura më sipër janë rritur dhe janë bërë më komplekse dhe intriguese, kërkohet një administrim më i aftë dhe më eficient, kështu që edhe numri i personelit apo stafit administrativ duhet të rritet. Trupave gjysmë-qeveritare, të cilët janë ngritur për implementimet e politikave dhe reformave politike dhe ekonomike duhet t'u jepet më shumë liri veprimi dhe t'u jepen edhe role të tjera shtesë edhe pse ato nuk kanë pasur mundësinë t'i kryejnë më parë. Në qoftë se më parë administrata ishte e izoluar në veprimet e saj larg njerëzve, sot administratorëve u kërkohet të jenë më të lidhur me popullin, të konsiderojnë dëshirat e tyre dhe të pranojnë kritikën nga të gjitha anët që vijnë.

Është e qartë se problemet dhe kompleksitetet e ballafaquara sot nga Malajzia, janë rritur dhe shumëfishuar në numër në krahasim me ato të ballafaquara në vitet e

para paspavarësisë. Në pjesë të ndryshme të botës, vendet që kanë fituar pavarësinë në të njëjtën kohë me Malajzinë, janë thyer ose e kanë ndryshuar karakterin e tyre qeveritar. Shumë prej tyre janë ndarë në shtete më të vogla, të tjerat kanë humbur njësinë e tyre kombëtare, ndërsa shumë të tjera janë bërë kukulla të fuqive të huaja. Pothuajse të gjitha këto shtete të reja kanë hedhur poshtë ose kanë pushuar së praktikuari format e demokracisë që ata trashëguan dhe zgjodhën me fitoren e pavarësisë.

Do të ndjekë vallë edhe Malajzia këtë model? Do të mundet qeveria demokratike t'i përballojë të gjitha problemet e përmendura më lart apo do të zëvendësohet ajo me një diktaturë? Apo gradualisht Malajzia do të paralizohet dhe më së fundi të shpërbëhet si shtet pasi nuk mundi t'i zgjidhë dot këto probleme? Apo kuptimi i gjithë kësaj kauze do të shërbejë për malajzianët dhe liderët e tyre që të punojnë krah për krah për të ruajtur integritetin dhe sovranitetin e Malajzisë dhe karakteristikat që për kaq kohë e kanë bërë këtë vend multiracial të korrë suksese dhe progres në kuptimin e plotë të fjalës.

Pra për ku është duke shkuar Malajzia???

Quo Vadis Malajzia???

Treguesi i emrave:

A

administrata shtetërore, 30
administrimi i biznesit, 144
akide, 53-4, 56, 63-6, 68, 70, 75
aktet kriminale, 213
aktivitetet materiale, 43-4
Allahu, 45, 54-6, 67-9, 113, 124-5, 138, 141, 143, 151, 154, 187, 191-2, 201
anarkia, 104-5, 173, 211, 213-4, 245-7
anatomia, 68
animizmi, 53
aristokracia, 129
arti, 44, 55, 59, 78
artet marciale, 44
ateist, 134, 155

B

bakshish, 254-5, 258
Bakuni, 245

barazia e gjinive, 130
berberët, 55
besimi fetar, 41, 57, 63, 125, 170, 190
betejën e Uhudit, 243
borgjezët, 129
borgjezëve, 117
botën komerciale, 100
botës njerëzore, 44
burokratët, 93

C

civilizimi islam, 58-9
civilizimi modern, 58
Commonwealth, 151

D

dekadencia morale, 21, 114, 198
demokracia angleze, 118
demokracia parlamentare, 118
depresioni, 134, 259
dija, 65
diktatura e proletariatit, 201

disiplina perëndimore,
238

E

edukim i perëndimit, 53

edukimi, 56, 57, 62

edukimit fetar, 64

ekualizimin, 31

el-Biruni, 59

evolucioni i vlerave, 182

evropianët, 55, 58, 61

F

fakte fetare, 152

familja muslimane, 132

feja kristiane, 57

fetva, 146

feudalizmi, 59

filozofët, 53, 116, 126, 148

filozofia materialiste, 122

fitrat, 45, 71

fiziologjia, 68

forcat aziatike, 233, 237

forcat perëndimore, 233-7

fushata elektorale, 271

G

Gandi, 238

Gazaliu, 65-6

grupe presioni, 207, 209

guerilasit komunistë, 151,
278, 280, 282, 285

Gj

gjenerata moderne, 140

gjenocidi, 43

Gjermania Perëndimore,
242

gjuha kombëtare, 84-5

H

Hang Tua, 22

Hinduizmi, 53

historia islame, 45, 52, 190

historia moderne, 69

I

Ibën Rushdi, 59, 61, 68

Ibën Halduni, 59

idealist, 156

identiteti, 11, 84, 87, 108,
109, 197

ideologjia, 27-9, 32, 40-1,
92, 113, 115-6, 126,
129, 133, 135, 147, 151-
3, 155, 197, 201, 221,
223-4, 260

ideologjia materialiste, 28,
135

ideologjia socialiste, 29

imoraliti, 181

imperialisti, 233

imperializmi ekonomik,
98

Indonezia, 84, 152, 209

industria e naftës, 143-4

industria moderne, 98

industria e shtetëzuar, 119

industria tradicionale, 280

inflacioni, 37, 98-9, 144,
199
intelektualët, 116, 119
intelektualët socialistë,
117-8
interesi kombëtar, 228
Islami, 13, 16, 29, 43, 51,
53-6, 58-60, 62-3, 65-8,
72-6, 107, 120, 124-6,
133-4, 138, 140-1, 145,
147, 148, 152, 154-7,
159, 170, 175, 188, 190,
192, 194, 197, 201, 203,
213, 242, 252

J

jeta familjare, 43
Jugosllavia, 247

K

kapitalistët borgjezë, 119-
20
kapitalizmi, 113
kapitalizmi modern, 114
Karteri, 273
klasat, 132
klasa punëtore, 30, 121
kode të etikës, 253
kolonializimi britanik, 84,
86
kolonializimi ekonomik,
69
kompania, 30, 218, 220,
228, 239

komunalizmi, 284
komuniteti musliman, 66
komuniteti malajzian,
15-6, 184
komunizmi, 28, 113, 115,
117, 122, 201
konflikti, 28-9, 57, 62, 67,
109, 116, 127, 133, 135,
138, 140, 156, 183, 189,
193, 201, 279, 283
korrupsioni, 114, 210,
253-4, 256-63, 265-74
krishterizmi, 191
Kropotkini, 245
Kuala Lumpuri, 211
kultura, 53, 58, 92
kultura e zezakëve, 130

L

lëvizja punëtore, 246
lëvizjet studentore, 158
ligji i ekzekutimit, 245
ligji i turmës, 245
lobe, 207
lobim, 207
logjika materialiste, 27
lufta civile, 126
lufta, 12, 55, 58, 69, 99,
143, 158, 208, 241, 243,
279
Luji i XVI, 126

M

makina administrative, 41

Marie Antoinette, 126
MAS, 226, 229
masmedia, 106
matematicienët islamik, 54
mënyra e jetesës, 42
mësimet islame, 66, 120
misionarët kristianë, 64
modus operandi, 207
monarkia kushtetuese, 104
Muzaffer Shahu, 141

N

nafta, 99, 144, 147, 200,
223, 226, 227
nepotizmi, 261
Nixoni, 273
nouveau riche, 144

O

opozita, 107, 158-9, 165
organizimi efektiv, 238
oshënarë, 191

P

paragjykime, 45
Partia e Punës, 218, 220
Partia Laburiste, 218
Partia e Kongresit, 238
Perëndimi, 27-8, 55, 57-8,
60-2, 64, 67, 77, 82, 91,
92-109, 115, 117, 120,
130, 132, 164-6, 167,
169-70, 172, 182, 201,
237, 238

perëndimi i egër, 244
periudha Meiji, 108
Përplasjet raciale, 282
pikëpamja islame., 29
politika, 11-2, 55, 80, 92,
103, 105-6, 113, 130,
208-9, 225, 238-9, 266,
278
popullata civile, 213
principet socialiste, 218,
223-4
procedura ligjore, 154
Proudhon, 245
psikika malajziane, 53, 57
psikologjia komuniste, 28
psikologjia perëndimore,
27, 95
pushteti diktatorial, 224

Q

qeveria demokratike, 105,
106

R

revolucioni industrial, 114
Rilindja, 58, 61

Rr

rregullat fetare, 243
rregullat sociale, 152, 156

S

sindikata e tregtisë, 100
sindikatat punëtore, 105

- sistemi politik, 29, 104, 127, 208
- sistemi demokratik, 104
- sistemet feudale, 58
- sistemi binar, 60
- sistemi i vlerave, 9, 22, 27, 45, 173-6, 182-4, 252, 269, 273
- sistemi monarkist, 104
- sistemi numerik arab, 60
- sistemit shkollor, 56
- skllavëria, 41, 176-80
- socialistët, 28, 41-2, 121, 128-9, 156
- socialistët anglezë, 128
- socializmi, 16, 29, 32-3, 41, 113, 115-6, 120-2, 126, 147, 157, 201, 224, 227, 230, 246
- solidariteti islam, 156
- spiritualiti, 15, 28, 32, 136
- studentët, 61, 65, 72, 79, 86, 158, 167, 208-9, 211
- studimi akademik, 44
- sufizmi, 192
- Sukarno, 209
- sundimi absolut, 42
- Sh**
- shekullarizmi, 13, 15, 53
- shenjtori, 43
- shërbimet publike, 31, 263
- shërbimet sociale, 259
- shkencat shoqërore, 78, 79
- shkollat fetare, 63, 65, 201
- shoqëria materialiste, 27, 32, 41, 120
- shoqëria muslimane, 76, 124, 126, 132, 148, 154-5, 193
- shoqëria arabe, 176
- shoqëria malajziane, 19-20, 54-5, 79, 83, 169-70, 172, 183
- shoqëria amerikane, 164
- shoqëria moderne, 34, 81
- shoqëria socialiste, 29-32, 66, 72, 75, 119, 246
- Shqipëria, 10, 152, 159
- shteti policor, 174
- shtetëzimi, 29, 119, 122, 217-8, 220-1, 223-5, 227-30
- T**
- teknologjia, 55, 69, 117, 142-3
- teknologjia moderne, 117, 142
- Teoria anarkiste, 246
- terrorizma, 246
- Thanom Kititikachorn, 210
- tradita sociale, 179
- tregtia private, 222
- trupat ekzekutiv, 228
- trupat misionare, 56
- Tunku Abdurrahman, 277

TV, 202, 225

U

ulema, 21

UMNO, 239, 277, 280

ushtrime intelektuale, 20

V

varfëria, 33-4, 38, 40-1,
46, 123, 133, 139, 190,
197, 230

Vasko de Gama, 233

vëllazërimi islam, 157

vetëdisiplina, 93

vlera ekonomike, 77

vlera fetare, 146

vlera shpirtërore, 189,
191-2, 197-204

vlera sociale, 168

vlera spirituale, 27, 42-4,
53, 77, 124, 134-8, 142,
145, 148

Xh

xhahilijeti, 58, 242, 251

Z

zekati, 45-6, 71

W

Wehrmacht, 241

Dr. Mahathir Mohamad, njëra ndër figurat më të qëndrueshme dhe më të përfolura të skenës politike botërore, nga 16 korriku i vitit 1981 ka qenë kryeministër i Malajzisë. Për herë të parë bie në sy më 1969 kur, për shkak të një letre kritike që ia shkroi kryeministrit të asaj kohe Tunku Abdurrahman, u përjashtua nga partia në pushtet, UMNO. Para se të ripranohet në UMNO, në vitin 1972, ai e shkroi veprën e tij mjaft kontroverze *Dilema Malaje* që ekzaminon prapambetjen ekonomike të Malajzisë dhe mbron ndërhyrjen shtetërore për rimëkëmbjen e saj. Libri në fjalë atëbotë qe ndaluar. Në veprën e radhës, *Sfida* (1986), ai flet për shtrembërimet e fesë, devijimet në fushën e arsimit, flet për demokracinë, komunizmin, trajton çështjen e lirisë dhe disiplinës, si dhe pikëpamjet për këtë botë dhe tjetrën. Në veprën *Një marrëveshje për Azinë* (1999), Dr. M. Mohamad flet për luftën e Malajzisë për pavarësi dhe i gjykon ata që verbërisht e adhurojnë tregun e lirë.

Si kryeministër i katërt i Malajzisë, Dr. Mahathir Mohamad ka luajtur një rol të rëndësishëm në marshin bindës të popullit të tij drejt *Vizionit 2020*, drejt planit skematik për një Malajzie plotësisht të zhvilluar. I lindur më 20 dhjetor 1925, ai ka studiuar mjekësinë në Singapur ku është njoftuar me gruan e tij të ardhshme Hasmah Mohd Ali. Pasi një kohë punoi si mjek në shërbimin qeveritar, hapi ordinancë private në qytetin e lindjes Alor Setar. Në vitin 1974 hoqi dorë edhe nga kjo punë që t'i kushtohet vetëm karrierës politike. Është baba i shtatë fëmijëve.

Mahathir Mohamad
SFIDA

Boton: Logos-A

Biblioteka: Lexo

Për botuesin: Adnan Ismaili

Kryeredaktor: Husamedin Abazi

Redaktor biblioteke: Dr. Ali Pajaziti

Redaktor artistik: Edi Agagjyshi

Redaktor teknik: Afrim Gashi

Mbikëqyrës i shtypit: Imer Gogjufi

Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup

Shtypi: Focus -Shkup

Copyright©Logos-A, 2006

**Shënimi i CIP katalogut i këtij libri gjendet
në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare
ISBN: 9989-58-179-7**

www.logos-a.com.mk





Dr. Mahathir Mohamad, njëra ndër figurat më të qëndrueshme dhe më të përfolura të skenës politike botërore, nga 16 korriku i vitit 1981 ka qenë kryeministër i Malajzisë. Për herë të parë në sy më 1969 kur, për shkak të një letre kritike që ia shkroi kryeministrit të asaj kohe Tunku Abdurrahman, u përjashtua nga partia në pushtet, UMNO. Para se të ripranohet në UMNO, në vitin 1972, ai e shkroi veprën e tij mjaft kontroverze *Dilema Malaje* që ekzaminon prapambetjen ekonomike të Malajzisë dhe mbron ndërhyrjen shtetërore për rimëkëmbjen e saj. Libri në fjalë atëbotë qe ndaluar. Në veprën e radhës, *Sfidat* (1986), ai flet për shtrembërimet e fesë, devijimet në fushën e arsimit, flet për demokracinë, komunizmin, trajton çështjen e lirisë dhe disiplinës, si dhe pikëpamjet për këtë botë dhe tjetrën. Në veprën *Një marrëveshje për Azinë* (1999), Dr. M. Mohamad flet për luftën e Malajzisë për pavarësi dhe i gjykon ata që verbërisht e adhurojnë tregun e lirë.

Si kryeministër i katërt i Malajzisë, Dr. Mahathir Mohamad ka luajtur një rol të rëndësishëm në marshin bindës të popullit të tij drejt *Vizionit 2020*, drejt planit skematik për një Malajzie plotësisht të zhvilluar. I lindur më 20 dhjetor 1925, ai ka studiuar mjekësinë në Singapur ku është njoftuar me gruan e tij të ardhshme Hasmah Mohd Ali. Pasi një kohë punoi si mjek në shërbimin qeveritar, hapi ordinancë private në qytetin e lindjes Alor Setar. Në vitin 1974 hoqi dorë edhe nga kjo punë që t'i kushtohet vetëm karrierës politike. Është baba i shtatë fëmijëve.

ISBN 998958179-7



9 789989 581793